



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

DISERTACION

PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE:

"DOKTOR I SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE"

TEMA:

**VËSHTRIM MBI GJUHËN E SOTME TË POLITIKËS
(FUNKSIONE DHE VEÇANTI LEKSIKO-GRAMATIKORE)**

KANDIDATI

Msc. Lediona LUMI

UDHËHEQËSI SHKENCOR

Prof.dr. Abdulla BALLHYSA

ELBASAN, 2021

DOKTORATURË

Përgatitur nga: Lediona Lumi

Për marrjen e gradës shkencore “DOKTOR”

Specialiteti : Gjuhësi

**VËSHTRIM MBI GJUHËN E SOTME TË POLITIKËS
(FUNKSIONE DHE VEÇANTI LEKSIKO-GRAMATIKORE)**

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Abdulla BALLHYSA

Mbrohet më, përpara komisionit të vlerësimit:

1. _____ (kryetar)
2. _____ (oponent i tezës)
3. _____ (oponent i tezës)
4. _____ (anëtar)
5. _____ (anëtar)

Mirënjohje

Kur e propozuam bashkarisht si temë doktore “Vështrim mbi gjuhën e sotme të politikës” me udhëheqësin shkencor Prof.dr Abdulla Ballhysa, besimi im si doktorante në proces ishte mbështetur në rezultatet dhe vlerësimet maksimale që arritëm të sigurojmë në nivel masteri shkencor, por edhe në besimin dhe bashkëpunimin e mëtejshëm me udhëheqësin.

Vizioni, strategjia dhe bashkëpunimi me udhëheqësin më ndihmuan të mësoj rreth metodologjisë shkencore të kërkimit mbi gjuhën e sotme të politikës, të ndërtoj një strukturë kërkimore që i përgjigjet kriterëve, parimeve dhe metodave bashkëkohore të një punimi në nivel doktore.

Në këtë mënyrë falenderimi dhe mirënjohja më e madhe e imja i takon udhëheqësit dhe drejtuesit shkencor, Prof. dr. Abdulla Ballhysa, falë të cilit unë sot jam e gatshme të paraqitem para Jush për të mbrojtur temën kërkimore për marrjen e gradës Doktor i Shkencave.

Falenderime dhe mirënjohje u takojnë dhe Prof. Albert Riska e Prof. Teuta Toska, si dhe departamentit të gjuhës shqipe që me sugjerimet dhe orientimet që më kanë ofruar gjatë dy prezantimeve të këtij punimi ma kanë bërë më të lehtë ngarkesën psikologjike dhe përgjegjësinë morale dhe shkencore në punën time. Besoj se ky punim do të jetë një prurje e re dhe do të pasurojë fondin e kërkimeve mbi gjuhën e sotme të politikës.

Falenderimi në fund, por jo për nga rëndësia, i takon familjes sime dhe vajzës, Sibora, për kohën dhe kushtimin që i kam mohuar.

Mirënjohje të gjithë dashamirësve,

Lediona LUMI

Abstrakt

Tema që kërkon të prekë ky punim është: **“Vështrim mbi gjuhën e sotme të politikës.(Funksionedhe veçanti leksiko-gramatikore)”**. Jemi fokusuar në disa prej tipareve më thelbësore të saj, disa prej funksioneve të saj më kryesore, dhe një vështrim më i gjerë i vlerave reale, të prekshme, i zhvillimeve të reja e më të fundit semantike të leksikut politik. Fillimisht punimi synon të paraqesë disa përkufizime teorike mbi konceptin e leksikut politik në gjuhësinë e huaj dhe atë shqiptare, kryesisht bazuar në literaturën gjermane, amerikane e atë shqiptare,si: Orwell, Lucas apo Samara, Duro, Kostallari, Lloshi, Thomai ,etj. Një pasqyrë të gjerë i jepet figurës kryesore gjuhësore që vepron në politikë, metaforës e gjithashtu “*contradicto in adiecto -s*”, si një mjet gjuhësor me vlerën e një mikroteksti, pra një kontradiktë së pari formale in terminis, kur shprehen njëkohësisht e për të njëjtën gjë dy koncepte e dy gjykime e që përjashtojnë njëri-tjetrin ,e cila shfrytëzohet jashtëzakonisht nga politikanët.Synohet në punim të zbulohet funksioni real dhe ai i aparencës që përshkon fjalimet e parrullat e politikës, ndryshe të njohur si elementin e papërcaktueshmërisë së tyre. Në këtë punim jemi përpjekur të shtrojmë si problem nevojën e një konceptimi shkencor e sa më të drejtë të leksikut politik. Duhet vlerësuar drejt edhe rolin e mjeshtërive të fjalës shqipe (ku përfshihen politikanë, shkrimtarë, gjuhëtarë, oratorë, burra shteti, gazetarë, analistë, etj) të cilët me veprat dhe shkrimet e tyre, e kanë lëvruar dhe e kanë pasuruar leksikun politik. Meritë të veçantë kanë ata në përpunimin semantik të përmbajtjes dhe të ngjyrymeve të leksikut politik të shqipes letrare. Ata i kanë përdorur fjalët e këtij leksiku në lidhje të caktuara sintagmatike e paradigmatiche (polisemike, sinonimike e antonimike), duke ndërtuar figura të bukura me karakter shprehës-emocionues. Disa nga problemet e karakterit semasiologjik janë të trajtuara në këtë punim, si p.sh prejardhja (derivacioni) e kuptimeve dhe e ngjyrymeve të reja në kohën e sotme, si dhe tipat e saj, mund të trajtohen në mënyrë më të thelluar e më të veçantë në të ardhmen.

Metodologjia e punimit është mbështetur në tërsinë e koncepteve, parimeve, teorive dhe metodave bashkëkohore siç janë metodat e përqsjes, metoda e krahasimit dhe e analizës mbi bazën e gjuhësisë gjenerative.

Abstract

The topic that this paper seeks to touch on is: "A look at today's language of politics (Lexical-grammatical functions in particular)". We have focused on some of its most essential features, some of its key functions, and a broader look at the real, tangible values, new and latest semantic developments of the political lexicon. Initially, the paper aims to present some theoretical definitions on the concept of political lexicon in foreign and Albanian linguistics, mainly based on German, American and Albanian literature, such as: Orwell, Lucas or Samara, Duro, Kostallari, Lloshi, Thomai, etc. A broad overview is given to the main linguistic figure operating in politics, to the metaphor and also "contradicto in adiecto", as a linguistic tool with the value of a microtext, ie a first formal contradiction in terminis, when expressed simultaneously and for the same two concepts and two judgments that exclude each other, which is extremely used by politicians. The aim of the paper is to discover the real function and that of appearance that permeates speeches and slogans of politics, otherwise known as the element of their indeterminacy. In this paper we have tried to raise as a problem the need for a scientific and fair conception of the political lexicon. The role of the masters of the Albanian word (including politicians, writers, linguists, orators, statesmen, journalists, analysts, etc.) who with their works and writings, have delivered and enriched the political lexicon should be properly appreciated. They have special merits in the semantic elaboration of the content and nuances of the political lexicon of literary Albanian. They have used the words of this lexicon in certain syntagmatic and paradigmatic connections (polysemous, synonymous and antonymous), constructing beautiful figures with expressive-emotional character. Some of the problems of semasiological character are treated in this paper, such as the origin (derivation) of new meanings and nuances in the present time, as well as its types, can be treated in more depth and more special ways in the future.

The working methodology is based on the set of contemporary concepts, principles, theories and methods such as methods of approach, method of comparison and analysis on the basis of generative linguistics.

“Gjuha është arsenali i mendjes njerëzore dhe përmban në të njëjtën kohë trofetë e së kaluarës së saj dhe armët e triumfeve të ardhshme.”

(Samuel Taylor Coleridge)

DEKLARATË STATUTORE

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara apo të referuara.

Pasqyra e përmbajtjes

Abstrakt	4
Abstract	5
HYRJE	9
0.1 Në vend të parathënies.....	9
0.2 Përligjia e temës.....	11
0.3 Objekti i studimit	11
0.4 Çështjet që shtrohen dhe hipotezat e punimit.....	12
0.5 Rezultatet e pritshme dhe perspektiva	13
0.6 Metodologjia e punimit.....	14
0.7 Struktura e punimit	15
0.8 Literatura dhe bibliografia	20
KAPITULLI I PARË	21
1.1 Gjuha e politikës si një “lloj” i veçantë gjuhe	21
1.3 Gjuha politike mjet komunikimi e angazhimi qytetar	24
1.2 Funksionet e gjuhës politike	25
1.5 Funkzioni i mburrjes së mendimeve	26
1.6 Funkzioni i ndryshimit të mendimeve	29
KAPITULLI I DYTË.....	31
PËRBALLJA ME TË KALUARËN TRADICIONALE – TOTALITARISTE NË GJUHËN E SOTME POLITIKE	31
2.1 Gjurmë të së kaluarës që ende vegjetojnë në shqipen e politikëbërësve	31
2.2 Gjuha e drunjtë dhe forca e saj imponuese. Po gjuha e pjerrët?.....	65
KAPITULLI I TRETË	73
TRAJTIM LEKSIKOLOGJIK E LEKSIKOGRAFIK I GJUHËS POLITIKE	73
3.1 Trajtimi leksikologjik e leksikografik i gjuhës politike	73
3.1 Funkzioni propogandues i gjuhës politike	90
3.2 Parullat.....	90
3.3 Fjalori terminologjik-politik	91
3.3.1 Fjalori institucional	91
3.3.2 Fjalori i ideologjisë	92
3.3.3 Fjalori i përgjithshëm bashkëveprimor	93
3.3.4 Figurat retorike.....	93

3.3.5 Gënjeshtira si sfond njerëzor.....	94
KAPITULLI I KATERT	95
NDËRTIMI I TEKSTEVE POLITIKE.....	95
4.1 Metafora dhe tekstet metaforike	95
4.2 Aparenca dhe ligjërimi real në fjalimet e parrullat politike.Ç’fshihet pas metaforave poltike?	103
4.3 Përdorimi stilistik i “contradictio in adiecto-s” në politikë	118
4.4 Disa tipare të gjuhës së sotme politike(leksiku në veçanti).....	124
4.5 Mënyrat e fjalëformimit dhe rrugët e pasurimit gjuhësor të leksikut politik	171
4.6 Pse birësojnë fjalë të huaja politikanët?!	184
4.6.1 Huazime që s’gjenden në fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe.	187
4.6.2 Pashirrrmat ideoemocionale, shenja-shprehi që po i zhdukin shprehjet tona shqiptarçe	191
FJALOR	195
5.1 Fjalorth-tregues me fjalë e terma nga fusha e leksikut politik	195
PËRFUNDIME	243
BIBLIOGRAFI.....	249
SUMMARY	253
SHTOJCË.....	270

HYRJJE

0.1 Në vend të parathënies

“Arsyeja e ekzistencës së gjuhës së politikës është liria
dhe fusha e akumulimit të saj është veprimi.”

Hannah Arendt

Nocioni i gjuhës së politikës është mjaft i përhapur dhe tejet kompleks, meqë gjithësecili mund të ketë një kuptim dhe interpretim të vetin, dhe rrjedhimisht të ndryshëm nga të tjerët. Pikërisht shumëkuptimësia paraqet edhe problemin thelbësor në përkufizimin e gjuhës së politikës, pasi që nëse lihet si çështje e lirshme interpretimi, lehtësisht mund të shndërrohet edhe në çështje kontestimi të përhershëm. Prandaj, do të duhej të pajtohemi rreth një përkufizimi punues e të pranueshëm, me qëllim që të jetë i kuptueshëm dhe i përdorshëm më tej. Në këtë kontekst, do të përpiqemi t'i japim disa përmasa themelore e dalluese konceptit të gjuhës së politikës. Duke marrë parasysh këtë, politika si nocion në kuptimin e ngushtë merr dy trajta themelore, si veprimtari dhe sjellje në njërën anë nëpërmjet gjuhës, dhe si vendimmarrje e politikbërje në anën tjetër. Për të parafrazuar Heywood-in (2008), politika është pushtet dhe shpërndarje burimesh, por shfaqet edhe si çështje publike dhe si arti i qeverisjes. Në kuptimin përmbajtjesor, politika dhe funksionimi i saj si gjuhë komunikimi publik, si një çështje praktike rreth qeverisjes dhe administrimit të shoqërive, e ngacmon kërshërinë e njeriut qysh prej kohërave më të vjetra. Mirëpo, sot gjuha e politikës si disiplinë studiohet në mënyrë objektive, sistematike dhe shkencore. Kjo nënkupton, që në njërën anë kemi ata protagonist që merren drejtpërdrejt me politikë, duke u quajtur politikanë, dhe në rastin e dytë kemi ata që merren me politikë në trajtën shkencore, duke e studiuar atë dhe duke u munduar që ta kuptojnë dhe sqarojnë më mirë. Kategoria e parë janë zyrtarë të emëruar e të zgjedhur, përfaqësues politik apo persona që synojnë poste publike, duke ushtruar pra politikën si profesion. Ndërkaq kategoria e njerëzve që merren me politikë nga ana kërkimore shkencore dhe akademike njihen kryesisht si politologë ose shkencëtar të politikës, pra kanë thirrje profesionale, por që praktikisht nuk kanë pushtet politik. Disa studiues e përkufizojnë shkencën e gjuhës politike si përpjekje për njohuri përmes metodave përkatëse hulumtuese, si gjuha e sistemeve politike apo dhe politikat e caktuara. Ndërsa disa nga burështetasit e shquar të shekullit XIX-të, siç ishte kancelari gjerman Bismarku (Otto von Bismarck) i cili qe i

mendimit se, politika nuk është shkencë dhe si e tillë nuk mund të mësohet, por është ‘art i së mundshmes’ dhe kush nuk e zotëron këtë aftësi nuk duhet as të merret me politikë dhe gjuhën e saj (Kevenhörster 2015). Vetë termi politikë rrjedh nga fjala antike greke polis, d.m.th. qytet-shtet. Kjo lë të nënkuptohet se që nga fillimi politika merr domethënien e një organizimi shoqëror e politik përmes qeverisjes. Ndërsa Aristoteli e quan njeriun zoon politikon, pra qenie politike, që karakterizohet me organizim shoqëror brenda entiteteve politike. Në pjesën dërmuese të fjalorëve, nocioni gjuhë e politikës shpjegohet si praktikë e gjuhës së komunikimit midis njerëzve, ose art i mbrujtjes së mendimeve dhe ideve me qëllim drejtimin dhe administrimin e shteteve apo njësive të tjera politike (McLean 1996, 446). Në anën tjetër, përkufizimi i politikës nga autorë të ndryshëm merr kuptime nga më të ndryshmet, të cilët disa politikën e shohin si gjuhë e veçantë drejtimi: ‘kush, çka, kur dhe si përfiton’ sipas Harold Lasswell, apo kapacitet idesh e vizionesh i klasës shoqërore që realizon qëllimet dhe interesat e veta, e deri te ‘shpërndarje autoritative e vlerave’ sipas një mjeti të përbashkët komunikimi mbi bazën e një marrëveshje shoqërore siç është gjuha dhe që quhet gjuha e sotme politike. David Easton (Tansey 2000, 4-7).

Hapi i parë që duhet të bëhet gjatë studimit të çfarëdo disipline shkencore, e sidomos atyre të shkencave shoqërore, është të mësohet gjuha profesionale, respektivisht terminologjia përkatëse e kësaj disipline shkencore dhe fushës së studimit. Kështu, shkencë politike posedon një gjuhë mjaft domethënëse dhe komplekse, që ngërthen koncepte e nocione kuptimplota, ide e hipoteza që i drejtohen një publiku të gjerë. Së këndejmi, çdo politolog kompetent kur flet me këto terma dhe nocione është, apo së paku do të duhej të ishte i vetëdijshëm, se kujt i drejtohet dhe për çka në të vërtetë bëhet fjalë. Prandaj familjarizimi me terma profesionale nënkupton edhe konceptimin dhe përdorimin e drejtë të nocioneve, fjalëve dhe termave bazë të gjuhës politike (Goodin, Rein, Moran 2006). Kështu terminologjia e përdorur në analizimin e politikave, është mjaft specifike dhe kërkon domosdo njohjen e mirë të tyre, me qëllim që njohuritë të fitojnë një bazë të fortë. Në mënyrë që komunikimi me qarqet e caktuara profesionale dhe me publikun e gjerë të jetë i drejtë. Meqë komunikimi nuk shërben vetëm si mjet shkëmbimi informatash, por edhe si mjet krijimi të kuptimit dhe interpretimit të tyre. Në gjuhën shqipe, sikurse edhe në gjuhë tjera, nuk ekziston një term i posaçëm për politikën sikurse që është në gjuhën angleze fjala ‘policy’ e që për dallim nga fjala ‘politics’ e përshkruan më së miri atë që ne po e quajmë me këtë rast linjë veprimi, strategji, ligje, lojë dhe Gjuha e Politikës. Me këtë rast ne do e përdorim qëllimisht, në trajtën e një togu me qëllim të diferencimit nga variacionet e tjera dhe shmangies së keqkuptimeve eventuale. Përkundër vështirësive semantike shkaqet e kësaj përshtatje besoj se janë të arsyeshme. Në

përgjithësi, termi “gjuha e politikës” është i shumëkuptimshëm; pra edhe si tërësi e një gjuhe specifike, të zgjedhur e një regjistri të lartë komunikimi që shoqërohet me sjellje, qëndrime dhe veprime politike, pastaj si një ‘art i së mundshmes’, diçka si “mjeshtëri qeverisjeje”, si gjuhë retorike komunikimi, por edhe si mekanizëm vendimmarrës. Kështu, pra gjuha e politikës mund të përshkruhet e dallohet në tre aspekte thelbësore, që duke e huazuar nga termi anglosakson, mund ti veçojmë në a.funksionet e saj më kryesore, në vlera reale semantike të gjuhës dhe në leksikun politik.

0.2 Përligjia e temës

Ndryshimi i sistemit politiko-shoqëror në vitet “90 dhe vendosja e Demokracisë në Shqipëri këto 30 vjet sollën ndryshime dhe zhvillime të reja në gjuhën e politikës si një gjuhë e politikanëve që i drejtohet një publiku të udhëhequr nga idealet e lirisë dhe të pronës private. Kjo periudhë u shoqërua dhe nga një zhvillim dhe dinamikë gjuhësore dhe në fushën e terminologjisë politike, dinamikë e cila paraqet funksionet, tiparet dhe veçoritë e saj të cilat do ti bëjmë objekt studimi. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhe rruga e hapur drejt Bashkimit Europian veçanërisht gjatë këtij dhjetë veçari të fundit ka ndikimin e vet dhe në dinamikën e zhvillimit të gjuhës shqipe. Kështu procesi i integritit, po shoqërohet me forcimin e funksioneve të gjuhës së politikës si një gjuhë e superstrukturës shtetërore, gjuhë e parlamentit, gjuhë e ideologjisë dhe po shoqërohet me krijimin e shumë fjalëve e togjeve të reja në gjuhën shqipe të cilat shoqërojnë ndryshimin e realitetit politik. Nga gjuha e politikanëve shqiptarë do të arrijmë të zbulojmë atë që studiuesit e huaj e kanë quajtur e folura europiane. Kjo e folur lidhet me çdo marrëveshje, me çdo strategji kombëtare, normë a nismë që i ka dhënë jetë një dukurie gjuhësore, një termi leksikor të gjuhës së politikës. Tipare të kësaj gjuhe, funksionet e saj të ngërthyera brenda fushës së politikës do të jenë objekt dhe pjesë përbërëse e vëzhgimeve tona. Përzgjedhja e kësaj teme është frymëzyar dhe nga motoja për një shoqëri të hapur ku mendimi dhe fjala e lire është në themel të gjuhës së politikës, ku individi dhe grupi, apo lideri dhe publiku shfaqin qëndrimet, idetë apo vizionin e tyre për një të ardhme sa më emancipuese.

0.3 Objekti i studimit

Objekti kryesor i punimit është: “ Vështrim mbi gjuhën e sotme të politikës” (Funksione dhe

veçanti leksiko-gramatikore), leksiku politko-shoqëror, objekt ky i studiuar në rrafshin semantik, gramatik dhe terminologjik të gjuhës shqipe.

Në këtë studim do të vëzhgojmë prirjet dhe funksionet e tiparet kryesore të leksikut politiko-shoqëror në ligjërimin politik të gjuhës së folur dhe të shkruar shqipe, duke u përqëndruar jo vetëm te përmbajtja shkencore e termave të kësaj fushe por dhe tek ajo semantike e social kulturore.

Gjatë analizave tona, do të analizojmë funksionet dhe tiparet kryesore gjuhësore si mbrujtja e mendimeve politike, ndryshimi i mendimeve me anë të gjuhës, bashkëveprimi i terminologjisë së politikës jo vetëm në ligjërimin mediatik shqiptar por dhe atë të specialitetit. Me këtë të fundit, kemi parasysh fjalime të aktorëve të ndryshëm politikë, njoftime për shtyp të liderëve politikë dhe partive të tyre, gjuha e politikanëve në Parlamentin Shqiptar si dhe botime në shtypin dhe fushën e politikës. Këto tipare do të hulumtohen në tekste të specializuara dhe të paspecializuara. Gjuha shqipe do të shërbejë si model analizues dhe krahasues standartizues.

Në fund të këtij studimi, do të ndërtojmë një model për hartimin e një fjalori terminologjik të fushës së politikës në të cilin synojmë të përfshijmë leksikun e specializuar të kësaj fushe (termat).

Në kuadër të këtij punimi, analiza gjuhësore e fjalëve dhe e termave që përbëjnë leksikun e ligjërimin politik do të ngërthejë fjalë dhe terma të cilat qarkullojnë në hapësirën publike shqipfolëse të komunikimit politik, hapësirë e cila strukturohet në një mjedis sa juridik, ekonomik e mediatik aq dhe politik që është objekt i studimit tonë.

0.4 Çështjet që shtrohen dhe hipotezat e punimit

Së pari, ndërmarrja e këtij studimi do të na shërbejë për t'u dhënë përgjigje disa çështjeve kyçe të cilat i kemi bërë objekt studimor.

1. Çfarë funksionesh, tiparesh dhe veçantish paraqet gjuha e politikës?. Ku ndodhet shkolla shqipe e leksikologjisë, leksikografisë, terminologjisë në lidhje me arritjet e kësaj fushe në kërkimin tonë? Cilat janë prirjet e këtij leksiku në raport me gjuhën shqipe? Ku qëndrojnë veçoritë e shqipes në raportet semantike dhe bashkëvepruese të termave politike?
2. Në lidhje me të kaluarën tradicionale-totalitare -a kemi një përballje të gjuhës së sotme të politikës me gjurmë të gjuhës së kaluar totalitare? Ç'është gjuha e drunjtë dhe si funksionon sot forca imponuese e saj? A gjejmë gjurmë të një leksiku të gjuhës së drunjtë?

Si i referohen politikanët e sotëm gjuhës së drunjtë?

3. Nga këndvështrimi sasior, në një korpus të mirëpërcaktuar, cilat fjalë e terma janë më të përdorshme në literaturën e specializuar por edhe në shtyp? Cilat lloje termash zgjedhin politikanët, gazetarët apo opinionbërësit për të përballuar situata të ndryshme politike? Çfarë faktorësh ndikojnë në këtë zgjedhje? Sa ndikojnë elementet social-kulturore dhe veçanërisht ideologjia në krijimin, rrënjësimin apo shuarjen e neologjizmave? Ç'po ndodh me huazimet në shqipe, janë ato një dukuri e gjuhëve të dominuara apo u përkasin edhe gjuhëve të tjera? A strukturohet gjuha e politikës në varësi të qëndrimeve politiko-shoqërore?
4. Në këndvështrimin cilësor, a mund të ndërtojmë një fjalor me termat politike dhe leksik më përdorur në ditët e sotme? Çfarë veçorish dhe tiparësh do të ketë ky fjalor terminologjik, bazuar në fjalimet e letrat e politikanëve, në batutat, togjet dhe idomat më të zgjedhura nga ata në përdorimin e kësaj gjuhe në publik?

Krahas pyetjeve të mësipërme të cilat do të jenë në vëmendjen tonë përgjatë trajtesave të çdo kreu, ky punim ngre edhe katër hipoteza të cilat do të përpiqemi t'i mbështesim, apo edhe t'i kundërshtojmë, sipas rastit.

1. Funkcionet e gjuhës së politikës si funksioni shtetëror, ideologjik, propagandues. Tiparet e leksikut politiko-shoqëror në shqipe paraqesin veçoritë e tyre, veçori të cilat kushtëzohen nga kontekstet e ndryshme socio-gjuhësore të formimit të fjalëve si edhe nga dallimet mes mjeteve fjalëformuese të gjuhëve.
2. Gjuha e drunjtë një përballje e gjuhës së sotme të politikës me gjurmë të gjuhës tradicionale –totalitare. Fuqia imponuese e gjuhës së pjerrët në gjuhën e sotme. Metafora dhe funksioni i saj në gjuhën e politikës. Parrullat, aparenca dhe vlera reale e leksikut të sotëm politik.
3. Dinamika shoqërore ndikon në dinamikën gjuhësore. Kështu, prirjet e pasurimit të leksikut politiko-shoqëror në shqipen e sotme janë të orientuara më së shumti drejt një terminologjie në ndryshim e sipër që lidhet kryesisht me integrimin e Shqipërisë në BE.
4. Hartimi i një fjalori leksikografik për termat e politikës mbush një "boshllëk" në fushën e botimit të fjalorëve terminologjikë-politikë, ndonëse nuk është çelësi i artë për zgjedhjet profesionale të një gjuhe potenciale siç është gjuha e politikës.

0.5 Rezultatet e pritshme dhe perspektiva

Rezultatet që priten të nxirren nga ky punim janë të lidhura ngushtë me qëllimet, çështjet, hipotezat dhe objektivat e këtij punimi.

Rezultati i parë i pritshëm është nxjerrja në pah e **tipareve** të leksikut politiko- *shoqëror të gjuhës shqipe*.

Pas analizave dhe vëzhgimeve që do t'i bëhen korpusit të përzgjedhur për efekt studimor, rezultati i dytë i pritshëm i këtij punimi është nxjerrja në pah e **prirjeve** të leksikut të shqipes dhe funksioneve të këtij leksiku.

Rezultati i tretë i pritshëm i këtij punimi është **konceptimi** mbi baza shkencore (ndërtimi i modelit) i hartimit të një fjalori të termave të politikës në nivel përzgjedhës me vlerë kuptimore-semantike.

Hapja e perspektivave të reja për studime të mëtejshme në fushën e leksikut politiko-shoqëror dhe botimi më pas i një fjalori leksikologjik (i shtypur dhe elektronik) për termat e politikës.

0.6 Metodologjia e punimit

Metodologjitë mbi të cilat jemi mbështetur për hulumtimet kërkimore në këtë studim janë ato të fushës së leksikologjisë dhe terminologjisë të para në rrafshin përqasës/kontrastiv. Metodologjia bazë e cila na ka udhëhequr në këtë studim është tërësia e koncepteve, parimeve objektive dhe teorive bashkëkohore që synojnë të paraqesin disa përkufizime teorike mbi konceptin e leksikut politik në gjuhësinë e huaj dhe atë shqiptare, kryesisht bazuar në shkollën e mendimit gjerman, amerikan e atë shqiptar,; me përfaqësues si Orwell, Lucas, Lakof apo Samara, Duro, Kostallari, Lloshi, Thomai ,etj. Një rëndësi i jepet trajtimit të gjerë të figurës kryesore gjuhësore që vepron në politikë, metaforës e gjithashtu “*contradicto in adiecto -s*”, si një mjet gjuhësor me vlerën e një mikroteksti, pra një kontradiktë së pari formale in terminis, kur shprehen njëkohësisht e për të njëjtën gjë dy koncepte e dy gjykime e që përjashtojnë njëri-tjetrin, e cila shfrytëzohet jashtëzakonisht nga politikanët. Synohet në punim që nëpërmjet metodës sasiore dhe cilësore të mbledhjes së leksikut politik si dhe metodës krahasuese midis semantikës dhe formës gramatikore të termave politike të zbulohet funksioni real dhe ai i aparençës që përshkon fjalimet e parrullat e politikës, ndryshe të njohur si elementin e papërcaktueshmërisë së tyre.

Metodat e punës leksikologjike marrin parasysh hipotezat teorike që refuzojnë apo pranojnë ligjërime/prodhime të folësve me anë të korpusit. Një tjetër metodë e zbatuar në këtë studim (kreu IV), është edhe metoda e terminologjisë së sotme – socioterminologjia- e cila, ndryshe nga ajo tradicionale, gjatë studimit të termit në një perspektivë gjuhësore, e studion termin të pashkëputur nga konteksti i përdorimit.

Kështu, metodat e leksikologjisë teorike dhe përshkruese, të terminologjisë janë pikënisja metodologjike e kërkimit tonë për vetë faktin se qëndrojnë në themel të analizave të ndryshme që i bëhet fjalësit të përgjithshëm dhe të specializuar si edhe përbëjnë bazën e punës leksikografike/terminografike për hartimin e fjalorëve të përgjithshëm/të specialitetit.

0.7 Struktura e punimit

Ky punim përmban pesë kapituj. Koherenca mes tyre do të sigurohet nga vijimësia e çështjeve të trajtuara të cilat do të zbresin nga rrafshi teorik i kreut të parë dhe pjesërisht i të dytit, në atë praktik ku me anë të metodave leksikologjike dhe terminologjike do të mëtohet t'u jepet përgjigje çështjeve të ngritura për shqyrtim ku edhe do të analizohet konkretisht korpusi i përzgjedhur për qëllime të këtij punimi.

Në kapitullin e parë trajtohet gjuha politike si një lloj i veçantë komunikimi, një mjet komunikimi e angazhimi qytetar i shoqërisë për lirinë, vizionin e saj të jetës dhe përdorimi i një leksiku që strukturon ndërtimin e një të ardhme sa më të mirë, me një gjuhë zbukuruese dhe emancipuese. Po në këtë kapitull trajtohen funksionet e gjuhës së politikës siç është ai i mbryjtjes së mendimeve, i ndryshimit të mendimeve apo ai propogandues. Punimi në kapitullin e parë synon të paraqesë disa përkufizime teorike mbi konceptin e leksikut politik në gjuhësinë e huaj dhe atë shqiptare, kryesisht bazuar në literaturën gjermane, amerikane e atë shqiptare.

Edhe në fushën e politikës gjuha zë një vend qendror për politikanët .Gjuha i ofron politikës një mjet për të informuar, udhëzuar, për të bindur dhe për të indoktrinuar. Natyrisht vendin e parë në komunikimin politik e zë përmbajtja, por ndikimi i disa parullave, formulat për t'iu drejtuar dikujt ose papërcaktueshmëria e disa shprehjeve nuk duhen nënvlerësuar për sa i përket fuqisë vepruese të tyre.Sipas Martin Greiffenhagen –it në një demokraci si të asaj të Republikës Federale Gjermane, politikë do të thotë veçanërisht një argumentim publik dhe një debat parlamentar.(Martin.Greiffenhagen, (ed): “Lufta për fjalët? Termit politike në Meinungsstreit”, Munchen, Shtëpia botuese Carl Hanser Verlag, 1980, f.10)

Ç' domethënie ka në veçanti gjuha e folur për politikanët dhe procesin e të mbraujturit të mendimeve në përgjithësi .Qysh prej kohës së republikës greke dhe romake, politikanët studionin për këtë arsye logjikën, retorikën ,dialektikën dhe hermeneutikën. Në pikat vijuese do të shqyrtohen funksionet e ndryshme të gjuhës politike, duke iu përkushtuar në radhë të parë gjuhës politike në funksionin e saj të veprimit gjuhësor dhe funksionit mendim-mbraujtës si dhe mendim –ndryshues.Si mund të jetë gjuha në politikë njëkohësisht edhe një veprim?Çfarë synimesh mund të ndjekë gjuha në politikë dhe ç'rrjedh nga kjo për ndërtimin e saj ? Si pikë rëndësie në këtë punim do të merremi me veçantitë e gjuhës politike .Çfarë roli luan parulla politike? A ka leksema specifike, që përdoren si leksik në radhë të parë në rrethin politik? Pse përdorin politikanët në fjalimet e tyre figura retorike dhe terma të papërcaktuara?

Gjuha politike – sikur pothuajse në të gjitha fushat e tjera – lëviz brenda një korrelacioni mes veprimit individual gjuhësor dhe rregullave të detyrueshme kolektive në përdorimin e gjuhës. Ajo i referohet gjithnjë kornizës shoqërore, brenda së cilës flitet ose shkruhet¹. Si konkludim logjik rezulton nga një shndërrim politik ose shoqëror edhe një ndryshim gjuhësor, trajtimi i të cilit nuk do të jetë pjesë e kësaj pune. Wolfgang Brüggemann i referohet dallimit që bën gjuhësia mes gjuhës funksionale dhe gjuhës mendimore dhe e përkufizon gjuhën funksionale si “një gjuhë e cila shpreh probleme të pazgjidhura gjuhësore dhe pikas procese politike ose përcakton institucionet në mënyrë terminologjike”². Në këtë punim do të ndriçohen të dyja anët e gjuhës politike. Sikurse hetohet aspekti i gjuhës funksionale në kreun mbi leksikun politik, ashtu do të diskutohet këndvështrimi i gjuhës mendimore për herë e më shumë në kreun mbi figurat retorike “ ne”-në inklusive d.m.th ne që i referohet simbolikisht një unë-uni të fshehur pas pasqyrës së premtimeve të perealizuara dhe papërcaktueshmërinë e termave. Pajisur me referime të para për sa i përket funksionit të gjuhës politike, Armin Bukhardt-i e përshkruan komunikimin politik në vend të parë si të “organizuar sipas një qëllimi final”³.

Në kapitullin e dytë ky punim tenton të zbërthejë përballjen e gjuhës së sotme të politikës me të kaluarën tradicionale-totalitariste, gjurmë të së kaluarës që ende vegjetojnë në shqipen e politikbërësve shqiptarë. Gjuha e drunjtë dhe forca e saj imponuese është dëshmi që gjuha e së kaluarës gjallon akoma sot. Nuk kishte sesi t'i shpëtonte fokusit të këtij punimi edhe një “përplasje” e së kaluarës totalitariste të Shqipërisë me Shqipërinë e paskomunizmit, e pluralizmit partiak. Në formë “gjurmësh” jemi përpjekur të inkuadrojmë disa prej fjalëve që ende vegjetojnë tek shqipja e re e paskomunizmit si turmë, tufëzim, totalitar, diktatorial,

¹Andreas. Dorner, “Gjuha Politike - instrument dhe institucion i politikës”, B17/91, f.3-11.

² Wolfgang.Bruggemann, “Shënime mbi gjuhën politike”, Dusseldorf ,1977, f.12

³ Armin.Burkhardt, “ Parlamenti dhe gjuha e tij”, Shtëpia Botuese Max Niemeyer, 2003.

autoritarist, herarki politike etj. Nga analiza e mësipërme e këtij leksiku në këtë punim dhe trajtim del se përmbajtja dhe ngjyrimi (konotacioni) i tij nuk mund të kuptohen si “një transplatim” mekanik i ideve a i politikës së ditës. Në një fjalor shpjegues ky lloj “transplatimi” mund të shfaqet me përkufizime të karakterit stereotipik, pa marrë parasysh përbërësit kuptimorë realë me karakter objektiv. Kjo do të thotë se sot studimi e kodifikimi i tij nuk duhet të pajtohet me trajtime e me analiza formaliste të fjalëve, të termave ose të kuptimeve të këtij leksiku. Po qe se termi pluralizëm do të vijonte të shpjegohej si “pikëpamje idealiste ose si “pikëpamje borgjeze e revizioniste” dhe “fashizëm” do të përkufizohej në fjalor fare shkurt dhe vetëm si “sistem politik i vendosur në Europë gjatë viteve 1919-1922”, pa një vlerësim kritik e objektiv të përmbajtjes (pa përbërësit “diktatorial” e “autoritarist”), atëherë nuk do të ishte pasqyruar kuptimi i vërtetë i tyre dhe do të kishim vetëm gjurmë të një gjuhe totalitare që përsëritet edhe sot.

Në kapitullin e tretë pasqyrohet trajtimi leksiologjik dhe leksikografik i gjuhës së sotme politike. Jemi përpjekur ta trajtojmë këtë leksik politik jo vetëm si një tërësi elementesh të lidhura në sistem, por edhe si një nga mjetet gjuhësore gjithnjë në lëvizje e në zhvillim të vazhdueshëm (në përmbajtje dhe në strukturë), të kushtëzuar nga faktorë të brendshëm e të jashtëm, të lidhur me sistemin e koncepteve që shënojnë fjalët dhe termat e kësaj fushe, si dhe me mendësinë e me botëkuptimin e bartësve të shqipes, i cili herë pas here ka ndryshuar e është modifikuar (nga njëra etapë historike në tjetrën) dhe që ende vijon të zhvillohet e të ndryshojë.

Zhvillimet e ndryshimet në përmbajtje dhe në strukturë të këtij leksiku kanë sjellë si rezultat në kohën tonë jo vetëm krijimin e fuqizimin e një nënsistemi të veçantë leksikor, me kufij pak a shumë të qartë, por edhe përsosjen e tij (nga ana strukturore e funksionale), njësitë e të cilit përbëjnë një tërësi elementesh me lidhje varësie të ndërsjella, ku vihen re: raporte të reja ndërmjet fjalëve e termave, një prodhueshmëri e gjallëri jo e zakonitë e disa prej tipave kryesorë fjalëformues, një bashkëveprim i ngushtë i termave me leksikun e përgjithshëm të gjuhës letrare(standarde) shqipe etj. Kur themi se leksiku i politikës, karakterizohet nga tipari i përmbajtjes së tij të veçantë, kjo nuk do të thotë se duhen përligjur përkufizime të tilla në fjalor, ku edhe fjala minifund shpjegohet si “veshje e modës borgjeze e revizioniste”. Trajtimi leksikologjik dhe leksikografik i gjuhës së sotme të politikës lidhet me regjistrat e gjuhës siç është fjalori institucional, fjalori i ideologjisë, fjalori i propogandës me formula, togje, idioma e parrulla të një regjistri të lartë retorik ku zbulimi, premtimi ose gënjeshtër shfaqet si një sfond i moralit njerëzor. Në këtë punim jemi përpjekur të shtrojmë si problem nevojën e një konceptimi shkencor e sa më të drejtë të këtij leksiku. Duhet vlerësuar drejt edhe rolin e

mjeshtërive të fjalës shqipe (ku përfshihen shkrimtarë, gjuhëtarë, oratorë, burra shteti, gazetarë, analistë, etj) të cilët me veprat dhe shkrimet e tyre, e kanë lëvruar dhe e kanë pasuruar leksikun politik. Ata e kanë pasuruar këtë leksik me njësi të reja (të krijuara prej tyre). Meritë të veçantë kanë ata në përpunimin semantik të përmbajtjes dhe të ngjyrymeve të leksikut politik të shqipes letrare. Ata i kanë përdorur fjalët e këtij leksiku në lidhje të caktuara sintagmatike e paradigmatiske (polisemike, sinonimike e antonimike), duke ndërtuar figura të bukura me karakter shprehës-emocionues. Figuracioni, epiteti, metafora, alegoria, ironia dhe tropet e tjera, që gjejmë në shkrimet dhe retorikën e tyre, e bëjnë ligjërimin shumë tërheqës, për lexuesin e dëgjuesin, prandaj edhe sot vazhdojnë të lexohen me vëmendje e kënaqësi artikujt publicistikë. Disa nga problemet e karakterit semasiologjik të trajtuara në këtë punim, si p.sh prejardhja (derivacioni) e kuptimeve dhe e ngjyrymeve të reja në kohën e sotme, si dhe tipat e saj, mund të trajtohen në mënyrë më të thelluar e më të veçantë në të ardhmen.

Në kapitullin e katërt punimi tenton të zbërthejë e ta drejtojë vëmendjen kah metafora si një mjet gjuhësor figurativ të gënjeshtërt ose gjysëm të gënjeshtërt dhe kjo e fundit si një atribut njerëzor në kohë të kohërave. Të tjera çështje që preken në mënyrë sipërfaqësore, pasi duhet të inkuadrohen e të rishihen me kujdes në të ardhmen janë edhe problemi i ndërvarësisë që kanë politikanët sot e gjithë ditën me huazimet, interferimet e huaja, në thelb duke i "birësuar" ato. Pasqyrohen edhe motive të tjera si: zhvillime të reja semantike në gjuhën e politikëbërësve, probleme të polisemisë, sinonimisë, antonimisë etj, problemi i ngjyrymeve (konotacioneve) të kësaj gjuhe e të këtij leksiku, duke i inkuadruar në kontekstin e konferencave, gjuhës së shkresave, gjuhës së parlamentit, gjuhës së kontekstualizuar para medias e në media, gjuhës së shtypit etj. dhe gjithashtu të vendoset një balancë mes parrullave të thata të së djeshmes e asaj çka ndodh sot. Së fundi, nuk kishte sesi t'i kalonte syrit të këtij punimi edhe një trajtim i thelluar leksikologjik e leksikografik i gjuhës së politikës, duke nxjerrë në pah probleme të tilla si politizmi e shpolitizmi i gjuhës, probleme të normës së këtij leksiku, skema mbi të cilat ngrihet ngrehina e prejardhjes kuptimore në këtë gjuhë (skema tufë, e përzier, varg); probleme të tjera që kërkohen të shpalosen janë edhe problemi i rrugëve të pasurimit gjuhësor, problemi i pseudohuazimeve të tilla ,si: kolltukofag, karrikexhinj, dollarofag, lidershhip, stabilokraci, mikokraci, neobllokmenë etj; problemi i termëzimit dhe i shtermëzimit e i situatave apo kushteve në të cilat ky proces ndodh; çfarë e afron e çfarë e largon gjuhën e politikës nga shkenca e nga gjuha e letërsisë, cila është lidhja e gjuhës së politikës me mendimin e si zbërthehet kjo lidhje ,etj.

Gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit në leksikun politik të shqipes janë vërejtur mjaft prurje a njësi të reja, me interes të veçantë, nga ana cilësore e sasiore. Zhvillimi e pasurimi i tij në

kohën tonë lidhet drejtpërdrejt me nevojat që ka gjuha dhe shoqëria jonë për fjalë e terma që shënojnë koncepte të reja në fushën e mendimit politik. Ky zhvillim e pasurim lidhet edhe me rrugën ende të hapur drejt standardizimit më të plotë të shqipes letrare, me përpjekjet që po bëhen për pastrimin e saj nga fjalët e huaja të panevojshme, si edhe me njësimin dhe ngulitjen e normës leksikore të kodifikuara në përgjithësi drejt në fjalorët e shqipes së sotme, por jo pa disa probleme që kanë dalë në formë diskutimesh e vërejtjesh të lidhura me konceptin për këtë leksik dhe për normën leksikore, me raportin ndërmjet denotacionit (karakterit shenjues a emërtues) dhe ngjyimit (konotacionit) të këtij leksiku, me kërkesën për trajtim më të mirë leksikografik të përmbajtjes e të ngjyimeve të këtij leksiku (të mbështetur në tiparet e tij të përgjithshme e të veçanta), me shpolitizimin dhe me një mënyrë pasqyrimi sa më shkencore të ngjyimeve të tij në fjalor (si nuanca të kuptimeve ose si kuptime të veçanta të figurshme), me përkufizimin a me shpjegimin më të saktë sipas vlerës së tyre reale (objektive) ,etj.

Jemi përpjekur të zbulojmë e të trajtojmë disa nga tipat fjalëformues më prodhues e më të gjallë (aktivë), klasat dhe grupet e termave a të fjalëve që janë rritur e janë zhvilluar ose që përdoren më dendur në këtë fushë të veprimtarisë, duke u mbështetur në konceptin e drejtë shkencor për fjalën, në kuadrin e lidhjeve dialektike të saj me termin e me konceptin(a me realien) që shënon dhe funksionin e gjuhës me shoqërinë e me mendimin. Jemi përpjekur kështu të shpjegojmë dhe të sqarojmë se me mirë zhvillimet në jetën shoqërore e politike, lidhjet edhe mjaft zhvillime leksiko-semantike e ngjyimore të këtij leksiku, brenda truallit gjuhësor të shqipes. Si objekt analize në këtë punim ka shërbyer lënda e vjelë prej disa njësisish nga letërsia politike e shoqërore, nga ligjërimi në median e shkruar dhe elektronike, nga shtypi shqip i përditshëm e periodik në Shqipëri. Si çështje trajtohen edhe lidhjet sinonimike e antonimike ndërmjet fjalëve e kuptimeve të këtij leksiku, me ngjyimin (konotacionin) në kuptimin e gjerë e të ngushtë të tij, me aftësinë e tij shprehëse, me gjendjen e sotme të normës leksikore etj.

Ka një ndryshim të madh midis rritjes natyrale të gjuhës së gjallë dhe keqpërdorimit të saj. Ta keqpërdorosh gjuhën, është më shumë sesa thjesht një çështje fjalësh. Ndryshe nga sa besohet rëndom, gjuha nuk e pasqyron realitetin, ajo nuk bën përshkrim të thjeshtë të botës ,siç shfaqet. Përkundrazi, gjuha ndihmon në krijimin e realitetit, duke u dhënë kuptim ngjarjeve: ajo nuk është neutrale. Ndryshimi i madh që i diferencon politikanët nga njerëzit e zakonshëm qëndron tek kuptimi që ata u japin fjalëve, ndaj edhe siç ka thënë edhe një shkrimtar dikur, zgjedhja e fjalëve është, gjithashtu, zgjedhja e botës. Fjalët janë jetike edhe për vetë mendimin.

Qëllimi i këtij punimi synon të zbërthejë gjithashtu, me fjalorin e tij në fund një panoramë të mirëfilltë të asaj se çfarë ndodh ndërmjet kuptimit të mirëfilltë (denotativ, i drejtpërdrejtë i një fjale apo një fraze ose ai që jepet në fjalor për të) dhe kuptimit të figurshëm (konotativ, i sugjeruar nga lidhjet ose emocionet e shkaktuara të momentit nga një fjalë ose frazë). Shumica e fjalimeve politike tentojnë të kthehen në të barasvlefshmen linguistike të “junk food –it” (ushqim i skaduar) amerikan, pasi tentohet të preken ndjenjat, por një publik i tejmësuar me të njëjtat fytyra, me të njëjtat zëra, jo vetëm që nuk emocionohet, përkundrazi i shndërron këto figura në objekte loje, përqeshjeje.

Në fund të këtij punimi paraqitet një fjalorth i përbërë prej 397 fjalësh ndërkombëtare ose jo, të zbërthyera me etimologjinë përkatëse, së pari si terma të fushave specifike të caktuar , p.sh :të përdorura së pari në mjekësi, fizikë, matematikë, astronomi etj. dhe sesi ato vijnë te gjuha e politikëbërësve, në çfarë vitesh apo shekujsh (në rastet e mungesës së një date) ato gjejnë “strehë” te kjo gjuhë me anën e prejardhjes kuptimore, por tashmë si zhvillime të reja të mirëfillta semantike, siç ndodh te fjala njollë, bazë, lidhje, monitorim, infiltrim, absorbim, akses, aferë, aks, cinizmi politik, duke pritur Godonë etj, apo edhe sesi kalket frazeologjike ose jo vijnë e “rreshtohen” te kjo gjuhë më së miri sipat termit “gjenerim organik i shtetit” nëpërmjet gjuhës politike.

0.8 Literatura dhe bibliografia

Për hartimin e këtij punimi kemi shfrytëzuar një bibliografi të gjerë të studiuesve vendas dhe të huaj të gjuhësisë së zbatuar, gjenerative dhe veçanërisht të leksikologëve, leksikografëve, terminologëve. Shpërndarja gjeografike e këtyre botimeve është po ashtu e gjerë. Për shkak të kuadrit tonë studimor, kryesisht, është punuar me studime të hartuara në gjuhën shqipe, gjermane, italiane dhe angleze. Punimet e shfrytëzuara janë libra studimorë, artikuj shkencorë, monografi. Ndër studiuesit vendas mund të përmendim studimet e kërkuesve shqiptarë të botuara në ato filologjike, konkretisht, Fjalori i gjuhës shqipe 1981, 2002, 2008 A. Kostallari, J.Thomai, K.Cipa, A.Duro, M.Samara, K.Jorgaqi, Xh.Lloshi, etj.

Jemi konsultuar me literaturë të huaj si me autorët: Tuckerova V Totalitarian Language: Fidelius Vs. Havel Vs. Rorty, Columbia University, Conference: Thinking in/after Utopia. East European and Russian, 2011, Kemplerer, Viktor. The language of the Third Reich: LTE Lingua Tertii Imperii: A Philologist's Notebook, Continuum International Publishing Group, 2006 etj.Një pasqyrë e hollësishme është në fund të këtij punimi.

KAPITULLI I PARË

Gjuha e fjalës së vërtetë nuk duhet të meket e as të dridhet kur demaskon kolltukofagë të pandershëm...

Noli

**...dhe kolltuku ku je ulur
duke çjerrur nderin zvarrë
është trekëmbëshi që përdita
varet kombi në litar...**

Ali Asllani

1.1 Gjuha e politikës si një “lloj” i veçantë gjuhe

Në të gjitha fushat njerëzit komunikojnë me njëri-tjetrin, gjuha merr rolin më të rëndësishëm për t'i shprehur mendimet tona. Ajo është mjete më i rëndësishëm i marrëveshjeve njerëzore e prandaj elementi bazor i të gjitha marrëdhënieve sociale⁴.

1.Edhe në fushën e politikës gjuha zë një vend qendror për politikanët .Gjuha i ofron politikës një mjet për të informuar, udhëzuar, për të bindur dhe për të indoktrinuar. Natyrisht vendin e parë në komunikimin politik e zë përmbajtja, por ndikimi i disa parullave, formulat për t'iu drejtuar dikujt ose papërcaktueshmëria e disa shprehjeve nuk duhen nënvlerësuar për sa i përket fuqisë vepruese të tyre.Sipas Martin Greiffenhagen -it në një demokraci si të asaj të Republikës Federale Gjermane, politikë do të thotë veçanërisht një argumentim publik dhe një debat parlamentar⁵.

2.Edhe këtu na shfaqet se ç' domethënie ka në veçanti gjuha e folur për politikanët dhe procesin e të mbraujturit të mendimeve në përgjithësi .Qysh prej kohës së republikës greke

⁴Wolfgang.Bergdorf,"Fjalët si armë. Gjuha si instrument i politikës", Stuttgart, Shtëpia botuese Bon , 1979, f.8

⁵Martin.Greiffenhagen, (ed): "Lufta për fjalët? Termat politike në Meinungsstreit", Munchen, Shtëpia botuese Carl Hanser Verlag, 1980, f.10

dhe romake, politikanët studionin për këtë arsye logjikën, retorikën ,dialektikën dhe hermeneutikën. Qëllimi i kësaj detyre do të jetë fillimisht të ndërmerret një përpjekje për të përkufizuar gjuhën e politikës.Çfarë nënkupton gjuha politike dhe çfarë definicionesh të ndryshme na paraqesin literaturat përkatëse. Në pikat vijuese do të shqyrtohen funksionet e ndryshme të gjuhës politike, duke iu përkushtuar në radhë të parë gjuhës politike në funksionin e saj të veprimit gjuhësor dhe funksionit mendim-mbrujtës si dhe mendim – ndryshues.Si mund të jetë gjuha në politikë njëkohësisht edhe një veprim?Çfarë synimesh mund të ndjekë gjuha në politikë dhe ç’rrjedh nga kjo për ndërtimin e saj ? Si pikë rëndësie në këtë punim do të merremi me veçantitë e gjuhës politike .Çfarë roli luan parulla politike? A ka leksema specifike, që përdoren si leksik në radhë të parë në rrethin politik? Pse përdorin politikanët në fjalimet e tyre figura retorike dhe terma të papërcaktuara? Në fund të punimit tonë do t’i përmbledhim rezultatet dhe do ta shqyrtojmë gjuhën e politikës për sa i përket veçantive të saj.

Se çfarë kuptimi ka termi “gjuha e politikës” ose “gjuha politike” nuk është përcaktuar as në gjuhësi përfundimisht. Në këtë kontekst duhet të merret parasysh se gjuha politike – sikur pothuajse në të gjitha fushat e tjera – lëviz brenda një korrelacioni mes veprimit individual gjuhësor dhe rregullave të detyrueshme kolektive në përdorimin e gjuhës. Ajo i referohet gjithnjë kornizës shoqërore, brenda së cilës flitet ose shkruhet⁶. Si konkludim logjik rezulton nga një shndërrim politik ose shoqëror edhe një ndryshim gjuhësor, trajtimi i të cilit nuk do të jetë pjesë e kësaj pune. Wolfgang Brüggemann i referohet dallimit që bën gjuhësia mes gjuhës funksionale dhe gjuhës mendimore dhe e përkufizon gjuhën funksionale si “një gjuhë e cila shpreh probleme të pazgjidhura gjuhësore dhe pikas procese politike ose përcakton institucionet në mënyrë terminologjike”⁷. Në këtë punim do të ndriçohen të dyja anët e gjuhës politike. Sikurse hetohet aspekti i gjuhës funksionale në kreun mbi leksikun politik, ashtu do të diskutohet këndvështrimi i gjuhës mendimore për herë e më shumë në kreun mbi figurat retorike , “ne-në” inklusive d.m.th ne që i referohet simbolikisht një unë-uni të fshehur pas pasqyrës së premtimeve të porealizuara dhe papërcaktueshmërisë që merr ky përemër vector i v.së parë, shumë. Pajisur me referime të para për sa i përket funksionit të gjuhës politike, Armin Burkhardt-i e përshkruan komunikimin politik në vend të parë si të “organizuar sipas një qëllimi final”⁸. Ai i referohet faktit se gjuha politike përdoret gjithmonë sipas qëndrimeve politike, rrjedhimisht nuk e ka vetëm funksionin e prezantimit, por përmban gjithmonë edhe një karakter apelativ dhe nuk është deskriptive ose informuese. Aspekti i influencimit të

⁶Andreas. Dorner, “Gjuha Politike - instrument dhe institucion i politikës”, B17/91, f.3-11.

⁷ Wolfgang.Brüggemann, “Shënime mbi gjuhën politike”, Dusseldorf ,1977, f.12

⁸ Armin.Burkhardt, “ Parlamenti dhe gjuha e tij”, Shtëpia Botuese Max Niemeyer, 2003.

dëgjuesve/lexuesve nëpërmjet një përdorimi të caktuar të gjuhës është i konsiderueshëm në fushën e politikës. Burkhardt-i shton më tutje se gjuha politike është kryesisht publike dhe një komunikim i drejtuar publikut. Ky definicion duket në fillim shumë kufizues, megjithatë me këtë kufizim rroket edhe të gjitha llojet e teksteve politike, si programe partiake, fjalime fushatash, fjalimet e politikanëve, debate parlamentare ose projektligje⁹. Ia vlen të mendohet në këtë mes se çfarë aktesh ligjërimore nuk mund të merren sipas këtij definicioni si gjuhë politike.

Vetëm kontrata dhe marrëveshje të fshehta mes disa aktorëve ose letrat dhe telefonatat mes politikanëve si dhe debatet në komisionet larg nga publiku nuk do të merreshin pastaj si gjuhë politike, ndonëse edhe ata hasen në fushën e politikës. Gjuha politike sipas Jozef Klein-it nuk është një shembull tipik i një gjuhe specifike. Karakteri i saj i përzier, kryqëzimi i saj me gjuhë të tjera specifike si dhe gërshetimi i saj i gjerë me gjuhën e përditshme flasin kundër një karakterizimi të tillë. Edhe Walter Dieckmann-i nuk sheh në gjuhën politike një gjuhë veçmas specifike, por e cila mund të quhet në përgjithësi më shumë si një “kompleks veprimor e funksional” dhe nuk paraqet një fushë të vetën të kufizuar. Megjithatë ekziston një dallim mes gjuhës politike dhe gjuhës së përditshme. A. Naser Shrouf përmbledh përkufizime të ndryshme shkencore për gjuhën e politikës në një përcaktim terminologjik shumë përgjithësues në vijim: “Një sërë punimesh shkencore e konsiderojne për këtë arsye gjuhën politike si gjuhë shteti ose të gjithë atë, e cila i referohet shtetit ose pushtetit shtetëror: Institucionet, funksionet dhe praktiket e politikës”. Një përkufizim shumë të detajuar me kritere specifike formulon Klaus Watzin siç shihet në vijim: “Si gjuhë politike duhet të quhen të gjitha veprimet gjuhësore, me të cilat një folës/shkrues përpiqet të ushtrojë ndikim shtetëror në mbrujtjen e opinionëve në jetën publike ose brenda institucioneve politike (parlament, qeveri, administratë, gjyqësi, parti dhe organizata politike)”. Sipas kësaj, gjuha politike ndërlihet në kuptimin më të gjerë me një grup specifik personash, nga të cilët përcillet kjo gjuhë (politikanë, nënpunës). Pyetja se çfarë vetish specifike gjuhësore duhet t’i nënrenditen gjuhës politike shkakton ende debate në shkencë.

Gjuhëtarët shqiptarë bien dakord se gjuha politike është mjeti kryesor i politikëbërjes dhe përdoret në varësi të interesave të caktuara politike e mund të jetë e qartë dhe e paqartë sipas vërtetësisë së këtyre politikave. Ajo është gjuha që të vret natën e të qan ditën, - shprehet një studiues kosovar, duke vënë theksin në pabesinë e saj, në forcën ekstremisht të theksuar

⁹ Muller. Ulrich , Hundsnurscher. Franz , “Një analizë gjuhësore të fjalës politike”, Shtëpia Botuese Kummerle, Verlag, 1989

shigjetuese e manipuluese ndaj atyre që mundohen ta frenojnë a t'i bien ndesh. Ajo është gjuha e karrikexhinjve, e kolltukofagëve...

Shkrimtari Xhorxh Orwell thotë se armiku më i madh i qartësisë së gjuhës është mungesa e sinqeritetit. Sipas tij gjuha politike është ndërtuar e tillë që të bëjë gënjeshtat të tingëllojnë të vërteta dhe vdekjen të respektueshme. [Orwell, "Politics and the english language", 1946] Autorë të tjerë amerikanë R.Denton dhe G. Uduord e karakterizojnë komunikimin politik si një mënyrë e qëllimtë e dërguesit për të ndikuar mjedisin politik. Ata thonë se: "faktori themelor që e bën një komunikim 'politik' nuk është burimi i mesazhit ,por përmbajtja dhe qëllimi i tij". Pra, është "komunikimi i qëllimtë i politikës", në të cilin aktualizohen jo vetëm ai verbal e me shkrim, por edhe prezantime vizuale si p.sh. veshjet, simbolet (kujto simbolet, logot e PD-së, PS-së, dora që prek e shtrëngon një trëndafil rozë, forma e stërzgatur e një D-je të madhe , etj). Gjuha politike mund të ndërtojë realitete politike nëpërmjet forcës së argumenteve bindëse. Ndërkaq edhe sociologu Gëzim Tushe nëemisione si i ftuar, krahas mirëpranimit të idesë së mësipërme , mbron edhe bindjen se janë më së shumti argumentet emocionale ato të cilat e kanë vështirësuar akoma më shumë transmetimin e mesazhit politik mes palëve. Shumëkush sot mund të thotë se propaganda është diçka që i përket se kaluarës, megjithatë literatura akademike shprehet se disa nga format e saj janë edhe sot,si: përsëritja e frazave, eufemizmi, indoktrinimi i publikut, duke thirrur kryesisht më shumë emocionet sesa intelektin. Të synosh drejt një komunikimi të qartë dhe të drejtpërdrejtë është një utopi, pasi siç thotë Orwell çdo përpjekje kundër abuzimit me gjuhën është thjesht sentimentalizëm i vjetëruar, njëlloj si të preferosh qirinjtë ndaj dritës elektrike.

Edhe një letër e palexuar, drejtuar komisionit për peticion, është tentativë për ndikimmarrje dhe duhet të vlerësohet për këtë arsye si gjuhë politike. Ky përcaktim terminologjik ka, sipas mendimit tonë, dobinë e vet në literaturën përkatëse. Në përpjekjet për të përcaktuar gjuhën politike kriteret na ofrojnë orientim për ta qartësuar thelbin e gjuhës politike. Nën pikave që vijojnë do t'u japim prandaj si bazë përkufizimin,si më të duhurin sipas mendimit tonë.

1.3 Gjuha politike mjet komunikimi e angazhimi qytetar

"Gjuha nuk është vetëm një instrument i politikës, por në përgjithësi kushti i mundësisë së saj për të komunikuar dhe tërhequr një grup sa më të madh dëgjuesish me qëllim që liderët

politikë të parashtrojnë platformat dhe idetë e tyre. Aristoteli në librin e tij “Etika”¹⁰ pohon se angazhimi politik është angazhimi më i lartë qytetar. Politikani, si aktori që vepron në skenën politike, përdor gjuhën në situata të ndryshme [...]. Gjuhë politike do të thotë për këtë arsye veprim politik¹¹.” Njëri nga funksionet qenësore të gjuhës politike duhet të jetë veprimi, i cili ushtrohet përmes një akti të caktuar ligjërimor. Gjuha nuk është - siç konstaton ai – vetëm një mjet politik, neve na paraqitet edhe pyetja: A mund të mendohet politika, pa përdorimin e gjuhës? Një folës gjatë aktit të të folurit ndërmer më shumë se prodhimin e strukturave fonetike, leksikore dhe gramatikore. Në një bashkëveprim me mjedisin e tij, duke përjashtuar këtu të folurit me vetveten, ai shkakton reagime të veçanta tek bashkëbiseduesit e tij përmes fjalëve që përdor. Qartë si rrallë ndonjëherë shfaqet karakteri veprimor i gjuhës në përdorimin publik të gjuhës në politikë. Vetëm disa fjalë të formuluar në mënyrë jokonkrete mund të shkaktojnë mosmarrëveshje mes partive ose konflikte në marrëdhëniet ndërkombëtare të shteteve. Një fjalim i vetëm mund të mbrojë një politikan. Në mënyrë të përmbledhur: Gjuha politike mund të ketë pasoja të pandërmjetme dhe mund ta ndryshojë realitetin.

1.2 Funksionet e gjuhës politike

Funksionet e gjuhës së politikës i referohen një numri të shumtë teoricienësh të politikës që përbëjnë “një bashkimi themelor komunikimi” dhe që nënkupton “elemente themelore” sipas një kuptimi logjik-ideor të cilët janë në sasi të ndryshueshme dhe të përcaktuara në lidhje të tjera , me të cilat shfaqen në gjuhë si një histori narrative. Propp tek “ Morphology of the Folk-tale”(1968) njih 31 elemente funksionesh, një grup i zgjedhur fjalësh në fjali me qëllim të caktuar për t’u përdorur dhe për të ndërtuar një ligjërim, në rastin tonë ligjërimit politik, të organizuar sipas rregullave sintagmatike dhe paradigmaticke. Claude Bremond (1973) me “funksion” zhvillon idenë e Propp-it si një rend logjik, si mundësi, aktivitet, ndërveprim, rezultat përfundimtar. Roland Barthes e përdor termin “funksion” në “Introduction to the Structural analysis language”(1975) të lidhur me termin “indeks” (pasqyrë treguese), grup elementesh në rolin e një historie narrative. J.Culler sugjeron termin “lexie” (leksik) duke iu referuar Barthes, një tekst gjuhe që kuptohet nga një tekst tjetër.Gerard Genette e përdor termin “funksion” si një sistem i përcaktuar dhe i ngurtë rregullash në kuptimin strukturalist

¹⁰ Aristotel, “Etika”, Toena, 1998, fq. 39

¹¹ Girnth. Heiko, “Gjuha dhe përdorimi i gjuhës në politikë”, Tubingen, Vëllimi 39, 2002,f.1.

për të ndërtuar një ligjërim politik si një “lojë shahu me gurë” që ndërton një strategji fitoreje në dobi të liderit apo partisë së tij. Një “funksion politik” i gjuhës është një ligjërim idesh ose konceptesh politike nga lideri ose simpatizantë të tij, ligjërim që paralajmërojnë ngjarje që zhvillojnë veprime ,siç janë votimet apo zgjedhjet politike parlamentare.

1.5 Funksioni i mbujtjes së mendimeve

Si një funksion tjetër i gjuhës politike duhet të përmendet krahas karakterit të saj veprimor edhe roli i saj si mjet komunikimi ,duke u aktualizuar me qëllim të shoqërizimit të individit. Edukimi – si dhe edukimi politik – i jep një grupi atë që është dhe atë që duhet të jetë pronë e mirëqenë gjuhësore e të gjithëve në interes të bashkëjetesës dhe të bashkëveprimit kolektiv. Në kuptimin politik duhet të mësohen mënyra të caktuara të të menduarit ose konceptime vlerash, të cilat i përbëjnë ideologjitë e ndryshme të disa filozofëve/mendimtarëve. Çdo vendim politik vjen para një procesi të ri të mbujtjes së mendimeve. Por,funksioni i të mbujturit të mendimeve në gjuhën politike është – siç tregon citati i përparshëm i Armin Brukhardt – rrallëherë vetëm deskriptiv, por fillimisht i organizuar sipas një qëllimi final dhe ndjek për këtë arsye një qëllim të caktuar.

Nga Platoni e këtij ideja se ekziston një lidhje e brendshme dhe e ngushtë midis mendimit dhe gjuhës ka qenë e pranishme dhe e pandërprerë në historinë njerëzore, edhe pse në formë të ndryshme. ndonjëherë është bërë përpjekje për ta parë e konsideruar gjuhën si pasqyrë të mendimit.

Sofistët e lidhin mendimin mbi gjuhën ngushtësisht me konceptin e njohjes, sipas të cilit veprimtaria mendore është e ndikuar nga përvoja individuale, e ndjeshme dhe e ndryshme nga një folës tek tjetri. Ato do të na conin tek trinomi realite-mendimi-gjuhë që do të përbëjë në thelb gjithë arkejtizin e mendimit filozofik deri më sot. Mendimi pasqyron strukturën e fundit të realitetit dhe gjuha nga ana e saj pasqyron një lloj kërkimi të dyanshëm mes referentit dhe veprimtarisë së mendimit të kryer mbi të (i shenjuari). Gramatika e Port- Royalit nisej nga ideja se për aq kohë sa ka një mendim universal, ky mendim do të shprehej nga një gjuhë universale. Shtrohen mijëra pyetje lidhur me këto dy shtylla të historisë njerëzore dhe ngelemi vetëm në stadin e hipotezave. A mund të komunikohet pa gjuhë?

Cila është primare gjuha apo të menduarit? Nga se dallohet gjuha dhe mendimi? C’i përbashkëson këto dy dukuri? Dhe përgjigjet rrjedhin më tej. Është mundësia për të komunikuar pa gjuhën, sic është rasti i mjaft kafshëve dhe i komunikimit joverbal midis njerëzve, po ekziston, gjithashtu edhe mundësia e përdorimit jokkomunikativ të gjuhës. A nuk thoshte Platoni se “të menduarit është një dialog me shpirtin”? Tema se cili është raporti midis gjuhës dhe mendimit ka qenë në themel të abstraktit shkencor nga më të mëdhenjtë e shek të kaluar në fushën e psikologjisë me protagonistë Piazhën (Jean Piaget) dhe Vigockin (Lev Vygotskij). Sipas psikologut zvicerian Piazhë, nga ana logjike zhvillimi gjuhësor nënkupton dhe ndjek zhvillimin konjitiv (njohës) të njeriut. Ndërkohë për Vigockin gjuha nuk nënkupton mendimin, as nuk e paraprin atë. Mendimi dhe gjuha janë formuar më tepër si aftësi të ndryshme, por jo të pavarura nga njera-tjetra. Madje, qysh në ngjizje ekziston një lidhje e fortë ndërvarësie.

Dekarti: “Është e qartë se unë jam një send që mendon. Përveç kësaj, derisa unë nuk mund ta konceptoj veten ndryshe, përveçse duke menduar, të menduarit është në thelbin tim”.

Në vazhdim mjaft ithtarë të tjerë të fushës së psikologjisë së zhvillimit, i kanë dhënë jetë mendimit se gjuha është një aftësi e pavarur, e dallueshme nga aftësitë e tjera mendore që ka si funksion fillestar kryesisht të komunikuarit, por që më pas kryen funksione të rëndësishme rregulluese të mendimit. Efektet e gjuhës mbi mendimin janë studiuar dhe eksperimentuar edhe nga Karmikel (Carmichael) i cili shpjegonte sesi përcaktimi jo shumë i qartë gjuhësor i mendimit (me anë të fjalëve, termave e figurave të turbullta) ndikonte në mbajtjen mend e riprodhimin e përpiktë të mesazhit. Cilatdoqofshin raportet e këtij debati që i ka rrënjët qysh në lashtësi e që sot e kësaj dite qëndron i hapur, një gjë është e qartë: është i padiskutueshëm roli i gjuhës në shprehjen dhe në zhvillimin e mendimit. Po në këtë debat, të dhëna vijnë edhe nga patologjia të cilat theksojnë lidhjen e fortë që qëndron midis këtyre dy aftësive, edhe pse shkenca deri më sot nuk ka arritur të shpjegojë në mënyrë përfundimtare mekanizmin e kësaj sjelljeje e këtyre raporteve.

Mendimi njerëzor udhëhiqet nga nevoja e unitetit të bashkësisë njerëzore, por për mundësitë shprehëse varen shumë nga forma e organizimit gjuhësor. Marrëdhëniet e gjuhës me mendimin dhe psikologjinë e popullit janë të lidhura me mënyrën e jetesës dhe janë prerje të një realiteti të caktuar. Gjuha duhet parë si ergon, si dicka e dhënë e përfunduar, dhe si energia, si ndryshim që rrjedh nga vetë natyra e gjuhës, në të cilën gjenden të dhënat që mbartin lëvizjen e saj, një vetëlëvizje e brendshme, element i përhershëm i shpirtit njerëzor dhe krijim i popullit që e përdor. Për Humboldin forma e gjuhës është e përhershme dhe e qëndrueshme në gjuhë, që ndikon veprimtarinë e shpirtit, që e ngre tingullin e artikuluar deri

tek shprehja e mendimit. Me formën e brendshme të gjuhës (tingull-nocion) Humboldi lidh marrëdhëniet e gjuhës me mendimin. Gjuha është formë e mendimit, “fjala është e tillë që në mënyrë të lirshme e bën nocion njësinë e mendimit”. Fjala është shenjë, por jo në atë masë sa të zhdukë lidhjet me frymën. “Gjuha, - thekson Humboldi, është përsëritje e pandërprerë e ndikimit veprues të shpirtit mbi tingullin e artikuluar, për ta shndërruar këtë tingull në shprehës të mendimit. Por, në të njëjtën kohë mendimi është në luftë që të clirohet nga prangat e gjuhës pasi gjuha bëhet pengesë për një mendim “të pastër”. Ky koncept i fundit të con në idenë e gjuhës si mjet marrëveshjeje dhe mosmarrëveshjeje në të njëjtën kohë. Tezat humboldiane mund të përmbliken në këto postulate:

- Gjuha merret si formë e mendimit në kuadrin e lidhjeve përmbajtje-formë
- Ekziston një lidhje dialektike mes gjuhës e mendimit dhe të gjuhës me të folurit
- Gjuha dhe mendimi janë limite të njëri-tjetrit sikurse gjuha dhe të folurit kushtëzojnë njëri-tjetrin si realizime të mjetit me funksionin brenda një sistemi
- Gjuha pasqyron ngritjen e shpirtit nga forma më të ulëta në më të larta p.sh kuptimi i fjalës “dritare”: it finestra,fi fenetre, gjerm da genster, të cilat lidhen me i.e *pham, dukem, shfaqem, angl. window, rrymë ajri, rus.okno, lidhet me shikim. (Këtu pasqyrohen mënyra jo të barabarta të të vështruarit të realitetit dhe jo një logjike të brendshme).

Sosyri me revolucionin e tij gjuhësor do ta shohë gjuhën si formë të vecantë që formëson mendimin, i cili për nga natyra është kaotik. Gjuha,- thoshte De Sosyri, - mund të krahasohet me një fletë letre: mendimi është njëra anë e tingulli ana tjetër. “Gjuha, - theksonte Sosyri, - është thesar i depozituar në mendimin e një bashkësie individësh, gjuha nuk është e plotë te asnjëri, ajo ekziston përsosmërisht në masë”.

Sepiri është një nga tre themeluesit e strukturalizmit amerikan krahas Boasit dhe Blumfildit, por ndryshe nga ata ai ishte mentalist. Ai mendonte se strukturës gjuhësore i përgjigjet një realitet mendor i cili mund të pranohet duke studiuar gjykimet e folësve mbi gjuhën e vet, krahas studimit të përdorimit të lirë të gjuhës së tyre. Sepiri e përkufizon gjuhën si një metodë të thjeshtë njerëzore dhe jo instiktive të komunikimit të ideve emocioneve dhe dëshirave me anë të një sistemi simbolesh të prodhuara në mënyrë të qëllimshme. Nga pikëpamja gjuha na bëhet shfaqja e jashtme e mendimit sikurse raporti mjet-prodhim.

Të njohura janë edhe mendimet e austriakut Wittgenstein: ‘Gjuha nuk është vetëm një mjet i jashtëm, një veshje. Gjuha, gjuha jonë e parë, “Heinsprache”, gjuha e shtëpisë bën pjesë në argumentimin efektiv, relacional dhe konjitiv.’ Kërkime interesante të kryera në Paris nga një psikoneurolog argjentinas Zhak Meler (Jaques Mekler) tregojnë se qysh nga dita e dytë e jetës

njeriu orientohet, sintonizohet me ritmin, me melodikun e gjuhës së nënës. ‘Gjuha,- shprehet autori,-është në ndjenjat tona, në trupin tonë më parë sesa në intelektin tonë.’ Pra, autori e lidh përgjithshmërisht gjuhën, intelektin njerëzor me shkallën më të fundit, duke i veshur më parë tipare biologjike natyrore, psikologjike e më pastaj intelektuale, mendore. Për t’iu rikthyer sërish Eitgensteinit dhe “Tractatus-it” të tij: Për autorin gjithcka që mund të mësohet edhe mund të thuhet: caqet e gjuhës janë caqet e mendimit, prandaj një filozofi e plotë e së kumtueshmes është ajo që Kanti e ka quajtur “mendim”.

Nietsche: “Aristokracia e mendjes duhet të drejtohet nga aristokracia e gjuhës”.

Dekarti: “Mendja është një mjet universal që mund të shërbejë për të gjitha rastet”. Comski në gjysën e dytë të viteve 1900 u shpreh së pari për një gramatikë universale të lindur tek cdo njeri. Mendimet e gjuhëtarit kanë kontribuar në turbullimin e bindjes bihevjoriste se: nuk kishte kuptim të tentojë, të ndërtojë çfarë ndodh brenda mendjes, por duhej të studioje vetëm sjelljen. Sot shkencëtarët shohin brenda trurit, mes teknikave të ndryshme, për të zbuluar sesi hapësirat cerebrale aktivizohen në vijim të asaj që themi e bëjmë. Në veprën “Gjuha dhe problemet e njohjes” në kapitullin e pestë të titulluar “Një shikim drejt së ardhmes: perspektiva për studimin e mendjes” Comski shprehet: “...ne përpiqemi të ndërtojmë një gramatikë, një teori të një gjuhete vecantë, që të përshkruajë mënyrën sesi kjo gjithë i cakton paraqitje mendore specifike secilës shprehje, duke përcaktuar kështu formën dhe domethënien e saj... që një njeri të kuptojë një shprehje gjuhësore, mendja/truri duhet të përcaktojë formën e saj fonetike dhe fjalët e saj dhe pastaj të përdorë parimet e Gramatikës Universale .Çdo njeri mund të perceptojë përmes introspeksionit se zotëron një mendje, e cila dallohet tërësisht në veçoritë e saj nga trupat që përbëjnë botën fizike. Çomski diskuton gjerë e gjerë me kartezianët të cilët e konsiderojnë mendjen një “substancë e dytë” apo një substancë e vetme e dalluar nga trupi. Gjuhëtari shtron pyetjen se si këto substanca ndërvepronin, në ç’mënyrë veprimet e mendjes mund të çojnë në veprimet e trupit. Për të nuk ekziston diçka si “mendja e një kafshe”, pasi kafshët janë thjesht një makineri, ata i nënshtrohen shpjegimit mekanik. -Mendja, - konkludon gjuhëtari, -është modulare, e përbërë nga sisteme të ndara.

1.6 Funkzioni i ndryshimit të mendimeve

A janë vallë fjalët në gjendje të ndryshojnë botën?

Më parë, u prek shpesh rëndësia e funksionit mendim-ndryshues ose funksioni kontrollues i gjuhës politike. “Kush i emërton gjërat, i sundon ato” -argumenton një shprehje gjermane. Çfarë detyrash vendimtare ka përdorimi i gjuhës së politikës përmes një folësi- qoftë në fjalime fushatash zgjedhore, debate parlamentare ose deklarata qeveritare? Gjuha politike duhet t’i bindë shikuesit për një qëndrim të deklaruar, të sjellë miratim dhe t’i mbështesë pikëpamjet e paraqitura. Aktori gjuhësor i politikës do të përpiqet të evokojë kognicione, emocione dhe vlerësime të veçanta tek recipientët e tij për t’u mësuar një veprim të caktuar politik. “Forca e gjuhës për të sajuar kuptime e bën atë një element qendror kontrollimi të politikës, i cili i lejon politikës, pa dhunë fizike ose joshje materiale, të mobilizojë masa njerëzore – edhe atëherë, kur pengesa morale duket se e pamundësojnë një mobilizim të tillë.” Ky citat i Andreas Doner-it përshkruan në mënyrë impresionuese impaktin e gjithashtu edhe rrezikun që përmbajnë gjuha politike dhe potenciali i saj manipulues. Në qoftë se mbulohen edhe dramatizohen rreziqet përmes mjeteve retorike të eufemizmit dhe të hiperbolës, bëhet për qytetarët gjithnjë e më e vështirë t’i njohin faktet e vërteta.

KAPITULLI I DYTË

PËRBALLJA ME TË KALUARËN TRADICIONALE – TOTALITARISTE NË GJUHËN E SOTME POLITIKE

2.1 Gjurmë të së kaluarës që ende vegjetojnë në shqipen e politikëbërësve

Gjuha e drunjtë në Shqipërinë e viteve 1945-1980 ndan edhe disa tipare të përbashkëta me neogjuhën, si: absurditetin, pavërtetësinë, karakterin luftarak, përsëritjen e vazhdueshme etj.

Pavarësisht kuptueshmërisë së saj relative, kjo gjuhë nuk është aspak krijuese. Ajo përdor kuptime të leksikalizuara që i përkasin thelbit të fjalorit të shqipes 1980 dhe ajo fiton nga përbërësit e automatizuar të sistemit të gjuhës, gjuhës totalitare ose "gjuhës së propagandës" Meqenëse ky punim përfaqëson një përpjekje për të shpjeguar këtë gjuhë, vlen të japim disa nga karakteristikat e saj. Të gjitha këto karakteristika janë të lidhura me termat ideologjike që janë të nxitura nga sistemi komunist, duke përfshirë: programin, risinë e atëhershme të regjimit të krijuar, funksionin e mbajtjes së optimizmit dhe entuziazmit për një qasje të re që ishte alokuar me brezin e ri, ideologjia, bazuar në baza të supozuara shkencore të doktrinës marksiste-leniniste.

Nga pikëpamja gjuhësore, forca lëvizëse ose drejtuese ishte përdorimi i shpeshtë i antonimeve në promovimin e ideve komuniste. Ato janë përdorur një formë të madhe negative si dhe të vlerësimeve pozitive (ky lloj përdorimi i antonimit, të dikotomive, prek përgjithësimin e folësit në mënyrë të tillë, që ata ta perceptojnë gjuhën monotonisht, si një varg komponentësh të përsëritura, ose me fjalë të tjera si lavazh truri)

Karakteristikat kryesore të gjuhës së drunjtë në fjalorin e gjuhës shqipe 1980 shfaqen si më poshtë:

Varfërimi i gjuhës

Përdorimi i klisheve

Përdorimi i shpeshtë i antonimeve, i kundërvënive (shpeshherë dhe i dikotomive)

Karakterit luftarak dhe agresiv

Monotonia dhe përsëritja.

Pavërtetësia dhe absurditeti i tejskajshëm

Zhargoni totalitar

Esperantizmi

Emërzimi

Devijimi semantik

"Në përgjithësi të gjitha regjimet përpunojnë ideologji ad hoc, të cilat profilizojnë gjedhe të gjuhës për shprehjen e tyre. Kjo rrugë e shprehjes nuk përbëhet nga realitete të krijuara nga veprimtaria praktike e bashkësisë, por janë realitete të importuara ose të imponuara nga ideologjia ose individi i pushtetshëm. Një shembull tipik i kësaj është realiteti i ideologjisë marksiste në Shqipëri. Mes tri fakteve bazë që lidhen me gjuhën: përvoja - të kuptuarit e saj të shprehurit e saj, dy të fundit përbëjnë shenjën: në rastin e stereotipizmit ideologjik, pra në rastin e gjuhës së drunjtë, nuk ka rëndësi referenti, si element i përjetuar nga bashkësia dhe që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përvojën, por krijohet një referent tjetër B, i krijuar nga vetë dogma ose i importuar. Kështu një pjesë e korpusit të fjalëve të gjuhës së gjallë pësojnë devijimin semantik: që synon imponim dhe manipulim të mënyrës së të menduarit të individëve. "E natyrshme" në gjuhë është kur bashkësia kodifikon një përvojë të drejtpërdrejtë, "artificiale", nga ana tjetër është kur bashkësia kodifikon një përvojë të importuar apo një përvojë futuriste. Në këto raste, semantizmi gjuhësor vjen si kalk, merret si i tillë dhe riprodhohet si i tillë. Përvoja e imponuar, në këtë rast, nuk është thjesht një citim, por mëton të bëhet një perceptim, botë, realitet në shoqërinë që e jeton ideologjinë."(Rrokaj&Toska,*Stereotipi ideologjik dhe pasojat e tij në gjuhë*,Seminari XXXIII Ndërkombëtar për gjuhën.....,Prishtinë 18-30 gusht). Pra një nga mënyrat parësore me të cilat operonte gjuha totalitare ishte devijimi, shmangia semantike e fjalëve/leksemave, më thjesht manipulimi semantik. Ky devijim mund të çonte deri në shpërfytyrimin të kuptimit të fjalëve me peshë që transmetonin ideologjinë bazë të rendit socialist.

Kështu fjala ateist është vlerësuar si një fjalë me ngarkesë të madhe pozitive, ateistë janë të gjithë ata njerëz që kanë besim të fuqitë e tyre, ndërsa besimtar për një njeri i cili beson në Zot, (fjala ka një nuancë negativiteti me anë të së cilës përcaktohen njerëzit e dobët, njerëzit që nuk janë luftarakë, që nuk janë në nivelin e frymës revolucionare të kohës. Shembuj të tjerë të devijimit semantik ka shumë për llojet e arteve të ndryshme që gëlonin në mbarë botën,si:arti abstrakt, impresionist, kubizmi modern, disiplina shkencore ,si: pragmatizmi, lloje sportesh si: tenisi, boksi. Këto janë trajtuar si fjalë që përmbajnë jo vetëm negativitetin, por dhe rrezikshmëri në jetën sociale dhe përballë tyre është vendosur i vetmi, uniku dhe i paqortueshmi arti dhe kultura e realizmit socialist.

Françoise Thom, në studimin me titull "Gjuha e drurit" shprehet që në fillim se: "Asnjë regjim nuk është aq prolix sa regjimi komunist dhe aq shumë xheloz për monopolin e tij mbi gjuhën; asnjë regjim nuk ka ditur ta kapë mirë gjuhën dhe ta kanalizojë për qëllimet e veta." Ky

monopol mbi gjuhën shfaqet në krijimin e një "gjuhe të re", si të thuash të një varianti ideologjik dhe në shtrirjen e gjerë që ky variant fiton, duke u marrë gjithnjë e më shumë terren varianteve të tjera të një gjuhe. Kështu, studiuesi Samara e pohon këtë në një artikull të vitit 1985: "Çështja është se ky leksik (bëhet fjalë për leksikun politiko-shoqëror) përfshin jo vetëm fjalet e termat që kanë të bëjnë me jetën dhe veprimtarinë e organizatave të ndryshme politike e shoqërore, por edhe mjaft terma nga fusha e filozofise, e ekonomisë politike, e drejtësisë, e moralit, e ushtrisë etj." Përdorimi i termave nga gjithë këto fusha në sferën që përfshin leksiku politiko-shoqëror shpjegohet me rolin ndikues e zotërues të politikës e të ideologjisë mbi format e tjera të ndërgjegjes shoqërore. Diku më tej ai e pohon "mësymjen" që ky leksik po i bënte gjuhes: "madje as që mund të vendoset një kufi i prerë midis këtij leksiku dhe leksikut të përgjithshëm. Orulli (Orwell) e kuptoi i pari se ky variant i ri gjuhësor nuk ishte një zhargon si gjithë të tjerët, porse bëhej fjalë për një metamorfozë që pësonte gjuha në kontakt me ideologjinë. Kjo gjuhë e ideologjise madje pretendonte se kishte monopolin e së vërtetës.

Pikërisht është kjo dobësi që shfrytëzohet nga hartuesit e gjuhëve totalitare, ideologjike apo dhe ato të propagandave e fjalimeve politike. Gjuha e drunjte zbuluar në fjalor i takon pikërisht kësaj kategorie fjalësh, atyre abstrakte dhe ideologjike. Manipulimi semantik ndodh në këtë mënyrë: për shenja të stabilizuara në kuptimin që, shenjat janë të perceptuara në masë të madhe në mënyrë pozitive te njerëzit, gjuha totalitare në pamundësi për të ndryshuar shenjuesin, nuk ndryshon formën edhe pse kjo nuk i leverdis, por ndryshon të shenjuarin ose thelbin e substancës. Në qoftë se entiteti/subjekti i ri do që të perceptohet pozitivisht, ose ky subjekt është perceptuar me kohë shumë pozitiv, ndryshon substancën, por jo formën e një shenje të stabilizuar dhe e percepton përsëri pozitivisht. Fjala **demokraci** mund të shërbejë si një shembull. Vendi ynë në periudhën e diktaturës nuk kishte asnjë lloj lidhjeje apo përafrimi me demokracinë, por gjithsesi shenja u jep emrave apo fjalëve të këtij sistemi një konotacion pozitiv. Po ashtu përdorimet në shtete të emërtuara si Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, Republika Demokratike Popullore e Koresë, Republika Demokratike Gjermane etj. Të njëjtën gjë mund të themi për fjalët liri, parti, diktaturë (në rastin e diktaturës së proletariatit), popull.

Një tjetër pasojë e pushtetit të krijimit të kuptimit semiotik të gjuhës është fakti se ajo që është emërtuar/etiketuar ka shumë rëndësi mënyra se si është emërtuar. Gjuha totalitare merr përparësi nga kjo, kështu ajo në fillim krijon diçka dhe më pas e emërton, ndërsa zgjedh një nga tre lidhjet themelore emocionale që njerëzit njohin: pozitive, neutrale dhe negative. Prandaj kur një regjim totalitar paraqet një realitet të ri, ose mund të krijojë një shenjë të re ose të ndryshojë kuptimin e një shenje ekzistuese dhe me këtë zgjedh kategori emocionale ose

vlerësuese, e cila i vjen për shtat qëllimit të paramenduar: p.sh fjala kulak, ateist, te internuar, imperialist, kapitalist, anglez, amerikan, borgjez e shumë të tjera. Në këtë rast në të vërtetë nuk kemi ndryshim të thelbit ose të të shenjuarit sepse ai është i njëjti, por ndryshim të formës ose të shenjuesit. Ky model ose hap devijues është me i pasur me material gjuhësor të devijuar të paraqitur në fjalor, sepse dihet që është më e lehtë të manipulosh formën se thelbin apo substancën e një shenje. Pra, ne e kuptojmë dhe e përftojmë realitetin nëpërmjet simboleve, kështu që është shumë e thjeshtë të ndryshojmë domethënien dhe kuptimin e realitetit nëpërmjet ndërrimit të kuptimit të këtyre simboleve ose në këtë rast lidhjen e simbolit me objektin.

Gjuha totalitare bëhet një mjet për të manipuluar mendjet njerëzore, një mjet fuqie, ajo kryen paralizimin e mendjeve njerëzore për të mbajtur fort devijimet semantike e kryera më lart nëpërmjet dy rrugëve: totalitarizmi komunist nxit një besim të rremë mbi fjalët, duke forcuar njerëzit të mos dyshojnë asnjë çast se fjalët nuk janë të lidhura me realitetin.

Ndalon qarkullimin e lirë të nocioneve dhe të fjalëve në shoqëri përmes të cilës ne ndryshojmë dhe përshtatim kuptimet e fjalëve sipas kuptimit tonë zëvendësues të realitetit. Ajo imponon në çdo rast një lidhje statike të ngrirë midis fjalëve dhe nocioneve që ajo ka paraqitur. Pra, pasi e ka krijuar shenjën gjuhësore të re ose pasi e ka ndryshuar shenjën ekzistuese, totalitarizmi ngrin marrëdhëniet midis fjalëve dhe mendimeve rreth saj.

Ngurtësia e këtyre fjalëve është kaq e madhe sa rrezja e tyre shtrihet në përdorimet e tyre si togfjalesha, grupe emërore, fjali, duke krijuar kështu njësi të ngurta fjalësh në trajtën e togfjaleshave të ngrirë, të grupeve emërore të ngrira, klisheve të ngrira, deri dhe në fjali të ngrira. Këto njësi të ngurta ose njësi fjalësh të drunjëzuara janë të krijuara jo vetëm nga bashkimi i fjaleve të ngurta me të tjera të ngurta, por edhe gjatë bashkimit fjalë të ngurta me fjalë neutrale. Po ashtu një fjalë e ngrirë shërben edhe si bosht semantik për të mbledhur rreth fjale e grupe të tjera fjalësh. Fjala ballist kuptimi i së cilës është dhënë në fjalor:

Ballist-Anëtar i 'Ballit Kombëtar' (organizatë politike tradhtarë e borgjezise dhe e çifligareve, që bashkonte rryma të ndryshme reaksionare në kohën e Luftes Nacionalçlirimtare dhe që me një program demagogjik nacionalist iu kundervu Frontit Nacionalçlirimtar e bashkëpunoi me pushtuesit fashistë e nazistë).

Kundrejt ballistëve do të vihej fjala partizan e komunist. Fjalë të tjera idealist e materialist që përmbajnë në të vërtetë një trajtim filozofik shumë të thellë, shkolla të veçanta e histori rrymash e qëndrimesh filozofike dhe nuk kanë lidhje me asnjë qëllim politik. Shndërrimi bëri që idealist të quhej një person i cili ishte ithtar i idealizmit në filozofi dhe materialist iu përgjigj kryesisht materializmit. Shndërrimi bëri që këto fjalë të përdreshin për qëllime ideologjike.

Fokusohe mi në zëvendësimin e kuptimit të disa fjalëve. P.sh: fjalët Perëndim dhe Lindje. Ajo çfarë na intereson në analizën tonë është ana politike dhe jo gjeografike e këtyre fjalëve. Në fjalor është dhënë: PERENDIM m. 3. Vendet a shtetet kapitaliste te Evropës Perëndimore si dhe të Amerikës. Monopolistet e perëndimit. Sthurja (degjenerimi) në perëndim. Kjo, sepse këto shprehje i referohen jo vetëm vendeve të vendosura në lindje ose perëndim të Shqipërisë, por ato përfshijnë gjithashtu Austrinë, Italinë, Amerikën, Norvegjinë etj. Fjala kapitaliste, mund të përdoret si një sinonim për këtë koncept të veçantë. Ky kuptim reflektohet në ndarjen e botës: në pjesën perëndimore dhe pjesën lindore. Është me interes të theksohet se asnjë ndryshim semantik nuk ka ndodhur në lidhje me fjalët, por ndryshimi (devijimi) është në një pjesë të konceptimit të fjalëve, në një shtesë konceptuale të re, bashkangjitur me vlerësimet përkatëse emocionale dhe kaq i mjaftonte regjimit për t'i përdorur fjalët Lindje dhe Perëndim për qëllimet e tyre. Terma ,si: humanizmi, liria, demokracia, populli, barazia, drejtësia, kapitalizmi, lindje, perëndim, kur bashkoheshin me fjalë të tjera nuk kishin asnjë lidhje me kuptimin e tyre të parë, bashkime të tilla nuk ofrojnë gjë tjetër në gjuhën e drunjtë vetëm përbuzje, arrihej të bëhej dhe devijimi tyre: humanizmi kishtar, demokracia borgjeze, barazia në vendet kapitaliste, drejtësia imperialiste etj.

Rast kur me fjalët bashkoheshin mbiemra të vlerësuar si negativë: perëndimor, reaksionar, kapitalist, kapitalizues, revizionist, amerikan, imperialist, borgjez, anakronist, spiun, kundër revolucionar, konspirues, oportunist, diferencues, liberal, reaksionar, luftënxitës, modern, mikroborgjez, antipopullor, fetar, sabotues, ekspansionist, idealist, etj.

Nje grup tjetër mbiemrash është parë si pozitiv në mënyrë të padiskutueshme dhe shërbenin si për devijim dhe për përforsim devijimi: popullor, demokratik, proletar, internacional, socialist, komunist, moral, progresiv, luftues, luftarak, revolucionar, vetëmohues, marksist, leninist, masiv, punëtor, materialist, etj.

Më sipër janë dhënë vetëm shembuj njëfjalësh nga fjalori . Rast kur një fjalë me rëndësi të madhe për regjimin e saj kohe përbënte një bosht semantik dhe krijonte një numër të madh njësisht të tjera të ngrira të përbëra nga dy ose më shumë fjalë. Marrim fjalën popull dhe e ilustruam me fjalët që janë grumbulluar rreth saj: ushtria popullore, pushteti popullor, gjyq popullor, gjykates popullor, republika popullore e Shqipërisë, drejtësia popullore, keshilli popullor, vetëmbrojtja popullore, policia popullore. shkenca popullore, shtypi popullor, sport popullor, hakmarrja popullore, antipopullor, kuvendi popullor, masat e gjera popullore masat e gjera punonjëse), uniteti Parti - popull etj. Shembull tjetër është fjala refren për kohën armik: armik i popullit, armik i Partisë, armik i masave punonjëse, armik i përparimit, armik i socializmit (komunizmit), armik i klasës (punëtore), armik i pushtetit popullor, armik i revolucionit, etj. Pasi kemi dhënë filozofinë e krijimit dhe e vendosjes së gjuhës totalitare, do

të japim faktet gjuhësore të vjelura në bazë të mendimit të Rrokaj dhe Toska se si është vendosur e renditur kjo gjuhë, mënyrat si ka operuar devijimi semantik i gjuhës së drunjtë në fjalor, cili është trajtimi leksikor dhe semantik. Gjuhën e drunjtë në Fjalorin e gjejmë në tre rrugë, që lidhen me mënyrën e shpjegimit të fjalëve në fjalor:

- 1) Në shpjegimin leksikor tërësor të fjalës;
- 2) Në një pjesë të shpjegimit, në disa ose ndonjë përbërës kuptimor.
- 3) Te shembujt, te frazat e fjalitë që tregojnë përdorimin e fjalëve

Sipas rrugës së parë bëjnë pjesë shpjegimet leksikore të cilat i nënshtrohen një formulimi ideologjik që nuk kanë lidhje me realitetin gjuhësor. Ky tip është i imponuar nga ideologjia Në këtë grup fjalësh bëjnë pjesë të gjitha fjalët që përbëjnë kolonat e manifestit të komunizmit, si: socializëm, komunizëm, komunist, parti, popull, imperializëm, borgjez, reaksionar, marksizëm, leninizëm, etj. Ilustrojmë me shembuj: IMPERIALIZEM m. Faza me e lartë dhe e fundit e kapitalizmit, që karakterizohet nga përqendrimi i prodhimit e i kapitalit në duart e monopoleve të mëdha e nga sundimi i oligarkise financiare, nga krizat dhe nga kontradiktat e lufta e papajtueshme ndërmjet vendeve të mëdha kapitaliste për të siguruar lënde të para e tregje, për të eksportuar kapitalet, për të pushtuar vende të tjera, për të rindarë botën dhe për të shfrytëzuar gjer në palcë popujt e tjerë; kapitalizëm monopolist, formë e organizimit ekonomik, politik e shtetëror në këtë fazë të lartë e të fundit të zhvillimit të kapitalizmit monopolist, parazitar e në kalbëzim. Imperializmi amerikan (anglez, gjerman, japonez...). Imperializëm ushtarak. Krerët e imperializmit. Shërbëtor i imperializmit. Kriza e imperializmit. Lufta kundër imperializmit. Kjo fjalë është një nga fjalët kryesore që përbëjnë stereotipitetin ideologjik të kohës, kështu që asnjë shpjegim individual nuk mund të bëhet për të, koncepti i saj vjen si kalk , jo si interpretim natyral i bashkësisë njerëzore. Prandaj imperializmi duhet të pranohet pa asnjë lloj mëdyshjeje si një sistem shumë negativ për shoqërinë dhe shumë i rrezikshëm,duhet të shmanget dhe të luftohet.Po ashtu shih internacionalizëm,marksizëm,proletariat,komunizëm,socializëm në fjalor.

Devijimi semantik në të vërtetë ka të bëjë me dukurinë e manikeizmit, pasi ashtu siç e shpjegon Thom qëllimin e krijimit të gjuhës së drunjtë sovjetike për të pasqyruar një botë të ndarë në dy fusha lufte që i kundërvihen njëra-tjetrës dhe nuk mund të kenë asnjë lidhje ,asgjë të përbashkët me njëra-tjetrën, pra e gjitha bota sipas këtij studiuesi shpjegohej nga gjuha e ish- Bashkimit Sovjetik në këtë mënyrë, e vjetra - e reja, errësira-drita, regres progres, fitore-humbje, miq - armiq, masa-individi, nuk mund të ketë asnjësi në këtë jetë shoqërore, pasi jeta është tërë kohën në gjendje lufte dhe duhet patjetër të zgjedhësh një kamp luftues. Pikërisht ky ka qenë dhe qëllimi i devijimit semantik të kryer në fjalorin e 1980.

Ajo se çfarë u konstatua tjetër gjatë analizimit të fakteve gjuhësore ishte se numri i fjalëve që përbëjnë themelet apo bazën e ideologjisë ishte shumë i vogël. Më pas me anë ketyre fjalëve të devijuara në mënyrë të plotë janë krijuar të tjera fjalë të devijuara . Këto fjalë janë në numër shumë më të madh në krahasim me numrin e fjalëve që përbëjnë bazën e ideologjisë totalitare. Devijimi, arritur vetëm në një përbërës kuptimor ose disa, është kryer në këtë mënyrë: DJATHTIZEM Rryme armiqësore e reaksionare që lufton kundër vijës revolucionare brenda nje partie komuniste ose brenda lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe që i shërben borgjezisë e kapitullon përpara saj, oportunitizëm i djathtë, pikëpamjet, qëndrimet e veprimet e përfaqësuesve të kësaj rryme. Rreziku i djathtë. Lufta kundër djathtëzimit; vetëm me anë të fjalëve ose emrave: Rrymë armiqësore e reaksionare, lufton kundër vijës revolucionare me përdorimin e pjesës së fjalëve bazë ideologjike.

Shembuj të tjerë të këtij lloj devijimi që janë arritur të bëhen vetëm me anën e një përbërësi të devijuar ose disa janë: pionier, fatos, autarki, anëtar, autokritike, anglez, amerikan, amerikanate, amerikanizoj, antimilitarizem, antipushtet, antipopullor, antizogist, andart, argiomarksist, et po ilustrime dhe disa shembuj nga fjalori. FARKËTOHEM vetv. 1. Kalitem fizikisht e moralisht, bëhem i aftë për të kapërcyer veshitë e pengesa, edukohem e pajisem me vetitë e revolucionarit të vendosur dhe me tiparet e moralit komunist, formohem nga ana ideopolitike, profesionale etj. Farkëtohem në punë (në aksione). INDIFERENTIZEM m. libr. Te qenët indiferent; qëndrim a sjellje prej indiferenti, moskokëçarje, mosinteresim për punën dhe për jetën e të tjerëve, për problemet shoqërore dhe që është një shfaqje mikroborgjeze. Indiferentizem politik. Shfaqje të indiferentizmit. Lufta kundër indiferentizmit. Sillet me indiferentizem Bie në indiferentizem. Përbërësit semantikë me anë të të cilëve fjala është devijuar janë: shfaqje mikroborgjeze. DEVIACION m. sh. Shmangie nga parimet e marksizëm-leninizmit, largim nga vija e përgjithshme politike e nje partie marksiste; grup anëtarësh në gjirin e një partie marksiste që shmangen nga vija e përgjithshme e kësaj partie dhe synojnë të bëhen një rrymë më vete. Deviacion i djathtë/ i majtë. Deviacion oportunist (anarkist, socialdemokrat). Lufta kundër deviacioneve.

Gjuhën e drunjtë e gjejmë edhe në formulimin e pjesës së shpjegimit leksikor të fjalës. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një devijim semantik të kuptimit të fjalës, por me një konceptim të devijuar pjesërisht të fjalës në tërësi ose në ndonjë përbërës kuptimor të saj, ose e thënë me thjeshtë në shtim të një konceptimi ideologjik. Të kesaj natyre janë fjalët të cilat në vetvete përmbajnë një shenjim neutral, por dhe këto nuk i kanë shpëtuar asaj tendence për ta ndarë botën në bardhë e zi.: arsim, antagonizëm, aristokrat, auditor, arendë, atë, argat, aparat (kupt. 3), anti amerikan, antidemokratik, antizogist, shoqëri anonime, andart, etj. IMORAL mb. 2. Që shkel kërkesat e moralit socialist, që është në kundërshtim me moralin tonë, që

dëmton e prish moralin e shëndoshë. Vepër (shfaqje) imorale. Sjellje imorale. ELITE f. përmb. libr. Pjesa me e lartë e me e privilegjuar e klasave, e shtresave, a e grupeve shoqërore sunduese ne vendet borgjeze e revizioniste përkundrejt klasave e shtresave të shtypura dhe njerëzve te thjeshtë, pjesa më e mirë e më e zgjedhur e nje terësie. Elita e privilegjuar. ARSIM m. Terësia e njohurive dhe e shprehjeve që jepen me sistem e sipas një programi në shkolla e kurse të ndryshme për të mesuar e për të edukuar brezin e ri dhe masat e gjera punonjëse; sistemi i shkallëzuar nëpërmjet të cilit jepen keto njohuri; përhapja e diturive në masat, si një nga fushat e veprimtarisë shoqërore, arsimin. HUAJ mb. 7. fig. Që i kundërvihet frymes sone nga përmbajtja e nga idetë ose që është larg saj, që nuk ka të bëjë fare me pikëpamjet dhe mendimet tona, që është në kundërshtim me idetë e marksizmit dhe pengon zhvillimin e shoqërisë. Shfaqjet e huaja. Qëndrim i huaj. Sjellje e huaj. Konceptet e huaja në ndërgjegjen e njerëzve. Kjo është e huaj për ne.

EGOIZEM m. Tipar borgjez a mikroborgjez i një njeriu që mendon vetëm për vete, që do vetëm vetveten e nuk shqetësohet për të tjerët, që vë interesat vetjake mbi interesat e shoqërisë. Egoizem borgjez (mikroborgjez). Egoizem profesional. Ndjenja e egoizmit. Shfaqje egoizmi AUDITOR m. sh. 3. fig. Vend ku mësohet për të zgjeruar e për të theluar njohuritë teknike e shkencore, politike, ideologjike etj. Kthehet në një auditor të madh, ATË. 4. fet. Titull fetar që u jepet priftërinjve a murgjve; në sh. apostujt, shenjtorët që i kanë sjellë shërbime kishës në veprimtarinë e saj reaksionare (ne vendet ku vepron kisha e krishterë në të kaluarën edhe në Shqipëri). Atë shpirtëror. Etërit e kishës.

Në ndihmë të devijimeve të drunjëzuara vjen edhe pjesëza GJOJA, në sferën e ligjerimit fetar të dhënë në fjalor: FERR m. 1. fet. Sipas perfytyrimeve fetare: Vend ku **gjoja** shpirtrat e te vdekurve mundohen e vuajnë për mëkatet që kanë bërë në të gjalle; sketerrë. kund parajsë. Ferri dhe parajsa; Mundimet e ferrit. Si në ferr. FILANTROP m. sh. libr. 1. Ai që u jep te varferve ndonje lemoshe gjoja për të treguar se i ndihmon, ai që përkrah nevojtares sa për sy e faqe, ai qe merret me filantropi (në vendet borgjeze). Siç shihet çdo gjë që i përkiste botës së huaj, asaj borgjeze. Po ashtu, foljet drunjëzohen te fjala dervish –murg i sektiit bektashian, qe jeton e kryen shërbime... (në vendet ku **vepron** feja myslimane); te devocion ne kuptimin 2..... (në vendet ku **vepron** feja); te arendë, argat (në vendet ku **sundon** prona private e tokës; po ashtu edhe aty).

Një rishkrim të historisë sipas konceptit oruellian në romanin e tij "1984" shfaqet edhe te ANTIZOGIST mb. hist. 1. Që luftonte kundër regjimit antipopullor të Ahmet Zogut, që

drejtohej kunder regjimit zogist. Lëvizje (demonstrate) antizogiste. Grup antizogist. 2. si em. -
-Im sh-E-ET. Kundërshtar i regjimit antipopullor të Ahmet Zogut.

Pësojnë devijimin semantik dhe fjalët që i përkasin ligjërit fetar në shqipë, si p.sh. FE Besimi i verbër se gjithçka në botë përcaktohet e drejtohet **gjoja** nga forca të mbinatyrshme, hyjnore, i cili ka lindur qysh në kohë shumë të hershme dhe është i papajtueshëm me botëkuptimin shkencor, materialist; tërësi dogmash që japin një botëkuptim fund e krye idealist e reaksionar, i cili është armik i betuar i përparimit e i shkencës, dhe përdoret nga klasat sunduese për të mashtruar e për të nënshtruar masat punonjëse; besimi te zoti. Feja e krishterë (ortodokse, katolike, myslimane); Origjina (përhapja) e fesë. Lufta kundër fesë. Ndërroi fene. Mohoj (luftoj) fenë. **Feja është opium për popullin**. Shkalla e lartë e agresivitetit ideologjik shfaqet në çdo përbërës të përshkrimit kuptimor. Mbiemri "i verbër" asgjëson gjithë shpjegimin dhe leximin e saj. Po ashtu të vihen re shembujt që të mësojnë të luftosh, të mohosh fenë, sepse ajo është opium për popullin. Gjuha e drunjtë ndërfitet jo vetëm në përkufizime leksikore e kuptime të para, në kuptime të tjera të fjalës, të dyta, me radhë, por arrin të veprojë deri edhe në shembujt e ilustruar të fjalorit : **BLLOK** vetëm pas njëmbëdhjetë kuptimeve është dhënë në fund në një përdorim pa u lidhur me shpjegim leksikor ,si:BLLOK m. sh. 11. fig. Grup i madh sendesh, njesish a çështjesh që merren si një e tere. Bllok kryesor. Zgjidhja e çështjeve në bllok. Si bllok graniti shih te GRANIT-I 1. Jemi (qëndrojmë) bllok jemi të bashkuar fort, qëndrojmë të bashkuar njësh dhe pa asnjë të çarë. E ka bllok me dikë; është i lidhur ngushtë me dikë, nuk ndahet prej tij. Edhe pse fjala nuk është përdorur në mënyrë ideologjike, ajo nuk mund të lihej pa u përdorur duke shfrytëzuar semantikën e kohës dhe duke e kthyer në një fjalë në funksion të ideologjisë , frymës së kohës, unitetit, bashkimit në ide, punë e luftë.

"Gjuha e drunjtë shfaqet në shembujt ilustrues të kuptimeve të leksemave. Aty shembujt janë sintagma e më rrallë fjali, të cilat kodifikojnë, ndërfitjen në sistem të gjuhës së drunjtë. Me tepër se të japin një realitet të përdorimit të fjalës e kuptimit të saj në shqipen e atëhershme, shembuj, në pjesën më të madhe të rasteve, synojnë të mësuarit e ideologjisë dhe, në rastin më të skajshëm, të ndërhyjnë në strukturën semantike të fjalës e përdorimin e saj në ligjërim. Kështu, me qëllim të qartë didaktik, shembujt synojnë a diktojnë ligjërimin e atyre që do të përdorin fjalët në komunikimet e tyre."(shih Rrokaj & Toska, *Stereotipi....*)

Po citojmë më poshtë një tufë frazash e fjalish, pjesë e arsenalit ideologjik që vijnë si shembuj në fjalë, që nuk janë domosdo pjesë e ligjërit politik. Mund të vihet re mësymja ideologjike që u bëhet fjalëve të leksikut të përgjithshëm prej këtyre shembujve, pasi është pikërisht kjo

pjesë ajo që na ka dhënë më tepër material për të studiuar gjuhën e drunjtë totalitare. Ato përbëjnë në të vërtetë gjithë pjesën ideologjike të fjalorit: jeta e atëhershme, edukim komunist, punë vullnetare, njollë politike, njeri me njollë në biografi, Front Demokratik. RPSSH, PPSH, diktatura e proletariatit, referendum popullor, vija e drejtë, shfaqje e huaj, hero i punës socialiste, Sekretar i Rinisë, Sekretar i parë, i deleguari i Komitetit, i dërguari i posaçëm, armiqtë e klasës, aderoi në parti, afri klasore, afrimi i kongresit, afrimi me bazën, me masat, aksion me goditje të përqendruar, ana ideo-profesionale, analizë marksiste, armiqtë e mundshëm, çetat e vetëmbrojtjes popullore, dënim politik, dënimi i shfaqjeve të huaja (dënim i zakoneve prapanike, i diferencimit klasor), diktati imperialist, diskriminimi i zakoneve, (në vendin kapitalist). Divergjencia ideologjike, diversionet e organizatave armiqësore, drejtësia e vijës marksiste, dualizëm i papranueshëm, dyfishohet prodhimi, E presim kryelartë festen!, Ecim kryelartë!; element sabotues, element turbullues; heroizem masiv; kasapët imperialistë.

anglo-amerikan -Klasa antagoniste (antagoniste); E ardhme e lumtur (e ndritur, e shkëlqyer). E ardhme e sigurt (e dyshimtë). E ardhmja e fshatit. E ardhmja e vendit (e popullit). Ndërtojmë të ardhmen. Punoj për të ardhmen. Siguroj të ardhmen. Te gjithë shembujt janë në kuptimin e dytë të fjalës "e ardhme". Janë të gjitha shprehje të gjuhës së drunjtë. Ose - Arkitekt i revolucionit (i socializmit) në drunjëzimin "arkitekt": (Armëmbajtës- Ai që punon në shërbim të dikujt, vegël e dikujt). Armëmbajtësit e borgjezisë, Armik i përparimit (i lirise); Vend (shtet) armik. Ushtri (forca) armike. Llogoret armike. Element armik. Operacioni armik i dimrit. ("armik"); Punë (veprimtari) armiqësore. Veprim (akt) armiqësor. Politikë (propaganda) armiqësore. Qëndrim armiqësor. Qëllime armiqësore, Arsenal ideologjik (politik), Arsimon masat (popullin, Arti popullor, kombëtar). Arti socialist (revolucionar). Arti përparimtar. Vepër arti. Punonjësit (dashamirët) e artit. Ngre në art. Në njësinë e drunjtë Art shembujt janë që në kuptimin e parë. Pamja dhe imazhi ideologjik që krijojnë shembujt sjellin qartësi. Kemi një përputhje të qartë mes ideologjive socialiste, komuniste dhe nacionaliste. I arratisur politik ky është shembulli i parë që jepet në kuptimin e fjalës "i arratisur". Shembulli flet qartë! Apo shembuj në një fjalë të përgjithshme, si: aspekt- Aspekti politik (ideologjik). Aspekt i luftës së klasave; te fjala ashpërsoj- Ashpërsimi i kontradiktave (i marrëdhënieve). Ashpërsimi i gjendjes (i krizës). Ashpërsimi i luftës së klasave. Shembull i parë te fjala "atdheu"- Atdheu socialist. Kurse në kuptimin e dytë kemi shembullin :Atdheu i socializmit; Atmosferë -Atmosferë eshëndoshë (e gjallë). Atmosferë revolucionare. Atmosfera politike. Atmosferë pune (lufte) etj.

Monotonia dhe përsëritja.

Përsëritja ishte një mjet i fuqishëm në duart e gjuhës totalitare sepse siguronte një rend ciklik fjalësh, termash, shprehjesh e klisesh që luajnë rolin e një lavazhi truri. Ideologjia duhej promovuar duke dhënë bazën, terminologjinë. Nuk ka rëndësi se çfarë shenjimi i japim apo çfarë shpjegimi i japim secilit term, shpjegim i kuptimtë apo i pakuptimtë, shpjegim real apo joreal, mjafton që fjalet t'i përmbahen asaj që synohet dhe të përsëriten sa më shumë të jetë e mundur deri në ekstrem duke e bërë gjithë leksikun e fjalorit të drunjte, jo vetëm të varfër, abstrakt, por edhe përsëritës, monoton deri të mërzitshëm:

Shfrytëzohet me borgjezia shfrytëzon klasën punëtore (proletariat, gratë, fëmijët), etj.

Shkul me shkulim nga rrënjët besëtytnitë, paragjykimet fetare, etj.

Shtrembërim me shtrembërime në vijën politike, etj.

Thyej me thyejmë çdo bllokadë, agresion imperialist, agjenturë të borgjezisë, etj.

Pseudo- me vende pseudoasnjëse (për vendet perëndimore), pseudofilozofët revizionistë, pseudoatdhetarët e Ballit Kombëtar, etj.

Sthurje me shthurje e rinisë në vendet borgjeze, revizioniste, kapitaliste, perëndimore, etj.

Shembull më konkret: fjala KRIZE me kriza e rendit kapitalist. Kjo fjalë është shpjeguar kështu në fjalor:

1. ek. gjendje a periudhe shumë e rëndë ekonomike e vendeve kapitaliste, që shfaqet herë pas here me superprodhim mallrash, me rënien e prodhimit, me falimentim në masë të ndërmarrjeve ekonomike, të bankave, me shkatërrimin e prodhuesve të vegjël, me ngritjen e çmimeve me shtimin e papunësisë dhe me varferimin e metejshëm të proletariatit e të masave të tjera punonjëse. 2. Gjendje e vështirë në një fushë (politike, ekonomike etj) kur kontradiktat janë ashpërsuar shumë deri në shperthim dhe kur ka çrregullime të rënda në këtë fushë. Siç shihet kemi përsëritje të fjalëve bazë: **kapitaliste, proletariat**. Kur bëhet fjalë për shpjegimin e përbërësve që përmbanin konotacion negativ për jetën socialiste, në mënyrë të padiskutueshme do të ekzistonin edhe shembuj me fjalë si: luftoj, mposht, diskreditoj.

Përmbysje me përmbysje e rendit të vjetër; Sundoj me sundim kolonial, imperialist, borgjez; Çakall me çakejtë gjakpirës, çakejtë imperialistë, reaksionarë, etj. Pazarllëq me pazarllëqet diplomatike, të industrialistëve imperialistë; Demaskim me demaskimin e fesë, armiqve, tradhtarëve; Asgjësoj me asgjësoj diversantët, asgjësoj bandat.

Kjo rrugë ndiqet edhe në fjalët që përmbajnë pozitivitet në semantikën e tyre; është shfrytëzuar përdorimi i shpeshtë dhe i pamungueshëm i fjalëve kyç të dhënies së "lartësisë së rendit socialist". Detyrimisht do të ndiqet e kundërta me rastet e fjalëve të mësipërme (negative), kështu fjalët mbroj, ndjek i/e ndritur, i/e sigurt, dritëplotë, i çeliktë, ndërtoj, e

lumtur, edukoj, demokraci, fryma, unitet, liri, bashkoj, i/e begatshme, besoj, betohem, besnikeri, bollek, çelik, etj. Do të kishim shprehjet: Mbroj atdheun socialist, Ndjek vijën e partisë, Udhëheqje e ndritur, e ardhme e ndritur, E ardhme e sigurt, Udhëheqje driteplote (Partia na dritësoi). Udhëheqje e çelikle, unitet i çelikle, rini e çeliktë, edukim komunist, edukim klasor, fryma e aksionit, frymë revolucionare, fryma e proletariatit, unitet i pathyeshem, unitet ideologjik, unitet i pikëpamjeve, besnikëria ndaj vijës(idealeve të Partisë).

Ajo çfarë është më e rëndësishme është se shprehje të tilla që japin platformën ideologjike të realizmit socialist të ideve të pagabueshme të idhujve Marks e Engels, përsëriten në mënyrë të vazhdueshme, kështu me një mesatare çdo tre deri në katër faqe të fjalorit të gjuhës shqipe 1980 mund të mendohet lirshëm se një faqe e tërë i përket pikërisht ideologjisë së asaj kohe. Rreth tridhjetë e katër përqind e veprës është e tillë. Fjalët SOCIALIZEM, KAPITALIST, IMPERIALIST, KOMUNIST, POPULLI, PARTI, MARKSISEM-LENINIZEM, janë përdorur e përsëritur me një frekuencë shumë të lartë në krahasim me fjalët e tjera që mund të përmbajë një gjuhë.

Klishetë: Nga të gjitha tiparet e gjuhës së drunjtë, klishetë janë ato që të lejojnë të studiosh tërë detajet njëherësh së bashku rreth menyrës depërtuese, funksionimit dhe strukturës së gjuhës së drunjtë. Këto shprehje janë një karakteristike shumë e rëndësishme e gjuhës totalitare dhe një tregues më i qartë dhe më i plotë i natyrës së vërtetë të këtij fenomeni, pasi te klishetë veçojmë: 1. Shkëputjen e shenjës me të shenjuarin 2. Struktura të gatshme 3. Ngurtësinë e njësisë 4. Artificialitetin 5. Mungesa e autenticitetit(origjinalitetit) 6. Stereotipitetin 7. Përsëritjen (mbipërdorimin)

Një klishe është një shprehje, një ide ose element i një veprë artistike e cila është mbipërdorur aq shumë sa ka humbur origjinalitetin, kuptimin dhe efektin e saj deri në atë pikë sa është bërë e vdekur, irrituese, sidomos kur kohë më parë , ajo është konsideruar kuptimplotë ose risi. Pamja e klisheve gjeneron një ankth të autorësisë si një shprehje e përbashkët, klisheja interferon në konceptin e origjinalitetit të shkrimtarit, në vlerat e tij dhe në vlerat e kuptimeve që janë prona të këtij shkrimtari. Studiues të ndryshëm argumentojnë se si shprehje të gatshme, të vdekura, janë joreflektuese e zënë një vend funksional në gjuhë, vend jo plotësisht të pakuptimtë semantikisht. Studiues të tjerë shprehen se klishetë nuk duhen trajtuar vetëm si fjalë boshe, por ato i qëndrojnë faktit se klishetë mbajnë një të vërtetë, një të vërtetë të vjetër të dukshme, kjo jo prej përmbajtjes semantike, por prej përdorimit të tyre të përsëritur. Dhe nuk ka të vërtete me te madhe se klishete jo aq shumë një përmbajtje të vërtetë semantike sesa fshehje të së hidhurës jetë totalitare. Klishetë janë shprehje gjuhësore të gatshme, e

metaforave te vdekura dhe fjalëve të mbiperdorura. Klishtë nuk e lejojnë folesin apo shkruetin që të jete i lirë në zgjedhjet që bën e mungesa e lirisë së zgjedhjes dhe te kombinimeve , çon në mënyrë të patjetërsueshme në nje gjuhe opake.Ato mësohen më shpejt nga gjithçka në gjuhë. Me konkretisht, ne do të studiojmë atë se çfare quan studiuesi Ardian Vehbiu me klishe: "Me klishe kuptohen bashkimet e fjalëve, bashkim ky që nuk është i detyrueshëm gramatikisht dhe që përdoret aq shumë sa e ka humbur fuqinë e saj shprehëse bashkë me kuptimin logjik.": Fitore e lavdishme, mobilizim revolucionar, marshojmë perpara, thjeshtësi proletare, heroizëm i pashembullt, thjeshtësi proletare, marshim i pandalshëm, unitet i çeliktë, kontradikta të papajtueshme, dualizëm i papranueshëm, grushtbashkuar, etj. Në rolin e klisheve janë përdorur edhe ndajfoljet: kudo, mbarë, me mish e me shpirt, pa përjashtim, pa pushim. lart e më lart, me çdo kusht, fund e krye, në të gjitha drejtimet, deri në pikën e fundit të gjakut;mbiemrat: e pakompromis, te paçmuar, e përherëshem, i përjetshëm, i lavdishëm, të pakundërshtueshëm, i paharrueshëm, i paapelueshem, i padiskutueshëm. Shembuj të klisheve: aktivizimi i masave, akumulimi socialist, paragjykimet fetare, imperializmi amerikan, shfaqje e huaj, prona socialiste, agjitacion e propaganda, diktatura e proletarietit, plani pesëvjeçar, marksizem-leninizëm, armiku i popullit, i deklasuar, vegël e armikut, bindje ateiste, vihet në shërbim të të huajve, popull i bashkuar, jete e begatë, partia e punës, pasuria e popullit , mbledhja e bllokut, biografi e pastër, njolle ne biografi, i denuar politik ,unitet i çeliktë, afrimi me shokët, luftë e pakompromis, vendim i paapelueshem, argument i pakundershtueshëm, etj.Klisheve linguistike u është bërë një klasifikim (është fjala këtu jo për klishe gjuhësore të tematikës ideologjike), por ne po i bëjmë një paralelizëm me klishtë e gjuhës totalitare, për të parë se si janë vendosur ato në këtë gjuhë:1. Klishtë-Idioma 2. Klishtë-Proverba 3. Klishtë-Metafora 4. Klishtë-Krahasime 5. Klishtë-Slogane – Parulla. Si idioma, mund të përmendim: ndajmë shapin nga sheqeri, rreshqiti nga vija, hedhin baltë(mbi fitoret tona), Ndajmë grurin nga egjri, etj. Ato dallojnë me nj.frazeologjike në këto drejtime: figurshmëria dhe kuptimi i plote i implikuar,joliteral te nj.f ;nj.fr.përdoren me pak se klishtë;nj.f janë origjinale,sjellin zhdërvjelltësi,larmi,individualitet,por klishtë sjellin të kundertën;nj.f. sjellin histori në çdo kohe dhe klishtë dalin sh.kollaj nga përdorimi;nj.f. nuk mund të përkthehen fjalë për fjalë,klishtë nuk kane el.etnografike dhe perkthehen literalisht,si rasti I klisheve të komunizmit të njehta ne të gjitha vendet me teorinë marksiste(përkrahëse). Në mbështetje të superioritetit të njësive frazeologjike japim përkufizimin:Njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përberë nga dy ose me shume fjalë shënjuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e nje fjale të vetme, riprodhohet në ligjerim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme.Klishe si proverba: Nje dru i shtrembër prish tërë

stivën!, Uji fle, hasmi s'fle!, Delen që ndahet nga tufa e ha ujku!, Le të lehin armiqtë!, etj. Proverbat janë fraza të shkurtra që shprehim me pak fjalë filozofinë popullore (urtësinë popullore). Pikërisht për këtë arsye ato quhen dhe ndryshe fjalë të urta; gjuha totalitare i ka përdorur për t'i shërbyer qëllimeve të saj për të qenë më afër dhe më të kuptueshëm me popullin dhe ka arritur të zgjedhë prej tyre ato që i shërbejnë ideologjisë revolucionare, ideologjisë kundër të huajve, armiqve e vigjilencës ndaj tyre. Disa herë ata kanë imituar duke zëvendësuar fjalë si te: Le te lehin armiqtë! Por sërish keto klishe - proverba janë të pakta për arsyet e njëjta që përmendëm për shprehjet frazeologjike. Krahasimoret: Si nje grusht i vetem, si nje trup i vetem; jetojmë, punojmë si në rrethim, ta mbajme te pastër Partinë si ujët e kulluar; Si metafora: Heroika e diteve tona, njollë në biografi, çrrënjësja e zakoneve prapanike, pastrojmë radhët, shkulum nga rrënjët mendimet prapanike, i prekur (për biografinë), lakra ne koke, korr fitore, shtrëngojme radhët, grushtbashkuar, rrethimi imperialist-revizionist, lufta e klasave, popull ushtar, ndertoj jeten e re, ndërtimi i socializmit, aksion me goditje te perqendruar, biografi e pastër, shfaqje e huaj, agimi i lirisë, agimi i jetës së re, e ardhmja e ndritur, farkëtimi i brezit të ri, sulmojmë kodrat, malet, greminë klasore, nga gjiri ynë, nga gjiri i kolektivit ,llogoret(barrikatat) e revolucionit, vé interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak, shkëmb graniti, ndërtimi i kulturës së re, nën kamxhikun e kapitalizmit, vija e partisë, ngrejmë nivelin ideopolitik, revolucionarizojme njerëzit(ushtinë, rininë, ndërgjegjen, shkollën, prodhimin, artin, prodhimin), e ardhmja jone dritëmadhe, kalojmë nga fitorja në fitore, shkëputet nga kolektivi, ndërtojmë te ardhmen me duart tona, na dha drite partia, zëri i masës, politika e grushtit të hekurt, drejtësia e vijës marksiste, me hapin e masave, doli (u shpall) sulmues, afrimi i kongresit, afri klasore, partia na rilindi, rrënjët klasore, brumos ideologjikisht, polarizimi i shoqërisë, goditen pikepamjet e gabuara(shfaqjet e huaja), ka zemër komunisti, kalitje ideologjike (politike), zbatimi i vijes së masave, hyj në Parti, ia fal zemrën Partisë, himnizimi i së ardhmes së lumtur, afrimi me shokët, armatos me kazma e lopata, batak ideologjik, bie në idealizëm, çizmja e kapitalizmit, dënojmë zakonet prapanike, deviza e revolucionit, edukim klasor, forcat lëvizëse të revolucionit, formim ideologjik, Fronti i punës, vegël e armikut, bindje ateiste, vihet në shërbim të të huajve, popull i bashkuar, jetë e begatë, partia e punës, pasuria e popullit, mbledhja e bllokut, biografi e pastër, njollë në biografi, i dënuar politik, unitet i çeliktë, afrimi me shokët, luftë e pakompromis, vendim i paapelueshem. Klishe - metafora janë të shumta në numër në fjalorin e 1980-ës gjë që sjell që kjo gjuhë të jetë akoma më e vështirë për t'u kuptuar e përvetësuar, reflektuar mbi të dhe lidhjet që mund të ketë me realitetin. Sipas studiuesve Lakoff dhe Johnson thelbi i kuptimit të metaforës, është të kuptuarit e të përjetuarit e një lloji sendesh në terma të një lloji tjetër. Si ilustrim japim shembullin e dhënë nga Ardian Vehbiu mbi metaforën e njohur të sistemit

totalitar *JETA PUBLIKE ËSHTE LUFTË*. Pra janë dy koncepte ose dy sisteme konceptuale: një lufta që përdoret për të sqaruar me mirë tjetrin koncept. Lakoff & Johnson e trajtojnë këtë rast se "duke na lejuar të përqendrohemi në një aspekt të konceptit, metafora mund të na pengojë të dallojmë aspekte të tjera të konceptit, të cilat janë inkonsistente me atë të metafores." Metafora *JETA PUBLIKE ËSHTE LUFTË* ndihmon gjuhën e drunjtë për t'i mbajtur në errësirë aspekte bashkepunuese ose komunikuese për aq kohë sa në të vërtetë, procesi i një beteje a lufte me patjetër kërkon gjithmonë fitues dhe humbës, triumfues dhe disfatist. E njëjta gjë vlen edhe për shumicën e metaforave në gjuhën e drunjtë ;e bëjnë gjuhën më të pakuptueshme duke i detyruar akoma edhe me shumë njerëzit t'i mësojnë në mënyrë mekanike, përmendsh, pa e marrë mundimin për t'i hyrë një analize logjike, pasi kjo lloj vështirësie i pengonte, por për më tepër ato ishin klishe e tashmë atyre nuk u duhej tjetër veçse të përsërisin si papagall fjalet që nuk i kuptojnë, të kënaqur vetëm me faktin se i përmbahen stereotipeve dhe nuk rrezikohen të ndahen nga turma. Si slogane do të shfaqen:" E presim kryelarte festen!, Ecim kryelarte!, Ngrehmë lart flamujt e revolucionit!, Nuk bejmë kompromis me armikun!, Nuk pranojmë lëshime!, Nuk e ndajmë pushkën nga libri! Gjithmonë gati!, Nuk na lëkundet besimi në fitore!, E presim Majin duarplot!, E vendosim vetë fatin tone!, Kalojmë nga fitorja në fitore!, Perpara drejt fitoreve të reja!, Komunistet s'i mposht asgjë!, Partia është farkëtuesja e rinisë!, Burimi i të gjitha sukseseve është Partia!, Armiqtë s'e mposhtën dot popullin shqiptar!, Aksionet kalisin rininë!, Punojmë për një ideal!, Populli shqiptar marshon gjithmonë përpara!, Shtrëngojmë radhët rreth Partisë!, Partia krijoi njeriun e ri!, Kur flet klasa, hesht burokratizmi!, Shkojmë drejt komunizmit!, Shqipëria është një kantier i madh ndërtimi!, Revolucionet janë lokomotivat e historisë!, Me armiqtë jemi matur e do të matemi gjithmonë!, Mbrojmë parimet e socializmit!, Borgjezia përpiqet t'i gaboje masat!, Konkurrenca rrjedh nga prona private!, Jetojmë, punojmë si në rrethim!, Ushton fjala e partisë!, Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!, Na pret e ardhmja e sigurt!,Nuk i nënshtrohemi diktatit të huaj!, Votat tona janë për frontin!. Rroftë 1Maji!, Imperialistet ua grabitën lirinë popujve!, Fuqizojmë mbrojtjen e Atdheut, Vdekje kapitalizmit!, Rreziku i infektimit nga ideologjia e huaj!, Rrojmë në një kohë të lumtur! , Partia organizuesja dhe frymëzuesja e të gjitha fitoreve të popullit tone!, Qendrojmë në gatishmëri!, Organizohemi në luftë e në mbrojtje!, Feja është opium për popujt!, Përparësia e stimujve morale përpara atyre materialë!, Jemi të gjithë ushtarë të Partisë! , Populli është në fuqi!, Nuk ka art të papartishëm!, Gati për punë e për mbrojtje!, Grushtbashkuar rreth partisë!, Jetojmë, punojmë si revolucionarë!, Mesojmë, punojmë, kalitemi!, Ç'thote populli bën partia, ç'don partia bën populli!, etj.

Veshja luftarake dhe agresive në çdo moment: Vihet re se emëruesi i përbashkët i saj është agresiviteti i saj. Fjalet e huazuara nga sektori ushtarak janë të zakonshme dhe shumë të përdorura. Kjo karakteristike e gjuhës së drunjtë është një veçori tjetër e manikeizmit të botës së ideologjisë komuniste, pra sasia e madhe e termave, fjalëve dhe shembujve, me një denduri të lartë nga ligjërimi ushtarak. Ushtria, lufta ushtarake është një realitet i zakonshëm në fjalor, por edhe leksiku ushtarak shërben si metaforë për një sërë shfaqjesh të jetës shoqërore dhe politike. P.sh.: ARMATE 1. usht. Njësi e madhe ushtarake, e përbërë nga dy a me shume trup-armata dhe e pajisur për veprime luftarake strategjike. Armate tankesh. Komandant armate. 2. fig. Mase e madhe njerëzish, që punojnë së bashku në një lëmë ose për një qëllim të vetëm; ushtri. Armatë e fuqishme. Armata e punëtorëve të pararojës. Armata e arsimtarëve (e mjekëve). Vihet përdorimi metaforik në kuptimin e dytë të fjalës dhe imazhi që krijon **metafora të shoqërisë si një ushtri, prej këtej koncepti i jetës si një betejë, ndikim i ideologjisë komuniste, që është ndërfaqet gjithandej në fjalor.** Po kështu kemi edhe shembuj të tjerë të ushtrisë e ushtarakes si metaforë, në të gjithë familjen e fjalës "armë", p.sh.: ARME 3. fig. Mjet për të luftuar kundër dikujt; mjet që përdoret për t'ia arritur një qëllimi; mënyrë a arsyetim për të mbrojtur a për të rrëzuar diçka; Armë e fuqishme (e shëndoshe, e sigurt). Armë politike (ideologjike). ARMATOS (kuptimi i katërt i fjalës 4. fig. Pajis me njohuri, me dije etj. për një veprimtari të caktuar; e bej te afte për të punuar a vepruar në një fushë të caktuar. E armatos me teorinë revolucionare.); ARMATOSEM- 3. fig. Pajisem me njohuri, me dije etj. për një veprimtari të caktuar; përgatitem për të punuar e vepruar në një fushë të caktuar. Armatosem me dije. Armatosem me teorinë revolucionare. Armatosem për jetën. **Po ashtu edhe frazeologjitë janë zgjedhur nga fusha ushtarake:** Shok armësh bashkëluftëtar shok i ngushtë në përpjekjet për të arritur një qëllim politik e ideologjik të përbashkët. Shesh armësh vend ku përgatiten dhe prej ku mund të fillojnë veprime luftarake kundër një vendi tjetër. Me armë në dorë - i gatshëm për luftë; pa u dorëzuar, duke luftuar. Edhe në një **fjalë të zakonshme si ASNJANËS**, kuptimi i dytë i saj është ushtarak: që nuk mund të shërbejë si fushe luftimi ose për vendosjen e trupave ushtarake (sipas një marrëveshjeje); që nuk i përket as njërës pale, as tjetrës. Fushë (zonë) asnjësore. Po ashtu, po të ekzaminojmë fjalën (luftë) luftoj. Gjuha totalitare e mbipërdor këtë fjalë e shpesh gjendet e përdorur në luftën e klasave. Kjo hyrje e re e kësaj fjale mund të zëvendësohet me sinonime të tilla si: ofensive, sulm, betejë, agresioni imperialist, ndeshem, mbroj. Antonim për fjalën luftëtar është armik ,si tek: armiku i popullit. Lufta ishte refreni i gjuhës së drunjtë , pra imperializëm, shembulli do të jepej patjetër me luftën kundër tij; po ashtu edhe për liberalizëm, por edhe për ato pozitive lufta do të ishte prezente; p.sh; ideologjike, parimore, socializëm. Gjithsesi shembujt mund ta përshkruajnë më mirë këtë karakteristike, përmendim:

lufta kunder imperializmit, lufta për ndërtimin e socializmit, lufta kundër shfaqjeve të huaja, lufta kundër zakoneve prapanike, lufta kundër thatësirës, lufta për shtimin e prodhimit, lufta kunder indiferentizmit, lufta kundër liberalizimit, luftë parimore, luftoj konformizmin, lufte e pandërprerë, lufte ideologjike, lufte e pareshtur, luftë kundër fesë, luftë kundër individualizmit, lufte indiferentizmit, lufta për sigurimin e bukës në vend, lufta për fitoren e se rese, lufta kundër veseve, lufta për shtimin e prodhimit, lufta për ngadhënjimin e revolucionit në gjithë botën, lufta kundër obskurantizmit, lufta kundër sëmundjeve ngjitëse, lufta kunder mushkonjave, lufta kundër mizave, lufta kundër dëmtuesve të pemëve e shumë lloje të tjera luftërash e luftimesh që përbënin lajtmotivin e jetës shqiptare. **Foljet po ashtu që janë ingranuar me një frekuencë të lartë në gjuhën e drunjtë kanë të bëjnë me konceptin e luftës dhe luftimit**, p.sh: mbroj, luftoj, ndeshem, sulmoj, godas, shkatërroj, mund, forcoj, thyej, jap jetën, sakrifikohem, ekzekutoj, rrëzoj, qëlloj, zhduk përballem, pushkatoj, asgjësoj, eliminoj, shpartalloj, shfaros, armatosem, varros, vigjiloj, vetëmbrohem, sulem, mposht, etj. Pasqyrohen një sasi tjetër të madhe të termave ushtarake e fjalë ushtarake që përdreshin jo vetëm në fushën e ushtrisë ,por edhe në fusha të tjera të jetës: brigadë sulmuese, brigadier, agjent, pritë, shtab, vigjilencë, spiun, sabotator, alarm, tradhtar, beteje, përleshje, front i brendshëm, front i jashtëm, detashment, disfatë, strategji, kushtrim, mobilizim strateg marshim, fushate, plumbin ballit, komandë, si një trup i vetëm, me zjarr e hekur,batalioni i punes.Fjalë, shprehje e klishe agresive e me karakter luftarak:Agresion imperialist, shtet agresiv, zbuloj kap, asgjësoj agjenteuren, antagonizmi klasor,lufta kunder fesë, lufta kunder anarkosindikalizmit, armata e punëtorëve të pararojës, armatos vendin, armatos me kazma e lopata, e armatos me teorine revolucionare, e armatos me shkencën e përparuar(jo me fenë), i armatosur ideologjikisht, popull i armatosur, thirrja e rezervistëve, Rinia, rezerve e Partisë, mobilizimi i rezervistëve, armë ideologjike (politike), armiqtë e brendshëm e të jashtëm, armiku i klases, armiku i popullit, armiku i pushtetit, vegël e armikut, barrikade ideologjike, luftë kundër bejlerëve, lufta kundër besëtytnive, beteja klasore, beteja për buken(për mbjelljet e pranverës, për korrijet, për plotësimin e planit, për kursimet), brigade e rinise(vullnetarësh, kontrolli, prodhimi, e shtypit, e traktoristëve, blegtorisë, e fushes, etj), lufta e klasave, komunist (revolucionar, luftetar, mesues) i devotshem, Mbrojtja e Atdheut është detyrë mbi detyrat, lufta kundër deviacioneve, iku si dezertor, jemi gjithnjë në sulm, sulmojmë për fitore të reja, sulmojmë malet kodrat, sulmojmë kodrat për t'i bërë pjellore, lufta kundër djathtëzimit, lufte e drejte, dhunë revolucionare, luftojmë kundër ekonomizmit, luftojmë fanatikët, mbrojtja e fitoreve, forcohet lufta e klasave, marshim fitimtar, forcat vullnetare te Vetëmbrojtjes Popullore dhe forca të organizuara në formacione ushtarake, fshikulloj të metat, fuqizojme mbrojtjen e atdheut, Gati për punë e për mbrojtje!, Gjithmonë gati!, gatishmëria e masave,

lufta kunder hegjemonizmit, heroizmi i ndërtimit të socializmit, përgatitemi për rast lufte, Nënë Heroinë (titull nderi që u jepet nënave në kohën e socializmit në vendin tonë, nënave që kanë lindur, kanë rritur dhe kanë edukuar mire tetë femije e lart), heroizmi i klases punetore, heroizmi i fshatarësisë kooperativiste, heroizmi i rinise, revolucionarizmi i hovshëm i jetës, punojmë (luftojmë) për një ideal, Lart flamujt e revolucionit!, Le të lehin armiqtë!, luftë kunder thatësires, luftë kundër sëmundjeve ngjithëse, luftë kundër mushkonjave, luftojmë shfaqjet e huaja, Mbrojmë parimet socialiste!, armiqtë e mundshëm, sulm i mundshëm, Nuk e ndajmë pushkën nga libri!, lufta kundër ndërhyrësve të huaj, ngre vigjilencën, ngre shpirtin luftarak, ngre frymën revolucionare, armiq të çdo ngjyre (imperialiste e reaksioniste), reaksioni i të gjitha ngjyrave, organizohemi në sulme e në mbrojtje, Te jemi të pameshirshëm me armiqtë!, ushtri e pamposhtur, vend i pamposhtur, luftë e pandërprerë, e pareshtur, popull i pathyeshëm, kala keshtjelle) e pathyeshme,Eshte plumb per armiqtë!, politika e grushtit të çeliktë.**Gjuhe absurde-absurditeti në çdo qelizë të saj:**

Fjalë e togje të tilla mund të përcaktohen vetëm si të pavërteta dhe në funksion të mbajtjes së frymës së optimizmit; këto të bashkuara bashkë të krijojnë përshtypjen e një absurditeti. Shembuj që kanë të bëjnë me mbajtjen lart së frymës revolucionare, frymës luftarake dhe frymës së optimizmit: E ardhme e ndritur(e lumtur, e shkelqyer), e ardhme e sigurt, e ardhme premtuese, plan i avancimeve, Parakalojme ballëlartë!, besimi në të ardhmen, Rrojmë në begati!, të korra te begata, Në rrugën e begatise!, Bilanc fitoresh(suksesesh)!, blegtori e përparuar, të ardhura të bollshme, Pushteti është i popullit!, buçet hareja, buçet fjala e Partisë, lulezim i bujshëm, rini çelik, demokraci socialiste, demokraci popullore, demokratizimi socialist, vihet ne sherbim te të huajve, agjent i armikut, armik i popullit, bandë të arratisurish, asgjuesuan bandat, popull i bashkuar, dështimi i planeve, i kompleteve, diktati imperialist, grup diversantësh, kriza e dollarit, Na dha dritë Partia! Nën udhëheqjen e driteplote!, shtim (ndryshim, gjallëri e dukshme), E presim 1 Majin duarplot!, ka drejtësi, drejtësia socialiste, Perpara drejt fitoreve te reja! , Shkojmë drejt komunizmit!, dyfishohet prodhimi, Lindi te ne një jetë e re!,Sot fshati lulëzon, entuziazmi revolucionar, entuziazmi i klases punëtore, epërsia e rendit socialist, dita (lumturia) e endërruar, E ardhmja e fëmijëve tanë është e sigurt, mbrojtja e fitoreve, Nga fitorja në fitore! Do ta trajtojmë në dy nënndarje karakteristiken:1.absurditeti i gjuhës së drunjte i pasqyruar në fjalorin e gjuhës ,si: Socializmi të bën njeri, arti i sotëm dekadent, arti borgjez, arti revizionist, agjenturë e imperializmit, agjenturë e borgjezisë, amerikanatë(veprim që shkel rregullat e zakonshme të sjelljes në shoqëri, sjellje e shthurur, aventure per te bere bujë), amerikanizoj, administrate e kalbur(për vendet kapitaliste), sistem i kalbur kapitalist, sjell zerin e klases punëtore, dolem nga skamja,

skandalet e shoqërisë borgjeze, veçimi politik i kulakëve, skllëvër të kapitalizmit, epërsia e rendit socialist, zbulimi dhe denimi i sabotatoreve, me (ne) rrugë partie(revolucionare), në saje të udhëheqjes së Partisë, sëdër revolucionare, rreshqiti nga vija, rreshqiti në idealizem, rreshqiti në oportunizem, rreshqiti në liberalizem, rrojmë në një kohë të lumtur, rrënjët klasore, Partia në rilindi, E rindertoi gjithë vendin, zhdukja e mbeturinave të kapitalizmit në çdo fushe, diktature revolucionare, degjenerimi revizionist, referendum popullor, shpallja e referendumit, organizuam një referendum, rehabilitimi i të denuareve, forcat reaksionare, element reaksionar, shkrimtar reaksionar, vend reaksionar, libër reaksionar, përgatitemi në rast lufte, qendrushmëria e rendit socialist, në aksion mori pjesë i gjithë qyteti, puçistet kundërrevolucionarë, edukimi ideopolitik i punonjesve, bëjnë provokacione (për shtetet e huaja të hamendesuara që janë në lufte me Shqipërinë), kurdisin provokacione, Partia e proletariatit, e ardhme e sigurt, e ardhme e lumtur, e ardhme e ndritur, e ardhme e shkëlqyer, nga fitorja në fitore, agimi i lirise, frazeologji agjitative, udhëheqje e pagabueshme e shumë të tjera. 2.Pavërtetësia e gjuhës së drunjtë në fjalor,si gjuhë joreale, gjuhë e shkëputur nga realiteti:Klerikët mbillnin përçarje, përgjërimet e imperialisteve për paqe, mobilizim i përgjithshëm, votim i përgjithshëm i fshehte, vë interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak, arti i përket popullit, politika e grushtit të hekurt, ndertimi i plote i shoqërisë socialiste, u rrit pjesëmarrja e të rinjve, demokratizimi i plote, të drejta të plota, miratim i plote, përkrahje e plote, plotfuqishmëria e popullit, politika e dyerve të hapura, populli është në fuqi, demokracia popullore, poshtërsitë e ballistëve, e gjithë bota përparimtare është pro nesh, disipline proletare, oxhaqet pushtojnë qiellin, votuan një qind për qind, u qindfishua prodhimi, revolucionarizimi i thelle, revolucionarizimi i mëtejshëm, revolucionarizimi i gjithanshëm, revolucionarizimi i vazhdueshëm i pandërprerë, gjykatë revolucionare, art revolucionar, edukim revolucionar, ligje, diktature, botëkuptim, qëndrim revolucionar, romantika e diteve të sotme, rrezikshmëria e imperializmit, kapitalizmi ka marrë rrokullimën, ndërgegje socialiste, sugjerime nga masa, përparësia e stimujve moral mbi stimujt materiale, kolektiv i shëndoshe, kuadro të shëndoshë, shfrytëzimi i njeriut nga njeriu në kapitalizem, shkojmë drejt komunizmit e shumë të tjera. **Gjuhe artificiale, esperanto,esperantizmi:**Karakteristikat e rreshtuara me pare të cilat ishin devijimi semantik, klishetë, emërzimi, përsëritja, pavërtetësia dhe absurditeti nuk bëjnë gjë tjetër veçse i japin gjuhës së drunjtë një ngjyre shumë të theksuar artificializmi. Por artificialiteti i saj nuk mbaron këtu; ai vazhdon të theksohet edhe më tepër për arsyt e dhëna më poshtë. Për të kompensuar humbjet e mëdha që vinin nga reduktimi i theksuar i masës së madhe të hequr si nga ligjërimi dhe fondi gjuhësor prej gjuhës së drunjtë, gjuhës shqipe ,nën urdhrat e gjuhës totalitare, i duheshin bërë zëvendësime dhe shtime të fjalëve. Përballe politikës gjuhësore SPASTRIM dhe PASURIM, ose përballë

reduktimit/varfërimit, gjuha e drunjtë si një gjuhë "e pajetë" mund vendoste vetëm politika gjuhësore të marra nga një gjuhë tjetër artificiale , atë të esperantizmit. Gjuha esperanto, kishte në fillim të krijimit të saj si gjuhë e re një numër të vogël fjalësh, asaj iu desh të krijonte fjalë të reja nëpërmjet sufikseve të vendosura në çdo fjalë ekzistuese në funksion të krijimit në mënyrë të lehtë e të pasur të fjalëve të reja. Të njëjtën gjë do të bënte dhe simotra e saj edhe pse qëllimet e tyre janë ekstremisht të kundërta. Esperantizmin e leksikut të shqipes me të drejtë mund ta dallojmë në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe 1980 ose fenomenin e përdorimit të mjeteve të fjalëve të reja për të shprehur nocione e kuptime të rregullta leksikore. Në krijimin e neologjizmave apo të përshtatjeve të prurjeve të fjalëve të ardhura kryesisht nga ruset, shpesh vihet re një artificialitet. Ndërsa përsa i përket ligjërit, studiuesi Ardian Vehbiu del në përfundimin se shume folje në gjuhën shqipe që mbarojnë me -oj të cilat përbëjnë dhe shumicën e foljeve, të japin përshtypjen se krijojnë rreth vetes në fjalorin e 1980 ,pothuaj vetvetiu një familje fjalesh të prejardhura sipas modelit të mëposhtëm:Kërkoj-folja baze; Kërkohe-trajta pësore/vetvetore e foljes ;Kërkim-emri foljor abstrakt veprimi; Kërkues- mbiemri prejfoljor i vepruesit; Kërkuese- forma femërore e këtij mbiemri Jokerkues- mbiemri që tregon një tipar të kundërt me kërkues I kërkuar mbiemri prejpjesor me kuptim pasiv/pësor ;I kërkueshëm- mbiemri që tregon mundësi për të pësuar veprimin Kërkimor- mbiemri lidhor, që tregon marrëdhënie me emrin e veprimit ose veprimtarisë përkatëse;

Kërkese- emër foljor abstrakt që shpreh zakonisht veprimin si akt pikësor ose rezultatin e veprimit;Morkërkim-mungesa e veprimit të shprehur nga kërkim;

Kërkimtar emër vepruesi që e shpreh konceptin në një plan më abstrakt se kërkues;

Kërkimtari- emër abstrakt që shënjon veprimtarinë përkatëse, në një plan më abstrakt se kërkim;

Kërkueshmëri- emër abstrakt që shpreh mundësinë e veprimit i ndërtuar mbi temën e

mbiemrit i kërkueshëm.Kjo do të çonte për të gjithë përdoruesit dhe shkruarit e shqipes që të përdornin e të stërviteshin në krijimin e fjalëve të tilla, njëlloj ashtu siç do të krijonin format gramatikore të një fjale të eptueshme si p.sh: zgjedhimin e foljes kerkoj në kohën e tashme mënyra deftoe . Me të drejtë mund të pohojmë se fjalori trajton si njësi më vete të gjithë serinë e fjalëve të tilla: zbuloj, zbulim, zbulues, zbuluese, i zbuluar, i pazbuluar, zbulimor, i zbulueshëm, zbulueshmëri, kërkuj, kërkohem, kerkim, kërkues, kërkuese, jokerkues, i

kërkuar, i kërkueshëm, kërkimor, kërkuesë, moskërkim, kërkimtar, kërkimtari, kërkueshmëri. Duket sikur me anë të trajtimit të tyre si njësi të veçanta dhe me anë të këtij rregulli të fjalëformimit të bëhet i mundur një kontroll më i plotë mekanizmave neologjike në gjuhë. Pra njësor si te neogjuha e Oqeanisë që vendos rregull duke hequr të gjitha përjashtimet, në mënyrë që me anë të kontrollit të fjalëve të arrihej kontrolli mendimeve. Në të vërtetë janë shume folje kalimtare në këtë fjalor që janë trajtuar në mënyrë të pjesshme në këtë lloj fjalëformimi. Ato kanë prodhuar forma që nuk mund të përbëjnë fjalë, ose këto forma e bëjnë gjuhën të jetë shumë e thatë e shumë artificiale; artificialiteti i këtyre foljeve ka të bëjë në krijimin e fjalëve me një shkallë të theksuar abstraksioni.

Pra, fjalët zbulueshmëri, kërkueshmëri, burgëtoje, burgoje, jetërsim, jetërsor, ardhshmëri, e argjenduar, asgjësi, asgjëshëm, ashpëri, atëri, azgani, dallimor, dallueshmeri, dashurues (është marrë jo si emër ,por si mbiemër), etj.

Sic shprehet dhe studiuesi Vehiu, në studimin e tij rreth kësaj gjuhe:"Ky superprodhim e dëmton gjuhën dhe e kthen atë në një inventar shifrash e objektiviteti të pajetë, pra me një leksik abstrakt, ky leksik ka të bëjë me shmangien e fjalëve të huaja të panevojshme dhe pasurimin me fjalë të krijuara rishtas, kjo në përputhje përsëri me ideologjinë e trajtimit të fjalëve njësor si tonelatat e superfosfatit të prodhuara në Laç, rritja e nivelit të jetesës, e numrit të njerëzve të lumtur, etj." **Kundërvënia , dikotomitë të shfaqura edhe në konceptin e jetës ,gjithmonë në gatishmëri për luftë** : Përkrah vlerave të mëdha , duheshin pare faktet se pranë tyre qëndronte dhe rreziku se mund te keqkuptoheshin me ide që vinin nga sfera të huaja apo dhe nga e kaluara e errët, jo ato të pushtetit aktual dhe kështu mbase demokraci mund të ngatërrohej me demokracine e vendeve të tjera, të ashtuquajtura demokratike, parti me fjalët që shtetasit e tjerë mund të konsideronin, për fjalën politike e ideologjike duhej vendosur ekstremiteti plus dhe minus, politika e vendit tonë dhe atyre të tjerëve. Socializmi dhe politika e proletariatit shqiptar nuk është e ngushtë si ajo e vendeve të tjera, edhe pse ajo është e një vendi shumë të vogël, çdo gjë nuk e trajton lokalisht, por me gjithë proletarët e të gjithë botës, lufta, jeta dhe revolucioni i tyre është drejtuar globalisht ;në këtë këndvështrim janë parë e janë shpjeguar kundërvëniet dhe dikotomitë e fjalëve në gjuhën e drunjtë. Po ilustruam disa shembuj me fjalët që mbajnë themelet e ideologjisë totalitare të marra nga fjalori:

DEMOKRACI

Demokracia proletare. Demokraci popullore - formë e diktaturës së proletariatit në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në socializem, demokraci e masave të gjera të popullit, Demokraci

borgjeze- forme e diktaturës së borgjezisë, ku të drejtat e liritë e shpallura kanë karakter formal dhe nuk garantohen e nuk vihen në jetë për masat e gjera të popullit.

PARTI 1. Organizate politike e nje klase a e një shtrese shoqërore të caktuar, që ka programin e statutin e vet dhe që lufton për të mbrojtur interesat e klasës a të shtresës shoqërore, së cilës i perket. Parti politike. Parti borgjeze. Parti demokratike (konservatore, republikane). Parti fashiste. Parti revizioniste .Kongresi i partisë.

2. Reparti pararoje dhe i organizuar i klasës punëtore, që e udheheq atë drejt fitores së revolucionit proletar dhe për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste, që ka në themel të të gjithë veprimtarisë së saj idete e marksizmit. Parti komuniste. Parti marksiste. Parti e tipit të ri. POLITIKE. Politike revolucionare (marksiste, proletare). Politike reaksionare (borgjeze, revizioniste, antimarksiste, antipopullore). Politike e hapur (e çilter, parimore, e urte, largpamëse, e drejte, paqësore, e pavarur). Politike grabitqare (kolonialiste, hegjemoniste, shoviniste sunduese, kapitulluese). Politika e brendshme (e jashtme). Politika dhe ekonomia. Politika e dyerve (e portave) të hapura. Politike e grushtit të hekurt. Politika e kulaçit dhe e kërbacit politike që behet herë me te mire e me premtime te bukura here me kërcënime, me shtrëngim e me dhune. Përçues i politikës. Ndjek një politike të caktuar. Ndryshoi politiken. E vë politiken në plan të parë, etj. SOCIALIST mb.1. Që ka të bëjë me socializmin; që lidhet me socializmin, që mbështetet në parimet e socializmit ose që ka për qëllim vendosjen dhe ndërtimin e socializmit. Rendi (sistemi) 4. keq. Qe ka te beje me një parti reformiste me parime socialdemokrate, qe eshte karakteristik për një parti reformiste socialdemokrate. Partite socialiste të Evropës. LUFTE f. sh.

1. Ndashje e armatosur ndërmjet shtetesh a forcash kundërshtarë, që zhvillohet zakonisht me një varg betejash; koha sa vazhdon kjo ndeshje dhe gjendja që krijohet ndërmjet palëve që ndeshen; përleshje e armatosur ndërmjet forcash ushtarake kundërshtarë në një vend të caktuar, beteje, luftim. Luftë e drejte (revolucionare, çlirimtare). Luftë popullore (partizane). Luftë mbrojtëse (sulmuese). Luftë e padrejtë (imperialiste, pushtuese, grabitqare, shkatërrimtare). Luftë civile (qytetare). Luftë bërthamore (bakteriologjike, kimike). DIKTATURE f. sh.1. Pushtet i pakufizuar shtetëror, që shpreh e mbron interesat e klasës sunduese dhe që ushtrohet me dhunë nga një njeri ose nga një grup njerëzish; pushteti i diktatorit. Diktature ushtarake (politike, fashiste, monarkiste). Diktaturë absolute. Diktaturë e egër. Diktatura e skllavopronarëve (e feudalëve, e borgjezisë).

Diktatura e proletariatit pushteti shtetëror i klasës punëtore që vendoset pas fitores së revolucionit socialist nën udhëheqjen e partisë marksiste, që shpreh e mbrohet interesat e të gjithë punonjësve dhe që është tipi më i lartë i demokracisë.

Për të gjithë ata që hapin e lexojnë fjalorin përveç dikotomisë në shembujt e dhënë ilustrues menjëherë vënë re për fjalët si: revolucionar, pergatis, udhëheqesit, udhëheqja, ndihma, teoria marksiste, njerëzit e popullit (tone), hartoj, krijoj, kritikoj, filozof, atdhetar, marksizëm, etj. Në vazhdimësi hasin kundërvënje me anë të antonimeve: aventurier, kurdis, krerët, klika, lëmosha, frazeologji marksiste, agjenturë, fabrikat, sajot, vjell vrer kundër, pseudofilozof, pseudoatdhetar, pseudomarksizëm.

Gjatë gjithë veprës studimore përsëriten në mënyrë të vazhduar kundërvënja e njësive të ngurta të gjuhës së drunjtë, kështu me patjetër për çdo shprehje të ngurtë e deri në klishe të gjuhësore do të kishim përgjegjësen e kundërt. Të gjithë shembujt e mëposhtëm tregojnë për një qëndrim ekstrem të ideologjisë ku dualizmi apo shumësia as që mund të mendohej:

Arti i sotëm dekadent borgjez e revizionist -arti socialist

Unitet ideologjik-divergjenca ideologjike

E ardhmja jone dritëmadhe- e djeshmja e hidhur, e kaluara e errët

Fryme revolucionare-frymë grupazhi

Ide reaksionare-ide revolucionare

Klase sunduese-klase e shtypur

Kriza e kapitalizmit-epërsia e rendit socialist

Nën thundrën e imperializmit, nën kamxhikun e kapitalistëve - Nën udhëheqjen dritëplotë të

Partisë Ndjenja e klasës- ndjenjë individualizmi ;Njollë në biografi- biografi e paster

Pastertia ideologjike-njeri me mbeturina

Prona private-prona e perbashket, prona socialiste

Qëndrim lokalist- qëndrim proletar Vend socialist-vend borgjez, kapitalist

Rronim në mjerim e padituri-rrojmë në një kohë të lumtur

Palëkundshmëria e rendit socialist-revolucioni e ka lekundur sistemin kapitalist

Na dha drite Partia! - Borgjezia përpiket të gabojë masat!

Demokracia socialiste-degjenerimi revizionist

Socializmi është shpresa dhe e ardhmja e të gjithë popujve, drejtësia e rendit socialist-shfrytëzimi kapitalist

Shtrembërime në vijën politike -palëkundshmëria në vijën (tezën) e Partisë

Shtresa e kulakëve- shtresa e punëtorëve, shtresa e varfer ;Shkrija me masat-veçimi politik i kulakëve;Thellimi i vijes së masave - shkrija e kuadrove me masat ;Unitet i pathyeshëm-urrejtja klasore

Ushtria popullore-trupat pushtuese amerikane

Shkrija me masat –veçimi politik i kulakeve

Procesi i të emëruarit, një proces i pëlqyer në vetvete:Emërim quajmë shndërrimin e pjesëve të ndryshme të ligjëratës si folje, mbiemër në një emër. Emërimi është karakteristike e ligjëritimit totalitar dhe atij burokratik të sotëm. Vumë re gjatë analizimit të njësive të drunjëzuara përdorimin e shpeshtë të një lloji emërimi. Emër foljor + emër në gjinore. Gjuha e drunjte e ka karakteristikën e emëzimit, sepse ajo preferon më shumë emrat sesa foljet, pasi kuptohet që emri të tregon dhe imponon nje proces te mbaruar, i cili as që bëhet fjalë të diskutohet, ndërsa folja të jep lirinë të vendosësh vepruesin, kryefjalën dhe mundësinë që të veprohet. Në sistemin totalitar ka shumë procese të rëndësishme të cilat qëndrojnë shumë lart dhe shpeshherë madhështia e tyre qëndron në lartësimin e tyre dhe jo në përcaktimin e personave që kanë vepruar për ta kryer këtë. Pra, në fjalor vëmë re përdorimin e togjeve të tipit emër foljor + emër në gjinore. Kjo gjinore si nënprodukt i emëzimit , vetëm sa shënon ekzistencën e marrëdhënies midis veprimit të shprehur nga emri i parë prejfoljor dhe emrit të dytë në gjinore, duke lënë vend për interpretim ose duke nënkuptuar raportet kuptimore midis pjesëve të togut. Këto raporte në përgjithësi interpretohen dhe rindërtohen pa vështirësi sepse kjo varet nga kodi i përbashkët që gjuha e drunjte ka vendosur tashmë.

1. Analizojmë emërzimin e togut të fjalëve: pjesëmarrja e masave. Ky emërzim është kryer në këtë mënyrë si produkt i emërzimit të fjalëve të mëposhtme. Masat marrin pjesë. Pra, gjinorja shpreh kryefjalën e foljes përkatëse (marr pjesë) dhe do të kuptohet si gjinore kryefjalore. Në këtë analizë të thjeshtëzuar të gjitha llojet e këtij tipi janë në të vërtetë jo shumë të qarta në përdorimin e tyre. Kuptimi i gjinores që ndjek një emër foljor varet nga kalimtarësia e foljes, kur folja është jokalimtare dhe veprare, gjinorja priret të shënojë kryefjalën. Ndërsa format e emërzuar që përftohen duke kaluar përmes një faze të ndërmjetme me foljen në pësore, lejojnë mënjanimin e plotë të kryefjalës: emër foljor+ emër në rasën gjinore që rrjedhë nga kundrinoret e drejta të drunjëzuar, në emra prejfoljorë: EDUKIMI I NJERIUT TE RI (prindërit edukojnë të rinjtë)

Zhargonit totalitarist: Ky zhargon është krijuar nga pushteti në fuqi dhe i ndikuar pjesërisht nga ligjërimi burokratik sovjetik. Kjo me përpjekje për hegjemonizëm sa me të plotë të mbare proletariatis socialist në mbarë botën sjell ekzistencën e një leksiku të veçantë që kishte të bënte me dallimin e një grupi personash, specialistësh që ishin në gjendje t'i përdornin këto terma duke u dalluar nga pjesa tjetër e njerëzve, profesioneve. Kështu disa persona mund të përdorin me siguri termin revizionizmi sovjetik dhe kur duhej të përdorej termi tjetër socioimperializmi sovjetik, ose të dallonin midis imperializmit ndërkombëtar, neokolonialistëve, borgjezisë ndërkombëtare. Kjo mund të përcaktonte me pas faktin se sa njerëzit do të kishin sukses në fjalime të ndryshme propagandistike dhe në ecjen lart në karrierën e tyre. Pikërisht për këto arsye, nuk kishte si të mungonte një nga metodat revolucionare të ndërhyrjes së ideologjisë, me anë të zhargonit të vet unik në shoqëri. Po ashtu, përcaktimi dhe dallimi midis formave organizative të sistemit totalitar dhe sistemeve qeverisë së mëparshme: komitet ekzekutiv-bashki, kuvend popullor- parlament, etj. Termet e tjera, si: plenum, aktiv, byro (politike), presidium, aparati KQ, keshilli i lagjes, qendra e punës, kuotizacioni, shtabi i çetës, kooperativat e konsumit, pasuria e shtetit, shtëpia e pushimit, e lindjes, e pionierit, vater (kulture), organizate (bazë). Kishim të bënim me strukturat e jetës politike të organizimit të shtetit dhe këtyre strukturave u përgjigjeshin një numër i madh kategorish, praktikash e veprimtarish publike si: formë edukimi, kolektivizimi, zbrësje në baze, çetë pionierësh, mbledhje mesimore, qarkullim i kuadrit, punë fizike, boshti ideologjik, trekëndëshi revolucionar (mësim, punë prodhuese, kalitje fizike dhe ushtarake), hap toka të reja, revolucionarizimi, dydynamësi, lojë krijuese, militantizmi, frymë revolucionare, etj. Terma e shprehje si: kauzë, edukimi ideo-politik, interesi i përgjithshëm, autokritike, tendenciozitet klasor, botëkuptimi marksist-leninist, repart i klases punëtore, shembulli i të përparuarve, emulacion, llogaridhënie, mësimet e Partisë, uniteti Parti- Popull, stafeta e

revolucionit, vetëmbrojtja popullore, punë vullnetare. Emërtimet e dokumenteve karakteristike për kohën si: fletë-rrufe, triske, tesera, flete-hyrje, flete-dalje; po ashtu fjalët karakteristike për zyrën, karakteristike për zyrën e kuadrit: vërejtjet me shënim në biografi, ose vërejtje në kartën e regjistrimit. Emërtimet për veprimtaritë e ethshme të shoqërisë: mbledhja e kolektivit, mbledhja e lagjes, mbledhja e bllokut, mbledhja e organizatës, mbledhje rinie, etj. Për veprimtaritë artistike e sportive masive: koncertet e majit, olimpiadat, spartakiadat, manifestimi. Pjesëmarrësit nga ana tjetër etiketoheshin si: punonjës pararoje, qitës i dalluar, sulmues, hero i punës socialiste, kandidat partie, mësues i popullit, agjikator, komisar, sekretar i Rinisë, Sekretar i parë, i deleguari i Komitetit, i dërguari i posaçëm, aktivist, brigadier, etj. Emërtimet e tjera sipas kategorive, shtresave të shoqërisë sipas vizionit marksist: klasat e përmbysura, klasa punëtore, brezi i ri, fshatarët e pasur, fshatarësia punonjëse, të lëkundurit, armiqtë e klasës, nacionalistët e ndershëm, kulakët, çifligarët, afendikotë, ose grupmoshat: fatosët, yllkat, pionierët (e Enverit), debatikasit. Krahas ritualizimit mbytës të jetës sociale përdorimi i zhargonit totalitar ndihmonte në politizimin e mëtejshëm të çdo pjese të jetës duke përforcuar idenë se jeta në vendin tonë në periudhën e diktaturës duhet të ishte vetëm një pjesëmarrje e vetëdijshme në procesin politik të pasqyrimin të rendit të shndritshëm socialist.

GJUHE E PERMBYTUR NGA VARFERIA: Orwell në shtojcën e romanit të tij "1984" shkruan: "Çdo reduktim i gjuhës ishte njëkohësisht përfitim, meqë sa më e vogël të jetë rrezja e zgjedhjes, aq më i dobët është tundimi për të menduar. Në analizë të fundit shpresa ishte që ligjërimi i nyjëtuar të prodhohej nga laringu pa kurrfarë pjesëmarrjeje të qendrave të trurit". Më poshtë po rendisim disa prej shkaqeve të cilat detyrimisht çuan në varfërimin e shqipes. Varfërimi i gjuhës shqipe u krye lidhur me faktin se vendi ynë ishte në marrëdhënie me shumë pak vende dhe me ata të cilët ishte fqinjë dhe përbënin djepin e kulturës botërore ishin të ndaluar komunikimet. Pra, sigurimi i fjalëve të reja, i pasurimit të gjuhës nga ky burim nuk mund të bëhej. Në vendin tonë ndryshe nga vendi i Oqeanisë si në romanin e Orwell, në shqip nuk kishte një polici gjuhësore, por një politike të tillë me efekte anësore që çonin të kuptohej se kishte synime të ngjashme me atë të vendit distopik të imagjinuar të 1984. Një mënyrë tjetër që ndihmonte në spastrimin e gjuhës shqipe ishte mënjanimi i polisemisë, i zhdukjes së disa kuptimeve të një fjale.

Një mënyrë e pasurimit të fjalorit padyshim janë prurjet nga e kaluara, por për të kaluarën përpara 1944 duhej të tregohesh një kujdes i madh, burime si për shembull letërsia, duhej të kalonte në sitë; kështu nuk do të merreshin në konsideratë prurjet nga autorë të ndaluar nga

diktatura, të tillë si Fishta, Konica, At Zef Pllumi, Mitrush Kuteli, Kasëm Trebeshina, Petro Marko, letërsia shqiptare e bejtexhinjve e shumë të tjerë.

Faktorë të tjerë që kanë ndikuar thellësisht në reduktimin e fjalëve janë:

Mënjanimi i pasurisë së dialektit geg,

Mënjanimi i fjalëve fetare,

Mënjanimi i pasurisë kulturore , botërore në arte të ndryshme si: në letërsi, kinematografi, pikturë, muzikë e shumë fusha të tjera të kulturës po edhe të shkencës kjo si rrjedhojë e mospranimit të asnjë lloj tjetër politike, filozofie apo kulture e cila mund të prekte dhe sado pak çdo element të socializmit dhe vlerat e larta të Realizmit Socialist.

Një sulm tjetër ishte përsëri kundrejt ligjërimit publik, i cili u ngushtua së tepërmi me format e tij jetësore duke u zëvendësuar në total nga ligjërimi politik dhe gjuha e drunjtë e tij. U fshinë tre sferat themelore të ligjërimit publik;

-Ligjërimi juridik (mungonte oratoria e figurës së avokatit të mbrojtjes)

-Ligjerimi fetar

-Reklama

Në përputhje me direktivat e partisë që u kundërviheshin kënaqësive materiale, pasurimit, ekonomia u varferua totalisht nga larmia e mallrave ose të tregut me pakicë, vendin e asortimenteve të zhdukura e zunë emërtimet e përgjithësuara për llojet e ushqimeve. Pra, varferimi ishte total, në mungesë të lirisë së tregtisë, të pronësisë dhe zëvendësimi i tyre me fjalët e pakta të lidhura me realitetin gri të njëjtë, të unifikuar në çdo gjë, në veshje, në banesa, në dyqane, në prona dhe natyrisht në mendime e gjuhë. Njerëzit në vend të llojeve të pasura të djathërave do të kishin mundësi të blinin vetëm djathë, në vend të llojeve të ndryshme të peshkut, do të blinin vetëm peshk e me radhë: bukë, vaj, krem, kolonjë. Fjalët u thjeshtëzuan dhe u reduktuan, dhe u zëvendësuan me ane të nje fjale të vetme ku përfshiheshin shumë asortimente; kështu: dyqani i bukes, metrazhe, ushqimore, veshmbathje kinkaleri etj.

Ashtu siç shprehet studiuesi Ardian Vehbiu "Sistemet e vyera leksikore të trashëguara me shekuj u lanë pas dhe u zëvendësuan nga Kazma e Lopata!!!

Polisemi e lënë në hije:

Veçori e përbashkët midis neogjuhës dhe gjuhës së drunjtë shqipe është çuarja e fjalëve drejt monosemisë. Kuptohet që kjo karakteristikë lidhet me ligjërimin, por gjetëm edhe shembuj të mënjanimit të polisemisë edhe në fjalor. Prirja drejt monosemisë së termave të gjuhës shqipe ishte e lidhur, mund të themi me ideologjinë moniste, sepse ajo siguron palëkundshmërinë e qëndrimit në një vijë, kurse polisemia me larminë e saj të kuptimeve mund të çojë në pluralizëm të mendimit. Pra, kur themi socializem shtetëror, socializmi në semantikën e tij do të ishte patjetër një rend i paqortueshëm me të gjitha atributet maksimale dhe nuk mund të

kishte kuptime të tjera të derivuara prej tij. Po ashtu fjalët: Marksi, Engelsi, puna në kolektiv, klasë punëtore, partizan, amerikan, shovinist, shfaqje e huaj, ateist, fetar, parti, armik i popullit, imperialist, revizionist, borgjez, lufta e klasave, diversant, agjent, diktatura e proletariatit, kulak, diktatura e proletariatit, yllka, fatos, etj., ofrojnë vetëm një kuptim të përcaktuar mirë dhe në asnjë mënyrë nuk ekziston mundësia që puna në kolektiv të ketë dhe mangësitë e veta, si psh: mosnjohjen e meritave të një personi ose të disave që kanë punuar më shumë se të tjerët dhe marrja e këtyre meritave prej gjithë të tjerëve. Puna kolektive dhe ajo prodhuese është gjithmonë e padiskutueshme në vlerat e mëdha që ka. Filozofia e Marksit dhe Engelsit, themeli i diktaturës së proletariatit nuk ka se si të ketë qoftë edhe ndonjë pikë shumë të vogël për t'u diskutuar. Diskutimi i fjalëve të tilla monosemantike është rreptësisht i ndaluar. Me siguri monosemia ka qenë një nga elementët më të fuqishëm shfarosës së bashku me spastrimin duke e tranguar gjuhën shqipe e cila ka qenë gjithmonë në vështirësi rritjeje, pasurimi i shtuar i kësaj peme në të vërtetë nuk kishte lidhje me rritjen e degëve të saj, lulëzimit, por vetëm një shtim i pjesëve plastike të marra nga një pemë tjetër artificiale. Kjo bëri që intelektuale të kohës, artistë, shkrimtar, poetë të ishin gjithmonë në udhëkryq midis zgjedhjes së jetës dhe pajetës. Për ta shpjeguar më qartë si funksiononte vendosja e kësaj karakteristike po japim një shembull duke përfshirë ligjërimin bisedor dhe shikojmë prirjen e monosemisë të fjala pionier. Në fillim fjala në fjalor është shpjeguar kështu: Pionier ai që hedh hapat e para ose çan i pari një rrugë të re në një fushë të panjohur a të pazhvilluar të veprimtarisë, ai që i pari vë themelet e diçkaje në një të shkencës, të kulturës, të politikës. Ky ishte kuptimi i parë, ndërsa kuptimi i dytë ishte ai nxënësve të shkollave në klasat e tetëvjeçares që ishin quajtur të tillë, sigurisht që kuptimi i dytë ideologjik dominoi mbi të parin, pasi në atë kohë asnjë nuk mendonte të sillte një risi, por duhet të ishte pjesë e turmës të ndiqte çdo urdhër, kjo çoi dalëngadalë në zhdukjen e nocionit të vërtetë kuptimit të fjalës pionier, të eksploruesit të shtigjeve të reja, të pazbuluara më parë, sepse pionerët duhet të ndiqnin ato rrugë që i përpiluar me përpikm mbajtësit e pushtetit. Mendojmë se kur monosemia bëhej shumë e fortë atëherë mund të kalohej lehtë dhe në deviacion semantik.

I rikthehem trajtimit të zhdukjes së kuptimeve në fjalor; kjo u bë në kuadër të karakteristikës kryesore të gjuhës së drunjtë, varfërimit të një gjuhe natyrore ose në kuadër të spastrimeve të deklaruar nga autorët e fjalorit. Po japim disa shembuj të mënjanimin të polisemisë:

VELLA m. sh.

I. Djali kundrejt femijëve të tjerë që kanë prindër të njëjtë. Vellai i madh (i vogël). Vella i gjetur. vella vetëm nga nëna ose vetëm nga babai. Vellai im. I vellai, vëllai i tij (i saj). Vella e moter. Vella prej babait (prej nënës) djali kundrejt femijëve të tjerë nga baba (ose nga nëna)

tjetër. Vëlla qumështi djali kundrejt fëmijëve të një familjeje tjetër, nëna e të cilëve i ka dhënë gj. Vëlla shpirti vëllam. Vëllai për vëllanë fj.urtë. vellezërit duhet ta ndihmojnë kurdoherë njëri - tjetrin. Jemi vëllezër. E kam vëlla. Duhet si vëllezër e shkuar vëllezërve.

2. etnogr. Vëllam. E kishte bërë vëlla. Ishin bërë vellezer.

3. Ai që është i një gjaku a i një fisi me dikë tjetër, ai që është i së njëjtës kombësi ai të njëjtit komb me një tjetër, bashkëkombës. Vellezër të një gjaku 4. Ai me të cilin na lidhin kushtet shoqërore, idealet e qëllimet e përbashkëta; shok mendimi e ideje, shok lufte; shok a mik shume i ngushtë. Vellezër klase. Vellezër armësh. Jemi vëllezër.

E kam vëlla e shkuar vëllait e kam shok e mik shume te dashur, si vëlla e me të afërm se vëllane. Përdoret për t'iu drejtuar me ngrohtësi, në mënyrë familjare e miqësore një burri, një djali ose një të riu. Eja ti vëllai im! Që thua ti, vëlla i dashur... More vëlla! C'të të them more vëlla!

6. bot. Kalli misri, gruri etj., që del e rritet njëkohësisht nga e njëjta rrënjë; këlysh, vet. sh disa kallinj misri të ngjitur së bashku. Bime me shume vellezër. Ka nxjerrë vellezer. Kanë dalë vëllezër;

7. Përd. mb. sipas kuptimeve 3, 4 të emrit. Popuj vellezer. Vende vëllezër

Vëlla pa hile krahin, vëllam. Sikur edhe vëllai të me linde çfarëdo që të ndodhë, edhe sikur të me vijë diçka shume e mire (për një punë që s'dua ta bëj. Gjumi është vëllai i vdekjes fj.u. shih te GJUM/E-1. Vellezer jemi, shoke s'jemi shih te SHOK-U.

Me gjithë tetë kuptimet e dhëna është përmendur vëllezër të një klase, por serish nuk është përmendur kuptimi që përdoret për besimtarët e krishterë mes tyre (MOHOHET FEJA)

DISKOTEKE f. sh.

Koleksion pllakash gramafoni; vendi ku ruhen pllakat e gramafonit. Diskotekë e pasur.

Diskoteka e Radiotelevizionit (e Institutit të Folklorit). Pasuroj diskoteken

Përsëri mungon kuptimi i dytë i fjalës për vendin që quhet diskotekë.

BUST m. sh. art. Skulpturë që paraqet pjesën e sipërme të trupit të njeriut që nga mesi e lart ose koken dhe një pjesë të krahërorit. Bust i vogël. Bust mermeri.

Në një shoqëri ku në shumicën e rasteve përdoret një lloj cope, një prerje e njëjtë e saj dhe jo vetëm e saj, por edhe e flokëve në vazhden e njëjtësisë ose unifikimit, nuk është dhënë kuptimi tjetër i fjalës për pjesën e sipërme të rrobave të njeriut si dhe të pjesës anatomike që tregon pjesën e sipërme të njeriut.

Shembuj të tjerë mënjanimit të polisemisë janë:

goté, gotizem, gotik, alternativ (si mbiemer), estetike, aksesor, publikoj, publikim, /e publikuar, stacione (për televizione) motorist, model, modele, rezidence, akreditim, akreditoj e

akredituar, akrep e gaforre (per shenje astronomike), akumulator, alegro(per person), antiparti, bord, brilant, buxhetor, yllke, e kerkuar , antimilitarizëm, lakim, lakoj,e lakuar(per personat, çështjet për të cilët është folur shumë).

Heqja e kuptimeve të fjalëve është kryer me të njëjtin qëllim që është bërë dhe reduktimi duke qenë se vetë mënjanimi i polisemisë nuk është gjë tjetër veçse një nënloj reduktimi gjuhësor apo semantik, kështu mendojmë se nuk është e nevojshme t'i përsërisim edhe një herë arsyet e kësaj taktike të përdorur. Mënjanimi i polisemisë si një dhjetë nënlojet e reduktimit/varfërimit të fjalëve nuk është karakteristike në masë aq të madhe sa është vetë varfërimi i gjuhës. Kontributin më të rëndësishëm për analizat e mësipërme na i kanë dhënë: Ardian Vehbiu me veprën e tij "Shqipja totalitare: Tipare ligjërit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990" . Me përsiatjet e tij mbi realitetin e gjuhës totalitare e deri te përdorimi i saj në komunikimin publik, nisur nga "hipoteza se ndikimin më të madh e më dëmprurës totalitarizmi e solli në mënyrën e përdorimit publik të shqipes..." (A.Vehbiu, 2009, f.23). Autori e mënjanoi hetimin e fjalorëve të kësaj periudhe në lidhje me shfaqjen e kësaj dukurie, duke qenë se, sipas tij, "fjalorët nuk kanë ndonjë ndikim të madh në mënyrën si shfaqet ose si shtjellohet gjuha" (A.Vehbiu, 2009, 123). Ndër punimet më të njohura në ndihmë vijnë nga Ladislav Bod, "Gjuha dhe pushteti politik: reflektime mbi stalinizmin (shicun 1975, Eliades), M.Bronski, "Totalitarny jezyk komunizmu" (Kultura, 12, 1979); Colin H.Good, "Die deutsche Sprache und die Kommunistische Ideologie" (Frankfurt, 1975); Louis Martinez, "La langue de bois sovietique" (Commentaire, dimer 1981-1982, vellimi 4); Françoise Thom, "La langue de bois" (Commentaire Julliard, 1987), Patrick Seriot, "Langue et ideologjie dans le dictionnaire Ožegov" (ne "L'Enseignement du russejanar 1977) , Cornelia Berning "Vokabular des Nationalsozialismus" (Berlin, 1964), K.W.Fricke, "Die Sprache des Vierten Reiches" (Deutsche Rundschau, 1952). Determinizmi gjuhësor mbron idenë që ka të bëjë me faktin se gjuha dhe struktura e saj limiton dhe mendimin njerëzor. Individët krijojnë përvojë në botë duke u mbështetur në gjuhën e tyre që ata përdorin në vendin ku jetojnë. Përsa i përket interpretimit që do t'i jepnim shprehjes së mësipërme do të thoshim se shpesh ka fakte të pamohueshme në lidhje me efektin ndikues që mund të ketë gjuha në mendjen njerëzore. Kështu të njohura janë veprat e George Orwell "Ferma e kafshëve" dhe romani "1984", në të cilën ky autor si një profet i vertete parashikon duke përshkruar efektet që bëri sistemi me anë të gjuhës së re, për nënshtetasit e tyre; kjo gjuhë e quajjt më vonë nga studiuesit "Gjuha e drunjte" pasi ajo nuk ishte krijuar për të gjeneruar gjuhë dhe mendime individuale, por për të marrë masat, për t'i bërë ata të mos mendojnë rreth asaj se ç'po ndodh rreth tyre; është fjala për atë lloj gjuhe në të cilën janë mbështetur sistemet totalitare, nazizmi, Bashkimi Sovjetik, vendet e lindjes dhe patjetër po ashtu vendi ynë gjatë 45 viteve të diktaturës. Studiuesit

anglishtfolës e njohin dhe e barazojnë me Neogjuhën, gjuhën totalitare, gjuhën e komunizmit, gjuhën e diktaturës. Në kulturën franceze studimi i gjuhës së drunjtë është parë shumë gjerësisht dhe ka shumë prurje kërkimesh të cilat më pas janë përkthyer në anglisht. Kërkuesit francezë preferojnë termin gjuhë e drunjtë. Kjo e fundit sipas tyre është një gjuhë e projektuar me qëllim kryesor në dhënien e formës mendimeve dhe veprimeve të njerëzve; gjuha e drunjtë kërkon të përfshijë pothuajse në mënyrë natyrale një grup njerëzish të cilët nuk duhet të kujdesen shumë për shpirtin kritik dhe konceptues që transmeton gjuha.

Format e shfaqjes së gjuhës së drunjtë janë: Neogjuha (newspeak), gjuha totalitare ,propaganda gjuha ligjore ,gjuha politikisht korrekte, marketingu ,format e gatshme gjuhësore, etj.

Në anglisht: newspeak totalitarian language, communist language, dictatorial language. (Martland T.R. The Review of Metaphysics, Vol. 29, No. 1 Sep. 1975, fq. 19). Një analizë e përveçme e këtij fenomeni ishte siguruar nga George Orwell në esenë e tij "Politika dhe gjuha angleze" dhe veçanërisht përmes gjuhës së tij Newspeak në romanin e tij "1984"

George Orwell bëri një përpjekje për të përshkruar këtë lloj gjuhe, të cilën e quajti Neogjuhë. Ky autor arriti të krijonte një fjalë artificiale duke denotuar një gjuhë artificiale që shpreh absurditet dhe pakuptueshmëri.

"Ju nuk keni një vlerësim të duhur për Neogjuhen, Winston- tha ai pothuajse trishtuar. Kur ju e shkruani atë, akoma keni në mendje Gjuhen e Vjetër... Në zemër ju preferoni mbeteni e të vazhdoni me gjuhën e vjetër, me gjithë paqartësitë që ajo ka , edhe format e padobishme të kuptimit. A nuk e shikoni që Neogjuha çdo ditë e më tepër arrin të zvogëlojë fjalorin e saj dhe bëhet më e thjeshtë?"

Si përfundim sjellim mendimet e studiuesit Andrei Reznikov për shndërrimet gjuhësore të cilat kishin çuar në përfitimin e Neogjuhës janë si më poshtë:

(Reznikov A. George Orwell's Theory of Language. Authorilouse, 2001, f.43, Cit. Vehbiu A, Shqipja Totalitare, Tirane, 2010, f 28.)zvogëlimi ose tkurrja e numrit të fjalëve në përdorim,mënjanimi i polisemisë,zbrazja e fjalëve nga kuptimi ose shndërrimi i fjalëve në zhguaj të zbrazët,përdorimi i tepruar i ndërtimeve të gatshme, klisheve dhe shkurtimeve,përdorimi i antonimeve eufemistike,zhvillimi gjuhësor prapavajtës ose ekspansioni në të shkuarën , zhvillimi gjuhësor deri në një cak të dhënë,etj.

Abëcëja e marksizmit Afrimi me masat Afrimi me shokët Afrohet I Maji! Agresion (për të shtypur lëvizjet demokratike, revolucionare dhe për të vendosur regjime reaksionare) Agresion imperialist, mikroborgjez Agjenturë imperialiste Agjitacion Agjikator Agjikator politik Agjitrop Aderoi në parti Agjitropi i brigades Aksion Aksion kombëtar

Aksion politik (ideologjik, artistik,sportiv, etj.) Aksion me goditje të përqendruar Aksionet kalitin rininë Aksion për hapjen e tokave të reja Aksionar i madh kapitalist Aksionist

*Akte diversioni Agimi i revolucionit Aktiv, (aktivi i partisë) Aktivist Aktivizim i masave
 Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse Amerikanatë, Amerikanizoj
 Amerikanizim
 Ana ideo-profesionale Analizë marksiste Antagonizmi klasor Agimi i lirise, i botës së
 reAntifetar
 Antikapitalist Antimarksist Antimilitarist Antipushtet Antipunëtor Antipopullor Antirevizionist
 Antisocialist Arkioportunist Altoparlanti i borgjezisë Arkirevizionist Arkishovinist Arkitekt i
 revolucionit Armata e punëtorëve Armatos me kazmë e lopatë Armatos popullin
 Armik i maskuar Armiku dhëlparak Armiku i popullit (i klasës) Armiqtë e mundshëm Akrobat
 (kupi II fig. Zakonisht për veprimtarinë politike) Armiqtë s'e mposhtin dot popullin shqiptar!
 Arsenal ideologjik Art militant Arti socialist Art i sotëm decadent, borgjez erevizionist Ateist
 Afri klasore, ideologjike Afrimi i kongresit Afrimi me bazën
 Balli Kombëtar Ballist Bandë reaksionarësh Bashkimet Profesionale të Artizanatit Bashkimi i
 Grave të Shqipërisë
 Bashkimi i Rinise së Punes së Shqipërisë Batak ideologjik Baza (vjen nga baza) Baza e
 Partisë Bëj agjitacion Bie në idealizëm Bindje ideologjike Biografi e pastër Borgjez,
 borgjeziaBorgjezia përpiqet të gaboje masat Boshti ideologjik Botëkuptim jomarksist, jofetar
 Brigadë agjitacioni
 Brigadë (e blegtorisë, e traktoristëve, kontrolli, e rinisë, etj.) Brumos ideologjikisht Burim i të
 gjithave sukseseve është Partia! Byro
 Çakejtë imperialistë (gjakpirës) Çetat e Vetëmbrojtjes Popullore Çetë vullnetare popullore
 Çifligar Çifligaro-borgjez Ç'thotë Partia bën populli, ç'do populli bën Partia. Çizmja e
 imperializmit
 Dënimi i shfaqjeve të huaja, (dënimi i zakoneve prapanike, i diferencimit klasor) Dënimi i
 zakoneve prapanike Detyrat e planit pesëvjeçar Detyrë partie Deviacion i djathtë Deviza e
 revolucionit Devotshmëria ndaj partisë Diktati imperialist
 Diktatura e proletariatit Diskriminimi i zakoneve, (në vendin kapitalist) Divergjencia
 ideologjike
 Diversant Diversion Diversionet e organizatave armiqësore Djallëzitë e armikut Djathtizëm
 Dogmatizmi fetar Doktrinë idealiste (reaksionare)
 Doli sulmues Drapër e çekan (simbol i punës, i bashkimit të klasës punëtore me fshatarësinë
 punonjëse) Drejtësia e vijës marksiste Drejtoria e agjitropit Dualizëm i papranueshëm
 Dyfishohet prodhimi Debatikas Degjenerimi revizionist Demokracia socialiste
 Demokratizimi socialist Dënim politik E ardhmja jonë dritëmadhe! E majta, (e djathta)
 ekstreme E djeshmja dhe e sotmja E djeshmja e hidhur E kaluara e errët E presim kryelartë
 festën!
 E presim IMajin duarplot! Ecim drejt jetës së re e të lumtur! Ecim kryelartë! Edukim klasor
 Edukimi i brezit të ri (i klasës punëtore, i punonjësve, etj.) Edukimi komunist Edukimi në
 gjirin e kolektivit Ekspansioni imperialist EkspONENT i Ballit Kombëtar Ekstremistët liberal
 Element sabotues Element turbullues Emër fetar (keq.)Emulacioni socialist Entuziazmi i lartë
 i klasës punëtore Epërsia e rendit socialist Epoka e socializmit (e sotme, e re, e Partisë, etj.)
 E vetmja rrugë (për socializmin) Eshtë plumb për armiqtë Eshtë shpallur sulmues
 Falimentimi i sipërmarrjeve kapitaliste Farkëtimi i brezit të ri Farsa e zgjedhjeve në vendet
 kapitaliste Fatos Fëlliqësitë e botës kapitaliste Filizat e socializmit Flamuri i emulacionit
 socialist Flamuri i punës
 Flamuri i aksionit Fletërrufe Flota pushtuese amerikane Forcat lëvizëse te revolucionit
 Forcat vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore Forcimi i diktaturës së proletariatit Formim
 ideologjik (ideopolitik)Formim marksist (komunist) Formimi i njeriut të ri Fronti i punës
 Fryma e aksionit
 Frymë grupazhi Frymë revolucionare Frazheologji agjitative Fund e krye idealist e reaksionar
 Fuqitë imperialiste Fuqizojmë mbrojtjen e atdheut Formimi (shpartallimi i grupazheve)*

Gangsterizmi imperialist Gati për punë e për mbrojtje! Gatishmëria e masave Goditën pikëpamjet e gabuara, shfaqjet e huaja Grupazh antiparti Greminë klasore Grup antiparti Grupazh Gjallëria e rendit socialist Gjenia e masave, e Marksit Gjithmonë gati! Gjyq para masave Gjyqi i Gjyqtar popullor Hegjemonia e proletariatit Heroi (Heroinë) i/e Punës Socialiste

Heroika e ditëve tona Heroika e ndërtimit socialist Heroizëm masiv Heronjtë e klasës punëtore Himnizimi i së ardhmes së lumtur Himnizimi i shoqërisë komuniste Hipokrizia fetare Histerizmat e muzikës perëndimore Hov revolucionar Hyj në parti (në organizatën e rinisë, në organizatën e bashkimeve profesionaleve)

Ia fali zemrën Partisë I shërbej atdheut socialist I shkëputur nga interesat, nga masat, nga kërkesat a nga ideologjia klasore Ide reaksionare Ide revolucionare Ideal i përbashkët Idealet e partisë sonë Ideologjia e huaj është helm për rininë Ideologjia marksiste-leniniste Iluzion mikroborgjez Imperialist Imperialistët ua grabitën lirinë popujve! Imperializëm Industrializmi socialist Interesa të ngushta vetjake Internacionalja socialiste (komuniste, fshatare, proletare)

Internimi i të burgosurve Intriga të imperializmit, të revizionizmit, të armiqve) Jemi grusht! Jeta socialiste! Jetojmë si revolucionare! Ka ca mbeturina Ka zemër komunisti Kalbëzimi i rendit kapitalist, borgjez Kalimi i pushtetit në duart e popullit Kaloj nga administrata në prodhim Kalitje ideologjike (revolucionare, e gjithanshme) Kalojmë nga fitorja në fitore! Kamp revisionist Kapitalizëm Kasapët imperialist Kemi një ideal! Këndi i emulacionit Këndi i agjitacionit

Kërkesat e moralit socialist Kështjellë e kuqe Kështjellë e pamposhtur Klasa jonë punëtore heroike Klasë e shtypur Klerikët mbillnin përçarje Klikë revizioniste Koha jonë heroike Komisar i kuq Komiteti Ekzekutiv Komiteti i Partisë (i Rinisë) Komiteti Qendror Komunist Komunist i vërtetë Komunistët s'i mposht asgjë! Komunizëm Kongresi i Partisë Konkurrenca rrjedh nga prona private Kontrolli i masës Kolektivi i agjitorëve Kooperativë

Krenohemi për fitoret e arritura Kriza e kapitalizmit Kuadër me origjinë popullore Kulak Kur flet klasa, hesht burokratizmi! Laik i vendosur Larot e Ballit Kombëtar Lart flamujt e revolucionit! Lart frymën revolucionare! Lavdi popullit tonë heroik! Le te lehin armiqtë!

Leku i popullit Leninist i vërtetë Liberal Liberalizim Lufta e klasave (ideologjike, parimore, kundër imperializmit, kundër fesë, kundër individualizmit, indiferentizmit, për ndërtimin e socializmit, kundër shfaqjeve të huaja, kundër thatësirës, etj.) Luftë e pandërprerë Madhështia e epokës sonë Manifestimi i IMajit Marksizëm-leninizëm Marshim fitimtar Marshimi i pandalshëm i Shqipërisë Socialiste Marshojmë drejt fitoreve të reja! Marshojmë kryelartë! Masa joproletare Mbeturinë e vjetër Mbrohemi me armë në dorë! Mbroj pasurinë socialiste Mbrojmë Atdheun socialist! Mbrojmë parimet e socializmit, marksizëm-leninizmit! Mbrojtja e fitoreve Me armiqtë jemi matur e do të matemi gjithmonë! Me biografi te panjollosur Me hap krenar

Me hapin e masave Me syrin klasor Me zemër të kuqe Mendim prej revolucionari Mësimet e kongresit Mësimet e Leninit Metodologjia marksiste, metoda e realizmit socialist Mënjanohej nga shokët Mikrobet e shoqërisë Mikrobi i indiferentizmit, i pronës private, i interesit vetjak Mikroborgjez Mishërimi i ideve të Partisë Mjete diversion Modë e huaj Monopolistët Moral komunist Mpreh vigjilencën revolucionare Mungesë ideshmërie Muzikë e shturur (për muzikën e huaj moderne) Myku i botës së vjetër Ndershmëria e klasës punëtore Ndërtimi i kulturës së re

Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste Ndërtimi i socializmit Ndërtojmë shoqërinë e re Ndërgjegje e lartë socialiste Ndërtuesit e socializmit Na dha dritë Partia! Ndikim i huaj Na pret e ardhmja e sigurt! Ndjek mësimet (Vijën) e Partisë Natyrë klasore Ndjenja e klasës Ndryshimet revolucionare Në gjirin e shoqërisë (popullit, punëtorëve, kolektivit) Nderoj me grusht Në rrugën e fitores! Nën çizmen e imperializmit Nën drejtimin e organizatës bazë Nën kamxhikun e kapitalistit Nën thundrën e imperializmit Nën udhëheqjen dritëplotë të Partisë.

Nënë Heroinë (Emërtimi u jepej atyre nënave që kanë rritur e edukuar shumë mirë tetë fëmijë e lart në kohën e socializmit) Nga fitorja në fitore! Nga gjiri ynë Ngrejme lart flamujt e revolucionit! Ngritja e nivelit ideopolitik Ngjyrë socialiste Normat e moralit komunist Nuk bëjmë kompromis me armikun Nuk e importojmë modën (muzikën, ideologjinë) e huaj Nuk e ndajmë pushkën nga libri! Nuk i ndajmë fjalët nga veprat Nuk i nënshtrohemi diktatit të huaj! Nuk ka armik të na gjunjëzojë! Nuk ka art të papartishëm! Nuk na lekundën besimin në fitore Nuk pranojmë lëmoshë Njeri i brumosur ideologjikisht Njollë në biografi

Opiumi i fesë Oportunist Optimizmi revolucionar Organizata- bazë Organizohemi në luftë e në mbrojtje

Papajtueshmëria klasore Papajtueshmëria me armiqtë Parakalon kryelartë populli (ushtria, rinia) Parimet e moralit komunist Partia e Punës Partia është farkëtuesja e rinisë! Partia krijoi njeriun e ri! Partia na rilindi! Partia organizuesja dhe frymëzuesja e të gjitha fitoreve të popullit tonë! Partishmëria proletare Pastërtia ideologjike Pasuri socialiste Pashmangshmëria e fitores së revolucionit Patos ideor Patriotizmi socialist Për ideal! Përgjigjem para masave

Përpara drejt fitoreve të reja! Peshkaqenët kapitalistë Pikëpamje joproletare Pishtar i revolucionit, i socializmit Pionier (kuptimi i dytë) PKSH Plane grabitqare (të vendeve të huaja kundrejt nesh) Punë agjitative Planet mashtruese (për armiqtë) Plani i masivizimit Plani pesëvjeçar Plenumi i Komitetit Qendror Plumb për armiqtë! Polarizimi i shoqërisë kapitaliste Politika e grushtit të hekurt Politika e kulaçit dhe e kërbaçit Politikan akrobat Popull i papërkulshëm Popull krenar Popull pallëngjeshur Populli është në fuqi! Populli shqiptar marshon gjithmonë përpara! Poshtë imperializmi! PPSH Pranimi në Parti Prirje individualiste Projekt-direktivat e planit të ardhshëm pesëvjeçar Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni! Proletariati Propagandimi i shembullit të mirë! Pseudoasnjësi e disa shteteve Pseudomarksistët, pseudosocialistët, pseudopatriotët e Ballit Kombëtar Punëtor Partie Punonjësit e agjitropit Punojmë (luftojmë) për një ideal! Pushteti popullor (arti popullor, shtypi popullor, ushtria popullore, vetëmbrojtja popullore, etj.) Pushteti kaloi te masat! Qarqet shoviniste

Qëndrojmë në gatishmëri Qëndrueshmëria e rendit socialist Qendër agjitacioni Qëndrim i lëkundur Qëndrim liberal (mikroborgjez) Qëndrim lokalist

Regjim antipopullor Reaksion i të gjitha ngjyrave Reaksionar Realizmi socialist Repart pararojë, (i klasës punëtore, etj.) Revizionist

Revolucion ekonomik (tekniko- shkencor, politik, ideologjik, profesional, etj.) Revolucion industrial Revolucionar deri në palcë Revolucionarizimi i hovshëm i jetës Revolucionarizimi i pandërprerë i jetës së vendit Revolucionarizojmë njerëzit (ushtrinë, rininë, ndërgjegjen, shkollën, prodhimin, artin, etj.) Revolucionet janë lokomotivat e historisë! Revolucioni e ka lëkundur sistemin capitalist Revolucioni nuk importohet! Rinia, rezervë e partisë Roli njohës, edukues i artit e i letërsisë Romantika e ditëve të sotme RPSSH Ruaj kuadrot e pastra, radhët e pastra

Rrënjët ideologjike Rrënjët klasore, ideologjike Rreziku i infektimit nga ideologjia e huaj Rrëshqiti nga vija Rroftë 1 Maji! Rrojmë në një kohë të lumtur Rronim në mjerim e padituri

Rruga e ndritur e socializmit Sabotatorët Sabotimet e armiqve Sedër revolucionare Sekretari i parë i Komitetit të Partisë Sektorizmi Sistem i kalbur capitalist Sipas paragjyqimeve fetare Socialist Socializëm Socializmi është shpresa dhe e ardhmja e gjitha popujve

Socializmi ngadhënjyes Socializmi të bën njeri Solidarësia klasore (proletare) Spastrim i çdo gjëje të vjetër Spastrim i organeve të pushtetit, të parties Spastrim rrënjësor Spiunazh i huaj Sulmojmë kodrat, (malet) për t'i bërë pjellore! Sulmojmë për fitore të reja! Sulmues i pesëvjeçarit të gjashtë Sulmues i punës socialiste Syri vigjilent i popullit Shamia e aksionit Shamia e pionierit Shënojmë fitore të reja Shfaqje të huaja Shfaqje të indiferentizmit, të individualizmit Shfaqje të modernizmit Shfrytëzimi kapitalist Shkojmë drejt komunizmit Shkojmë nga fitorja në fitore

Shkrirja e kuadrove me masat Shkrirja me masat Shmangia e rivendosjes së kapitalizmit Shndërrim revolucionar i shoqërisë Shok, shoqe Shoqëri pa klasa Shosha e partisë Shovinst Shoqëria kapitaliste Shqipëria është një kantier i madh ndërtimi! Shtim i hovshëm Shtrembërimi në vijën politike Shtresa e kulakëve Taktikë revolucionare Të jemi kurdoherë syhapët! Të lëkundurit Të luftohen e të hiqen nga koka idetë e shtrembra! Të mendojmë, të punojmë, të jetojmë si revolucionarë! Të mirat e kooperativizmit Të mos shkoqen forcat! Të shtunat komuniste Teoria marksiste (reaksionare) T'i mbajmë të pastra radhët tona! Tribunë e edukimit revolucionar Trupat pushtuese amerikane Thelbi klasor Thellimi i vijës së masave Thjeshtësi proletare (komuniste, popullore, etj.) U nda nga shokët Ua prishëm imperialistëve planet djallëzore Udhëheqje e pagabueshme Ujqit imperialistë Unitet i pathyeshëm Unitet ideologjik Urrejtja klasore. Ushton fjala e Partisë Ushtri e pamposhtur Ushtri vullnetare Ushtria popullore Utopia borgjeze Vdekje kapitalizmit! Vë interesin e përgjithshëm mbi atë vetjak Veçimi politik (izolimi) i kulakëve Vegël e reaksionit (e armikut) Vendos organizata e partisë Vendos populli Vend borgjez Vend kapitalist Vend revizionist Vepër e masave Vepër socialiste (qusheshin kështu të gjitha ndërtimet e asaj kohe, ura, pallate, etj.) Vepër e ndërtimit socialist Veprat e pesëvjeçarit Veprimtari sabotuese Vërtetësia e teorisë marksiste Vetëmbrojtja popullore Vërejtje me shënim në biografi Vigjilenca e masave të popullit Vija e masave Vija e Partisë Vija politiko-ideologjike Vijë (tezë) e paluajtshme Votat tona janë për Frontin Xhungla kapitaliste Yllkat Zbatimi i vijës së masave Zemër komunisti Zyrtësia e së kaluarës

2.2 Gjuha e drunjtë dhe forca e saj imponuese¹². Po gjuha e pjerrët?

Synimi i politikës është të godasë me fjalë vëmendjen e “konsumatorit” elektoral dhe ky është një veprim pragmatik. Politika është një akt ftese, por jo një formulë gjuhësore e kodifikuar. Në paragrafët e mësipërm lidhur me leksikun politik është shprehur se edhe terminologjia speciale apo termat e shkencave të tjera bëhen pronë e këtij leksiku, duke mbartur në politikë vlera përdorimore të caktuara. Është e pamotivueshme që një term specifik që e përdor një specialist i asaj fushe, të riorganizohet me një kuptim ndoshta krejt tjetër nga kuptimi i parë e të fitojë një status-fjalë në gojën e politikanit. Është domethënëse për këtë fjala punëtor, si një emërtim profesioni në fillim dhe më vonë në frëngjishten e viteve 1869 kaloi si term shoqëror-politik. Në Shqipëri në fund të 1920-ës, bashkë me punëtor nisi të merrte kuptim shoqëror dhe vetëm me Luftën e II-të Botërore u bë term i politikës (këtë e dëshmon më së miri referimi i fjalës në fjalorin e 1980-ës ku fjala ndahet në dy kuptime). Sot fjala po e bjerr këtë kuptim. E njëjta gjë paraqitet edhe me fjalën shok. Duke krahasuar me Fjalorin e 1980-ës me atë të 2002-shit, shohim se tek i pari ruhen nëntë kuptime ndërsa tek i

¹² Këto dy nocione vijnë nga dy literatura: Francoise Thom, “La langue de bois”, Commentaire Julliard, 1987; A. Ballhysa, “Klasa e shkrimit”, Sejko, 2009, f.132. E para i referohet gjuhës së re të pushtetit, komunizmit, e cila shërben si mjet për ideologjinë shterpë që ajo kërkon të transmetojë. Për më tepër shih artikullin e T. Toska “Gjuha e drurit dhe shprehësia në Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”; gjuha e pjerrët apo e përlurra janë terma që përdoren për fjalë që e paraqesin objektin në mënyrë tendencioze, me konotacion negativ.

Duke shqyrtuar fjalorin “Le petit Robert”, 2008, Le Robert dallojmë përkufizimin e mëposhtëm për gjuhën e drurit (Langue de bois): Origjina e fjalës është ruse. Është përdorur përpara revolucionit për të cilësuar burokracinë e carit rus; u përdor për diskursin ideologjik të Ruisë U.R.S.S ;është një formë shprehjeje e përdorur për njerëzit e politikës, bosat, shefat e komponentët ndrmjetës të saj dhe teknokratëve për të maskuar mungesën e informacionit të saktë për të evituar përgjigjen e pyetjeve të sikletshme, për të mos shokuar një bashkëbisedues, për të treguar një ideologji ose një vizion për botën, për të kaluar përgjegjësitë duke dalë i pastër etj.

dyti vetëm pesë. Kuptimet 5, 7, 8 të paraqitur tek Fjalori i 1980-ës për ditët e sotme dalin jashtë kontekstit të jetës pluraliste e duken “të dala mode”. Më poshtë po i paraqesim: **shok**: 5. Anëtar i Partisë së Punës së Shqipërisë. Anëtar i organizatave të masave në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, anëtar i një partie a i një organizate marksiste – leniniste; pjestar i një kolektivi: shtetas i saj; fjala që përdorim përpara emrit të plotë ose vetëm përpara emrit a mbiemrit të udhëheqësve të Partisë e të shtetit, të anëtarëve të Partisë e të organizatave të masave, të punonjësve që kryejnë detyra shtetërore e shoqërore dhe të pjestarëve të tjerë të kolektivave punonjëse, të cilëve u drejtohem me nderim a zyrtarisht; fjalë që përdorim përpara emrave të përgjithshëm a të veçantë të punonjësve, kur flasim zyrtarisht për ta. Shoku Enver, shok i vendosur (i ngritur, i përgatitur). Shok i vjetër (i ri). Shok partie, shokët e partisë (e Rinisë e Bashkimeve profesionale). Shokët e Byrosë, shokët e partive komuniste marksiste – leniniste, shokët përgjegjës, shokët punëtorë (kooperativistë). Erdhi një shok nga qyteti (nga fshati). Shokët e bazës (qendrës). Diskutimet e shokëve. Të dashur shokë! Shoku qytetar! Shoku inxhinier! Shoku oficer! Shoku ushtar! Shok, kalo djathtas! Pa dëgjoni, more shokë! 7.bised. ortak (në vendet ku ka pronë private; në të kaluarën edhe në Shqipëri). Ia hëngri paratë shoku. 8. Si mb.- shoqe drejt. Që është bashkuar me të tjerë në një traktat, në një marrëveshje a në një organizatë ndërkombëtare dhe që gëzon disa të drejta më të kufizuara, në krahasim me anëtarët kryesorë. Fuqi shoqe. Anëtar shok.(Vini re përdorimin simbolik të shkronjave të mëdha tek fjalët që lidhen me institucionet komuniste.) Në fjalorin e 2002 e paraqet: 3.fjalë që e përdorim me nderim përpara një emri të përveçëm ose një emri të përgjithshëm sipas funksionit. Shoku Agim. Shoku inxhinier. Ndërkaq po t’i referohemi fjalorit të 2006-ës kjo fjalë përsëritet du herë. Në zërin e parë mes kuptimeve të tjera që përbashkohen me fjalorët e mësipërm i dallon: 3.përdoret kur i drejtohem dikujt me nderim; zoti; shoku inxhinier; dhe fem.shoq/e, - ja sh. –e(t): shoqe shkolle; shoqe jete ,bashkëshorte; nuk i gjendet shoqja nuk ka ndonjë tjetër si ajo. **Në zërin e dytë përdoret: shok**, - u m.mjek.psihol. 1.gjendja e organizimit kur ka rënë menjëherë e gjithë veprimtaria jetësore nga shqetësimi a nga ngacmime të fuqishme: është në gjendje shoku, 2.fig.emocion i fuqishëm dhe i papritshëm; tronditje e fortë shpirtërore (dallo origjina e kësaj të fundit vjen nga: shock (1) – “goditje e papritur” 1560, një term ushtarak, ga frëngjishtja e vjetër choquer grevë kundër”, ndoshta nga Frankish, nga një bazë imituese schokker “për të shtyrë, goditje”; ose scoc “goditje, ritëm”. Kuptimi për “një përshtypje e papritur dhe shqetësuese në mendje” vjen në 1705; kuptimi mjekësor vërtetohet në 1804; si folje “ të përballurit me një kontakt vident “vulokset në 1570; kuptimi për të dhënë një goditje elektrike“ është nga 1706; kuptimi i “të ofendosh, të fyesh” është regjistruar para 1690-ës; shoku i thithjes vulokset në 1906; valë shoku në 1907; shoku – rozë prezantohet në shkurt 1937 nga Elsa Schiaparelli, një dizenjuese

italiane e modës; shokuere – “diçka që të godet apo të eksiton” në 1824; trupat shok 1917, vjen nga gjerm.Stobtruppen dhe ruan kuptimin origjinal ushtarak të fjalës.2. në fillim të shekullit të XIV-të me kuptimin “pako e grurit” nga gjermanishtja shok “shoku i misrit” në origjinal “grupi i të gjashtëdhjetëve; nga skukka, skok, scok “gjashtëdhjetë copa” gjashtëdhjetë pjesë”; “grumbullime duajsh”. 3.më 1819 vjen me kuptimin “maë e trashë e flokëve”; me origjinën e fjalës si mbiemër flok i trashë (1680) dhe me kuptimin emëror për “qen xhiroje me flokë të gjatë e të ashpër” (1630), emër për këtë tip qeni që mendohet se origjinën e ka nga Islanda i pajisur me një xhufkë.)

Siç shihet zëri i dytë vjen me një homonimi të plotë rrjedhojë e përputhjes fonetike së dy fjalëve. Gjithë sa u paqyrua më sipër është bërë në favor të idesë se vetëm me 2 nacione bindemi se tradita ende nuk i ka shkëputur lidhjet me të tashmen, pasi ne ende i gjejmë në qarkullim këto dy fjalë punëtor dhe shok që në kontekste të caktuara e ruajnë ngjyresën e çensurës komuniste (kujtoni asosacionet që krijon fjala o shoku, shok të artikuluar nga personazhet e Portokallisë). Megjithatë nuancimet ideologjike të tyre përditë e më shumë po zbehen duke iu drejtuar fjalëve zotni, zonjë, madamë, zoti, shkëlqesia juaj etj.Duke iu rikthyer fjalës punëtor do të shohim se fjalori i 1980-ës që në zërat 1, 2 për këtë fjalë kërkon e vendos përballje midis shoqërisë socialiste e asaj kapitaliste-revizioniste: punëtor, - m.sh. – ë, ët . 1. Në shoqërinë socialiste: ai që bën vazhdimisht punë drejtpërdrejt në prodhim (në industri, në ndërtim, në transport, në shpërndarje e në shërbime të ndryshme ku përdoret fuqia e krahut dhe prona i përket gjithë popullit) dhe është pjesëtar i klasës punëtore. E cila përbën forcën udhëheqëse të diktaturës së proletariatit e luan rolin e hegjemonit në shoqëri. Punëtorët shqipëtarë. Punëtor i përparuar (i ndërgjegjshëm). Punëtor krahu (transporti, ndërtimi, miniere). Punëtor i pararojës. Punëtorët e nëntokës (e industrisë, e peshkimit, e bujqësisë). Punëtorët e mirëmbajtjes (e ngarkim – shkarkimit). Virtytet e punëtorëve. Figura e punëtorit. Zotimet e punëtorëve. Aleanca e punëtorëve me fshatarët. Me origjinë punëtore. U bë punëtor. Punëtor politik, punëtor partie, ditë punëtore, ndërgjegjja punëtore, rinia punëtore, klasa punëtore, kontrolli punëtor, levizja punëtore. 2. Në vendet kapitaliste e revizioniste: ai që punon me mëditje dhe shfrytëzohet e shtypet nga borgjezia, ai që është i zhveshur nga pronësia mbi mjetet e prodhimit dhe që nuk zotëron asgjë tjetër veç fuqisë së tij të krahut të cilën është i detyruar t’ia shesë kapitalistit. - ; proletar. Punëtor me mëditje. Gjërat e punëtorëve. Pronari pushoi nga puna punëtorët. Aristokracia punëtore, qeveri punëtore. Madje kalohet edhe në “Bletë punëtore a)bleta që bën mjaltë, bleta femër; b)vajzë a grua që punon shumë a bën punë të mirë. Punëtorët mbledhin nektarin. (vini re togfjalëshat ideologjike dhe asosacioni komik që vendos një prej personazheve të “ Portokallisë” me frazën “bletë

punëtore” në ditët e sotme apo shokët Zylo bashkëkohorë, që duken jo vetëm të vjetëruar, por edhe qesharakë.).

Si shembull tjetër tërheq vëmendjen fjala **plan** e cila në komunizmin shqiptar identifikohet gjithnjë me togun plani i shtetit (me orientimin politik të regjimit e jo aq me nevojat ekonomike të vendit) të cilat rrjedhuan në plan mobilizues, e tejkaloj planin.me rënien e regjimit togjet bien prej përdorimit. **Po kështu ndodh edhe me pushtet, kurs, reforma, kuadro, kuvend, lëvizje etj**), p.sh. pushtet menjëherë u lidh me popullor, shtetëror, pushteti i klasës punëtore/ i borgjezisë apo me shprehjet pushteti i përket popullit/ është i veshur me pushtet (sot me imunitet për parlamentarët), pushteti është levë e partisë etj.

Ashtu si edhe në ligjërimin politik të sotëm edhe në të kaluarën një pjesë e mirë e këtij leksiku përbëhet nga togfjalësha : aksion me goditje të përqëndruar, mbëshetja në forcat e veta, lufta e ftohtë, bota e tretë, lidhjet e pushtetit me popullin, mblehje organizate, pleniumi i partisë, diktatura e proletariatit, revolucioni socialistet,. Një vecori përbashkuese e të dy periudhave ka të bëjë me universalizmin dhe renditjen varg të mjeteve të aktualizuara të shprehjes¹³, të cilat bëjnë të mundur kristalizimin e një shtrati kuptimor në të cilin bien fjalët që ipërkasin po asaj fushe tematike. Në sistemin monist, p.sh mjaftonte mbiemri popullor, ndërsa në vitet 1990 vendin e tij e zuri demokratik, madje sipas revolucionit popullor (socialist) u bë dhe revolucioni demokratik. Kështu lufta kundër...pranon çfarëdo fjale, që shënon diçka e cila shihet si shoqërisht negative, duke arritur deri te lufta kundër thashethemeve¹⁴. Ndonëse në vitet e para pluraliste u ngulmua që të futej zoti kudo, sot ende nuk është realizuar ky përgjithësim dhe as nuk është zhdukur shoku, që dëshmohej tek loja humoristike zoti shoku filan. Për çdo rrymë apo shoqëri veçohet një grup nocionesh karakteristike të saj të cilat përbëjnë fjalët kyç të saj. Mjafton të përmendim diktatura e proletariatit, revolucionizmi, kooperativat, lufta e klasave, social(imperializmi) etj. Ky kuptim politik i fjalës aktualizohej me një togfjalësh dhe bartej edhe në togje të tjera, edhe kur nuk ndiqej nga gjymtyra tjetër pranëvënë p.sh nga klasa punëtore kalohet tek klasa me kuptimin e gjithë togut duke sjellë frymë e klasës punëtore.Deri në 1991 tek ne fjala parti do të thoshte PPSH ,dhe Fjalori i 1980-ës e nxjerr atë si kuptim më vete:Komiteti qendror i PPSH ;Kongresi i 7-te i PPSH ;Tështa e Partisë; Ç’thotë Partia bën populli ;ç’don populli bën Partia;fjalë e urtë kur hyri Partia etj. Kuptimi i dytë për Partinë,~A II f.sh.~,~të. Pjesë a sasi e madhe mallrash ose lëndësh që çohen së bashku diku.Parti malli.Parti leshi(pambuk ,lëkurë).Shitja e partisë së parë(vjen si një e plotë në fjalorët e 1980-ës,2002-shit,2006-ës). Në thelb edhe titulli martir i

¹³ Xh. Lloshi, “Stilistika e gjuhës shqipe”, art.cit, Albas, 2005, f.232

¹⁴ Po aty, f.232

demokracisë u fut si kundërvënje ndaj dëshmor i luftës. Konotacionet që vitet e fundit po marrin fjalë si komunist apo ballist janë diametralisht të kundërta. Një rrjedhim i natyrshëm i këtyre proceseve është përfitimi i eufemizmave politike: “Pas kësaj, ashpërsimi i luftës së klasave”, eufemizma që marksizëm-leninizmi kishte gjetur për terrorin, po bënte kërdrinë”. (Kadare, “Nga një dhjetor në tjetrin”,1991)¹⁵.

Të tjera mund të përmendim: “konflikt industrial” për “grevë”; “përplasje verbale” për “sherr”; “ndotje akustike” për “zhurmë”; “marketing politik” për “pazarllëqe, pazare të pista, mitmarrje”; “puthadorë” për “servila”; “lufta e vitalitetit meritokratik kundër kalcifikimit hierarkik”; “artikulime politike” për “ndeshje me fjalë” (nëpër konferenca hidh e prit për shtyp); “piramida të reja” për “mashtime të komplikua në formë hierarkie”; “modalitetet e nisjes së bisedimeve” për “kushtet, obligacionet”. Konotacioni është një tjetër element që na përbashkon me të kaluarën, të cilën R.Barthes e quan “sistem parazit i gjuhës së mirëfilltë¹⁶”. (Kujtoni konotacionin negativ me të cilin bashkëshoqërohet fjala fashizëm edhe në fjalorët më “asnjanës” të huaj). Parullat, sloganet që në gjuhësi emërtohen si teori të klisheve, stereotipave janë një tjetër element i fortë përbashkues. Forca e tyre ndikuese shfrytëzohet jo duke shpalosur fakte dhe informacione, por me manipulimin euforik të vlerave e vlerësimeve. Përsëritja nëpërmjet medias dhe mjeteve propaganduese bën që ato të veprojnë tek ndjenjat e dëshirat, si anët më të brishta tek njeriu. Shfrytëzimi i përmasës imagjinare dhe simbolike në artikulum duket se sjell më shumë efekt tek “konsumatori elektoral”.

Demonstratat e dhjetorit 1990 u bënë duke përdorur më shpesh parrullën “E duam Shqipërinë si gjithë Europa!”. Në këtë fjali thirrmore përdoren të gjitha përftesat shprehëse, deri edhe rimat e aliteracionet¹⁷. Në monizmin shqiptar reklama ndalohej, por parullat prireshin të mbulonin malet, fushat e kodrat¹⁸. Gjuha e cila në më të shumtën e rasteve merrej si citim i pandryshueshëm nga fjalimet e diktatorit Hoxha ishte vetëm një tërësi stereotipash të ngurtësuar dhe në një frazeologji e konotuar: Partia rekomandon që të këndohen dhe këngë dashurie?! Sot, parlamentarët e kanë të pamundur të shkëputen nga parapëlqimi për epitetet demokratik e pluralist. Apogjeu i manipulimit të fjalës arriti kulmin me parrullën “Me ne fitojnë të gjithë!”, pikërisht në kohën e katastrofës së firmave piramidale që pastronin para të pista?!

¹⁵ Xh. Lloshi, “Stilistika”, Albas, 2005, f.233

¹⁶ R. Memushaj, “Hyrje në gjuhësi”, Dituria, 2002.

¹⁷ Xh. Lloshi, vep.cit, f.234

¹⁸ Vini re hiperbolizimin që i bënte Partia-shtet reputacionit e frymës së saj me parrullat, të aktualizuara në filmin më të fundit “Parrullat”.

Megjithatë, format, prafabrikatet, kuptimet, teknikat e ndërtimit të dialogut dhe reflekset gjuhësore të mbijetuara prej asaj kohe janë ende të gjalla në përdorim, duke u ushqyer në mënyrë parazitare nga dëshira e elitave të sotme për pushtet, vaniteti i profkatarëve, demagogjia sidomos në mediat, qëndrimet populiste dhe shprehjet e fosilizuara të ligjërit publik, që nxjerrin krye sa herë që prejardhja nuk identifikohet dot¹⁹. Asgjë nuk ilustron dot më mirë ndërhyrjen totalitare në gjuhë sesa klisjet apo frazat e gatshme. Totalitarizmi lëshoi në ligjërimin publik frazat e veta proverbiale, po aq anonime e autoritare sa proverbat e mirëfillta, por që i referoheshin urtësisë së klimës pushtetare apo udhëheqësit suprem. Ja, disa shembuj frazash të tilla:

- Me popullin për popullin;
- Shqipëria është fener ndriçues në brigjet e Adriatikut;
- Jemi shërbëtorë të popullit;
- Beso e kontrollo (ka thënë Stalini);
- Feja është opium për popullin;
- Parti-Enver jemi gati kurdoherë;
- Ne në gojë të armikut hedhim valle;
- VF- LP;
- T'u qepemi kodrave dhe maleve e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat;
- Lart frymen revolucionare!
- Armiku na ka në grykë të pushkës, por ne e kemi në grykë të topit etj.

Ja edhe disa raste klisesh:

- Gjaku i dëshmorëve;
- (armiqtë) do të lënë kockat;
- Grusht bashkuar;
- Mësimet e pavdekshme (të Illicit);
- Pilulë e sheqerosur
- Lakra në kokë
- Kjo e tokë e larë me gjak
- Duart me kallo
- Shqipja dykrenare etj.

Më e famshmja formulë, që sot edhe gjithë ditën shërben si mjet humoristik, është ajo e tipit “Të rrojë Partia!”, “Të rrojë shoku Enver!”, që riprodhonin nga njëra anë autoritetin totalitar

¹⁹ A. Vehbiu, “Shqipja totalitare. Tipare të ligjërit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990”, Çabej, 2007, f.230.

dhe nga ana tjetër frikën visherale ndaj atij regjimi. Evokimi i autoritetit të padiskutueshëm pas këtyre shprehjeve klishe kishte një efekt bllokues për dialogun pasi tek e fundit sloganeve të tilla mund t'u përgjigjeshe vetëm me slogane të mëtejshme: Të rrojë shoku Enver! Marrtë nga ditët tona! Armiku të na marrë të keqen! Rroftë populli ynë punëtor! Rroftë sa malet! Iu bëftë dita njëmijë etj.

Duartrokitjet frenetike, ulërimat korale të tipit: “Parti-Enver” i jepnin fund kësaj farse autoritare, i jepnin fund togfjalëshave të stisura e që në ligjërim silleshin si të mëvetësishme. Gramatikisht këto formula nuk ishin të detyrueshme në kombinim, por duke u përdorur aq shumë kishin humbur forcën dhe logjikën e tyre shprehëse. Në përgjithësi (tipar ky edhe i çdo slogani, shënimi ynë L.L) kuptimi i klishesë zhvendoset nga rrafshi kumtues në një rrafsh retorik pro klisheve të denotacionit vjen edhe zëvendësohen nga elementet e mbishenjimit. Klishetë kanë të bëjnë me nevojën instiktive për të nënvizuar e për të theksuar autoritetin dhe shpesh në totalitarizëm i bashkëngjiteshin një modifikuesi shpesh të panevojshëm si: fjalimi pragmatik i sh. Enver ; u dhamë përgjigjen e merituar; me djersën e ballit, me unanimitet të plotë etj.

Sot, klishe të tilla janë: lufta e klasave politike; ngërçi i pazgjidhur në politikë; poli i tretë asnjëanës, lideri i gjithësdjathtës së re, gjuetia e shtrigave e politikanëve (Edi apo Saliut) etj. Mbiemri rimerr kuptimisht një përbërës semantik të emrit –p.sh folja shkull e përmban kuptimisht emrin rrënjë apo emri unanimitet nocionin e plotësisë, ngërçi me pazgjithshmërinë etj. Fjala në politikën e sotme dhe atë të djeshme intensifikohet, nënvizohet zakonisht nëpërmjet epiteteve apo epiteteve metaforike: provokacione të ndyra, fitore e lavdishme, godas ashpër, unitet i çeliktë, theshtësi proletare, mobilizim revolucionar, heroizëm i pashembullt, shndërrime të thella/rrënjësore etj. Gjithnjë këto fjalë shoqërohen me ndajfolje, mbiemrave apo shprehjeve absolutizuese si: përfundimisht, definitivisht, katërcipërisht, kurdoherë, përherë, kurrën e kurrës, në instancë të fundit, nga Vermoshi në Konispol, nga Jugu në Veri, me mish e me shpirt, në mënyrë të pashmangshme, kategorikisht, totalisht, globalisht, i gjithë populli punonjës, proletarë të të gjitha vendeve, unanimitet, i madh e i vogël në të gjitha aspektet, pa kursyer asnjë sakrificë, në të gjitha format, me hir e me pahir, e çdo kusht, me çdo mjet, deri në pikën e fundit të gjakut, lart e më lart, fund e krye, në jetë të jetëve etj, ose përdoren mbiemra/ndajfolje në shkallën sipërore- relative apo sipërore - absolute : fitorja më e madhe, dënimin më të rëndë, maksimal optimal, minimal, suprem, global, universal etj. contradicto i adiecto që kemi shpalosur më sipër në paragrafët e mëparshëm rishfaqet edhe në komunizëm: energji të pashtershme, luftë e pakompromis, kujtim i paharrueshëm, propozim i papranueshëm, themelet e patundura, me vlerë të paçmuar/

të pallogaritshme, autoritet i padiskutueshëm, vendim i paaplikueshëm, argument i pakundërshtueshëm, kontradikta të papajtueshme, marshim i pavdekshëm etj.

Ja, sesi shprehet Vehbiu për këtë çështje: “Klishetë derelativizuese (ose të mohimit total të kundërshtimit si një teknikë e tërthortë e absolutizmit) sillnin me vete një botëkuptim në thelb statik në ligjërim, sepse vetvetiu e përjashtonin nuancën, ndryshimin, reformën dhe evolucionin²⁰. (f.188)

Klisheja, slogani çon vetvetiu në homogjenizimin e ngjyimeve tek fjalët meqenëse synojnë t’i zëvendësojnë shprehjet e individualitetit të folësit me vullnetin për solidarizim. Do të pyesnim a ka kallëpe të parafabrikuara sot në shoqërinë shqiptare? Sigurisht, që ka sa kohë ka një pozitë dhe një opozitë që lufton e sa kohë që lufta për pushtet prek edhe gjuhën, gjuhëtarët..., sa kohë që me fjalën manipulohet, mbishtresohet dhe sa kohë që me fjalën shpërthen lufta.

²⁰ Vehbiu, ndër të tjera i quan këto shprehje si kundërti elementare, në thelb antonimike që e përjashtojnë njëra-tjetrën kuptimisht.

KAPITULLI I TRETË

TRAJTIM LEKSIKOLOGJIK E LEKSIKOGRAFIK I GJUHËS POLITIKE

3.1 Trajtimi leksikologjik e leksikografik i gjuhës politike

Leksiku i politikës përfshin fjalë, terma, shprehje dhe kuptime me ngjyrim apo jo, duke përbushur kështu nevojat për të komunikuar me fjalimet publike, me raportet e diskutimet në konferenca, në mbledhje partish e organizatash të ndryshme (qeveritare e joqeveritare) etj, mjete gjuhësore këto polifunksionale. Për shkak të përdorimit kaq të gjerë e të dendur të këtyre mjeteve, në leksikun e politikës vërehen ndryshime e zhvillime të vazhdueshme në strukturë dhe në përmbajtje (terminologjike ose joterminologjike) shoqëruar me lëvizje të brendshme semantike. Rezultatet janë mbresëlënëse në pasurimin e leksikut të përgjithshëm dhe në terminologji. Prurje të reja cilësore e sasiore nga fusha të tjera bashkëpunuese vërehen përditë e më shumë në fjalimet e politikës të cilat zënë gati 2/3 e informacionit ditor që konsumon qytetari sot, dashur padashur. Njësitë e reja përditë e më shumë ia zënë vendin atyre të vjetra. Konceptet e reja po zbarkojnë dita-ditës e së bashku me to edhe kuptime të derivuara e të panjohura më parë. Mjafton të shqyrtohet pak nëpër faqet e fjalorëve të huaj apo në botën e internetit e një lumë fjalësh me prejardhje kishtarë, mjekësore, filozofike, matematikore, ushtarake etj vjen e të përplasen në fytyrë me një ngjyrë tjetër ngjyrimin politik. Për realizimin e një analize të plotë strukturore-semantike të këtij leksiku duhen marrë parasysh një bashkëlidhje reciproke e faktorve gjuhësorë me ata jashtëgjuhësorë, të cilët kanë bërë të mundur këto zhvillime të natyrshme. Interesi që të zgjon ky leksik do të vështrohet në këtë punim në dy rrafshje: rrafshin e veçantë shenjues (denotativ) e atë ngjyrimor (konotativ) të cilat të udhëheqin drejt karakterit të veçantë emërtues terminologjik e joterminologjik apo atij shprehës-emocionues. Huazimet apo “interferencat, turbulencat” janë njëra nga metodat e sjelljes së prurjeve, njësitë të reja që i intereson leksikologut në radhë të parë. Polivalenca e këtyre njësitë leksiko-semantike të reja ka sjellur përdorime të paimagjinueshme të përfshira në mënyrë implicite (të pashprehur) në rrjedhë të kohës. Gjuha e politikës nuk ngelet në stadin e huazimeve të fjalëve të huaja, por parapëlqen të marrë edhe nga fusha të tjera si ekonomia, publicistika, teologjia (feja), historia etj. Fjalët (me një kuptim apo me disa kuptime) dhe

termat që ngërthen politika sot, pasqyrohen e zërthehen nëpër fjalorë njëgjuhësh (shpjegues) dhe dygjuhësh apo fjalorë të fushave përkatëse si filozofike, enciklopedike etj. Neomenklatura përkatëse terminologjike me strukturë njëfjalëshe ose togfjalëshore (si politikë financiare, politikë kulturore, politikë gjuhësore etj) nuk ka sesi të mungojë. Kjo e fundit shfrytëzohet shumë nga publicistika (media e shkruar apo elektronike). “Por, kjo nuk do të thotë se në këtë leksik përfshihet pa përjashtim gjithë terminologjia teknike e shkencave shoqërore ose tërë nomenklatura, e cila është speciale fjala vjen për financën (si kontabilitet, overdraft, llogari rrjedhëse, debit e kartë debiti, kartë krediti etj.), që nuk ka karakter publik dhe përmbajtje politiko-shoqërore, që s’ka ndonjë lidhje me ideologjinë ose me regjimin dhe përdoret vetëm nga një rreth shumë i ngushtë specialistësh²¹”.

Nga filozofia: politolog, politizoj, dialektikë, doktrinë, metodë, materie, ndërgjegja, idealist, objektivizëm, subjektivizëm, pragmatizëm, e vërteta (absolute, relative) ,etj.

Nga ekonomia: bazë ekonomike, kapital, krizë (politike, ekonomike), vlerë e shtuar, mbivlerë, pronë (private), privatizim, sipërmarrje (kapitaliste), monopol, monopolizëm, trust etj.

Nga drejtësia: alibi, akuzë e aktakuzë (politike), i paligjshëm, paligjshmëri, e drejta e fjalës(e shtypit), dhunoj ligjet, kod zgjedhor, kushtetueshmëri, kriminel (ordiner), antiterrorizëm, shfuqizim a abrogim (i një ligji), shtet i së drejtës, rehabilitim, votë, balotazh, veto etj.

Nga media: opinionist, komentator, gazetaresk (keq), konferecë shtypi, sigël, titroj etj.

Nga feja: amoral, antifetar, jofetar, bektashizëm, imoral etj.

Nga historia: aga(keq), bej, feudal, çifligar, vezir, bajraktarizëm (keq), komunaret e (Parisit), rilindje kombëtare (së fundmi si parrullë e PS-së si opozitë)²² etj. E njëjta fjalë si p.sh bazë (në raport me superstrukturën) është term i filozofisë, por në gjuhën e politikës vijon të përdoret me një kuptim tjetër (konteksti baza e partisë) në kundërvënje me qendër (e partisë), gjithashtu e këtij leksiku. Ndërkaq mohohet këtu kuptimi i kësaj fjalë si term i kimit (bazë e tretshme) ose si term i gjeometrisë (baza e trekëndëshit). Edhe tillë vjen edhe fjala ligj (shkelja e ligjit) si term mirëfilli i drejtësisë, por që e huazon edhe fizika (ligji i rëndesës, ligji i Njutonit); gjuhësia (konteksti ligji i ekonomisë gjuhësore, ligji i Grimmit), por në dy kontekstet e fundit ajo përdoret si term apo si gjymtyrë e togfjalëshave terminologjike pa

²¹ M. Samara, “Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2008, f.18. autori i vë fre leksikut politiko-shoqëror në fjalët profesionale e të fushave e nënfushave të caktuara, duke shprehur idenë se jo gjithcka mund të huazohet nga ky leksik. Kufiri është gjuha e specialistëve.

²² Po aty, prof. M.Samara argumenton faktin se studiuesit bashkëkohorë të gjuhësisë së tekstit e shohin këtë klasifikim si shprehje të përpjekjeve për përligjjen e një “metagjuhe”; pikërisht prof. P. Serriot flet për “langue de bois” apo gjuha e drurit, e drurit, e prekur edhe nga ne në punimin tonë. Përmendet punimi në frëngjisht i P. Serriot, “Language de bois, langue de l’autre et langue de soi”, 1989, ku ndahen mekanikisht leksiku që lidhet “me ne” dhe leksiku që lidhet “me ata”, sic ndodh në të gjitha regjimet totalitare.

përmbajtje politike. Më sipër u hodh ideja se gjuha e politikës përmban fjalë (me karakter të përgjithshëm) dhe terma (me karakter special) me strukturë njëfjalëshore ose togfjalëshore, por gjithmonë si “emërtim i një nocioni²³” dhe nuk mbart ose merr ngjyrimë siç mund t’i mbarte fjala. Termat janë kryesisht emra dhe mbeten më të saktë, më të përcaktuar se fjala nga ana semantike pasi shënon një nocion më të specializuar në një fushë të caktuar të teknikës apo shkencës; gjithashtu termi ka kuptim më të pavarur se fjala, ka karakter dituror²⁴. Mjafton t’i hedhësh një sy në fjalor kuptimeve të figurshme (joterminologjike) politiko-shoqërore dhe strukturës semantike që mbartin fjalët lidhje, bosht e të bindesh për gërshetimin semantik e strukturor të fjalëve me termat që gëzon ky leksik. Për më tepër iu referohemi togfjalëshave: lidhje interesash, mban lidhje të ngushta; formuan një lidhje të re, Lidhja demokratike (e Kosovës); Boshti i shteteve aleate, bosht (metodologjik, ideologjik), Boshti i djallit (fig), boshti PS-LSI etj²⁵. Por, këto fjalë e të tjera të paasqyruara ne citim kanë në strukturën e tyre edhe kuptime të tjera (p.sh lidhje si “lidhëse” e “nyje” komb; boshti “si pjesë e një mekanizmi”, “bosht i shkurtër për të tjerë fillin”, “drugë”, “drejtëz”vijë e përfytyruar astronomike”/ “bosht i dramës”/ “çështje bosht”/ “pjesë e makinave”. Fjala lidhje veç të tjerave sugjeron: “bashkim elementesh”; “pajtim”; “kurorë, varg”; “veshja dhe qepja e librit”; “përzierje e ngurtë a e lëngët”; “shkëputje për një kohë të gjatë” etj. në këto të fundit përmbajtja politike zhduket. Të tilla fjalë polisemantike “e veshin” sot gjuhën e politikës në çdo drejtim.

[“Pikërisht për arsye të bashkëlidhjeve të tilla ndërmjet termit e fjalës, ndërmjet kuptimit terminologjik dhe kuptimit joterminologjik(...)disa nga njësitë që mund të përdoren në këtë fushë mund të quhen edhe fjalë edhe terma ose ndryshe fjalëterma²⁶.] Gjithçka gjuhëtarët ia atribuojnë polisemisë si mjeti kryesor për zgjerimin e strukturëssemantike sipas tipave të prejardhjes semantike gjuhësore. si rast tipik mund të trajtohet kthimi i termit aga,-i si term

²³ Në fjalorin e gjuhës shqipe 2006 fjala term përkufizohet: 1.emërtim me një fjali a me një togfjalësh i një koncepti në një fushë të shkencës, të teknikës, të artit etj. 2.mat.numra a gjymtyrë përbërëse e një raporti: termat e jashtëm (e brendshëm).

²⁴ Prof.Samara në veprën e tij shprehet për termat si bartëse vetëm të një kuptimi ndërsa fjalët si të lidhura e të kushtëzuara me kontekstin nga vijnë (p.sh shembulli ynë: fjala-fjali Zjarr! lidhet domosdoshmërisht me një kontekst të caktuar); profesori përmend edhe definicionet “homonime terminologjike” apo “terma polisemantike” për termat me shumë kuptime. Shih më tepër f.22.

²⁵ Dallo se këto fjalë por edhe të tjera si aks; strukturë, notë, binjakëzim, forcë politike, piketa, rotacion, rrjedhë, optika, rang, terreni, trukim (i votave), tkurrja (e LSI), ekuacion (i fitores së zgjedhjeve), klasë politike, tryezë (e qeverisë), urë (komunikimi), imunitet, pjesë e paketës (kushtetuese), partnerë (ndërkombëtarë), tolerancë zero, rrjeta (e Edi Ramës), tutori (i PD-së), binarët (e interesave kombëtare), tensione (politike), ,zona euro, operacion ndërpartiak, notë zyrtare, dështim i procesit të integritimit, shkak(faktor)politik, hop (zhvillim me hop), ndalim (heqje e lirisë), muri i Realizmit-Socialist, sot si muri i integritimit, i tërheq nga zverku kërraba subjekti e pushtetit politik, tiradat proqeveritare, eminenca gri, eksponent i PD-së, sindromë e kërmillit (për një parti), komision i atestimit, optika e politikanit, libri i zi i korrupsionit, enturazhi miliardë, fletorja zyrtare, mafia shtetërore, ngërc politik, proces transparent, shorti i politikës, strukturë pushtetore, debat politik, kampi i republikanëve, pjekuri(maturi)politike, dialog politik, kapital politik.

²⁶ A.Duro, Fjala-term dhe struktura semantike e fjalës në SF.1992/3-4. Termi bërthamë atomi në fizikë vjen mbi bazën e derivacionit semantik nga bërthama (e një fruti); termi bosht(i tokës) vjen në gjeografi nga boshti (i një rrote) etj. po ashtu termi celulë opozitare (politikë) vjen nga celulë(qelizë bimore shtazore) në biologji. Autori trajton dy modelet termëzim dhe shtermëzim si dy procese që i kundrvihen njëri-tjetrit. Për më tepër shih edhe M. Samara, vep.cit, f.24

historie “feudal e çifligar në kohën e Mesjetës” me një fjalë të përgjithshme “drejtues”, njeri i vrazhdë, kryefamiljar që ka veç dëshirë të urdhërojë e të rrojë me mundin e të tjerëve” dhe mandej me një ngjyrim shprehës stilistik, pexhorativ e ironik në politikë “ kryetari i një çete”(shtermëzim).

Leksiku politikës është i ngjeshur me emra si përfaqësues të koncepteve, por edhe me mbiemra, si p.sh. ata të tipit popullor e kombëtar që luajnë rolin e gjymtyrëve në togfjalësha me një shkallë abstraktimi: identitet kombëtar, kauzë kombëtare, pushtet popullor, simbol kombëtar, fronti kombëtar etj. foljet e ndajfoljet nuk mund kursesi të mungojnë si : politizoj, shpolitizoj, katërcipërisht; gjithashtu emra tepër të zakonshëm të gjuhës së popullit përfshihen në këtë gjuhë kur përdoren figurativisht dhe me domethënie politike si: botak, llum, dekika, psh:”u mblodh llumi i qeverisë”. Nomenklatura terminologjike paraqitet në formën e disa togfjalëshave-emërtime të përveçme si Parti demokratike, parti Socialiste, Lëvizja socialiste për integrim apo disa emërtime të shkurtra, të përveçme (vetjake) si : NATO (organizata e atlantikut të veriut) etj. prejardhja kuptimore (semantike) është një nga format pasuruese të gjuhës politike e cila sjell njësi të reja, të prejardhura, por jo fjalë tëreja. Kuptimet që lindin janë të rikuptimësuar, abstrakte, konkrete, sidomos kjo vihet re tek fjalët polisemantike së cilës i shtohet a i mbishtresohet edhe një kuptim tjetër dytëor në sferën e fushës politiko-shoqërore. Këtë gjë e pamë më sipër me fjalët bosht, lidhje, bazë, qendër, lëvizje, çerdhe, udhëheqje, oborri (i Saliut), garë (elektorale), mbledhja (e PS), sfidë elektorale, ngërçi (politik) etj.kuptimi i prejardhur i këtyre fjalëve është drejtëpërdrejt i varur nga një kuptim tjetër terminologjik ose jo i një fushe specifike si p.sh: kuptimi “ i konkurrencës”në garë parazgjedhore kuptimin e saj terminologjik në sport; po ashtu, kuptimi i prejardhur i fjalës prapavijë, pararojë (politike) lidhen me përdorimet e tyre terminologjike në ushtri; kolaps zgjedhor (bllokim i zgjedhjeve, ngecje) lidhet me kuptimin specifik terminologjik në mjekësi “ndalim, ose bllokim zemre”. Siç është përmendur edhe më sipër tek përdorimi i metaforës rrjedhojat janë të tilla që një fjalë e një fushe ndërron fushën e përdorimit (mbart një kuptim tjetër), duke e zgjeruar, ngushtuar apo shpërngulur fare kuptimin e saj të ri, krahasuar me të vjetrin. Gjithçka merr ngjyresë e aktualizohet duke u vendosur në një kontekst të ri, në një tjetër kontekst²⁷ tashmë me ngjyrim politik. Nuk ka sesi të mungojë pas kësaj prejardhjeje semantike edhe lindja e kuptimeve të figureshme që s’mbartin aspak karakter terminologjik, por një shprehësi tepër të madhe. Të tilla do të përmendim: zvarritje “veprim i ngadalsuar i cili pengon zhvillimin ose bie ndesh me progresin (zvarritje burokratike); njollë, njollose si “ves apo cen moral jofizik i dikujt në ndërgjegje” (deputet i njollosur kokë e këmbë);

²⁷ Në fund të punimit tonë kemi vjelur jo më fjalë të përdorimit të përditshëm, por ndërkombëtarizma të cilave u është shpjeguar etimologjia me tri rrugët e mësipërme në varësi të kontekstit politik.

plasaritje “çarje, e çarë, mosdakordim opinionesh partiake); frymë “aspiratë, parim, synim e një veprimtarie: frymë partiake; çimentoj “forcoj, nguros (u çimentua uniteti partiak); i lëkundshëm “i paqëndrueshëm në bindjet e veta politike” (politikan i luhattur, i lëkundur, që kthen krahët nga fryn era); i nxehtë “debat i tensionuar, i acaruar (debat i nxehtë); i nderë, i tensionuar “ (situatë e nderë në marrëdhënien bilaterale); lart-poshtë “organet më të larta apo më të ulëta, vartëse të një partie (erdhi kërkesa e një partie nga lart); të tjera si shturen (shthurje), hitlerian, pastrohëm (pastrim ideologjike), brumosem (brumosje), shkurtoj (shkurtim) në personel, ngërç (diçka që s’funksionon, që s’ecën në një qëndrim politik), kapja (të kapurit e shtetit, përqëndrimi i pushtetit e duart e njëjës parti regjim totalitar, rrëzim i qeverisë (i një autoriteti), baza “qendra e partisë e cila lëshon tentakulat e saj nëpër rrethe TV ORA NEWS”, suspancë “heshtja elektorale pas votimit, apo heshtje e qëllimshme e një partie politike, mosreagim i saj”, krizë “palë politike që s’gjejnë dot gjuhën e përbashkët, por që fuqimisht ankohen për njëra tjetrën”; brenda “gjirit të një partie a një organizate”; zjarrndezës/zjarrvënës “luftënxitës”, ia vesh “ia atribuoj dikujt diçka, e vesh me pushtet të plotë”; shëndoshje “në parti nga ana organizative me anëtar të rinj apo me ide të reja²⁸ . këto zhvillime të brendshme semantike të fjalëve i dedikohen polisemisë, pra njësia e re lind mbi bazën e fjalës ekzistuese dhe nëprnjet metaforës a përdorimit metaforik realizohet ngushtimi, zgjerimi apo shpërngulja e kuptimit të parë (primar). Shkalla e risemantizmit (rikuptimësimit) sa më e madhe apo sa më e vogël qoftë do të përcaktojë nëse kuptimi është i qëndrueshëm duke dalë si kuptim më vete në fjalor, në të kundërt del si kuptim i figurtë apo si nuancë e bashkëshoqëruar me njëkuptim tjetër. Të tilla do të përmendim: kthesë politike, u ndesh “u konfliktua me anëtarin e një partie tjetër”, përpunoj “dikë, iambush mendjen me politikën e mia me agjitacion e propagandë”, rrugë “u zgjidh me konsensus të një partie çështja, me rrugë partie”, kalitje “qëndrime politkike”, zbres poshtë “nga qendra në bazë”, regjim i kalbur “në grahmat e tij të fundit”, gjendje e vakët “atmosferë politike asnjëanëse, pa debat, pa tension, pezull, thatësirë etj. Huazohen elemente të florës e të faunës me të gjitha mënyrat për të denigruar me çdo kusht figurën e kundërshtarit si p.sh: korb i zi, gjarpër, çimkë e hardhje(politike); mishkonja, miu (Erion Braçe), të gjitha këto me ngjyrim përbuzës, ironik e keqësues. Denduria e përdorimit të këtyre fjalëve në ligjërimin politik është faktori bazë që përcakton të sjellurit e tyre si fakte gjuhësore apo të mbetura ende në stadin e kuptimeve të prejardhura e të figurshme²⁹. Ngjyrimet të forta shprehëse-emocionuese, politiko-shoqërore do

²⁸ Mjafton të hapësh fjalorin e 2002-shit ose 2006-ës dhe të gjesësh të gjitha kuptimet e figurshme të një numri të madh fjalësh, që lidhen me nuanca politike.

²⁹ Pas fiksimit të një lloj ngjyrimi specifik në strukturën kuptimore të fjalës kalohet gradualisht në zgjerimin e bazës së saj dhe më në fund pas një përdorimi tejet të gjatë në ligjërim jo veç nga një subjekt, por nga një shumicë bartësish duke fituar statusin e një fakti gjuhësor apo të një kuptimi të ri në fjalor.

të shihnim edhe në disa togje si: carët (e caristët) e rinj, (neocaristët) me ngjyrim keqësues e ironik për “pushtetarë të rinj që i japin vetes detyra e liri absolute apo refresh i FRESH-it (Sali Berisha në një konferencë shtypi) edhe kjo me nota të forta ironie; mbledhje maratonë për “mbledhje që zgjat tepër”, verbëri politike, këlysh i Ps-së për “pjellë servile, shërbëtor i PS-së”, pazarllëqe e allishverishe “me kuptimin pazare të pista, jo të ligjshme” (herë shfaqet nëpër gazeta me emërtimin Novi Pazari); qen “njeri i egër dhe i keq”, çirak “servil i dikujt”, bishti i kryetarit “njeri pa personalitet, pa vlerë, por gjithnjë nën urdhërin e dikujt; ujëra të tepërta “propagandë e tepërt, e panevojshme që nuk sjell rezultat”, pishtar i demokracisë “ai që u ndriçon rrugën të tjerëve me një shembull të madh” (Azem Hajdari konsiderohet pishtar i demokracisë), llogotit “flas gjëra të pavlefshme apo që s’janë të nevojshme për atë kontekst”, çizme “pushtim, zgjedhë e huaj” (çizmja e Italisë, e Greqisë në Shqipëri), i kuq “komunist” (pashallarët e kuq socialistë), dhuratë “elementë shpërblyes nëndorazi për diçka të kryer” etj. të gjitha kuptime e ngjyrimet të ardhura mbi prejardhjen semantike si zhvillime të brendshme të gjuhës politike janë të lidhura pazgjidhshmërisht me dukuritë e reja në jetën politiko-shoqërore dhe në kontekste të tjera marrin ngjyrimet të tjera, shumica admiruese (për këtë referoju Fjalorit të 1980-ës mbi fjalët i kuq, pishtar etj).

Ja, sesi paraqitet në Fjalorin e 1980-ës në zërin 5. fjala **kuq** si mbiemër (i,e) – 5.fig. që lufton me vendosmëri për çështjen e revolucionit socialist, të klasës punëtore dhe të partisë së saj; komunist, revolucionar: që është karakteristik për revolucionarin e vendosur a për komunistin e vërtetë. Komisar i kuq. Kështjellë e kuqe e socializmit.me zemër të kuqe.

Dhe më tej pishtar 2.fig.poet. ai që me idetë e veta përparimtare e me veprimtarinë revolucionare u ndriçon e u hap rrugën masave të gjera të popullit në luftën për liri e pavarësi, ndriçues, udhërrëfyes. Pishtar i revolucionit (i socializmit). Pishtari i luftës çlirimtare. Pishtarë të çlirimit dhe të kulturës në fshat etj.

Burimet e pashtershme që zotëron shqipja, kanë bërë të mundur lindjen e lidhjeve të reja, e kuptimeve të reja, të prejardhura, të figurshme apo me ngjyrim, duke zgjeruar apo ngushtuar kështu strukturën semantike të fjalëve ekzistuese. Duke pasur parasysh këtë rrugë pasurimin, nëpërmjet zhvillimit të kuptimit brenda së njëjtës fjale (polisemisë), mund të zbulojmë edhe disa tipa derivacionalë kuptimore e ngjyrimorë në fushën e leksikut politik. Siç është shprehur edhe në paragrafët e mësipërm kjo bëhet e mundur nëpërmjet një figure letrare (metaforës, sinekdodës apo krahasimit) dhe gjithnjë ruhet një komponent semantik i përbashkët, si një lidhëse i të gjitha kuptimeve të kësaj fjale polisemantike. Nga konkretësia kalohet drejt abstraktes apo nga konkretësia tejkalohet në figurshmëri. Sinekdoda p.sh realizohet në togfjalëshin forumi i gruas shqiptare “tërësi e grave”, pra ndërrimi i njëjësit (pjesës) për të

tërën (shumësin) etj. kështu p.sh, nëse do të zbërthenim me metodën e analizës së përbërësve (komponenciale) përmbajtjene fjalës të ilustruar më sipër i kkuq “dikush që dallohet nga ngjyra e kuqe që e mban si shenjë a simbol apo njeri lëkurëkuq”; pamë gjithashtu edhe përbërësin (semën) “dikush që ka për ideal të tijin komunizmin”. Duke u mbështetur në studimin e J.Thomait “Leksikologjia” dhe “Tipat themelorë të derivacionit semantik në gjuhën shqipe (SF. 1981/3) bëhet e mundur të strukturosh 3 skemat semantike të kuptimeve të prejardhura, ku vendin parësor e zë ajo varg e pastaj ajo e përzier e ajo tufë.

1. **Skema semantike varg** (d.m.th kur kuptimet vijnë njëri pas tjetrit si hallkat e një zinxhiri) fjala oborr(-tare), njollë, shkelës, zjarrfikës etj e ilustrojmë këtë skemë.

Oborr 1.vend përpara ose prapa shtëpisë, i rrethuar me mur a me gardh; shesh i shtruar me pllaka guri 2.familja kooperativiste me kopshtin që i lihet për përdorim vetjak dhe me baëtitë..... 3.pallati i mbretit a i perandorit së bashku me pjesët plotësuese, përmbledh.tërësia e njerëzve të shtresave të larta që mban rreth vetes monarku, mbreti, rrethi i ngushtë i perandorit (Fjalor i 1980-ës)

OBORR

I (KUPTIM KONKRET)

↓

1.

↓


2.

2.**Skema semantike tufë** (d.m.th kur dy a më shumë kuptime kanë si burim një kuptim të përbashkët); e cila haset në fjalët lidhje, lëvizje, shthurje, zvarritje, brumosje, shkurtim, mbledhje, udhëheqje, kopje (e shtetit); plasaritje (në parti), çarje tej.


Udhëheqje: 1. Mënyra si organizohet e drejtohet puna e një organizate, e një ndërmarrjeje a institucioni, e një rrethi, e një grupi njerëzish udhëheqje e drejtë 2.parim që përcakton drejtimin e një veprimtarie ose të një pune, diçka që na tregon udhën kur duhet të ecim, parim drejtues 3.përmbledh.tërësia e drejtuesve, udhëheqësit; organi udhëheqës Udhëheqja e Partisë, Përbërja e udhëheqjes, zgjodhën udhëheqjen, detyra t e udhëheqjes.

Të gjitha këto kuptime të prejardhura lindin në bazë të kuptimit themelor “veprimi dhe rezultati sipas kuptimit të foljes udhëheq”

UDHËHEQJE



3. Skema semantike e përzier (d.m.th kur gërshetohen a ndërthuren dy skemat e mësipërme). Kanë lindur kuptimet e fjalës çerdhe, bazë, bosht, qendër, bllok, kthesë me dy apo tre blloqe semantike. Kështu fjala bllok e realizon këtë skemë me II kuptimet e saja në fjalorin e 1980-ës. Kuptimet 2 dhe 3 pra: 2.një lloj tulle e madhe prej llaçi a prej betoni me dy hapësira brenda dhe 3.rreth i madh, i gjerë, e i shkurtër prej betoni a llaçi të ngjeshur...drejtëpërdrejt lidhen me kuptimin parësor 1. Copë e madhe e rëndë e një lënde të fortë, që ka zakonisht forma të rregullta.



Kuptimet 4 dhe 5 lidhet me atë nr.6. pra 4: grup ndërteshash, që shërbejnë për një qëllim ose përbëjnë një tërësi me vete.

5:pjesë e një lagjeje në qytet, e përcaktuar si nënndarje e saj sidomos për veprimtarinë e organizatave shoqërore; banorët e kësaj pjese të lagjes. 6. Ngastër e madhe toke, që është mbjellë zakonisht me pemë frutore ose me drurë të tjerë. Kuptimet 9, 11 lidhen me kuptimin 7.

Pra 7: fletore e trashë për shënime, nga e cila mund të shkëputen fletët, fletë dokumentesh të lidhura bashkë, që shkëputen ose që mund të plotësohen. 9: tek. Tërësia e pjesëve të një mekanizmi ose të një pajisjeje, të lidhura sëbashku për një punë. II: fig.grup i madh sendesh, njësisht a çështjesh që merrn si një e tërë. Kuptimi 8 lidhet me kuptimin nr.4 dhe me kuptimin nr.3 lidhet kuptimi 10.

Pra 4: grup ndërtesash që shërbejnë për një qëllim ose që përbëjnë një tërësi më vete.

8: bashkim shtetesh, partish, organizatash ose grupesh, që bëhet për veprime të përbashkëta politike, ushtarake, ekonomike etj. bllok politik.

10: Sport. Pengesë që i krijohet kundërshtarit në sulm, për të mos lejuar kalimin e topit mbi rrjetë (në lojëne volejbollit). Bllok i dyfishtë. Bllok graniti. Siç shihet kjo skemë e prejardhjes semantike nuk mbetet shumë karakteristike, pasi zbatohet vetëm për ato fjalë me strukturë kuptimore shumë të gjerë e komplekse, në leksikon e politikës.

Për të kuptuar më mirë përmbajtjen me ngjyrim politiko-shoqëror e emocionues të këtij leksiku mund të bëhet një shtresëzim a klasifikim i tij sipas ngjyrimit, duke e ndarë atë në dy grupe të mëdha: në leksik me ngjyrim pozitiv dhe leksik me ngjyrim negativ, ku secili prej këtyre grupeve ndahet në disa grupe e nëngrupe.

A. Leksiku me ngjyrim pozitiv përfshin fjalët, përmbajtja e të cilave shënon diçka të bukur, të pëlqyeshme, të ndershme; ato shënojnë një cilësi të mirë e të dobishme të dikujt, me vlerë të përgjithshme shoqërore, që ndikon ose ndihmon për zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë. Në përmbajtjen e këtyre fjalëve pasqyrohet një qëndrim politiko-shoqëror dhe emocionues miratimi, inkurajimi e lavdërimi ose një ndjenjë dashurie, miqësie, besnikërie, entuziazmi e optimizmi etj. në këtë grupim të mad të këtij leksiku me ngjyrim dallohen disa grupe fjalësh.

Grupi i parë përfshin fjalë të tipit *demokrat e demokraci, hero, heroik e heroizëm, mëmëdhe, mëmëdhetar, atdhetar e atdhedashuri etj* ngjyrimi politik e shoqëror dhe emocionues i të cilave lidhet ngushtë ose drejtpërdrejt me përmbajtjen tyre emërtuese a shenjuese (denotative). Ky ngjyrim del shumë qartë e konkretisht në kontekstin e dhënë; ai nuk shprehet as nga tregues fonetikë (formalë), as nga ndonjë formant gramatikor e fjalëformues me funksion shprehës. Veçoritë e tij zbulohen më mirë po të bëjmë një nënndarje të këtij grupi fjalësh në tre nëngrupe:

Nëngrupi i parë është ai i fjalëve që kanë zakonisht një kuptim të drejtpërdrejtë me këtë përmbajtje; ato mund të jenë edhe me origjinë nga gjuhët e huaja ose terma ndërkombëtarë, si

p.sh. *hero e heroizëm, demokrat e demokraci, liri, liridashës, paqedashës etj.* Pasqyrimi i këtyre fjalëve ose përmbajtja politiko-shoqërore pozitive e tyre, duke u lidhur drejtëpërdrejt me kuptimin leksikor themelor, nuk ka ndonjë ngarkesë të veçantë stilistike, d.m.th gjatë përdorimit në ligjërim, si folësi ashtu edhe shkruesi nuk shprehin ndonjë qëndrim të veçantë subjektiv; përmbajtja e tyre pozitive pasqyron një realitet shoqëror e politik të përgjithshëm që konceptohet njëlloj nga të gjithë bartësit e gjuhës së sotme shqipe.

Nëngrupi i dytë përfshin fjalë që kanë strukturë pak a shumë të gjerë kuptimore (me disa kuptime), nga të cilët vetëm kuptimet prejardhura (një a dy prej tyre) kanë përmbajtje pozitive ose ngjyrim politiko-shoqëror dhe emocionues pozitiv; ndonjëri prej tyre mund të jetë edhe i figurshëm dhe me ngarkesë shprehëse, që del më mirë në një kontekst. Ato janë kryesisht fjalë shqipe dhe përkufizimi i kuptimit të prejardhur me ngjyrim letrar-shprehës shoqërohet në fjalor me shënimin fig.(=kuptim i figurshëm) ose me shënime stilistike, si: p.sh *flamur* “fig.ideal i lartë frymëzues, shembull frymëzimi”, *mburojë* “fig.mbrojtje ose pikëmbështetje e fortë dhe e sigurt” (siç del në kontekstin “mburojë e lirisë dhe e paqes”), *prij* “lart.udhëheq popullin në rrugën e drejtë”, *prijës* “lart.udhëheqës i shquar i popullit”(në kontekstin *prijës* i kombit) etj.

Një nëngrup më vete përbëjnë fjalët që në kuptimin konkret shënojnë kafshë ose bimë të veçanta, kurse në kuptimet e figurshme kanë ngjyime politike e shoqërore me karakter të theksuar letrar e shprehës-emocionues, si p.sh. luan e shqiponjë me kuptimin “*trim, luftëtar*”, “*petrit e sokol*” me të njëjtin kuptim etj. folësi ose shkruesi në vend të fjalëve trima luftëtar mund të zgjedhë sinonime me ngjyrim letrar luan e shqiponjë, pikërisht për ti dhënë ligjërimin karakter shprehës e emocionues. Ngjyrimet e mocionuese të këyre fjalëve janë bërë në shqipen e sotme edhe temë semantike për formimin e fjalëve të tjera të prejardhura ose të përbëra me karakter shprehës pozitiv, si sokoleshë (nga sokol +eshë) e luaneshë (në kontekstin “grua sokoleshë e “grua luaneshë” ose syshqiponjë (nga sy + shqiponjë, në kontekstin “partizanët syshqiponjë”).

1. Në grupin e dytë përfshihen vetëm pak fjalë të formuara me prapashtesat zvogeluese-përkëdhelëse -z e -th, si p.sh.mëmëz (siç del në kontekstin mëmëza jonë Shqipëri”), mëmëdheth “atdhe i dashur” etj, të cilat u japin fjalëve një ngjyrim shoqëror më të theksuar shprehës-emocionues. Fjalët e mësipërme të këtij grupi në ndryshim nga fjalët e grupit të parë kanë një ngjyrim pozitiv të dyfishtë, i cili lidhet jo vetëm me përmbajtjen leksikore të fjalës-temë, por edhe me funksionin e prapashtesës, e cila bëhet edhe treguese e jashtme e ngjyrimin shprehës-emocionues.

2. Grupi i tretë përfshin disa togfjalësha pak a shumë të qëndrueshëm me ngjyrim të theksuar pozitiv, të cilët kanë si gjymtyrë kryesore fjalë zakonisht me kuptim të figurshëm letrar, si p.sh. flamurtar i demokracisë, shkëmb graniti “vend i pamposhtur ose njeri i vendosur dhe i pathyeshëm”, martir i lirisë, çeliku i partisë etj.

Leksiku politiko-shoqëror me ngjyrim negativ përfshin një numër më të madh fjalësh ose togfjalëshash të qëndrueshëm, që përdoren për të shënuar diçka të shëmtuar, të papëlqyeshme e të pandershme, që nuk është në përputhje ose nuk shkon me parimet e me moralin e shëndoshë të tërë shoqërisë. Këto njësi shënojnë një cilësi a një veti të keqe, një ves a veprim të dëmshëm, që pengon ose frenon zhvillimin dhe përparimin shoqëror. Nga mënyra sesi shprehet ngjyrimi negativ leksiku i këtij grupimi mund të klasifikohet në disa grupe e nëngrupe:

1. Grupin e parë e përbëjnë fjalët me burim shqip ose me burim të huaj që përdoren sot jo vetëm në ligjërimin libror e bisedor, por edhe në ligjërimin e thjeshtë, me një ngjyrim politiko-shoqëror dhe emocionues negativ, i cili nuk shprehet nga ndonjë ndajshitesë a formant (p.sh. bandit, hajdut, kriminel, i korruptuar, gjakatar, tradhtar, tiran etj). Ky grup është mjaft kompleks dhe i larmishëm, prandaj njësitë e tij do t'i klasifikojmë të ndarë në disa nëngrupe:

a) Nëngrupi i parë është ai i fjalëve të tipit agresiv e agresion, barbar e barbarizëm, fashizëm e fashist, nazizëm e nazizist, hipokrit e hipokrizi, herezi e heretik, puçizëm e puçist, spiun, tradhëtar, terrorizëm, terrorist, prepotent etj, që zakonisht kanë vetëm një kuptim ose dy kuptime me ngjyrim politiko-shoqëror negativ. Në këtë grup fjalësh ka edhe mjaft huazime por shumica janë ndërkombëtarizma. Gjatë përdorimit të tyre në ligjërim këto fjalë zakonisht nuk shfaqen me ndonjë ngarkesë të veçantë stilistike, por përmbajnë në mënyrë të pashprehur (implicite) një ngjyrim a nuancë politiko-shoqërore e emocionuese, që në thelb është negative, prandaj mund të përdoren sipas rasis, edhe për të sharë edhe për të ironizuar. Kur thuhet p.sh. se “Ky ishte një akt terrorist e fashist”, shprehet një qëndrim politik i dënueshëm e përbuzës, po pa u sforcuar shumë nga ana emocionuese. Prandaj shpjegimi a përkufizimi i këtyre fjalëve në fjalor nuk shoqërohet me ndonjë shënim stilistik.

b) Nëngrupi i dytë është ai i fjalëve me burim shqip ose të huaj (kryesisht nga turqishtja), që përdoren me ngjyrim politiko-shoqëror e emocionues negativ vetëm në kuptimet e tyre të prejdardhura ose të figurshme; ndërsa ndonjë nga kuptimet e tyre të para a themelore, për shkak të zhvillimeve të reja dhe të ndikimit nga faktorë të rinj jashtëgjuhësorë mund të ketë dalë jashtë rrehtit të normës letrare, është vjetëruar, rrjedhimisht mund të jetë kthyer në historizëm ose mund të jetë zëvendësuar me një sinonim të ri. Ngjyrimi shprehës-emocionues del vetëm në kuptimet e dyta (të prejdardhura). Të tilla janë huazimet me burim:

-nga turqishtja, p.sh.jallanshahit (iron.) “dëshmitar i rremë”, matrapaz(Shar.) “tregtar mashtrues”, bashibozuk(keq.) “mashtrues”, allishverish(keq.) “marrëveshje politike e pandershme”, jeniçer(përb.) “njeri i shitur, mercenar”, asker (mospërf.) “militanat partiak me nivel të ulët, që kryen një detyrë si ushtar i çrregullt dhe i padisiplinuar”, zabit(mospërf.) “drejtues partiak, si një oficer i parregullt”, efendi (iron.) “zotëri mendjemadh e kapadai”, aga(iron.) “njeri kapadai”, bej(iron.) “pasanik, mendjemadh, aga”, zadrazem(iron.) etj.

-nga gjuhët sllave: kasnec(përb.) “lajmëtar a lajkatar që i bën reklamë politike dikujt”, krajl(iron.) “sundimtar absolut e mendjemadh” (në kontekstin “krajlët e partive radikale”), car (iron.) “udhëheqës partie ose shteti që drejton me metoda autoritariste”, aparatçik (keq.) “shtetar burokrat” etj.

- nga greqishtja: dhaskal, që përveç kuptimit të vjetëruar “mësues” (siç përdoret në filmin “Udha e Shkronjave”), sot ka marrë edhe një kuptim keqësues “propagandist i dobët, si një mësues i paaftë”, moleps(përçm.) “infektoj dikë, i ngjit një ves a një zakon të keq” etj.

-nga gjuhët romane: xhandar(keq.) “njeri i keq, që sillet egërsisht me të tjerët, xhandarmëri(keq.) “organizëm a institucion që përpiket të ruajë rendin egërsisht”, siç del në kontekstin “ministri e brendshme nuk është xhandarmëri”, etj.

c) Një nëngrup më vete përbëjnë disa fjalë nga mitologjia a legjendat biblike ose nga sfera fetare që në shqipen e sotme përdoren me një kuptim e ngjyrim politiko-shoqëror negativ, me karakter shprehës-emocionues, si p.sh.asket “mospërf.njeri që mundon veten, duke respektuar ca rregulla të forta e të tepërta”, asketizëm “të qenët asket”, kallogjer(keq.) “njeri që bën jetë të mbyllur”, murg(keq.) “njeri i shkëputur nga jeta e gjallë”, psall(mospërf.) “mban fjalime të mërzitshme” e psallme(mospërf.) “fjalim i përsëritur dhe i mërzitshëm”, ungjill(keq.) “dogmë që përdoret si mbështetje a referencë politike e ideologjike” etj.

d) Nëngrup të veçantë përbëjnë ato fjalë, që në kuptimin e tyre të parë shënojnë realie nga bota e kafshëve dhe e bimëve, disa prej të cilave kanë në thelb përmbajtje negative; ndërkaq ato përdoren edhe në kontekste politiko-shoqërore me kuptime që tregojnë cilësi negative të njerëzve dhe kanë ngjyrim të theksuar shprehës-emocionues, si p.sh. dhëlpër “njeri dinak”, gjarpër(përçm.shar.) “njeri shumë dinak që helmon gjakun a shpirtin”, shushunjë(keq.) “gjakpirës”, këpushë(keq.) “parazit gjakpirës, që të qepet dhe s’të ndahet”, ujk(keq.) “armik i egër dhe i pamëshirshëm”, qen (keq.shar.), zagar(keq.), kameleon(keq.) “njeri që ndërron shpesh mendje ose bindjet e veta”, etj.

e) Nëngrupi i pestë dhe i fundit është ai i fjalëve që në kuptimin e parë janë terma të një fushe të caktuar tekniko-shkencore, por duke u shterminologjizuar” ose duke kaluar në rrethin e kësaj fushe, përdoren në kontekste të reja të karakterit politiko-shoqëror dhe shndërrohen kështu në fjalë të zakonshme me ngarkesë shprehëse-emocionuese. Të tillë janë disa terma

nga fusha e mjekësisë, si p.sh gangrenë; nga fusha e sportit: start në kontekstin “dështoi starti elektoral”; nga fusha e letërsisë dhe e artit: komedi që përdoret e ironi për “farsë politike” në kontekstin “komedia e zgjedhjeve”; nga fusha të ndryshme të teknikës: zjarrfikës(keq.)”mbytës i grevës, i një reforme a i një lëvizjeje përparimtare” etj.

Rruga ose mënyra kryesore e zhvillimit dhe të rritjes së forcës shprehëse të këtij leksiku janë: a) rritja në sasi e në cilësi e mjeteve leksikore me ngjyrim emocionues dhe b) përdorimi i tyre letrar (estetik), në lidhje të caktuara sintagmatike, duke shfrytëzuar mundësitë që japin për këtë qëllim dukuritë leksikologjike të sinonimisë, të polisemisë, të paronimisë e të antonimisë, si dhe disa trope letrare (metafora, alegoria etj).

Nëpërmjet rrugës së parë shprehësia e këtij leksiku është zhvilluar dhe është rritur drejtpërdrejt si rezultat i zgjerimit të semantikës, për pasojë edhe si rrjedhim i pasurimit të përmbajtjes me ngjyime politiko-shoqërore emocionuese:

A. Te disa fjalë me burim nga shqipja, të parme ose të prejardhura, të formuara brenda shqipes me anë të ndajshesimit (me ndajshesa konotative), të kompozimit etj., që kanë ngjyrim pozitiv ose negativ si p.sh. pishtar (i lirisë), luaneshë (shqiptare), sokol e sokoleshë ose partizë (me ngjyrim negativ, p.sh. “për interesa mediokre partizash”, zbatharak e brekëgrisor (për “një politikan pa shkollë, të shkallës së ulët e varfanjak”), politikanxhi “politikan i keq”, punist”ish-anëtar i Partisë së Punës”, demokratist (“Ata duan të pastrojnë sheshin, ku, pastaj, të hedhin valle demokratistët, por jo demokratët”), meritokraci, korrupsionologji, presidentomani “dëshira e madhe pët t’u bërë president”, mitomani, xhuvelist e xhuvelizëm “ai që mban një qëndrim të lëkundur herë nga e majta e herë nga e djathta”, haxhiqamilizëm e haxhiqamilist “ai që bën agjitacion e propagandë ose sillet e vepron në politikë si një ushtar i çrregullt” etj.

B. Te disa huazime a fjalë të huaja që janë përdorur ose vijojnë të përdoren në ligjërim kryesisht për të ironizuar dikë a diçka, për të bërë një humor i cili kalon deri në ironi e sarkazëm etj., si p.sh. utilitarizëm “dobishmëri e vogël a e ngushtë”, pipino për “një fashist në kohën e regjimit musolinian” (në kontekstin “t’u tregojmë vendin pipinove”, onorevole për “zotëri pa dinjitet dhe i parespektueshëm, trojka (ruse), krajlat (serbë) etj.

Nëpërmjet rrugës së dytë, shprehësia dhe forca shprehëse e këtij leksiku është rritur: duke shfrytëzuar mundësitë e lidhjeve të shumëllojshme semantike të disa fjaëve me fjalë të tjera

ose duke përdorur për qëllime letrare poliseminë stilistike, sinoniminë stilistike, paroniminë dhe antoniminë stilistike.

Polisemia stilistike përdoret kryesisht në artikujt e publicistikës letrare për ta rritur e për ta fuqizuar shprehësinë në këtë fushë me anë të përftesave e stilemave të bukura, duke bërë ndërkëmbime me kuptimet e së njëjtës fjalë. Në këtë rast fjala polisemantike e përdorur për këtë qëllim në një tekst, mund të shpalosë e të na sjellë nëpër mend më shumë se një prej kuptimeve të saj, prandaj ligjërimi bëhet edhe më tërheqës, kështu ndodh p.sh: kur fjala kalë, si gjymtyrë e togut të qëndrueshëm kalë i Trojës, përdoret me qëllime shprehëse në kontekstin “kali i Trojës i opozitës po çalon nga të dyja këmbët”; kur fjala kalitet përdoret në kontekstin “Rinia nuk kalitet në koçavanë” ose kur fjala pastroj përdoret në kontekstin “ Të pastrojmë partinë, siç pastrojmë shtëpinë”.

Sinonimia stilistike e rrit shprehësinë kur në vend të një fjale nga ky leksik përdoren një a dy fjalë të tjera sinonimike, jo vetëm për të shmangur përsëritjet e mërzitshme, por edhe për ta bërë ligjërimin më të zhdërvjellët e më tërheqës. Sinonimet stilistike me ngjyrim shprehës emocionues sillen në tekste a në kontekste politiko-shoqërore si stilema për të ngjallur ose për të përforcuar edhe ndjena keqësuese; të tilla janë rastet kur në vend të emrit politikan përdoret me ngjyrim ironizues fjala politikaman, kur në vend të foljes iku ose u largua përdoren sinonimet u arratis, mori bishtin ndër shalë ose ia mbathi, kur në vend të fjalës vrull përdoret sinonimi yrysh, kur në vend të fjalës dinak përdoret fjala dhelpërak dhe kështu me radhë: ujdë e pazarllëk përdoren për marrëveshje, pjell për lind, rob e skllav për i nënshtruar a i shtypur, besnik, fidel etj.

Paronimia shërben për këtë qëllim, atëherë kur në vend të një fjale me ose pa ngjyrim përdoret një fjalë tjetër e ngjashme nga ana fonetike, e cila i jep kontekstit politiko-shoqëror karakter ironik, për të përqeshur dikë a diçka dhe për ta bërë në këtë mënyrë më tërheqës ose më afektiv ligjërimin. I tillë është kur në vend të fjalës politikan përdoret paronimi pehlivan ose kur në vend të fjalës kryeministër përdoret paronimi i ri krimministër.

Antonimia ashtu sikundër sinonimia stilistike, bën një efekt të veçantë tek lexuesi a dëgjuesi, sepse thekson në mënyrë tërheqëse idenë që duam të shprehim. Por, në dallim nga sinonimet, antonimet përdoren më shumë si mjete stilistike “periferike”, prandaj ato nuk i japin folësit a shkruarit aq shumë mundësi zgjedhjeje për shprehësi sa sinonimet. Në studimet për antoniminë stilistike, autorë të ndryshëm, duke u mbështetur në mendimin e Sh.Balisë se “vlerat shprehëse të fjalëve kushtëzohen edhe nga prejardhja shoqërore edhe nga pozita e personit që flet”, kanë theksuar se antonimet stilistike lindin midis së tjerash “në dritën e një

qëndrimi të caktuar”, se janë “faktorët shoqërorë ata që kushtëzojnë antonimet stilistike”. Prandaj ngjyrimet e këtij leksiku mund të shërbejnë si mjete të përshtatshme gjuhësore edhe për të dhënë në mënyrë afektive, të ngjeshur e të ndjeshme portetin e një dëshmori, të një prijësi a heroi, edhe për të bërë ironi ose sarkazmë me figurën e një diktatori. Ato shërbejnë edhe si lëndë bazë për të ndërtuar figurën letrare të antitezës. Nëpërmjet antonimisë stilistike, mund të pasqyrohet qëndrimi emocionues i një autori, i cili e përdor këtë dukuri për të prekur të tjerët më shumë në shpirt. Këtij qëllimi i arrihet duke bërë edhe krijime individuale fjalësh ose togfjalëshash, të cilat mund të duken pak të “çuditshme” duke i kundërvënë me fjalë të tjera një vargu tematik a semantik, për të ngjallur tek lexuesi a dëgjuesi një ndjenjë a situatë ironie e përqeshëse, si në rastin kur kundërvihet togu kali i Trojës me togun “e ri” gomari i trojës (në kontekstin “Kemi dëgjuar për kalin e Trojës, por në qeveri na ka dalë edhe një gomar Troje, duke aluduar për njërin nga ministrat”. Këtij qëllimi i arrihet gjithashtu duke ia kundërvënë kuptimin me ngjyrim pozitiv ose pa ngjyrim kuptimit me ngjyrim negativ a keqësues, i cili mund të jetë ngjizur ose mund të mos jetë ngjizur mirë si kuptim a ngjyrim i veçantë dhe si i tillë mund të mos jetë pasqyruar në asnjë fjalor normativ. Për këtë qëllim mund të kundërvihen edhe dy kuptime sinonimike: njëri me ngjyrim dhe tjetri pa ngjyrim (brenda strukturës semantike të së njëjtës fjale); si p.sh kuptimi pa ngjyrim i fjalës rrogëtar “nënpunës i rregullt që merr një rrogë të zakonshme” me kuptimin ngjyrimor a të figurshëm “nënpunës që punon sa për të marrë një rrogë, duke i shërbyer verbërisht dikujt, pa iu përkushtuar punës a profesionit të vet. Mbi bazën e kundërvënies së fjalëve të këtij leksiku, përveç antitezës, ndërtohet edhe figura letrare e oksimoronit. Me anë të kësaj figure, duke lidhur sintagmatikisht në mënyrë jo të zakonshme fjalë që përgjithësisht nuk lidhen nga kuptimi politikani mund të na paraqesë një ngjarje ose një realitet në mënyrë letraro-artistike e tërheqëse, me një stil të kursyer dhe me shprehësi të lartë. Kështu lind, rritet e përforcohet shprehësia, duke përdorur togfjalësha sintagmatikë të tillë, që dalin si tituj gazetash (a emisionesh): opozitarë vëllezër (që do të thotë jo pa ironi të fshehur “Kundërshtarë miq”), Drejtësi e padrejtë ose Padrejtësi në pallatin e drejtësisë, Organizim i çorgannizuar, lavdi e palavdishme, Armatim në emër të çarmatimit, Militarizim nën thirrjet për çmilitarizim etj. me këto sintagma mund të shprehet një ide a një pikëpamje politike e shoqërore në mënyrë shprehëse pa të cilat do të duhej të ndërtoheshin fraza të gjata, që mund ta mërztin lexuesin.

Shprehësia mund të realizohet dhe të forcohet në fushën politiko-shoqërore duke ndërtuar me këtë leksik disa figura letrare ose trope, siç janë: metafora, krahasimi, personifikimi etj. Në këtë mënyrë realizohen lidhje të veçanta sintagmatike të cilat e bëjnë ligjërimin më shprehës e më tërheqës për lexuesin.

a) **Metafora** përdoret si një mjet shprehës letrar, kur ajo ndërtohet me fjalë të këtij leksiku që kanë kuptim të figurshëm, në bazë të krahasimit sipas ngjashmërisë. Nëpërmjet metaforës bëhet vlerësimi emocionues i lidhjeve ndërmjet realieve a koncepteve të shënuara nga këto fjalë. Në këtë mënyrë janë përdorur e vijojnë të përdoren në këtë stil fjalët lapidar në kontekstin “fjalë lapidar” e përmendore (në kontekstin “ai mbeti një përmendore e demokracisë”) etj. Mbi këtë bazë kanë lindur edhe kuptimet përkatëse me ngjyrim ose të figurshme të atyre fjalëve. Një shprehësi e tillë vërehet edhe në togfjalëshat metaforikë: vigan i lirisë, ose shkëmb graniti a kala e pamposhtur (e demokracisë), grusht i hekurt etj, ku fortësia bëhet temë semantike e kuptimeve (të prejardhura) të figurshme dhe tipar i spikatur pozitiv. Nëpërmjet metaforës ligjërimi retorik, siç ka vërejtur edhe R.Qosja, “bëhet ligjërim i figurshëm, më tërheqës e më përgjithësues...”, siç vjen në rastin: ‘Ke të drejtë Ilir, **Shqipëria nuk futet dot në thes**, shumë mirë e paske thënë! Prandaj boll e **përdore** Presidentën e Republikës **si thes për atë farë LSI-je** dhe Presidentin e Shqipërisë **si gojën e shqyer të atij thesi!**’ Jan 28, 2021·Twitter,Rama Siç shihet përzgjedhjet leksikore të së njëjtës fushë leksikore thes & farë(LSI-je) ndërtojnë një lojë gjuhësore metaforike,të vështirë në lexim të parë nga një lexues i thjeshtë,etj. Lind i domodoshëm zberthimi metaforik i këtyre njërive frazeologjike dhe një rikuptimësim i fjalëve thes dhe farë(jofrymore) me el.frymore,njerëzore të LSI-së.

b) **Krahasimi** i ndërtuar me fjalë të këtij leksiku është përdorur dhe vijon të përdoret në këtë fushë për ta bërë më të gjallë e më të qartë idenë ose mendimin politiko-shoqëror. Siç dihet krahasimi në shqipen ndërtohet zakonisht me lidhëzat krahasore si e sikurse, psh.: “...qëndroi e luftoi si kapedan”. Por, ka raste kur lidhëza krahasuese mund të mungojë, p.sh “flamur ishe, pishtar mbete”. Në këtë rast mund të thuhet se krahasimi ka kaluar në metaforë dhe mbi këtë bazë kanë lindur kuptimet e figurshme të fjalëve përkatëse (flamur “ideal i lartë, si një simbol frymëzues” e pishtar “ai që me idetë e tij përparimtare u ndriçon rrugën edhe të tjerëve”), të cilat janë paqyruar edhe në fjalorët e shqipes së sotme.

c) **Personifikimi** ndërtohet me fjalë të këtij leksiku të cilat zakonisht shënojnë sende, por në kontekste të caktuara (jo të zakonshme) atyre u flitet ose u kuvendohet me to për probleme shoqërore sikur të ishin njerëz; rrjedhimisht nëpërmjet kësaj figure edhe liria mund “të shkelë gur më gur, opingapërgjakur mbi shkëmbinj”,apo edhe korrupsioni të zhytet në lllum,kënetë,moçal etj.

d) **Sinekdoda** shërben si figurë letrare për të sjellë efekte shprehëse në fushën politiko-shoqërore, atëherë kur disa emra (të këtij leksiku) përdoren në numrin njëjës me kuptimin e përgjithësuar të shumësit, si p.sh “**Pushkën** e shqiptarit e dëgjoji një botë e tërë...Një botë e tërë mori vesh se shqiptari e urren për vdekje fashizmin dhe do liri”. Në këtë rast pushka (në njëjës) përdoret me kuptimin “pushkët, armët”, ndërsa shqiptari me kuptimin “të gjithë

shqipëtarët”. Po kështu vlen të theksohet edhe fjala **dorë** në shprehjen “qeveria në dorën e Saliut”.

e) **Metonimia** ose përdorimi për shprehësi i një fjale të këtij leksiku në vend të një tjetre ndërtohet në bazë të afërsisë logjike e funksionale që kanë sendet a dukuritë të shënuara prej tyre; si p.sh.shkruhet se “Vendin tonë e shkeli çizmjja e huaj” (për të thënë, duke e nënkuptuar se “vendin tonë...e shkeli pushtuesi”) etj.

f) **Ironia** është përdorur dhe vijon të përdoret shpesh në stilin e politikës si një lloj i veçantë i metonimisë letrare ,duke u dhënë fjalëve të këtij leksiku një kuptim të kundërt nga ai që kanë në të vërtetë ose duke bërë sikur pranohet e kundërta e asaj që mendohet ,me qëllim që të përqeshet , të vihet në lojë dikush(p.sh.: një politikan) a diçka (një punë ose një veprimtari politike e shoqërore joserioze).Publicistët shqiptarë e kanë përdorur këtë figurë stilistike si shprehje të zemërimit e të urrejtjes që kalon deri në sarkazmë politike ose si një tallje të tërthortë të shprehur në formën e lavdërimit ,që në të vërtetë është një kritikë therëse.Kështu kanë vepruar,p.sh.,Sh. Musaraj në “Epopeja e Ballit Kombëtar” dhe U.Kostreci në “Epopeja e karkalecave”.Për të shprehur,por dhe për të theksuar ironinë,ndonjëherë për këtë qëllim,fjala me ngjyrim politiko-shoqëror pozitiv e këtij leksiku vihet në thonjëza.Në këtë mënyrë mund të ironizohet një diktator,duke e quajtur “*udhëheqës*” a “*prijës të shquar*”(për të nënkuptuar “një mburravec”) ose “*internacionalist*”(për të nënkuptuar “një nacionalist të tërbuar” a “një shovinist”), “komisare”(e partisë).

Në publicistikën e sotme shprehësia realizohet e përforcohet duke përdorur si **epitete** fjalë të këtij leksiku me kuptim intensiv,kryesisht të figurshëm, për të theksuar tiparet a virtytet e dëshmorëve ose të prijësve të vërtete të popullit.Kjo gjë bëhet me qëllim për të ngjallur tek lexuesi a tek dëgjuesi më shumë nder e respekt.Të tilla janë epitetet e përdorura me fjalë a emërtime të këtij leksiku, si *luan, petrit , hero , titan, vigan , mëmëdhetar* etj.me ngjyrim pozitiv , për të cilësuar djem luftëtarë e burra të shquar politikanë.Ndërkaq gruaja shqiptare është quajtur *shqiponjë , trimëreshë , sokoleshë e luaneshë*.Epitetet më të bukura shprehëse me ngjyrim pozitiv (përkëdhelës, admirues e lavdërues)i zgjedh dhe i përdor politikani për të vënë në dukje vetitë a cilësitë më të mira të njeriut, për të ngritur lart trimërinë, heroizmin ,vendosmërinë deri në vetëmohim, besnikërinë ndaj një ideje a ideali partiak.Përkundrazi, epitetet me ngjyrim negativ(si *judë, sharlatan, kloun, xhelat, shushunjë,krokodil,çimkë,rriqër* etj) përdoren për të demaskuar pushtuesin a armikun gjakatar, frikacakun e të pabesin ose njeriun me shpirt të vogël;për këtë qëllim po përdoren sot si epitete me ngjyrim negativ edhe emrat vetjakë të disa diktatorëve, terroristëve dhe armiqve të lirisë e të demokracisë në shkallë

ndërkombëtare a botërore(Sali Berisha e përdor shpesh bamirësit e topit referuar figurës së Bamir Topit).

Shprehësia mund të realizohet edhe nëpërmjet përdorimit të këtij leksiku për të ndërtuar disa figura të tjera , si *alegorinë*(p.sh. “Korbi ka veshur pendë palloi e po këndon sipas avazit që kanë kurdisur padronët e tij”), *simbolin*(p.sh. duke përdorur *flamurin*-si shenja përfaqësuese,më e nderuara dhe më e respektuara e kombit,*pëllumbin* si simbol të bukurisë, të butësisë e të paqes),etj.

3.1 Funkzioni propogandues i gjuhës politike

Strukturat gjuhësore në gojën e një politikani kanë një ndikim të madh në elektoratin e tij. Duke u nisur nga fjalimet politike, politikanët arrijnë të propogandojnë programin dhe idetë e veta politike, duke bindur elektoratin që të mbështesin dhe ta aprovojnë politikën e tyre.

PROPAGANDË f. *fjalor*,2006

Kuptimi i fjalës propagandë

propagánd/ë,-a emër i gjinisë femërore, veprimtari e gjerë me anë të shtypit, të radios, të fjalimeve etj. për të përhapur dhe për të ngulitur te njerëzit një doktrinë a një ide, për t'i bindur dhe për t'i mobilizuar për diçka etj.; i ligjërimit bisedor; përpjekje për t'i mbushur mendjen dikujt a për ta bindur për diçka: propagandë politike (kulturore); mjetet e propagandës.

3.2 Parullat

Siç u trajtua shkurtazi në pjesët e mëparshme, parulla ose fjala kyç formon një element qendror në gjuhën edhe ligjëratën politike - sidomos në reklamat për programet politike. Gjuhëtarë e shohin detyrën e parullës në ndikimin e opinionit në sistemin e të mbrujturit të mendimit (edukimi) dhe të ndryshuarit të mendimit (propaganda). Shumica përjashton parullat në ligjëratën jopublike dhe propozojnë një synim të përgjithshëm influencimi **të lidhur me një parullë të vetme**. Vetëm një shfrytëzim i tillë – në shumicën e rasteve bindja e të tjerëve – e bën parullën një parullë të vërtetë. Në këtë mënyrë mund të ndodhë që fjalë të tilla, si

demokraci, përparim ose socializëm të përdoren në situata specifike si parulla (p.sh., në fushatë zgjedhore), edhe pse kanë një përdorim tjetër në gjuhën shkencore.

Autorë të tjerë nuk shohin në parulla vetëm **gëzhoja të zbrazëta fjalësh**, si fjalë që përdoren shpesh në argumentimin publik dhe **që në formën e tyre të ngjeshur shprehin ose provokojnë qëndrime politike**. Parullat shërbejnë si elemente për të influencuar. Ato janë armët kryesore e argumentimit politik duke qenë vetë objekte të luftrave. Me anë të këtyre shpjegimeve terminologjike parullat mund t'i nënrenditen, ndër të tjerave, gjuhës politike, në të cilën mund të ndryshojnë kuptimin e tyre, kundruall kuptimit që kanë pasur në fillim. Dëgjuesi percepton nga një ligjëratë me shumë parulla një sërë fjalësh, të cilat i referohen sfondit ideologjik të veçuar nga teksti. Përdorimi i termave, që kanë përmbajtje pozitive si parulla, është njëri nga elementet kryesore në gjuhën politike. Veçanërisht në fushatat zgjedhore përdoren për shumë fjalë parulla, sepse ato zgjojnë dëshirat e shikuesit. Përmbledhtas mund të thuhet se parullat, si instrumente të rëndësishme të gjuhës politike, bashkojnë qëllime dhe vlera, përdorin në mënyrë të vetëdijshme asosacionet e dëgjuesit për t'i shfrytëzuar ato qëllimisht për një gjë të caktuar dhe arrijnë të prezantojnë fjalë - zgjidhjeje për programe të caktuara.

3.3 Fjalori terminologjik-politik

Gjuha politike ka fondin e vet të fjalëve dhe termave që i klasifikojmë sipas regjistrave të përdorimit.

3.3.1 Fjalori institucional

Siç përshkruhet edhe në literaturën përkatëse, termat specifike politike formojnë një pjesë të madhe të gjuhës së politikës. Për ta bërë paraqitjen e sasisë dhe të strukturës së leksikut politik të mundur, duhet të vihen si bazë kritere semantike dhe pragmatike. Kriteri semantik nënkupton se leksiku politik duhet të trajtohet në kuadër të sistemeve pushtetore dhe të ideologjive vendase. Dieckmann-i thotë lidhur me këtë: “Leksiku i çdo sistemi pushtetor kërkon një trajtim të veçantë.” Prandaj mundet që gjuha e nacional-socializmit të ketë shumë terma nga fusha e biologjisë, si *racë* ose *absorbim, celulë etj*, ndërsa fjalët *punëtor* ose *eksploatim* duhet t'i nënrenditen gjuhës së shtetit socialist. Krahas kritereve semantike,

leksiku politik mund të ndahet edhe sipas kritereve pragmatike. Këtu qëndrojnë në radhë të parë simbolet në fokusin e shqyrtimeve. Nëse simbolet përdoren në një kontekst politik dhe zhvillojnë një forcë të mjaftueshme, bëhen vetë politike. Shprehja *demokraci* – edhe në u kuptoftë si simbol ose parullë – mund të përdoret prej shteteve me kuptime të ndryshme, por një nënrenditje e kuptimit mund të bëhet vetëm pas zbatimit praktik të këtij kuptimi. Pasi u bënë këto përsiatje paraprake, do të pasqyrojmë në vijim se si duhet shikuar një hyrje ekzemplare të leksikut politik .Si grup të parë të leksikut të tij politik përmendim fjalorin institucional. Termi kap vlerëne një institucioni social që cakton për një kohë të vazhdueshme se çfarë duhet bërë. Duke kufizuar të vepruarit kuturu dhe arbitraritetin e sjelljeve sociale, termat ushtrojnë një efekt normativ dhe përcaktojnë detyra.Sipas kësaj gjuha institucionale shfaqet si një gjuhë institucionesh dhe organizatash të një bashkësie (p.sh., bundestagu, parlamenti, fraksioni etj). Përveç kësaj, në këto institucione trazohen role dhe detyra të caktuara në politikë (p.sh., kancelari, mandat etj). Në këtë mënyrë edhe veprimet dhe proceset politike i përkasin fjalorit institucional, si për shembull zgjedhjet e bundestagut, fushatë zgjedhore, lexim ligjor. Domethënë si fjalor institucional shfaqen të gjitha fjalët që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me insitucionet politike. Aty bëjnë pjesë institucionet vetë, rolet dhe veprimet/proceset që lidhen në këtë mënyrë me to.

3.3.2 Fjalori i ideologjisë

Gjuhës së ideologjisë i përkasin të gjitha ato fjalë që i theksojnë parimet e partive politike apo udheheqësve politikë, si *zgjedhje të lira/sekrete* ose *vendim i mazhorancës*. Fjalë të këtij lloji mund të japin përshtypjen e një leksiku gjithëpërfshirës, megjithatë duhet të merret në konsideratë se ato, sipas ideologjive të ndryshme, përmbajnë edhe konotacione të ndryshme. Fjalët e fjalorit ideologjik mund të shprehin gjithashtu edhe vlera bazore të një shoqërie, si *dinjtet njerëzor* ose *e drejta*. Nocioni "ideologji" është zbuluar dhe për herë të parë është përdorur nga ana e filozofit francez, Desti de Trasi. Kuptimi i fjalës ,FSHS,2006 :ideologji,-a emër i gjinisë femërore; numri shumë; -(të) sistem idesh e pikëpamjesh politike, filozofike, juridike, estetike, morale e fetare të një klase a grupi shoqëror, të një partie a sistemi politik-shoqëror; botëkuptim: ideologji sunduese.

3.3.3 Fjalori i përgjithshëm bashkëveprimor

Pjesa përbërëse e fundit e leksikut politik është fjalori i përgjithshëm bashkëveprimor . Këtu mund të radhiten shembuj si *viktimë, krizë* dhe *çështje*. Po ashtu mund të përfshihen edhe fjalët e veprimit gjuhësor ,si *:fjilloz, debaton* ose *negocion* .

3.3.4 Figurat retorike

Në debatin politik nuk merren në përdorim vetëm terma të veçanta, të cilat kanë për qëllim ta nxisin lexuesin të veprojë ose mendojë në një mënyrë të dëshiruar, më shumë përdoren edhe figura të caktuara retorike për ta forcuar këtë efekt edhe më shumë. Armin Burkardt i konsideron si mjete retorike, krahas metaforave, edhe pyetjen retorike, paralipsën, paralelizmën si dhe klimaksin, kiazmin dhe përsëritjen. Në vazhdim duam të trajtojmë secilën nga këto figura retorike më hollësisht dhe të parashtrijmë edhe shembuj. Në parlament – më saktë, në një situatë dialogu parlamentar – haset shpesh forma e pyetjes retorike. Qëllim nuk është marrja e një përgjigjeje , por arritja e miratimit. Folësi ka më shumë për qëllim të arrijë me një pyetje retorike miratimin e pjesëmarrësve të parlamentit dhe ta përfaqësojë pikëpamjen e tij në mënyrë sa më bindëse. Figurat retorike janë njëkohësisht pyetje , edhe pretendime dhe shfaqen në fjalime politike në fjali të tëra. Paralipsa, si një formë tjetër e figurave retorike, i bën të mundur folësit ta zmadhojë vëmendjen e dëgjuesve ndaj asaj që thotë ,duke mohuar shtjellimisht dhe në mënyrë paradoksale të ketë ndër mend ta thotë atë, që në fund të fundit e kumton. “Rreth këtyre pyetjeve kam folur këtu në debate të mëhershme. Nuk dua ta përsëris sërish, por e them me të matur këtë fjalë personale (...)” Siç tregojnë këto fjalë nga një debat parlamentar, politikani mohon të ketë dëshirë të shprehet më tutje për këtë çështje, por e bën këtë prapë se prapë dhe arrin t’i përsërisë mendimet e tij, pa qenë e mundur të ngrihet kritika se ka qenë synimi i tij direkt. Paralelizmi shfaqet në fjalimin politik kryesisht në formë anafore: **“Populli ynë zgjedh deputetë. Populli ynë nuk zgjedh kancelarin në ditën zgjedhore.”** Po qe se kjo përsëritje **“populli ynë”** në fjalimin e Rainer Barzel-it shërben si përforcim të asaj që është kjo, d.m.th një përsëritje e tillë, mund të bashkohet në një numërim në ngritje, në klimaks. “Kjo republikë nuk është e Helmut Schmidt-it, as imja ,por edhe as juaja dhe as e Rainer Berzel-it ose zotit Strauss. Ajo nuk është as e partive tona. Ajo është e popullit, që ka vatrën në lirinë e kushtetutës sonë”. Willy Brandt-i përpiqet nëpërmjet **klimaksit** të bëjë shumë të qartë se e kujt nuk është “kjo republikë”, por në radhë të parë synon të thotë se është e popullit. Në rritjen e komenteve të tij e ngre dhe drejton tendosjen e dëgjuesve kundrejt asaj që ka thënë në fund dhe e përqëndron kështu vëmendjen. Po ashtu nga Brandt-i rrjedh **kiazmi i radhës**: “Populli nuk ekziston për partinë dhe parlamentet. Ne jemi të detyruar të ekzistojmë për popullin.” Komentet që “ kryqëzohen” me njëri-tjetrin, me “popull”

në fillim dhe në fund të komentit, mbështesin po ashtu shprehësinë e fjalëve. Për sa i përket figurave të përmendura nga Burkhardt-i, d.m.th përsëritjet, ai kupton “shprehjen e sërishme të pikave thelbësore të një fjalie në mënyrë përmbledhëse”. Kjo mund të ndodhë nga njëra anë për të spikatur atë që është thënë, nga ana tjetër edhe **për të kërkuar të drejtën e fjalës**, nëse zhurma ose ndërprerje në formë thirrjesh e pengojnë fjalimin më tej.

3.3.5 Gënjeshtër si sfond njerëzor

Gënjeshtër është në botë. Ajo është brenda nesh dhe rreth nesh. Nuk mund t’i mbyllësh sytë përpara saj. “Omnis homo mendax,” – thotë një varg psalmi (115, II) dhe ne mund ta përkthejmë: “njeriu është një qenie e gjallë e cila di të gënjejë.” Në të vërtetë njerëzit gënjejnë- në të shumtën e rasteve- me gjuhën; ata thonë gënjeshtër dhe e kthejnë gunën nga fryn era dhe ajo nuk mund të pengojë që “flamujt e gënjeshtres” (Goethe) të shpalosen kaq shpesh. Ky mund të jetë vërtet një përkufizim mizantropik, por ai është i pakundërshtueshëm. Mitantropi i Moliere merr nga ai të drejtën për të urryer të gjithë racën njerëzore. Augustini si i pari person që ka parë “aspektin gjuhësor” të gënjeshtres u kujton njerëzve se gjuha nuk u është dhënë atyre me qëllim që ata të mashtrojnë njëri-tjetrin, por me qëllim që ata t’i rrëfejnë njëri-tjetrit idetë dhe mendimet e tyre. Kush e përdor pra gjuhën për të mashtruar ai e shpërdoron gjuhën dhe ky është mëkat. Fjalët e gjuhës janë shenja të shpirtit; është kundër natyrës së tyre dhe kundër shpirtit për ta vendosur atë në shërbim të gënjeshtres. Gjuha duhet të shfaqë idetë dhe mendimet dhe jo t’i fshehë ato. Funksionimi i gjuhës për shenjat është në rrezik. Ai është arritja më elementare, por pikërisht për këtë arsye më themelore e gjuhës. Gënjeshtër është prishja (zvetërimi) i gjuhës. Edhe nëse jo të gjithë njerëzit i fshehin idetë dhe mendimet e tyre me gjuhën, tek politikanët dhe diplomatët, gënjeshtër është pjesë e profesionit. Ajo është një art. Hermann Kesten e pranon idenë dhe e hap atë si një erashkë: “Ka profesione të tëra, nga të cilat populli që në fillim supozon, që ato do të detyronin përfaqësuesit e tyre të gënjenin, për shembull teologët, politikanët, laviret, diplomatët, poetët, avokatët, artistët, aktorët, falsifikuesit e kartëmonedhave, komisionerët e bursave, prodhuesit e produkteve ushqimore, gjyqtarët, mjekët, xhigolos (burrat që pëlqehen nga gratë), gjeneralët, kuzhinierët, tregtarët e verërave. Për rezervime, punë gjysmake dhe gënjeshtër është një gjuhë e mrekullueshme; ajo është një gjuhë e pabesë(...)”. Por, mund të ishte, që gjuha nuk është aspak veshje e mendimit, siç ka gjykuar njëherë Wittgenstein, por përkundrazi veshje ndryshe e tij. Një dyshim të tillë e hasim shpesh. Kur përpara shumë vitesh shkencëtarët e të gjitha disiplinave u bashkuan për një hulumtim shkencor kolektiv të fenomenit të gënjeshtres, edhe gjuhëtari Friedrich Kainz u ftua për të bërë një artikull mbi dukuritë e gënjeshtres në botën e gjuhës. Duke ndjekur Augustinin ai konstaton në fillim, që të gjitha gënjeshtërat janë thënie

gjuhësore dhe si pasojë bëjnë pjesë në fushën e madhe të gjuhës. Kainz kontrollon pastaj gjuhën për gënjeshtër dhe gjen nga këto kaq shumë, sa që lexuesi duhet të frikësohet shumë. Me të njëjtën të drejtë, siç thuhet nga gjuha, ajo mendokërka dhe vjershërokërka për ne, lejohet gjithashtu sipas mendimit të F.Kainz, që ajo gënjekërka për ne. Ai krijon për këtë shprehjen “joshje gjuhësore”. Ai mendon se të menduarit tonë lëviz në rrugë gjuhësore dhe që gënjeshtër e gjuhës si pasojë detyrojnë edhe të menduarit tonë për të gënjyer. Por, gënjeshtër gjuhësore janë, nëse i marrim gjërat me shumë kujdes, shumica e figurave retorike si eufemizmat, hiperbolat, elipset, shumëkuptimshmëritë, format dhe formulat e mirësjeljes, emfazat, ironia, fjalët-tabu, antropomorfizmat etj. Të vërtetës i mbetet në gjuhë ,vetëm një rrugicë e ngushtë. Kjo është, siç mund të merret me mend, fjalja dëftore e pastër, të cilën e do logjika. Ja ,pse njerëzit duhet t’i kuptojnë “ndërrimet e rrobave” të gjuhës shumë mirë. Është interesante që ne si folës të një gjuhe sinqerisht e dimë se luajmë përditë lojën e krijimit të hipotezave dhe të verifikimit ose falsifikimit të tyre, të njëjtën lojë, për rregullat e së cilës është zotuar shkencë. Gjuha është pikërisht sipas strukturës së saj një shkencë parashkencore,pasi me gjuhë ne zotohemi,premtojmë dhe “hedhim hi syve”.

KAPITULLI I KATERT

NDËRTIMI I TEKSTEVE POLITIKE

4.1 Metafora dhe tekstet metaforike

Metafora në politikë ka një histori të gjatë. Janë metafora të njohura: “Një gjel në çdo tryezë” e Roosevelt, ose “thikë pas shpine” e Hitlerit, ose “dielli i së ardhmes”. Pasuria më interesante e gjuhës është aftësia e saj për të krijuar dhe për të përdorur metafora. Për këtë gjuha e politikës i përdor ato në mënyrë frekvente. Metafora është një histori reale ose e imagjinuar, një anekdotë, një frazë plot efekt që mund të sqarojë ndryshe një situatë, apo të arrijë një objektiv komercial ose propagandistik, ose diçka që propozon tërhorazi një zgjidhje për një problem. Bëhet fjalë për një formë indirekte komunikimi, që lehtëson lidhjet (asosacionet) ndërmjet imagjinatës dhe reflektimit. E drejtëpërdrejtë ose simbolike ajo të sugjeron sjellje të reja dhe zgjidhje të menjëhershme. Për sa kohë metafora i destinohet imagjinare dhe kreativitetit

ajo themi se lehtëson përfaqësimet nëpërmjet imazheve mendore, për t'u përdorur në situata të tjera me të cilat është e mundur të identifkohet pa rrezikshmëri. Për më tepër metafora shmang destinimet e gjata, të lodhshme e shpesh një burim mërzie. Ajo nuk mund të kuptohet prej interlokutorit tuaj nëse konteksti është shumë larg nga konteksti i saj. Në fakt, efektiviteti i saj qëndron në lehtësinë që i garanton interlokutorit tuaj për të krijuar një paralele me atë që jeton, siç edhe shprehet Julian Jaynes në “ Shembja e mendjes dydhomëshe (original “Il crollo della mente bicamerale”), Adelphi : “ Metafora nuk është thjesht një gjuhë margjinale, por përdorimi i një termi përkatës i një diçkaje, për të përshkruar një tjetër si pasojë e disa ngjashmërive ekzistuese midis tyre ose në mes të marrëdhënieve që vendos me gjërat e tjera. Metafora përdoret për të përshkruar objekte ose (referentë) të çuditshme për njerëzit e tjerë të cilët s'mund t'i shohin ato. Në një metaforë janë gjithnjë të pranishme dy terma: objekti që duhet përshkruar (metareferenti në terma gjuhësorë) dhe diçkaja apo lidhja (marrëdhënia) e përdorur për ta shpjeguar atë. Një metaforë është gjithmonë një metareferent i njohur që “vepron” mbi diçka tjetër të panjohur. Është në sajë të përdorimit të metaforës që gjuha rritet. Përgjigja më e zakonshme e pyetjes “çfarë është ajo” kur përgjigja është e vështirë apo eksperiencia është unike, është: “ mirë eëë, është si.....”. Funkzioni i madh dhe i fuqishëm i metaforës është ai i të gjeneruarit (krijuarit) të përbërësve të rinj të gjuhës sipas nevojës, sa kohë që kultura njerëzore vazhdon të bëhet me komplekse. Ne priremi drejt tendencës që ta konsiderojmë gjuhën solide, të ngurtë, të palëvizshme si një fjalor apo të fortë si graniti, në vend që ta shohim si një det të shqetësuar duke shpërthyer në metafora ashtu siç edhe është realisht. Leksiku i gjuhës është kështu pra një seri e përfunduar termash që, falë metaforës, mund të shtrihet për të “mbuluar” një numër të pafund rrethanash, duke krijuar gjithashtu edhe rrethana të reja. Në një ese të tij Ernest Fenollos shprehet se : “ metafora është... substanca e vërtetë e poezisë”; pa të, ‘nuk do të kishte asnjë urë mbi të cilën të kalohej nga e vërteta më e vogël e dukshme në atë të madhen, të së padukshmes”. I pari që e ka zbuluar këtë instrument poetik qe Homeri, dy poemat e të cilit tejmbushen nga shprehje metaforike të të gjitha llojeve. Në një varg të Iliadës, poeti e krahason kasaphanën e frikës dhe dhimbjen torturuese në gjoksin e njerëzve, me sulmin e kombinuar të erërave nga drejtime të ndryshme me ujërat e detit. Mendoni për këto stuhi që i njihni kaq mirë ,duket sikur thotë poeti, dhe do të njihni diçka për frikën dhe dhimbjen. Por, është e rëndësishme që e kundërta të mos jetë e vërtetë. Mendoni sa të doni për dhembjen dhe frikën, por nuk do të dini asgjë për erërat dhe detin: krahasimi ka qëllimin e qartë të thotë së çfarë dhimbja apo frika i shkaktojnë zemrës së njeriut, nënkuptohet pra ndriçimi i një eksperiencie që nuk të shfaqet. Ndërveprimet që ne

kemi me të tjerët, kanë në fakt aspekte mirëkuptimi tamam brenda metaforës së teatrit dhe aktrimit. Ne kemi një maskë, individualizojmë një publik tonin, i kalibrojmë³⁰ ndërhyrjet tona në varësi të llojit të publikut që kemi përballë dhe nuk mbajmë të njëjtin qëndrim në shtëpi dhe në zyrë, në një funeral apo në një berrari. Çdo gjuhë filozofike dhe një pjesë e madhe e gjuhës politike është metaforike. Çdo metaforë sjell apo shpalos në dukje “një perceptim intuitiv të ngjashmërisë në gjëra të pangjashme” dhe sipas Aristotelit, prezanton tamam për këtë arsye një “shenjë të gjenit”, “që e zmadhon edhe gjënë më të madhe”. Sipas Kantit ky i folur për analogji, pra një gjuhë metaforike, është një mjet i vetëm me të cilin arsyeja spekulative që ne e quajmë mendim mund të manifestojë vetveten. Të menduarit pa imazhe “abstrakt” metafora i ofron një depërtim në botën e paraqitjes, të aparençave, funksioni i të cilës është të provojë realitetin e koncepteve tona”, duke anuluar kështu tërheqjen nga bota e jashtme si parakushti i aktiviteteve tona shpirtërore. Të gjitha termat politikë në pjesën më të madhe janë metafora”analogji të ngrira”, kuptimi autentik i të cilave zbulohet kur fjala rimerret në kontekstin e origjinës, sigurisht e pranishme në mënyrë të gjallë e intensive në mendjen e filozofit të parë që e përdori atë, Platonit. P.sh, kur Platoni futi në gjuhën filozofike fjalën e përditshme “idea” donte të ridëgjonte jehonën, oshëtimën e saj gjatë përdorimit në gjuhën e zakonshme. “Idea” apo “eidos” është sagama apo modeli që zejtari duhet të ketë para syve të mendjes para se të fillojë punën e tij. Është një imazh që i mbijeton “procesit të fabrikimit” – si në politikë, - dhe mund të shërbejë përsëri dhe përsëri e përsëri, duke fituar një jetë pa fund që ia bën të përshtatshme përjetësisë së qiellit të ideve. Një tjetër shembull: askush para Aristotelit kishte përdorur në një kuptim tjetër nga “akuzë” fjalën kategoria, që tregonte atë çfarë thuhej kundër të pandehurit në rrjedhën e procedurave gjyqësore. Sipas përdorimit aristotelian, kjo fjalë transformohet në diçka si “kallëzues” mbi bazën e analogjisë së mëposhtme: ashtu si në një aktakuzë (kategoruein ti timos) rrjedh (kata) mbi një të pandehur (diçka për të cilën ai akuzohet dhe pra që i përket) kështu predikati i atribuon subjektit cilësinë përkatëse. Kur kërkojmë të kuptojmë një gjë, mundohemi të gjejmë një metaforë për atë gjë. Jo një metaforë të çfarëdoshme, por një metaforë me më shumë familjaritet dhe që vëmendja jonë t’i kushtojë më shumë kohë. Disa breza më parë ndoshta do ta kishim përshkruar si një stuhi tringëllimën e armëve të super-njerëzve(kupto heronjve tek ‘Iliada’ apo ‘Odisea’) apo të zotave sovranë të angazhuar në luftë. Sot ne e reduktojmë “një

³⁰ Termi ‘kalibrim’ referuar Fjalorit të gjuhës Shqipe, Tiranë, 2006 botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë fillimisht del si folje kalibr/oj kl., -ova, -uar; tek i jap dickaje kalibrin që duhet; e mat me kalibër; spec.e klasifikoj dicka sipas madhësisë, sipas formës a cilësisë; kalibroj farat.

Për kalibrohet V.III. derivat i drejtpërdrejtë nga emërtimi kalib/ër, -ri m.sh. –a(t); tek.l.diametri i brendshëm i tytës së armëve, i predhës a fishekut etj.; kalibri i topit; 2.vegël e posacme për të matur a kontrolluar përmasat e një detali etj.; e mat me kalibër; 3.fig.lib. dicka që merret si masë a si shkallë vlerësimi; cilësi, vlerë; lojtar i kalibrit ndërkombëtar.

stuhi” në varësi të përvojave tona si artrit, xixa ,vende bosh dhe fantazia që të çon tek masa të mëdha ajrore që përplasen me dhunë ,duke shkaktuar zhurmë. Asnjë nga këto gjëra s’ekziston me të vërtetë siç e imagjinojmë. Imazhet tona për këto ngjarje fizike nuk janë edhe aq larg nga realiteti i imazhit të zotave luftues mes tyre. Megjithatë ato shërbejnë si një metaforë dhe na duken familjare ,kështu që mund të themi se ne e njohim një stuhi. Termin stuhi mund ta zhvendosim edhe në arenën tepër të nderë e të ndezur politike “stuhi politike” etj. Politikanët kanë ndërtuar me anë të metaforës një gjuhë me një fjalor të përditshëm dhe shpesh të papërballueshëm nga të gjithë. Edhe pse shpeshherë mundohen politikanët nuk dorëzohen lehtë ndaj formave leksikore të vjetëruara apo dialektore p.sh, karakterizohet për këtë kryetari i PS-së, zoti Edi Rama ku në librin – vetërrëfim – “Kurbani” nuk lë pa përdorur: [*Tirona, tironsit, muhabetit të omël në hije, kamët zhyt në vijat e ujit..... e gamorin lidh ke rrapi pazarit, tregtia voj e komshilliku hy e dil..... shtohu e jeto jetën pa tahma e gajle t’mdhaja në kët ven qi e ka fal zoti..... Që solli Tironën e përgjumjes së patrazuar orientale..... nga kthesa e detyruar djathtas për Tiranë, qeverinë bashkë me shejtonin n’bark.....*]³¹, apo kreu tjetër antagonist me të z. Sali Berisha teksa shpesh duket sikur e gllabëron gjysmën e foljeve – kallëzues *thuj, mujti, luj*, etj. Metaforat – frazat më të efektshme – që i kemi hasur edhe në gjuhë të tjera janë të panumërta si : të zbresësh në fushë (betejë), të zbresësh në arenën politike, teatri i vogël i politikës, të pilotosh kundër rrymës, etj., apo t’i japësh rremave kundër rrymës. Në kontekste të tjera më të gjera (kupto kongreset e partisë apo konventet) të folurit për veten kthehet shpesh në një formë autoironie, shpesh me të gjeturit aty për aty të një batute komike apo të treguarit të përrallave e barsaletave plot dredhi e shaka, të cilat kontribuojnë në të bërit të momentit verbal diskursiv pjesë integrale e spektaklit politik. Ja, disa shembuj tipikë: deputetja e Partisë Demokratike i drejtohet një deputeti të krahut të majtë me batutën “Varesh te palma po iu afrove Kryeministrisë” gjatë një debati të nxehtë televiziv për 21 janarin. (Aludohet për mosprekjen e institucioneve të shtetit). Apo rasti më tipik vjen nga dt. 6 gusht 2012 në seancën parlamentare kur deklarata e njërit prej deputetëve nis me pyetjen “Ku humbi lopa e Saliut?” në fshatin e tij Vicedol dhe përfundimi vjen tepër i habitshëm: kur gjendet lopa e Saliut, familjarët i thanë eja se u gjet e Saliu u shpreh se do të shkojë të shohë edhe tek ajo shpella më tutje. (barsaleta tepër ironike vjen e perifrastuar prej nesh në mungesë të një dokumentimi korrekt).

³¹ Edi Rama, “Kurban”, Tiranë 2011, f.426


Më poshtë po listojmë disa prej metaforave apo epiteteve metaforike më të hasura në politikën shqiptare:

Buzëqeshje protokollare, vathë partiake, lukuni e çartur kioskash, Gëjeshtra e Madhe, shkallët e ferrit politik, zëri i arsyes, tiradat e mosaryes, presidenti i Piramidave, arena politike, ngërçi fatal, instrument katharsisi, Konti i Montekristos (Edi Rama për F. Nanon), kurora e martesës Sali – Ilir, tra ekulibri, tolerancë zero, gjueti shtrigash, oborri i Saliut, korrupsion endemik, kazani i dokrrave, luajti një rol kyç, pranova dorashkën e Fatosit, një diell fatkeq, rotacion politik etj.

Komunikimi me një masë të gjerë njerëzish për të arritur qëllime politike në lashtësi mbulohej prej gojëtarisë (oratorisë) dhe qe mjeshtëri e një grupi të kufizuar njerëzish. Sot po ndodh e kundërta: gjithkush në shoqërinë tonë dashur pa dashur është kthyer në një politikan të vogël që gjykon çështjet aktuale të ditës e për këtë arsye pavullnetshëm gjuha e gjithësecilit rrjedh kah politikës gjithnjë e në lëvizje. Duket sikur fjalët janë shpirtëzuar, kanë marrë hov dhe presin me padurim të shkëputen prej gojës së publikut e të kthehen në ajsbergë, të cilëve një pjesë u shfaqet e tjetra iu zhduket (ndoshta si të mos jetë) nën ujë për të fshehur diçka të errët. Të tillë do ta përkufizonim ne në punimin tonë fjalën e një politikani – një ajsberg në lëvizje të parreshtur. Të duket sikur sot askush s’bën dot pa politikën, dogmën e saj, pa tharmin e saj, gjuhën – për këtë njerëz nga shtresa, profesione, mosha të ndryshme dëgjojmë të debatojnë e të zhyten në politikë përditë e më shumë. Përditë e më shumë dëgjojmë për broshura, libra, thirrje, trakte, fletushka, mbledhje, konferenca shtypi, kongrese, mitingje, takime, fjalime e diskutime, filma dokumentarë, videokaseta për propagandë e reklamë në shtypin e gjerë. Asgjë s’na bën më përshtypje nga gjuha jonë. Tashmë kjo gjuhë e politizuar është bërë njësh me njeriun vetë e kërkon të ushqehet nga trupi i tij. Gojëtaria (oratoria) siç thamë më sipër ka qenë zanafilla e debateve politike. Konica lidhur me këtë çështje shprehet: “Oratoria, duke qëndruar krahas historisë, teatrit, romanit e filozofisë, është nga ato lëme ku manifestohet, zhvillohet e afirmohet veprimtaria intelektuale e popujve”³². Përveç mjeteve për të arritur një ton solemn në gjuhën e politikës shpalosen përftesa të tilla sintaksore si : paralelizma, antifraza, pyetja retorike, reticënsa, përsëritjet, asosacionet historike, letrare, folklorike, kulturore, të shoqëruara me dinamikën e theksuar të intonacionit gjatë shqiptimit. R. Qosja ndër shumë kushte për të folur “bukur” në “Gojëtaria ose muza e harruar” përmend edhe faktet:

³² Konica, “Albania”, 1897, nr. 1

1. Ta mendosh më parë atë për të cilën do të flasësh
2. Të përgatitesh
3. T'i besosh vetë asaj që thua
4. Të njohësh mirë çështjen që trajton
5. Të nderosh e komunikosh me auditorin njëkohësisht
6. Të njohësh e të dëshirosh efektin e asaj që kërkon të arrish
7. Të zotërosh mirë me mjeshtëri një gjuhë të kuptueshme



Ne mendojmë se kushti themelor qëndron tek nr.3 për të qenë një politikan e gojëtar i zoti. Gjithçka duhet të ndikojë tek forca e logjikës me argumentin, faktin e njëherazi me emocionalitetin e shqiptimit duke e drejtuar “shpirtin” e auditorit tek “fjala që të tërheq”³³.

Fjala e thënë publikisht (me shkrim e me gojë) është një lloj veprimi plot potencë drejtuar masës së njerëzve. Ajo është një lloj ndikimi politik mbi ndërgjegjen e njeriut, mbi bindjet e qëndrimet e tij, mbi vullnetin e ndjenjat e tij që shpesh shfrytëzohen edhe për demagogji apo pikësynime të çastit³⁴. Në sistemin diktatorial agjitacioni dhe propaganda janë një veprimtari e përhershme me mbështetje shtetërore të ngurtë e të varfër, ndërsa në rrethanat e demokracisë ato shfaqen me forcë sidomos gjatë fushatave të zgjedhjeve, por edhe në këto rrethana

³³ Mendimi ynë vjen logjikshëm pas asaj që u përmend në paragrafin e mësipërm

³⁴ Nga Fjalori i Gjuhës Shqipe 2006

Demagogji; -a f.sh.-(të) mashtrimi i të tjerëve me fjalë të bukura e me premtime të rreme për qëllime e synime të caktuara; qëndrim me dy faqe; fjalë të bukura e të zbrazëta për të mbuluar e për të shtrembëruar të vërtetën. -k, -ke mb.që lidhet me demagogjinë, i demagogjisë; që është plot demagogji: politikë(deklaratë) demagogjike.

përmbajnë mjaft elementë demagogjicë e manipulimi. Politika jonë së fundmi ka parapëlqyer të shfrytëzojë shpifjet, fyerjet pa kufi dhe fjalorin e pakulturuar të ligjërit të shkujdesur. Në një situatë parlamentare të duket sikur je zhytur në një reklamë të madhe plot ngjyrëshe jo më tregtare ,por politike plot propagandë.

Politikanët luajnë me të gjitha efektet fonike, që nga shqiptimet dialektore e intonacionet vetjake e deri tek përftesat leksikore me shtrembërime tingullore të çfarëdorshme për t'iu drejtuar jo një publiku të specializuar, por heterogjen. Dikur kjo gjuhë i ushtrohej një censure të rreptë, ndërsa sot politika gjithnjë e më shumë ka marrë frerët në duart e saj. Sot nëpër ekranet shqiptare paraqitja e gjallë, pa redaktimin paraprak- si një formë kryerje e qëllimshme- ka zënë vend të posaçëm në gojën e politikës shqiptare.Për të kumtuar e ndikuar njëherazi zgjidhja mbetet jo më ajo drejtvizore ,por sintetizimi i shprehive, mënyrave të ndryshme të organizimit, shkrirja e të përgjithshmes me të veçantën, e automatizimit me të vetëdijshmen, modeleve me shfaqjet e pakursyera vetjake. A nuk do të ishte gjëja më e bukur dhe më e lehtë që si në një reklamë tregtare juve si shitës(politikan) të jepnit informacion të ditës dhe të synonit ndryshimin e opinionit në një drejtim të caktuar, duke ngulitur bindje politike, duke nxitur reagime shoqërore, e deri duke përfutur tek njerëzit paragjykime, shije e prirje sipas orientimit tuaj?!

POLITIKA	INFORMUES	FORMUES	PROPAGANDUES	ORGANIZUES
FUNKSIONET	(NJOHËS)	(EDUKUES)	(PASQYRUES)	(KUSHTËZUES)

Pavarësisht nga mëtimet për objektivitetin informacioni në politikë edhe kur thuhet edhe kur nuk thuhet diçka, është i nënkuptuar tendencioziteti³⁵. Rrjedhimisht gjuha e politikës do të parakuptohej nga një ndeshje e fortë interesash e cila në mjaft raste shkakton që informimi të kthehet në disinformim dhe formimi në deformim. Përgjithësisht nëpër botë politikanët synojnë një gjuhë jo të nderlikuar ,por tek në po ndodh e kundërta. Politikanët shqiptarë parapëlqejnë një gjuhë me teorizime e terminologji speciale e asnjëherë-tmerresisht e lehtë për t'u përtypur. Shembulli më tipik i përzgjedhur prej nesh përcillet si më poshtë: [‘ konti tjetër thoshte, tjetër mendonte (.....), mes logoresë tipike të fjalive’; në kërkim të zgjidhjes racionale të situatës kritike’ ; ‘për të koaluduar një qëndrim koherent joevaziv ‘ ; ‘duke

³⁵ Xh. Lloshi, “Stilistika e gjuhës shqipe”, Albas 2005, f.221

kuptuar peshën e rëndë të ngjarjes në një kontekst disfunkcionaliteti institucional’; ‘që të jepet mesazhi i ndërgjegjes publike të qeverisë sime në adresimin kontekstual’; ‘pa harruar se bashkia është një investim politik i maxhorancës sime, po edhe duke ndarë solidaritetin politik nga meskiniteti-tradicional’; ‘me një qasje që duhet të ravijëzojë publikisht konsekuencën time’³⁶]. Edhe toni i teksteve për pasojë nuk është asnjë, por përshkohet nga qëndrimi i shprehur, emocional dhe shpesh ngacmues, polemizues e goditës gjithnjë i ndërmjësuar në thelb nga nënshtrimet e anës logjike, arsyetimore sipas një orientimi pikant. Fjala në politikë u drejtohet arsyes e ndjenjave njëkohësisht, pra anës intelektuale dhe anës emocionale, mendjes dhe zemrës. Politika ndërthur mjetet e arsyetimit e të bindjes me mjetet ndikuese e shprehëse, shkencën me artin, parashikimin me sugjestionimin. Kjo ndërthurje siguron që përmbajtja dhe synimet e politikanit të depërtojnë, duke kapërcyer pengesat e komunikimit me një auditor të gjerë, të papërcaktuar, të përhershëm, që duhet tërhequr dhe nënshtruar. Nëpër mitingje të ndryshme elektorale të duket sikur fjala kthehet e transformohet në një puls mbresëlënës, ngacmues. Rëndësi të veçantë ka marrëdhënia që kanë me njëra-tjetrën fjalitë e llojeve të ndryshme.


Fjali thirrmore e dëshirore, i bëjnë thirrje dëgjuesit për pjesëmarrje. Fjalitë dëftore shërbejnë për të dëftyer (treguar) për një objekt a problem në mënyrë të thjeshtë dhe objektive. Përdorimi i fjalive të shkurtra, me informacion të qartë e të thjeshtë është tregues i kujdesit që ka autori për ta bërë tekstin sa më të kuptueshëm.

Fjalitë nxitëse synojnë të të bindin me anë të kërkesës, këshillës e propozimeve të bëra. Përdorimi i përemrit “ti” ose i ligjërimit të drejtpërdrejtë, konfidencial: përdorimi i

ligjërimit kinematografik (batutave të shpejta) , manipulimi i përdoruesve përmes figurës së gruas, burrit, fëmijës, pleqve, të moshuarve në përdorime të shkathëta, me efekte përgjithësimi.



³⁶ Edi Rama, “Kurban”, 2011, fq.79. Politikani e kryetari i tanishëm i PS-së mes ironisë dhe sarkazmës cilëson një tipar të politikanit F.Nano, një tipar tipik i shumë të tjerëve – moskuptimin, - frazat e errëta që deri diku edhe POLITIKANET vetë nuk arrijnë t’i deshifrojnë, duke ua përcjellë ndryshe popullit drejtpërdrejt.



4.2 Aparenca dhe ligjërimi real në fjalimet e parrullat politike.Ç’fshihet pas metaforave poltike?

Secili prej nesh është një prodhues dhe interpretues shenjash; njerëzit ndeshen përditë me shenja, synime, qëllime e funksione nga më të larmishmet. Për t’i deshifruar, për t’i dekoduar, për t’i lexuar e për t’i kuptuar ato nevojitet që njohja jonë të jetë e gjerë për këtë shumëllojshmëri shenjash e mënyrave sesi ato i paraqiten publikut. Pas një synimi të dukshëm fshihet një synim tjetër, pas një qëllimi të drejtëpërdrejtë fshihen të tjerë të tërthortë. Bota që na rrethon ngërthehet përditë e më shumë me mesazhe false, të fshehura e sajuara me kujdes, të cilat janë të zorshme për t’u zbuluar. Sipërfaqja e këtyre mesazheve mistifikuese paraqitet e bukur, premtuese deri diku edhe surreale dhe pas faqes së fshehur vjen e të shuplak në fytyrë realiteti i hidhur, qëllimi i vërtetë e i dukshëm, emocionet negative. Të tilla mesazhe false gjenerohen përditë e më shumë edhe në politikë nga politikbërësit. Kështu parrullat, fjalitë “lapidar”, maksimat politike karakterizohen nga një emocion i jashtëzakonshëm emotiv që arrin ta fshehtë në mënyrë perfekte përmbajtjen e vërtetë, që thjeshtë është një suregato idealizmesh e mistifikimesh të përditshme e rutinë e politikbërjes. Do të mund ta imagjinonim më mirë se në ç’gradë arrin ky tension i rremë kur këto mesazhe të sajuara prodhohen në kohë fushatash apo në manifestime politike. Si edhe në industrinë e reklamës, edhe në industrinë e politikës me sloganet e saj koncize shfaq, një funksion referencial apo edhe atë emotiv dhe fshehtë nën petkun e saj të priftit atë nxitës (konativ)³⁷, në momentin e prezantimit para një turme të madhe njerëzish dhe kjo më tepër sesa në përmbajtje qëndron në kuadrin fonik-timbrik, në shkoqitjen (shqiptimi i ngadaltë, duke i ndarë fjalët në rrokje) apo duke i dhënë një intensitet më të madh fillimit apo fundit të një fraze; zëri merr një fuqi shtytëse të veçantë pas çdo fjale dhe një fuqi tërheqëse që e magnetizon masën elektorale. Shfaqet në këto mesazhe

³⁷ Funkzioni referues realizohet kur komunikimi përqëndrohet mbi kontekstin, d.m.th mbi objektin-situatë të aktit komunikativ. Mesazhi tregon gjëra reale, përqëndrohet mbi përshkrimin e objektit të kontekstit (referentit) pa shprehur emocione personale e pa zgjuar emocione tek marrësi. Pra, ka vec dhënie informacioni pa asnjë lloj ngarkese emotive. Funkzioni emotiv realizohet duke u përqëndruar tek dhënësi i cili shpreh gjendjen e tij shpirtërore kur prodhon mesazhin në lidhje me atë cka po ligjëron duke synuar të matet tek marrësi një emocion i caktuar ose një reaksion emocionesh. Realizohet me pasthirrma apo fraza verbale stereotipe, folja në dëshirore apo urdhërore, me ndryshim intonacionesh etj.: “Eja me ne”, “Sot vendoset, sot fitohet”, “Fajin e ka Saliu”, “Nesër më mirë”, “Këtu fillon e ardhmja”, “Për një Shqipëri që ndryshon”, mbartin një forcë tepër të madhe “yshtëse”.

funkcioni emotiv mbisundues, por e vëteta është se aty rri i fshehur një tjetër mesazh, ai nxitës, ai ndikues, ai që pret që turma të veprojë në pajtim me të. Sërish i rikthehemi idesë së shprehur në paragrafet më sipër se gjuha në vetvete është një “mënyrë veprimi” e cila është e aftë të ndikojë sjelljet tona, e cila na bën ne të reagojmë, ajo është inputi, ne jemi feedbacku i saj. Asnjërit prej nesh nuk do t’i pëlqente të ndikohej nga fjala e drejtëpërdrejtë si një shuplakë e rëndë syve – ne do të kalonim në mohim absolut të saj. Përdoren kështu strategji të fshehjes e të “maskimit” të qëllimeve të vërteta, të mesazheve false. Të gjitha këto fjalime, debate parlamentare, fjalime fushatash, slogane e spote propagandistike në thelb janë një lojë që prodhon mesazhe e emocione false apo të shtremëruara. Nga ana tjetër një vëmendje i kushtohet edhe mesazhit si formë gjuhësore. Politikanët përzgjedhin nga ky repertor – kod shenja të veçanta të cila kombinohen në një mesazh në rrjedhën e ligjërimit. Si rrjedhojë gjithçka mund të ndodhë pikërisht sepse elementi gjuhësor bëhet kaq i vënë në dukje sa merr “një pavarësi” në sipërfaqje shenjuesi nga i shenjuari. Dhe kjo ndodh nëpërmjet një figure të rëndësishme të kuptimit, metaforës gjuhësore. Politika shqiptare e shfrytëzon në mënyrë të tepruar këtë figurë për të organizuar në një mënyrë të çuditshme, jonormale, të zakonshmen përmes një përpunimi të ndërgjegjshëm të materies gjuhësore. Vetëm pak sekonda më parë dëgjuam një thënie të ndërtuar mbi njëmetaforë. A.kuqezi i drejtohej kryeministrit aktual të vendit me shprehjen kryeministri – krokodil apo krokodili, ai që nxjerr lot krokodili përpara njëmasë të thjeshtë njerëzish. Për ç’arsye? Frazat e zakonshme, mënyra e të përjellurit të tyre realizohen tashmë në mënyrë automatike, mekanikisht, pa u vënë re. Nëse ky politikan “s’do të provonte diçka tjetër më të mirë” edhe aftësia komunikative e publikut do të ishte shumë e pakët. Automatizimi do të sillte si pasojë varfërimin e informacionit, mungesën e vëmendjes e deri largimin e masës nga fushata elektorale. Atëherë politikasi duhet t’i kundërvihet këtij varfërimi duke ia rikthyer jetën fjalëve të veta derisa standardet të zhduken, përditshmëria, banalja, e zakonshmja të befasojnë, të zhvendosin në një hapësirë tjetër, të çudisin e megjithatë të komunikojnë. Ashtu si edhe në gjuhën e letërsisë fjalimet oratorike të sotme shkëputen nga e zakonshmja dhe prodhojnë imazhe të pazakonta, duke kënaqur pritshmëritë e kënaqësitë e publikut për diçka të re të pathënë më parë. Me anën e metaforës gjuha në politikë arrihet të finalizohet një dykuptimshmëri. Gjuha përcillet prej imazhesh, ngjashmërish, komunikimesh jo të kodifikuara që rrjedhin e sjellin me vete një forcë të madhe shprehëse. Këto shkulje të kodit ligjor të ngrirë të politikës shkaktojnë tek dëgjuesi/lexuesi ndjesi të reja të cilat kurrsesi nuk mund të jenë të njëjta me sintagma të zakonshme p.sh: një krahasim midis frazës *megafarsë-hetimore* dhe *seancë hetimore*; *zemra e qytetit – qendra e qytetit*; *maskarada politike – lufta politike*; *debati shterpë – debat i perealizuar etj.* Sintagmat e zakonshme do të prodhonin veç ndjesi të pritshme, të automatizuara. Në pamje të parë

metaforat i sjellin gjuhës së politikës dykuptimësi (ambiguitet) dhe rezultojnë paksa kaotike në interpretim të menjëhershëm. Nëse shprehja është “ *e dendur*” interpretimi i dëgjuesit mund të bjerë edhe në gabim. Dëgjuesit në këtë dykuptimësi i nxitet kureshtja, imagjinata në rastet kur frazat nuk kthehen në të pambarimta (periudhë pas periudhe) edhe në rastet kur pas pauzave ai të arrijë të gjejë në atë “mungesë rregulli” pak rregull. Shpesh politikanët sikurse edhe shkrimtarët i përqëndrojnë vëmendje të madhe edhe shenjave gjuhësore, realitetit të tyre, elementeve të formës (shenjuesit) dhe përmbajtjen që ato prodhojnë. Rëndësi të njëkohshme merr çfarë thuhet dhe si thuhet. Por, gjuha e politikës edhe deformohet (shtrembërohet) me dashje mes zgjidhjesh të guximshme e të paparashikuara dhe politikani arrin të aktualizojë (gjallërojë) mundësi të fshehura e të pazbuluara të kodit gjuhësor të ngrirë. Në veçanti këtë ai e realizon me metaforën dhe ndërputjen e strukturave dhe fushave leksikore nga gjuha e gjallë e popullit, gjuhët sektoriale, zhargonet, dialektet etj. Kemi të bëjmë me një lloj “karremi” që përdoret me shumë sukses nga njerëzit e propagandës tregtare (në rastin tonë politike) dhe që tërheq “në grackë” marrësit e këtij mesazhi, d.m.th konsumatorin e atij malli (në rastin tonë masa popullore)³⁸. Teknikat, modelet e organizimit formal të gjuhës së poezisë (varg, rimë, ritëm, ekuivalenca fonike, metafora, metonimia etj) huazohen edhe në parrullat apo sloganet e politikës për të sugjestionuar e për të bindur në mënyrë indirekte spektatorin e thjeshtë. Por, ajo çka vlerësohet më shumë ka të bëjë me spontanitetin, origjinalen, të atypëratyshmen dhe jo me përsëritjen e gjedhëve gjuhësore të standartizuara. Jo më kot do të cilësohej një kod komunikimi me vete e për vete.

Si do të interpretohej nga një njeri i thjeshtë shprehja e mëposhtme: B. Topi – “Politika ka nevojë për rotacizëm” (në disa raste del edhe rotacion). Nga Fjalori i gjuhës shqipe botim i 1980 : rotaciz/ëm, - mi, m.gjuh. kalimi i rr-së në r midis dy zanoreve në fjalët e disa gjuhëve e disa dialekteve. Dukuria e rotacizmit. Kuptimi që merr një fjalë rikuptimësohet në nevoja për ndryshim, kthesë etj. Të tjerë shembuj ku fjala rikuptimësohet, duke shpërngulur me mënyrë metaforike përdorimin e saj në një kontekst tjetër (ku fjala merr një kuptim të figurshëm) paraqiten:

- **Odiseja** f.(gr. Odise – mbret Itakës sipas mitologjisë greke) 1. Mit. Eposi i njohur i Homerit mbi bredhjet dhjetë vjeçare dhe përjetimet e jashtëzakonshme të mbretit të Itakës, i cili pas rënies së Trojës kthehet nëpërmjet detit në atdhe. 2. fig.bredhje, endje, aventurë. **“Pra, është një odise e tërë shkëlqesh e karakterit ligjor dhe administrativ” (seancë parlamentare)**

³⁸ A. Ballhysa, “Formim Gjuhësor”, Sejko, f.40

- **Infiltrim-i** m (lat.infiltratio – depërtim, grumbullim,kalim. 1. **Kuptimi parësor vjen nga mjekësia med. a)depërtimi, grumbullimi në inde i lëndëve jonormale për to; b)gjendja e sëmurë e indeve që shkaktohet nga depërtimi i lëndëve jonormale në to;** 2.fig. futje a depërtim gradual i elementëve të huaj në vend, në një organizatë politike a në një ideologji. **“Për një kod i cili ka të infiltruar brenda një procedure shumë të sofistikuar dhe unë vetë profesionalisht nuk e kam parë...”** (seancë)
- **Finish-i** m – (ang.finish – fund) 1.sp.pjesa përfundimtare e një gare sportive; 2.fig.përfundim, fund i diçkaje. **“Sot paraqes para jush buxhein e shtetit të vitit 2009 i cili përfaqëson finishin e suksesshëm të një katërvjeçari...”** (seancë).
- **Kulis-a** f. – (fr.coullisse – keq.prapaskena) 1.prapaskenë; 2.fig.veprime që bëhen në fshehtësi e me qëllim të keq, intrigë. **“Që më shumë ngjajnë me kulisa mafiozësh, sesa me procese të hapura dhe transparente, siç duhet të jetë edhe ai i hapjes dhe administrimit të dosjeve të ish-diktaturës komuniste”.** (seancë)
- **Akses** – pasojë, hyrje, e drejtë, krizë, shpërthim, mundësi për të hyrë ose për të përdorur mbeten si sinonime të fjalës. **E përdorur në fillim të shek 14-të me kuptim “sulm i etheve” nga frëngjishtja e vjetër acces “sulm, fillimi i një sëmundjeje” (shek 14-të) nga latinishtja accessus “ një ardhje, një pasojë, një afrim”.** Kuptimet e mëvonshme vijnë direkt nga latinishtja. Kuptimi “ një hyrje, një prolog” është nga 1600-ta. Kuptimi” zakon ose fuqi për të ndërhyrë në jetën/prezencën e dikujt ose diçkaje” vjen në fundshekullin e 14-të. Si një folje së pari dëshmohet në 1962, fillimisht në informatikë, e lidhur me kuptimin vizitë, qasje,leje kalimi,fjalëkalim në një program”.
- **Eminenca** - rreth viteve 1400 **“projektim, gungë”.** Në fillim te shek 15-te merr kuptimin “pozitë e lartë ose pozicion i ekzaltuar, i lartësuar” nga frëngjishtja e vjetër eminence “ i ngritur” ose direkt nga latinishtja eminentia “person me rëndësi, person i ngritur”, nga eminentem, eminens “i shkëlqyer, i shquar”. Si një titull nderi (tani vetëm i kardinalëve) ajo është vulosur rreth vitit 1650-të. Ishte Francois du Leclere Trembley (1577-1638), agjent sekret i Risheljese(kardinali Richelier). Sinonimet e fjalës janë: lartësi, famë,

emër, eminencë, vend i ngritur etj. **“Disa e quanin eminenca gri e pushtetit, ai që gëzonte thujse autoritetin dhe privilegjet e një guvernatori.”**

- **Implementim** – Si fjalë e mesit të shek 15-të nga latinishtja implementem ”një mbushje” (me dispozita) nga latinishtja **implere** “**për të mbushur**” nga in (në) + plere (për të mbushur)(e lidhur me plenare). Kuptimin e “mjet” vjen që në 1550-ën nga nocioni i gjërave të siguruar, të kushtëzuara për të realizuar një punë; në kuptimin e “asaj që mbush një shtëpi”. Si folje del në 1806 fillimisht me origjinë kryesisht skoceze, ku përdorej me një kuptim ligjor “përmbushje”. Kjo çoi në keqpërdorimin për implementation, së pari e dëshmuar në 1926. Lidhja bëhet me fjalën “e zbatuar”(zbatim). **“Startimi i implementimit të forcave ndërkombëtare dhe i përbërësve civilë po zhvillohet në mënyrë pozitive.” fq 589 “Gjatë bisedimeve kërkova të vazhdonte pa ndërprerje puna për implementimin deri në fund të marrëveshjes së Ohrit.”**

Ndryshimet e ndodhura në politikë janë pasqyruar edhe në zërat më të rinj të Fjalorit politik (botim i ri, i përditësuar IDK Ian McLean dhe Alistar McMillan), duke mbuluar koncepte të tillë,si: kozmopolitizmi, përplasja e qytetërimeve, demokraci vendimore, politika e frikës. Ja,sesi paraqiten disa prej termave të derivuara në politikë (përzgjedhje e bërë imtësisht nga fjalori):

- **Absolutizëm** (absolutism) – fillimisht më 1733, **koncept teologjik që lidhej me pushtetin e plotfuqishëm të Perëndisë, e vetmja që vendos për shpëtimin e njeriut.** Koncept i shtrirë në politikë për të treguar një regjim, në të cilin sunduesi ka të drejtë të vendosi për gjithçka, zakonisht është përdorur për regjimet monarkike të fillimit të Kohës së Re, kryesisht të Luigjit XIV të Francës, sido që në kuptimin politik termi nuk është përdorur deri në fund të shek 18-të. Ndryshe nga tiranitë, regjimet absolute shiheshin zakonisht si të ligjshme, siç theksonte Luigji XIV i Francës në nëntorin e 1788, pak kohë para “Revolucionit francez”, kur kushëririt të Dukës së Orleanit se çdo vendim i marrë prej tij ishte i ligjshëm, sepse e kish dashur ai.

- **Apparat** – fjalë ruse, e përdorur për të treguar **makinen e administratës shtetërore.** Kuptimi i parë i saj në anglisht është përkeqësues dhe i referohet burokracisë së fuqishme komuniste-anonime dhe të privelegjuar; anëtarët e saj quhen në rusisht apparitciki. Si shumë terma të administratës komuniste, kuptimi i aparatit është i vagëlluar dhe i dykuptimtë. Në kuptimin më të ngushtë të gjuhës zyrtare sovjetike, fjala nuk kishte kuptim negativ.

Përkundrazi, ajo mund të merrej si diçka që tregonte atë pjesë të shtetit Gosplan (Komiteti i Planit të Shtetit) dhe Gosnob (Komiteti Shtetëror për furnizimet Teknike dhe Materiale).

- **Vëllai i Madh (Big Brother)** – në veprën e George Orwell 1984, mishërimi i pushtetit të shtetit është “Vëllai i Madh”, një mesoburrë i gjithëpranishëm, dhe në përgjimit të vazhdueshëm të popullit. Vëllai i madh ishte një figurë e fuqishme letrare e totalitarizmit. Pushteti i tij mbi mendjen e njeriut është i tillë sa që edhe kundërshtari i tij, Winston Smith-i, arrin në fund ta dojë Vëllanë e Madh. Sipas Orwellit, ai gërshetonte elemente të Stalinit, dhe të Hitlerit, por ndoshta edhe tipare të Lord Reithit (kryetarit të parë të BBC-së) të Perëndisë dhe Winston Churchill-it. Imazhi i Vëllait të Madh ka hyrë në gjuhën dhe propagandën dhe përdoret për të treguar pushtetin gjithëpërshirës të shtetit.
- **Amicus curiae** – fjalë për fjalë, **mik i gjykatës**, i cili mund të dëshmojë në procese gjyqësore, qoftë si këshilltar i çinteresuara, qoftë si përfaqësues i enteve të përfshira.
- **Analogji organike** – çdo formë e shpjegimit të politikës, duke bërë analogji me trupin e njeriut, të kafshës ose të sistemit ekologjik. P.sh, tek Koriolani i Shekspirit, aristokrati Menenius Agrippa përshkruan revoltën e plebenjve, me një parabolë që fillon: “Na ishte një kohë kur të gjitha gjymtyrët e trupit ngritën krye kundër barkut”. Zhvillimi më i plotë prej periudhës viktoriane dhe veçanërisht H.Spencerin. Pra, politika dhe shoqëritë janë organizma.
- **Aparteid** – fjalë në gjuhën afrikane që do të thotë “**veçim**”. Në Afrikën e Jugut veçimi racor ishte politikë zyrtare e qeverisë mes viteve 1948-1989. Termi e ka prejardhjen nga një slogan politik i sajuar nga Dr.D.F. Malan, lider i PK. Jugafrikane në 1944 e rrjedh nga fjala më sipër “ndarje”. Arkitekti kryesor i tij ishte H.F Verwoebol, me idenë e tij për Bantustan-atdheun kombëtar.
- **Aritmetikë politike** – term i Sir William Petty për të shprehur statistikat jetësore e ekonomike të cilat ai i mbledhi i pari sistematikisht.
- **Aristoteli** – kërkon të provojë se “**njeriu është frymor politik**”, d.m.th. një lloj frymori që e ka në natyrë të rojë në një polis ose në një qytet-shtet.
- **Autarki** – (autarchy, autarky) këto dy fjalë me rrënjë greke të ngjashme të prejardhura, por të ndryshme (archein, sundoj; arkein, mjafton) ngatërrohen shpesh. “Autarchi” – vetëqeverisje, pa ngjyresë përkeqësuese. “Autarki” – me një kuptim negativ, si një lloj **regjimi izolacionist** ndaj pjesës tjetër të botës.
- **Ballkanizmi** – ndarja e një shteti në njësi më të vogla territoriale. Termi ka **tendencën të nënkuptojë një politikë përça dhe sundo**. Termi u bë i njohur pas L.Parë Botërore, por u bë sërish aktual falë situatës politike të krijuar në Ballkan.

- **Beneluksi** – Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu. Pas themelimit të Bashkësisë Ekonomike Europiane (BE), të tri vendet kanë vepruar shpesh si një bllok i vetëm.
- **Bojkotim** – (boycott) **termi vjen nga kapiteni Boycott-i**, një çifligar irlandez që pasoi në 1880 mosmiratimin ndaj punës së tij, në mënyrë që ai të kthente apo të ndryshonte sjellje.
- **Borgjezia** – term që fillimisht u referohej vetëm atyre që rronin në qytet (bourgeoisie). Në shek. 17-18-të zuri të njëjtësohej me një shtresë të veçantë qytetarësh, tregtarët me vlerat dalluese të këtij grupi: kursimin, punën e pareshtur, drejtësinë morale, shenjtërinë e familjes dhe respektin e pronës private e të ligjit, fitimi. Borgjezia u bë objekt satire nga klasat e pronarëve të tokës, aq sa termi mori kuptimin përkeqësues të atij që grumbullon para, që shfrytëzon të tjerët dhe që rron sipas disa rregullave të ngurta. Më vonë Marksia e rimerr dhe e përdor atë për klasën kapitaliste e më pastaj si sharje nga e majta për të sulmuar armiqtë e vet. Fjala ende nuk ka mundur të hyjë në modë dhe pas rivlerësimeve të bëra.
- **Bota e tretë** – zanafilla mbetet e diskutueshme. Askush nuk e vë në dyshim se ky term u përdor **në Luftën e ftohtë** si vendet më pak të zhvilluara apo politikisht të paorganizuar. Përdorimi i termit sot bëhet i pakuptimtë sa kohë që Bota e dytë (komuniste) s’është më, duke çuar në keqkuptime.
- **Çarje** – term i marrë nga gjeologjia që tregon çarjen e një sistemi politik për së gjati, një vijë etnike ose ideologjike. Termi përdoret çlirët si ndarje midis dy përmasave të ndryshme apo si sinonim i çarjes së grupit. Per analogji kujtojmë metaforen organike që sjell paralelizimin e partise, shtetit me trupin e njeriut, me organet dhe me gjymtyret e tij.
- **Dalje** – (exit) të dalësh ose “të votosh me këmbët e tua” sipas Hirschman-it si mjet kërcënues ndaj udhëheqësve të një partie, për të ushtruar presion.
- **Demagog** – si tek demokracia, edhe ideja e demagogut i ka rrënjët në fjalën e dykuptimtë greke “demos” që do të thotë popull, pra në kuptimin edhe popullatë, turmë. Në kohët klasike ishte udhëheqës i turmës, por edhe i një shteti popullor. Në këtë kuptim asnjans, tani të vjetëruar, të gjithë udhëheqësit perëndimorë janë në njëfarë kuptimi demagogë. Sot kuptimi i fjalës është keqësues, si udhëheqës turme, me nënkuptimin se kush ngre turmën e bën këtë nisur nga një qëllim i dobët.
- **Dora e padukshme** – term i përdorur nga Adam Smithi si metaforë për veprimtarinë e tregut të pabashkërenditur. “Çdo individ... shikon vetëm fitimin e vet, dhe këtu, si edhe në shumë raste të tjera, ai shtyhet nga një dorë e padukshme të arrijë një qëllim

që nuk kishte në mendje”(Pasuria e kombeve 1776). Pra ai kundërshton dorën e padukshme të konkurrencës e të tregut real në ditët e sotme.

- **Fashizëm** – (fascism) Ideologji e djathtë nacionaliste ose lëvizje me strukturë totalitare dhe hierarkike që është në kundërshtim të thellë me demokracinë dhe liberalizmin. **Termi ka dalë nga Roma e Lashtë, ku autoriteti i shtetit simbolizohej nga “fasces”, një vandak shufrash të lidhura së bashku (uniteti i popullit) me një sëpatë në maje (udhëheqja). Simbolin e përvetësoi Musolini në lëvizjen e 1922-it në Itali, dhe pastaj u bë i përgjithshëm nëpër Evropë mes dy Luftërave Botërore. Në periudhën e pasluftës shpesh me parashtesën “neo-“; termi është përdorur për ato që konsiderohen pasardhësit e këtyre lëvizjeve.**

- **Gjiri i derrave** – E planifikuar nga CIA, si një përpjekje e dështuar për të përmbysur qeverinë kubane të F.Kastros, gjatë presidencës së Eisenhowerit e Kenedit në 1961.

- **Kapja e shtetit** – ndodh kur një numër i vogël kompanish janë në gjendje të modelojnë rregullat e lojës në avantazhin e vet, nëpërmjet veprimesh masive të paligjshme dhe përfitimesh private jotransparente për zyrtarët e politikanët. Ndër shembujt e një sjelljeje të tillë përfshihen aftësia për të kontrolluar votën e legjislativit, për të përfutur dekrete nga qeveria apo vendime të favorshme gjuhësore. Një koncept relativisht i ri që në fakt i bën jehonë konceptit të kapitalizmit të miqve (**klientelizmi**), **i përkrahur sidomos nga studiuesit e Bankës Botërore.**

- **Karizëm** – fillimisht term i teologjisë së krishterë “nder i dhënë nga hiri i perëndisë”, fjala u përdor nga Weberi për të shprehur atë që personaliteti i një individi të shquhet nga të zakonshmit duke i veshur fuqi apo cilësi të mbinatyrshme...ose të jashtëzakonshme. Termi u përdor për herë të parë nga Hitleri për të shprehur fuqinë yshtëse të tij mbi popullin gjerman.Gueti shtrigash-Witch hunt,1640,kuptimi bazë,literal:kuptimi i zgjeruar në1932,popullarizuar në Luftën e Ftohtë antikomuniste,histeri.Sot e përdorur shumë.

Vëreni sesi fjala në kuptimin bazë të saj pëson një transformim e vendosur në kontekstin politik me një sistem tjetër qëllimesh. Në këtë rast fjalët na shpjen në një kuptim tjetër jo të drejtpërdrejtë, metaforik, të nënkuptuar që i mbivendoset kuptimit të parë, denotativ.

Shenjuesi

I shenjuari

I-N-F-I-L-T-R-I-M

Mjekësia: depërtimi në inde të lëndëve

jonormale për to (kimike)

(kuptim denotativ)

Shenjuesi

I shenjuari

I-N-F-I-L-T-R-I-M

Politikë: futje a depërtim gradual i

elementëve të huaj në vend, në një

ideologji a organizatë politike (kuptim konotativ)

Shenjuesi

I shenjuari

K-a-p-i-l-a-r-ë

mjekesi,biologji: **Kapilarët** (*Latinisht: Capillus*) janë

enët më të vogla të [gjakut](#). Funksioni i tyre është shkëmbimi i lëndëve, lëvizja e lëndëve midis enëve të gjakut dhe [indeve](#). Që të kryejnë këtë punë, sipërfaqja totale e gjithë kapilarëve është shumë e madhe (sipërfaqja e madhe lehtëson [difuzionin](#)). Si pasojë, rrjedha e gjakut në kapilarë është e ngadaltë dhe kapilarëve u duhet të prodhojnë lëndë [antikoagulante](#) për të parandaluar [trombozën](#) (rrjedhja e ngadaltë është një nga tre faktorët që predispozojnë për trombozë; 2 të tjerët janë dëmtimi i [endotelit](#), dhe rritja e aftësive [koaguluese të gjakut](#)). Muret e kapilarëve janë shumë të holla dhe mure të tilla të dobëta nuk mund ta përballojnë presionin e lartë arterial. Presioni kapilar është shumë më i vogël sesa presioni arterial. Ulja e presionit bëhet e mundur nga [arteriolat](#). (kuptim denotativ)

Shenjuesi

I shenjuari

K-a-p-i-l-a-r-ë

Politikë: **07/04/2021**

Dita Botërore e Shëndetit, Manastirliu në qendrën e re shëndetësore në Krrabë: Vaksnim kapilar në gjithë vendin, ka nisur edhe vaksinimi i farmacistëve. (kuptim konotativ)

Ç-(m-o-n-t-i-m) dhe kuptimi i fjalës antonime m-o-n-t-i-m në fushn e punëtorisë

montím,-i emër i gjinisë mashkullore; numri shumës; -e(t) 1. veprimi sipas foljes: punëtor montimi. 2. montazh. Sinonime / Të ngjashme *Shih* [montoj](#)

montazh Ç-(m-o-n-t-i-m)

Veprimi sipas kuptimeve të

foljeve **çmontoj**, **çmontohet**. *Çmontimi i makinerisë. Çmontimi i tornos (i turbinës, i sondës). Punëtorët e çmontimit. Bëj çmontimin.* Shih edhe: **çmontoj**, **çmontohet**

Në politikë: Ç-(m-o-n-t-i-m) i regjimitL.Basha,zgjedhjet prill,2021.

Mund të ndodhë që plani i parë (denotativ) të lidhet me një plan të tretë, përveç planit të dytë e të realizohet kështu një raport i trefishtë konotacioni. Kështu fjala e përdorur në ligjërim evokon rreth vetes “duke përvetësuar” elementë të tjerë ngjyrues rreth planit të saj të parë. Si rrjedhim formohen nënkode të tjera e fusha semantike e asociative të strukturuar, linden polisemi të tjera që nuk shpëtohen prej rrënjës origjinare, kuptimit parësor. Këto mesazhe të mbishtuar, të hapur në interpretim, dytësorë mund të jenë të natyrave afektive – fizike, ideologjike, asociative dhe në dukje të parë qëndrojnë si asnjë, por në të vërtetë në industrinë e medias e të politikës fshehin me anë kodesh retorike “evokuese” një të vërtetë tjetër, mistike më në thellësi. Sado të ruhen prej tyre në thelb në jemi të ndikuar nga këto nënkode që përcjellin sloganet apo edhe ideologji të caktuara politike. Pas çdo fjale të shpëputur nga goja e politikanëve rezultatet mbeten të paparashikueshme...

Metafora në politikë“Gjuha politike është shpikur për t’i bërë gënjeshtat të tingëllojnë të vërteta dhe vrasjet të respektueshme dhe...ta bëjë rërën të duket solide.”

George Orwell

Pak teori për metaforën . Kuptimi i fjalës metaforë

metafór/ë,-a emër i gjinisë femërore; numri shumë; -a(t) term në letërsi; term në gjuhësi; përdorimi i figurshëm i emërimit të diçkaje për një tjetër nëpërmjet krahasimit sipas ngjashmërisë në një **tipar** kryesisht të jashtëm; shprehje me këtë kuptim; figurë e ndërtuar në këtë mënyrë (p.sh. **bajame** për “dy **gjëndra** në grykën e njeriut”, ditë e bardhë për “ditë e lumtur” etj.). metafór,-ík, -íke mbiemër; që lidhet me metaforën, i metaforës; që përmban **metaforë**: kuptim (**stil**) metaforik; fjalë (shprehje) metaforike.(Fjalor ,2006)

Metafora është cilësuar trop gjuhësor që mbart e realizon efekte artistike dhe retorike. Kjo mënyrë konceptimi u rishikua nga *Teoria e Metaforës Kognitive* që e konsideron metaforën jo thjesht si një zbulim i jashtëm poetik, që i përket thjesht gjuhës, si një dukuri konjitive-njohese(shih kognicioni është veprimi ose procesi mendor i të fituarit të

dijes dhe i të kuptuarit përmes mendimit, përvojës dhe shqisave. Fjalori i Oxfordit)

Metaforat thelbësore dhe personale

Me fjalë të tjera, metafora ka të bëjë me konceptimin e diçkaje, abstrakte, në terma të diçkaje tjetër konkrete, të cilën folësit e njohin mirë. Sipas Lakoff-it e Johnson-it (1980), për shembull në thënien JETA ËSHTË LUFTË, jeta, si një koncept abstrakt, konceptohet përmes një koncepti tjetër konkret, siç është lufta. Po ashtu në thënie si “harxhoj kohë”, tregon se njerëzit e konceptojnë kohën në terma të parasë që mund të shpenzohet. Këta shembuj, sipas dy autorëve të “Metaphors we live by”, provojnë se njohja njerëzore ka natyrë thellesisht metaforike.

Me sa duket metaforat nuk ndikojnë vetëm njohjen njerëzore dhe organizimin e kësaj njohjeje, duke qenë se janë ndër mjetet parësore për të kuptuar botën tonë të brendshme, botën fizike dhe atë sociale e kësajsoj luajnë rol tepër të rëndësishëm edhe në mënyrën se si sendërtohen realitetet sociale e politike (Lakoff, Johnson 1980).

Skenarët metaforikë janë një lloj interpretimi vetjak që gjithkush i bën botes perreth. Të këtij lloji për shembull janë skenarët metaforikë të MARTESËS mes shteteve evropiane, që shihen si *partnerë* a çift, apo partia si një FAMILJE E MADHE POLITIKE.

Skenarët metaforikë janë mbizotërues në debatet publike dhe në ligjërimin publik, jo vetëm për nga denduria e përdorimit, por edhe për faktin se ato formësojnë konceptimin e temave politike të synuara përmes skenarëve burimorë (siç mund të jenë DASHURIA-MARTESA-FAMILJA).

Përmes skenarëve metaforikë mund të kuptohet edhe se si vetëpozicionohen politikanët në raport me të tjerët që u përkasin kombeve të ndryshme, duke sendërtuar kështu realitete politike e sociale të cilat në mënyrë të ndërsjellë do të ndikojnë sjelljet (edhe ligjërimore) të popujve në fjalë.

Animizimi i çdo shteti në politike . Personifikimi i shtetit (SHTETI SI NJERI)

Skenarët metaforikë japin një tërësi projektimesh konjitive në diskursin politik të udhëheqësve të botës. Një prej skenarëve metaforikë që gjendet në fragmentet e këtij diskursi, është skenari SHTETI SI NJERI.

Kjo metaforë është thelbësore kur bëhet fjalë për diskursin politik, veçanërisht për atë që

lidhet me politikën e jashtme ose marrëdhëniet ndërkombëtare. Lakoff-i (1991) e përkufizon këtë skenar metaforik kështu: “Një shtet konceptualizohet si person, që angazhohet në marrëdhënie shoqërore brenda një komuniteti botëror. Territori i tij është shtëpia e tij. Ai jeton në një lagje dhe ka fqinj, miq dhe armiq. Shtetet shihen se kanë cilësi të vetvetishme: ata mund të jenë paqësorë ose agresivë, të përgjegjshëm ose të papërgjegjshëm, punëtorë ose dembela” (Lakoff,1991:3).

Një tjetër taktikë që skenari metaforik SHTETI SI PERSON përdor, është t’iu referohen shteteve si njerëz të cilët kanë një trup. Kështu konsiderohet trupi i njeriut si një prej fushave burimore më të shfrytëzuara, por gjithashtu edhe si një fushë ideale. Trupi i njeriut është fusha burimore ideale, përderisa, për ne, është qartësisht e përvijuar dhe (ne besojmë) se e njohim mirë”.

Në diskursin politik duket se është zakonshme që të lidhet fusha e synuar e institucioneve shoqërore e politike me fushën burimore të trupit të njeriut. Kur krijohet skica ‘I GJITHË SHTETI ËSHTË NJË TRUP’ theksohet shpjegimi i funksioneve të pjesëve të entitetit politik duke iu referuar pjesëve dhe organeve të trupit dhe të gjendjes së tyre shëndetësore”. (Shih Noli me fjalën kolltukofag ,përmendur me pare në punim). Elementet konceptuale të fushës TRUPI-SHËNDETI janë shumë të përhapura .

Why I think so often nowadays about Samuel Beckett's masterpiece while following statements on Albania and North Macedonia? (Any resemblance to real events or persons, living or dead, is purely coincidental of course) #Future of Europe Pse mendoj kaq shpesh në ditët e sotme për kryeveprën e Samuel Beckett ndërsa ndjek deklaratat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut? (Çdo ngjashmëri me ngjarje ose persona të vërtetë, të gjallë ose të vdekur, është sigurisht e rastësishme). ***Lidhja metaforike me veprën e S.Beket ‘Duke pritur Godonë’ përcjell idenë e pritjes pa fund për çeljen e negociatave për në BE apo të një pritjeje që i ke harruar qëllimin në vetvete ,aq shumë ka zgjatur.***

Marrëdhëniet ndërkombëtare janë marrëdhënie shoqërore

Në diskursin politik jo vetëm shtetet ndërtohen konceptualisht si njerëz, por metaforikisht edhe marrëdhëniet mes shteteve janë projektuar si marrëdhënie shoqërore. “Komuniteti ka lagje dhe shtetet e afërta konceptualizohen fqinj. Marrëdhëniet ndërkombëtare shihen si marrëdhënie shoqërore. Disa vende janë miq, ose të paktën miqësore; të tjera janë armike ose thjesht kundërshtarë”. Skenari metaforik për të cilin do të paraqiten shembuj përkatës

është: MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE JANË MARRËDHËNIE SOCIALE. Sintagma *vendet mike* ilustron faktin se konceptualisht marrëdhëniet ndërkombëtare mes shteteve të Ballkanit janë përvijuar si marrëdhënie sociale. Shtetet që ndodhen pranë njëri-tjetrit në Ballkan, konceptualizohen si *fqinj* dhe ata ndajnë *marrëdhënie të mira*. *Miqësi mes shteteve* ilustron analogjinë mes marrëdhënieve ndërkombëtare dhe marrëdhënieve shoqërore po ashtu edhe ndoshta natyrën e simbiozës që organet në trupin e njeriut krijojnë me njëri-tjetrin, ashtu sic edhe popujt marrin e japin mes tyre.

Këtu shohim të arsyeshme të sjellim përkufizimin për *analogji organike (organic analogy)* Çdo formë e shpjegimit të politikës, duke bërë analogji me trupin e njeriut, të kafshës ose të sistemit ekologjik. Për shembull, te Koriolani i Shekspirit, aristokrati Menenius Agrippa përshkruan revoltën e plebejve me një parabolë që fillon: ' Na ishte një kohë kur të gjitha gjymtyrët e trupit ngritën krye kundër barkut. Në filozofinë e shkencës, analogjia shikohet si një lloj arsjetimi induktiv. Rrjedhimisht, përligjja e argumentit analogjik zakonisht mbështetet në një bazë induktive. E reja dhe e pazakonta shpesh shpjegohet analogjikisht me diçka të njohur dhe të kuptueshme. Nocioni se entitetet shoqërore janë të ngjashme me sistemet organike dhe mund të shpjegohen me ligjet e këtyre sistemeve është një nga tiparet më të zakonshme të të menduarit të sotëm evropian, tipar që ndoshta ka arritur zhvillimin më të plotë me Herbert Spencer-in. Mirëpo ajo që Spenseri dhe shumë organistë të tjerë të periudhës viktoriane nuk donin të përfillnin, ishte se organizmat individuale kanë një qendër vetëdijeje, kurse shoqëria këtë nuk e ka. Dhe ndërsa shoqëritë mund të jenë diçka më shumë se një përmbledhje e pjesëve të tyre të veçanta, ky në vetvete nuk është argument për të thënë se shoqëritë janë organizma. JH(Oxford, Fjalor politik, faqe 29)

-Integrimi evropian si një rrugë si një udhëtim drejt se panjohures plot drite e shkelqim, në një pritje të gjatë e plot ankth, si një dritë në fund të një tuneli të errët. E ARDHMJA ËSHTË NDËRTESE.

Sot në Kavajë dhe Durrës pashë vendosmërinë e qytetarëve për ndryshim. Nëse doni ndryshimin - votoni 9. Nëse doni një të ardhme më të mirë për fëmijët tuaj - votoni 9. Nëse doni paga më të larta - votoni 9. Nëse doni që Shqipëria të anëtarësohet në BE - votoni 9.
[#ShqipëriaFITON](#) (twitter, Rama)

Të gjithë besimtarëve ortodoksë ju uroj nga zemra Gëzuar Pashkët! Drita e ringjalljes i mbush të zemrat tuaja dhe vatrat e çdo familjeje shqiptare plot me shpresë dhe besim se e mira do të mundë çdo sfidë, dhimbje dhe padrejtësi! Zoti e bekoftë Shqipërinë! Retë po largohen.

Pranvera po vjen! (twitter, Basha)

Një ndër metaforat konceptuale më të zakonshme, është ajo që ka të bëjë me të parin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian si një udhëtim, si një rrugë me pikënisje, por me pikëmberritje në pezulli. Ky udhëtim kryhet në një rrugë dhe gjithmone ka pengesa e barriera. Pengesat duhen hequr dhe udhëtimi duhet vazhduar në mënyrë që shtetet të vijnë me përparimin e progresin e tyre.

Pjesa më e madhe e mënyrës sesi politikanët flasin për integrimin, rrjedh nga mënyra sesi flitet për udhëtimet. Ata e shfrytëzojnë fushën burimore të udhëtimit për të folur për procesin politik të integritimit. Përmbushja e kriterëve për anëtarësinë e BE-së është të lëvizësh drejt një pike të caktuar, drejt një stacioni të caktuar Udhëtimi drejt BE-së ka disa sfida, të cilat u ngjajnë pengesave në rrugë dhe që duhen *përballur e tejkaluar* Udhëtimi mbaron kur shtetet e Ballkanit të kenë hyrë në portën finale që është BE-ja ,si rrugëtim drejt një stacioni përfundimtar.

Studimet në fushë të metaforave konceptuale tregojnë se këta skenarë shërbejnë si mjete për të ndërmjetësuar konceptimin e referentëve më abstraktë e më pak të njohur. Rishfaqja e tyre ndodh edhe në diskurse të tjera të natyrës jopolitike, madje edhe në ligjërimin bisedor mes njerëzve. Kjo dukuri është mëse e përligjur, po të kemi parasysh ndikimin e diskursit në krijimin e realiteteve të reja ligjërimore, por edhe faktin se i gjithë sistemi ynë konceptual është strukturuar në mënyrë metaforike.

-E SHKUARA SI MALLKIM,SI BALTE DHE SI LLUM Vrasin,kërcënojnë,akuzojnë, inskenojnë kapje njerëzish pa lidhje me PS që të baltosin PS,e kur kapen me presh në duar duke u betuar se do vrasin apo duke blerë vota me zë e më figurë, shfaqen deri në fund ashtu si janë:**Llumi i shoqërisë, mallkim i vjetër që do zhbëhet të dielën!**

Ndalimi i dhunshëm i disa iftareve mbrëmë nga paramilitarët e "mbrojtjes së votës" është

një çmenduri e padëgjuar!Thirrja ime është qetësi, qetësi, qetësi, durim, durim, durim,

besim, besim, besim! E diela do të shënojë fundin e mallkimit të së shkuarës mbi

rrugën e shqiptarëve Po pse vallë janë më të rëndësishëm për ty Saliu dhe Iliri se sa

Shqipëria Lulëzim?! Shqiptarët duan bashkim, duan që ne të gjithë të punojmë për ta dhe ekonominë e tyre përtej pandemisë, duke e lënë pas **politikën e vjetër të sherrit, dasisë,**

konfliktit deri në absurd! Pse ti jo?

Zakonisht flamuri si identitet për popullin animizohet, kur thuhet se flamuri ka qeliza, ndaj kemi të bëjmë me metaforën FLAMURI ËSHTË QENIE E GJALLË. Në këtë rast sillen pranë dy fusha të ndryshme semantike, njëra me tiparin semantik (-njerëzor), tjetra që mban tiparin semantik (+njerëzor). Metafora tjetër është FLAMURI si vendi ku prehente rennet për atdhe, pasi folësi shprehet se flamuri mban zemrat e martirëve të kombit. Metaforat jo thjesht shfrytëzojnë skemat kognitive, por edhe kanë retorike përmes efekteve emotive dhe letrare që evokojnë.

Territori i shtetit konceptohet si objekt i ngurtë që mund të copëtohet e të ndahet në shumë

copa.

Shqipëria përjetoj pushtime dhe një nga diktaturat më të egra. Ka ardhur koha që ajo të marrë frumë lirisht dhe të bashkohet në trupin e madh të Evropës.

Të bashkohemi me Evropën! Ajo shihet nga politika shqiptare si njeri që percjell siguri, paqe dhe stabilitet për popujt e tjerë, pra **metafora e nënës me të vegjëlit e saj ,struktur në gjirin e ngrohtë.**

Vendi/ shteti konceptohet njeri dhe veprimi që shënohet nga folja 'përjetoj' është po ashtu përvijim i animizimit dhe antropomorfizimit të një entiteti jonjerëzor. E njëjta pikëpamje është dhe në rastin kur flitet për bashkim me Evropën, si të flitej për bashkimin e dy njerëzve. Metaforat si zgjedhje personale janë zgjedhjet më të bukura e më domethënëse në ligjërimin politik:

O lula unë jam i frikësuar për njerëzit tuaj që **i bëni mish për top** me grumbullimet e turpshme të papërgjegjshmërisë suaj, duke mbledhur **njerëz të verbër me makina e me bori,** që virusi të bëjë dasëm teksa dhëndrri juaj premtion ta bëjë ditën natë! **Premtim i mbajtur fatkeqësisht!**(Rama,twitter)

4.3 Përdorimi stilistik i “*contradictio in adiecto-s*” në politikë

Oksimoroni vjen nga greqishtja oksymoron - i krisur, i luajtur mendsh.

Oksimoroni i ngjan paradoksit, si një antitezë e llojit te veçantë, në të cilën bashkohen kuptime te kundërta dhe del një kuptim i ri.

Është vendosje marrëdhëniesh sintaksore (bashkërenditje, nënrenditëse përcaktore, etj.) midis dy antonimesh.

Shembull :

qetësi shurdhuese, paqe e përgjakur, çorganizim i organizuar etj. (shih Wikipedia, Enciklopedia e lirë)

Duke analizuar tekste të ndryshme politike e pashmangshme është edhe një mjet gjuhësor me vlerën e një mikroteksti i cili haset dendur. [“Siç e thotë vetë emërtimi një kontradiktë, së pari formale, in terminis³⁹, kur shprehen njëkohësisht e për të njëjtën gjë dy koncepte e dy gjykime që përjashtojnë njëri – tjetrin, ose kur i vishet subjektit një cilësi e kundërt me thelbin e tij”]⁴⁰. Në politikë, por edhe gjatë përditshmërisë sonë e kemi parë të pranueshme kur i shërben arritjes së synimit që mbart një thënie, p.sh. kur kërkojmë t’i japim potencë argumentit nëpërmjet një kundërthënieje formale e cila në përmbajtje s’është e tillë, e tërë nuk paraqit ndonjë kundërthënie. Në normalitet do të na dukej si diçka absurde pasi nuk është e mundur dhe e llogjikshme që njëkohësisht e njëjta gjë të jetë e të mos jetë ajo. Nëse do të ndodhte kjo me dy fjalë, fjali kur njëra të pohonte atë që e dyta e mohon, rezultatja do të ishte zero. Kjo dukuri gjuhësore shoqërohet me funksionin e një oksimoroni⁴¹, ose përdoret gabim (me qëllim ose jo) si shprehje e paqartësisë së mendimit, e kundërthënive të papranueshme. Në leksikon e politikës kjo figurë fiton vlera plotësuese ,argumentative, duke mbartur vlera stilistike, kryesisht nuanca përforcuese e ngjyime negative si ironi, tallje, shpërfillje, përbuzje etj., por në disa raste edhe shaka e humor. Me këtë figurë ligjërimi i

³⁹ J. Thomai, “Teksti dhe Gjuha”, 1992, f.169

⁴⁰ Po aty, f.169 in terminis vjen nga latinishtja, e fjalë për fjalë do të thotë në aspektin; në drejtim; për sa i përket, në lidhje me; në terma, drejtperdrejt.

⁴¹ Ky term vjen si mjeti themelor mbi bazën e të cilit ndërtohet figura e paradoksit si figura që pohon një ide absurde në pamje të parë dhe në kundërshtim me logjikën. P.sh : “është i bukur se është i shëmtuar” ose “kush ecën ngadalë shkon larg” ose paradoksi i famshëm i Sokratit “unë e di që nuk di asgjë”.

Të famshme njihen edhe paradokset e Migjenit me: “ose...ose”; “Bukuria që vret”; Noli “Do të vrasim, Jezu se të kemi baba, do të varim Mesi se të kemi usta.”

politikanëve fiton gjallëri ekspresivitet ,duke rritur edhe shkallën e individualizimit e karakterizimit të personazhit rrëfyës. Kështu “*contradictio in adiecto*” merr fuqinë e një mjeti goditës kundër një dukurie, tipari a personi të padurueshëm. Realizimi më i zakonshëm i kësaj figure është bashkëlidhja e një emri me mbiemrin e prejardhur tematikisht prej tij me një parashtesë antonimike, si : merita të pamerituara, drejtësi e padrejtë, shtet i pashtet, votë e pavotuar, kompromentim i pakompromentuar etj. Në realitet burimin ky mjet e ka te bashkëlidhja e emrit me një mbiemër tjetër i cili në thelbin e vet e mohon tërësisht kuptimin e emrit (p.sh. fëmijë i rritur), fillimisht si shprehje e gabimit gjuhësor e pastaj si derivat i një mjeti stilistikor. Kundërthënia kuptimore, pra kundërthënia e përcaktuesit me të përcaktuarin pavarësisht se ç’gjymtyre i përkasin ata është themeli i këtij mjeti funksional në politikë.

Nga një kundërthënie formale kjo figurë të lejon të kalosh në një kundërthënie kuptimore. Gjymtyra e dytë e ndërtimeve të tilla lejon për lëvizje semantike: ose ndërron kuptimi themelor, ose spikat një përbërës i tij semantik e emocionues,i cili krijon kundërvënien me gjymtyrën e parë. Kështu tek çorganizim i organizuar gjymtyra e dytë (i organizuar) spikat përbërësin “sistematik, i vazhdueshëm, pa ndërprerje”; te heshtje që flet spikat kuptimi “domethënëse” apo “mbresëlënëse”; te drejtësi e padrejtë gjymtyra e dytë spikat përbërësin emocional – vlerësues (ironik apo përbuzës) “gjoja”, pothuajse sikur fjalët të viheshin në thonjëza. Por, “*contradictio in adiecto*” mund të mbarte edhe ngjyrimë emocionale pozitive për kënaqësinë, vlerësim, miratim, përkëdhelje etj, p.sh. “vdekje e bukur, jetoi sa deshi, i la të gjithë mirë dhe nuk vajti me brengë” (bisedë) etj. Me gjithë lirinë e ndërtimit të këtij mjeti, që lejon bashkëlidhjen e dy të kundërtave, të cilat nuk shkojnë me njëra – tjetrën, për të dhënë ato vlera që thamë, ka një logjikë të brendshme të kësaj bashkëlidhjeje si edhe një synim të qartë përse ndërtohet⁴².

Sigurisht mbetet konteksti i gjerë ai që do të zbulojë ose gabimin ose arsyen stilistike të një ndërtimi të tillë. Megjithatë në çdo rast si ti kthesh këto bashkëlidhje (me kuptim të drejtëpërdrejtë a të figurshëm), nuk shkojnë sipas vetë kuptimeve leksikore të fjalëve të cilat në kuptimin fillestar e të drejtëpërdrejtë, d.m.th si gabim në të shprehur kundërshtohet a hidhet poshtë ajo çfarë ke thënë me fjalën tjetër. Logjika, shija për figuracion, harmonia tekstore semantike janë ata që duhet të udhëheqin në ndërtimin e këtij mjeti ,jo veç të politikës, por edhe të letërsisë e të leksikut të përditshëm.

Si tipa strukturore realizohen:

⁴² J. Thomai, “Teksti dhe Gjuha”, 1992, f.17

Emër + mbiemër: (Çorganizim i organizuar ; Legalitet ilegal; Mirësjellje banale)

Emër + emër (Arsyeja e mosarsyes;Pambuk prej hekuri; Planifikim pa plan ,Tigër prej letre)

Mbiemër + mbiemër (Dëshira reale imagjinare; Pushteti i rëndë i lehtë; Shteti ligjor i paligjshëm; Lider sipëror i ulët)

Mbiemër + emër (Dhunë e ftohtë prej zjarri)

Emër + **folje** (Heshtje që flet)

Më poshtë po paraqesim disa prej “contradictio in adiecto” të hasura në literaturën tonë:

✓ “..... për të cilat u bë, me kalimin e viteve, pika gjithnjë e më e fortë përbashkuese, nganjëherë e vetmja, por mjaftueshëm joshëse për t’i bërë të gjithë **bashkë. Kundër** (f.10)

✓ “ po, ndoshta, mund të jenë edhe thjesht zëri i vjetër, mbytur në **furtunat** e përditshmërisë **shurdhuese** të politikës...” (f.12)

✓ “.....po kurrë s’e përdori për t’ia zënë **diellin kujt hijen** e madhe të veprës së tij të shumëvlerësuar asokohe, si baba i dhembshur e i ditur.....” (f.21)

✓ “ e di, e di, s’kam **dyshime të arsyeshme** në këtë pikë.....” (f.31)

✓ “....., duke e bërë **gënjeshtren të vërtetë e të vërtetën rrenë** me bisht, janë në fakt vetëm kostoja e lartë e një lufte të paskrupullt politike”. (f.51)

✓ “....., ashtu siç është bërë pothuajse e pamundur për publikun që të **çmësohet me mësimin** e imponuar.....” (f.33)

✓ “Përmes **shembullit të forcës** dhe jo nëpërmjet **forcës së shembullit**” (f.34)

✓ “ Pa atë fuqi, ëndrrat e ndryshimit të botës përreth mbeten dritëza iluzore që **fiken pa u ndezur**.....” (f.42)

✓ “ Qyteti kishte nevojë për gjithçka, buxheti i bashkisë ishte **asgjë presje diçka**. (f.49)

✓ “....., por kishin harruar se u **përkiste dhe të gjithëve përveç se secilit**.” (f.51)

✓ “.....gjenim shtigje e rrugë nga më të ndryshmet për interesa që më shumë **nuk afronin sesa përputheshin**,..... (f.55)

✓ “.....**sa i zgjuar aq i palexuar**, sa i vetësigurt në shfaqje aq i luhatur në brendi.....” (f.61)

- ✓ “Ishte një akt që mund të quhet edhe **jodemokratik** në metodologjinë e vet, por thelbësisht **demokratizues**.....” (f.89)
- ✓ “.....kur shesin me tangërllekun proverbial të të pandriçuarit dëngla për zhvillimin e këtij vendi gjithfarë **qorrash me një sy mes symbyllurve** nga dëshpërimi.....” (f.93)
- ✓ “.....që **polli zhvillimi katrahurë** nëpër bregdetin e Shqipëisë së re.....” (f.94)
- ✓ “.....Saliut ia kënaq loçkën e zemrës e i duket çudi e admirueshme teksa **e sheh me sytë që nuk shohin** atë që po i ndodh.....” (f.106)
- ✓ “.....çdo ditë një **mësim çmësimi**, një larje trush, një dozë helmi pushtetmbajtës.....”(f.111)
- ✓ “ Ka pasur, e di, edhe **arsye** për të mbajtur gjallë një luftë të tërë të **paarsyeshme**.....” (f.111)
- ✓ “.....jo pak raste kur puna të vinte përballë prurjeve të tyre në një **kohë që s’të jepte kohë**”. (f.116)
- ✓ “.....dëgjojnë pa asnjë paragjykim **të huajt e sërës sonë**”. (f.117)
- ✓ “**Gjuajtje e bukur**”, - ia ktheva” (f.118)
- ✓ “....., po edhe mundësinë të mbyllin qëllimisht sytë para shkeljeve të **ligjit** për interesa **të paligjshme**”. (f.124)
- ✓ “.....konfliktit politik pa asnjë sqimë **të arrivistëve ish komunistë të PD-së me komunistët ish arrivistë të Partisë së Punës.**” (f.134)
- ✓ “.....dhe **mikun armik** të Fatosit qysh nga dita inaugurale e katharsisit” (f.135).
- ✓ “...qysh në dekikat e para të krijimit të Partisë Demokratike dhe **mikun armik** të Fatosit qysh nga dita inaugurale e katharsisit...” (f.135)
- ✓ “Ndërsa për Fatosin katharsisi ishte **fundi i fillimit** aq premtues të orëve të veta më të mira dhe fillimi i fundit të shkëlqimit të vet si pjella.....” (f.135)
- ✓ “.....thjesht si derivate të një **ndërvarësie varësie** tribale, që detraktorët e mi.....” (f.139)

- ✓ “.....që dukej se çdo ditë mund të ngjallte të vdekurin e nisur për në banesën e fundit dhe të vdiste të gjallë.....” (f.146)
- ✓ “.....u dha njerëzve mundësinë të kuptonin arsyen që ngjante me të gjitha arsyet e paarsyeshme të sorrollatjeve.....”(f.149)
- ✓ “Kjo e bënte, siç e pat thënë vetë njëherë çakërrqejf, e sjell këtu dashamirësisht, me rrugaçin e politikanëve dhe me politikanin e rrugaçëve”. (f.150)
- ✓ “Ky që kemi sot në Shqipëri është një sistem pa sistem, një mol amullie që duhet.....” (f.208)
- ✓ “....., po sepse kryetari rifitoi duke humbur edhe atë që kishte e duke provokuar de facto.....” (f.211)
- ✓ “.....as për Ferrarin apo Bentley-n që për Tanin ishin skulptura vrapuese.....” (f.237)
- ✓ “.....mes të kësaj keqqeverisjeje dhe çorganizimit të organizuar të keqqeverisjes së Saliut,..... Publiku çmësohet me çmësimin e imponuar.
(f.247)
- ✓ “Unë smarr dot me mend asnjë arsye tjetër përveç të njëjtave arsye të mosarsyes që kanë bllokuar.....” (f.280)
- ✓ “.....dëshirës infantile për ta parë PS-në të zvogëlohej e bëhej LSI dhe LSI-në zmadhohej e bëhej PS.....” (f.289)
- ✓ “.....ekzaktësisht çka kishte kopjuar në errësirën ku qeveria mbante peng dokumentin.....” (f.318)
- ✓ “....., shpatullat nuk do t’ia rrihja kryeministrit që bënte të bukurin shejtan duke na i shitur të tërëve.....”(f.326)
- ✓ “.....me moton ‘PO NATOS, jo BERISHËS’ në një sulm ndaj institucioneve apo në fillimin e fundit të dhunshëm.....” (f.32)
- ✓ “.....e me fjalë gur të rënda qeverie, në fund të rrugëve pa rrugë që lidhin netët pa.....’ (f. 371)

- ✓ “E vërteta është se ne s’kishim tjetër veç mjeteve të protestës popullore në kushtet e **shurdhërisë së zhurmshme** të Saliut.....” (f.386)
- ✓ “.....veç Saliut përpara, në **rrugën e vet pa rrugë**.....” (f.390)
- ✓ “.....në një krevat me **të vdekurin e pakallur** të metalurgjisë komuniste(f.405)
- ✓ “..... e të gjejnë shtigje në **rrugën pa rrugë** të shtetit.....” (f.406)
- ✓ “....., **fjala vepër dhe vepra fjalë**, duke u bërë si ata zogjtë e kurdisur.....”(f.409)
- ✓ “.....nëse **puna e papaguar** e kohës së Enverit s’do të ishte zëvendësuar **me pagesën e papunësisë** që vjen tash njëzet vjet prej emigracionit” (f.411)
- ✓ “.....prej popullit në **rrugën pa rrugë të punëve të veta**....., madje për **arsyet e mosarsyes partiake**.....” (f.413)
- ✓ “.....nga **mbeturinat e inteligjencës** zyrtare e sekrete të diktaturës komuniste.....” (f.416)
- ✓ “.....pas në çorodinë e **rrugës pa rrugë** ku s’ka prind të mos i friket asaj.....” (f.436)

(SHKËPUTUR NGA “KURBAN”, EDI RAMA)

4.4 Disa tipare të gjuhës së sotme politike(leksiku në veçanti)

Leksiku politik është i zgjedhur, me terminologji të gjerë, me emra e fjalë abstraktë, me fjalë që kanë kryesisht kuptim të drejtpërdrejtë. Ashtu si edhe në letërsinë artistike edhe në politikë shfrytëzohen shpesh fjalë të figurshme, me ngjyrim emocionues, fjalë të vjetruara e dialektore, njësi frazeologjike, shprehje ndërkombëtare etj. Vendin parësor e zënë togfjalëshat⁴³ si : komitet drejtues, këshilli kombëtar, dega e PS, forumi i PD, seksion legjitimues, parti opozitare, koalicioni i maxhorancës, ekspertët e ODIHR, sesioni i ardhshëm plenar, shpërdorimi pa hesap i fondeve publike, koalicione qeverisëse,

⁴³ Të gjithë këto togfjalësha apo shprehje janë vjelur prej nesh brenda kuadrit kohor të një edicioni informativ në NEWS 24 dt.26.07.2012

akt historik, muri i korrupsionit, Rruga e Kombit, grupe interesi, proces publik transparent, muri shurdh i qeverisë, proces gjithëpërfshirës, sezon gjuetie shtrigash, betejë politike, riciklimi i mbetjeve në vend, arnim kushtetues, implementimi i kodit, aktorët politikë, drafti për imunitetin, sistemi zgjedhor, kodi zgjedhor, fryma e konsensusit, këshilltarët socialistë të Tiranës, LSI apelon, kufizimi (heqja e imunitetit), nisma e PD-së, sanksionimi i së drejtës, një hap kundër korrupsionit, pastrim parash, aleatët aktualë dhe potencialë, luftë boshe kundër korrupsionit, Komisioni i Venecias, qëndrime nihiliste, reforma zgjedhore, numërimi elektronik i votave, rruga e bashkëpunimit, koalicion antiqeveritar, kufizimi i lirisë, inspektim i përgjimeve, mbledhja e grupit parlamentar, atentat ndaj kushtetutës, trupa e Ambasadorëve të akredituar në Shqipëri, parti me duar të pastra, bllokimi i ëndrrës ,tolerancë zero, larja e parave të trafikeve, një nga 12 pikat kyçe (rekomandimet) e BE-së, beteja për Tiranën, implementimi i ligjit, menaxhimi i pasurisë së paluajtshme, fushatë elektorale, të arrihet një konsensus mes palëve, ulja e taksave të biznesit, debat parlamentar, mbi interesat personale të Klubit të tij të miliarderëve, zgjedhja e presidentit të ri, betim mbi kushtetutë, fjalimi i zotit Nishani, një konferencë për shtyp, menaxhim i integruar i mbetjeve. Karakteristikë për këtë leksik janë përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve parafjalore dhe lidhëzore, si : në bazë të, me anën e, duke u mbështetur në, përsa i përket, për faktin se, sipas deklaratave të, sipas të dhënave të, sipas burimeve presidenciale, sipas pohimeve të etj., që vijnë në adresë të cilitdo. Një ndër të tjera tipare thelbësore të këtij leksiku do të paraqisnim edhe fjalët e panumërta ndërkombëtare që mbulojnë deklaratat e politikanëve tanë si: transparencë, parlament (kuvend), afirmoj, modalitet, integrim, reformë, elektorat, koncesion, koalicion etj⁴⁴. Elemente të tjera që dallojnë në tekstet e politikanëve janë :

- Elementet e rimarrjes (anafrike) p.sh, “një kapitull i gjatë njëmbëdhjetë vjet u mbyll me thikat që therën , me pahirin e ahtimave të përgjakshme nën diellin përcëllues. Një tjetër kapitull, që s’ dihet sa do të zgjasë...”apo “po a ka pasur, në fakt, një Edi Ramë tjetër apo ai kam qenë jo unë? Sigurisht që ai kam qenë unë, po unë s’jam më ai, do të thoshte Andi Bushati. Apo “në të vërtetë, kishte qenë Shemsiu që e kishte fituar lojën dhe u pa qartë që Beqiri ndonëse u prish ca në fytyrë nuk e dha veten. Në të vërtetë Ambasadori i kishte thënë zëvendëskryeministrit se loja e...”

⁴⁴ Në fund të këtij punimi do të paraqitet një fjalorth me disa prej ndërkombëtarizmave të përdorura më shpesh në ditët e sotme prej politikës në tërësi, i pajisur me etimologjinë përkatëse për të shpjeguar sesi fjala nga një përdorim parësor p.sh.,nga filozofia, nëpërmjet shpërnguljes kuptimore ka rrjedhur në artikullimin politik.

(S.Ngjela,E. Rama)

▪ Elementet e zëvendësimit. Për të shmangur përsëritjen e së njëjtës fjalë në tekstet e tyre zyrtarët e vendit përdorin të tjera fjalë me anën e : përemrave, me anën e ndajfoljeve, me anën e sinonimeve, me anën e hiperonimisë, hiponimisë, me anë të konektorëve (lidhëzat, përemrat lidhorë, ndajfoljet etj), me anë të një përshtatjeje morfologjike etj.

▪ Me përemra: p.sh: “Në një shoqëri komuniste, kurrë nuk flitej për lirinë në sensin e saj intelektual dhe asnjëherë nuk flitej realisht për personalitetin e individit. Ai ishte anonim dhe i nënshtuar.”

(Ngjela, f.223, “Përkulja”)

Ndajfoljet mund të jenë tregues të kohës e të vendit⁴⁵ përdorur më parë në tekst; **hiperonimet** perdoren si fjalë që kanë kuptim më të gjerë se fjala e përdorur pak më parë; **parafraza** domethënë shprehja e të njëjtit kuptim me fjalën e përdorur; **hiponimet** ose një fjalë që ka një kuptim pak më të gjerë se fjala e përdorur, por që shumë mirë mund ta zëvendësojë atë pa ndryshuar kuptimin e tekstit; **konektorët** si elemente që luajnë funksion lidhës në tekst.

Sinonimet, antonimet (antitezat) në pjesën më të madhe janë jo të plota, pra kontekstuale, të vendosura në marrëdhënie me gjithë tekstin e thurjen e tij p.sh: “...sepse kanë krijuar një gravitet të ri kulturor, të bazuar mbi gënjeshtren, varfërinë e paditurinë.....” (Edi) apo “...me uniformizim të vazhdueshëm në padituri, frikë, nënshtim e kundërvënie të egra ndaj kujtdo nuk uniformizohet....” (po aty, fq 241)

Perifraza : “ Një vend në ndryshim, Shqipëria përtej klisheve, trafiqeve të të gjitha llojeve, kapje nga mafia, mbretërim i armëve të zjarrit....vendi i shqiponjave po shkëputet me vështirësi nga një reputacion i errët. Megjithatë Shqipëria po evoluon duke

⁴⁵ Literatura e vjelë sjell idene politikanët i drejtohen një argumenti qendror ose një teme themelore dhe e zhvillojnë më tej atë; paraqiten një rregullsi në shtjellimin e përmbajtjes me fakte ide e koncepte në mënyrë organike, në mënyrë që gjithçka të jetë në favor të çështjes së tyre. Tekstet paraqiten gjithashtu edhe koherente sepse (në disa pak raste me përjashtim) mbizotëron një lidhje logjike kuptimore, por edhe kronologjike tek të gjithë përbërësit; gjithashtu nga sa kemi arritur të zbërthejmë brendinë e tyre ato paraqiten homogjene , pasi e dinë se cilit marrës i referohen, kanë një qëllim final dhe kushtëzohen brenda një konteksti – kryesisht kontekstit rrëfim mbresash e opinionesh. Shpesh herë ky lloj vetërrëfimi merr vlera argumentuese ku teza e antiteza mbrohen apo hidhen poshtë edhe me shifra, fakte, prova, dokumente, statistika, burime informacionesh të sigurta plus p.sh.; [“Ndërsa, shikoje me vëmendje, kujt paguhet **1.4 milionë lekë (deputet)**, i merr tani po aq sa dikur, asnjë lek më shumë, fiks **141 mijë dikur, fiks 141** sot, kurse ministrave me pagë **2 milion lekë**, që dikur shteti u merrte **229 mijë** lekë, sot u merr **200 mijë**, pra më pak. Dhe vetë **Shkëlqesisë së tij, zotit Kryeministër**, pra vetes së vet nga **240 mijë lekë** taksë që shteti i **kërrente** nga xhepi kur hyri në zyrë, sot **mezi i nxjerr në majë të gishtave vetëm 200 mijë lekë** për rrogën dymilionëshe. Pa llogaritur që po **10 për qind** paguajnë edhe ato që fitojnë miliarda”] (Edi,f.417)

ngjitur rradhët. Madje vendi i ish-diktaturës paranojake ka marrë ftesën për të hyrë në NATO.

(shtypi i shkruar)

Hiponimia: “Urdhri i tretë ishte: Ndalohen pijet alkolike në lokalin e institucionit. Konjaku, fërneti, rakia e rrushit dhe dëllinjës mbeten edhe për pak kohë në ilegalitet, përpara se të zhdukeshin.”

Konektorët: “Triumfi i tiranisë shqiptare të pasluftës së Dytë otërore ndodhi në dy faza kur triumfoi komunizmi, kjo ngjarje ishte vetëm preludi dhe ne ende nuk mund ta dimë nëse.....si ajo që përjetuam.....Kurse faza e dytë është triumfi i vullnetit të Enver Hoxhës si pushtet, triumf ky...i cili e plotëson tiraninë si një pushtet.

(Ngjela, f.15)

- **Elemente pasthirmore dhe onomatopeike**

Më poshtë po paraqesim disa tituj gazetash të vjelura: E famshme ka ngelur shprehja e Ramës “ What the fuck!”, si një fjali – pasthirmë, me vlerë “Çfarë dreqin....?!”

Rama bëri ciu – ciu për të përndjekurit si Nexhmije Hoxha. Berisha heq emergjencën. Rama bën ciu-ciu (10 mars 2012 “Panorama”).

Rama: “Berisha bën ham- ham”;

Berisha: “Rama ka ku të bëjë ciu-ciu;

Të pranishme gjithandej janë edhe elementet fyese që kalojnë deri në degradim gjuhësor:

Topalli, Braçes: “Si të duron gruaja në shtëpi ?!”

Deputeti i PS: “ Ty s’të duron burri!”

Ruçi në Kuvend: Bode i thotë “Ik pirdhu!” Naços dhe kjo e aktualizuar më tej në disa reagime në shtypin e shkruar në formë ironie e sarkazme të thellë: “Topi do bëjë gol në partinë e vet.” (30 mars “Panorama”)

Rama: “Shqiptarët të pastrojnë plehrat e Berishës.....”

“Berisha si mbreti lakuriq.....”

Topalli: “Rama kërkon **gjethe fiku** ,por ajo të turpëron, s’të mbulon”

Xhaça: “Topalli përgojon jo vetëm burrat, por edhe gratë.....”

Braçe: “Berisha vdiq, tani duhet rrëzuar!”

Ngjela rrëzon tryezën: “Duket si lojë e Saliut.....”

Rama akuzon ballistët: “Ishit me gjermanët. Hanit pula!”

Rama,Alimadhit: “ Ik vazhdo të hash pula!”

Berisha: “Rama ka hall se në ç’ferrë do e vendosë Bamirin.....”

Oketa si Dokle, Topin s’e voton as Flamuri” dhe së fundi me një *contradictio in adiecto* të bashkëshoqëruar me një shprehje frazeologjike shfaqet:

Rama: “ Duhet plan solidariteti! Shqipëria **digjet nën dëborë, Saliu krihet para TV!**”

Ky pingpong mendimesh transformohet në një pingpong gjuhësor dhe lufta pret të marrë flatra...

Neologjizmat në gjuhën e politikës si fjalë- dëshmitare apo si fjalë – vulë.

-Sikurse e dinë mirë filologët dhe dashamirësit e letrave, fjalën *kolltukofag* e ka krijuar dhe përdorur Fan Noli, për herë të parë në një fjalim të dt. 23 shtator 1923 (sesioni i katërt i Këshillit Kombëtar, mbledhja e 27-të), ku bën polemikën e famshme me Ahmet Zogun,-shprehet Vehbiu në Peizazhe të fjalës,12 gusht 2010.

Kolltukofagu, në thelb, është pushtetari **patologjikisht** i lidhur pas kolltukut. Paralelizmi formal i *anthropofag* me *kulltukofag*, themeluar mbi emëruesin e përbashkët të prapashtesës, jo vetëm i referohet njësisë së objektit, por edhe e transferon konotacionin negativ të *anthropofagut* (pështirjen, refuzimin moral) te *kolltukofagu*.

Përndryshe, fjala *kolltukofag*, e nxjerrë nga ai kontekst, nuk ka kuptim; nëse *antropofag* është dikush që ushqehet me njerëz, *kolltukofag* do të ishte dikush që ushqehet me kolltukë; sa kohë që dihet se prapashtesa diturore *-fag*, me prejardhje nga

greqishtja e vjetër *φάγος* (*phagos* “llupës”), ndeshet në terma të tillë librorë si *bakteriofag*, *koprofag*, *nekrofag*, *lotofag*, *ezofag* etj., prej të cilave ndoshta vetëm *antropofag* e ka kapërcyer barrierën nga tekstet diturore në ligjëratën publicistike, si sinonim neutral i *kanibal*, ndërsa *ezofag* e ka humbur motivimin, madje edhe brenda sferës librore.

Kjo prapashtesë ka kuptimin “që ha, që ushqehet me, që konsumon, që dëshiron të hajë, që kërkon të hajë” objektin e denotuar prej temës së fjalës që i bashkëlidhet. (Shih po aty, Vehbiu, 2010)

Në fjalimin e tij Noli shprehet në mënyrë metaforike dhe paralelizon trupin e antropomorfizuar të Shqipërisë me një trup plot plagë të infektuara, që vuan e lëngon keq, pasi insekte gjakpirëse, këpusha e kandrra parazitare, të bëra njësh me të, përdita ushqehen me gjakun e saj. *Fjalori i shqipes së sotme (1984)* nuk e përmban fjalën. Në këtë moment merr jetë edhe fjala “kolltukofag”:

“E pesta, anarkia e idealeve: këtu idealet janë të errëta, të shtrembëra e të mumifikuara të Fanarit e të Buharës përfyten e përleshën në një luftë për vdekje me idealet e gjalla, elegante dhe të ndritshme të Perëndimit; na mungojnë vetëm idealet e **antropofagëve**.

Po për të zënë vendin e tyre kemi kolltukofagët, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten me plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpushë, që mund t’i copëtosh, po jo t’i çqitësh nga trupi që kafshojnë e thëthijnë. (shih metaforën konceptuale). Noli vazhdon më tej ,duke na sjellë në fjalim idenë e gjakpirjes me paralelizim të insektit me gjymtyrët e njeriut në rrëfimet herodotojane, duke shfrytëzuar sfondin e një beteje mitologjike:

“Herodoti na tregon se në betejën navale të Selaminës, një athenian kapi një anije persiane me dorën e djathtë e s’ e lëshonte gjersa ia prenë; ahëre e kapi me dorën e dorën e mëngjër; ia prenë edhe këtë; ahëre e kapi me dhëmbë dhe s’ e lëshoi gjersa i prenë kokën.

Sikur të ngjallej Herodoti përsëri do të shikonte që kolltukofagët tanë janë më të fortë se ky trim legjendar i vjetërsisë greke. Që t’i çqitësh këta tanët nga kolltuku duhet t’u preç jo vetëm duart e kokën, po dhe këmbët e trupin...”

Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe Tiranë, 1980, fjala “neologjizëm” si term gjuhësor përkufizohet ,si: “ Fjali ose shprehje që ka hyre rishtazi në gjuhë për të shënuar një send a një dukuri të re dhe që ende ndihet si e tillë”. Nevoja në politikë për të shprehur konflikte interesash me anë të rrjeteve publicistike çon shpesh në përdorimin e neologjizmave tipike për gjuhën e politikës. Këto fjalë përdoren në konfliktin e mendimeve si dhe në luftën për fuqi politike me përmbajtje interesash dhe qëllime të ndryshme.

Për shkak të tendenciozitetit (Xh.Lloshi, 2005) gjuha e politikës ka pamjen e një gjuhe të veçantë e kjo vërehet më së pari në leksikun e saj. Çdo fjale, çdo neologjizmë përkon me një kornizë konceptimi. Çdo politikan e njeh si një armë gjuhësore formimin e fjalëve të reja, duke shfrytëzuar mënyra të ndryshme fjalëformimi.

1. Si risi shfaqet dukuria e kompozimit ,por jo vetëm. Kompozitat e rralla vijnë kryesisht mbi bazën e inversionit,si: rrasuplasu, tymëflakta, puthadorë, lehaqenj, çadrapushke, stilopistoleta etj.

Grupi i dytë i neologjizmave përfshin fjalë që i përkasin ideologjive të ndryshme apo përgjithësimeve për një ideologji të caktuar dhe jo vetem,si: enverizëm, berishizëm, ristanizëm, ramizëm, fyhrerist, kuisling, ludist, mekartizëm, nanoizëm, fashizëm, klientelizëm. “Do t’i rezervojmë ‘partisë Rama’, apo partisë së Re të një grupi të vogël të pinjollëve të bllokut, 99-shave, Mjaftucëve të z.Rama, fatin që i rezervuam G99-ës në zgjedhjet e shkuara parlamentare”.

Në këtë lloj analize të nisur vlen të theksohet veçimi i një periudhe të caktuar, punohet për të studiuar leksikun e kësaj periudhe. Qëllimi është të zbulohen struktura leksikore “për të shpjeguar një ideologji”. Duket sikur here-here rëndësia që fiton lindja e një neologjizmi përkon me shprehjen në mënyrë sintetike të tipareve që gëzon ligjërimi i atij politikani apo përfaqësuesit e asaj partie. Ato provokojnë reagime të forta emocionale me konotacion pozitiv apo negativ, sa shpeshherë duket sikur fati i kësaj politike varet prej tyre. Në politikë neologjizmat nuk janë mjete të thjeshta, të parëndësishme komunikimi. Në duart e një politikani ato thjesht mund të kthehen në një mjet manipulimi.

Mënyra e fjalëformimit më e përzgjedhur në politikë vjen parashtesimi e prapashtesimi:

neo – neoshqiptarizma; neoberishist,neoliberal etj;

anti- antikontrabanda;-iada: ballkaniada, Saliada;

-mania: absurdomania, qeveriomania, apartmania, monkeymania, infomania, grandomania, arnautomania, euromania;

-izëm: enverizëm, haxhiqamilizëm; berishizëm e deri te politikanizëm m. libr. keq.si

mënyrë veprimi, qëndrim a sjellje prej një politikani joparimor e dhelparak. Ra në politikanizëm.FGJSH,2006.

-izimi: gjeorgjizimi, zveçanizimi, sanaderizimi; dekomunistizimi; De-edramaizmi

-izmi: thaçizmi, esatizmi, konsumerizmi; Edvinizmi

-ation: Berishation;

-lend: Fintalend (frëngj. “feint” si lëvizje, manovër, që pritet të ndodhë, por që befasisht, ndodh një lëvizje krejtësisht tjetër ose nuk ndodh asgjë;

- si sinonim i mashtrimit/ Dejtaland, dembela;

-nd: Ajvarland;

-kracia: meritokracia, pornokracia, imazhokracia, demokracia, eurokracia, Grueskokracia, - adhokracia, shkërdhatokracia; Drogokraci

-stan: Serbistan, Albanistan (vepër e A. Stefanit), absurdistan, pishmanistan, salistan;

-isht: shqipisht

-uc: stalinuc ,etj.

-llëk: salillëk

Model tjetër shumë i përzgjedhur , deri diku sociolinguistik, si një dukuri e re vjen edhe ai i përngjitjes së fjalëve në një të tërë me anën e shkrirjes, kontaminimit (bëhet fjalë për përngjitjen e dy fjaleve ose të pjesëve të tyre në një tërësi të re. Të tilla përmendim disa që politikanët i marrin hua nga gjuhët e huaja: demokracia (Demokracia + diktatura), demonokrate (demon+ demokrate), Drakullesku (Drakula+ Çaushesku), kleptokracia (kleptomani + demokracia), partitokratia (parti+ demokracia); Eurokracia (Europa + demokracia). Shumë veprues del modeli i përngjitjes së tërësishme të fjalës së parë në pjesën e dytë të fjalës së dytë ,në tipat si : leukracia (leum + demokraci), Ndokanator (Ndoka + terminator) ,respektikë (respect + frikë), bufreferendum (buf +referendum). Një përdorim të gjerë po gjejnë sot ndër politikanë edhe një numër kompozitash që kanë

si gjymtyrë të parë një temë emërore e cila shenjon emrin ose mbiemrin e një qeveritari të lartë (kryesisht kryeministri e ministrat), si : nanokorrupsioni, nanomafia, nanopushteti, nanotrafiku, nanoqeveria. Nuk mbeten prapa përzgjedhje leksikore të tilla ,si: saliada, berishation, salistan, saligërdeci, sllobodanostalgjia, grueskokracia, esatizmi, Ramëkriza, thaçizmi, etj. Shpesh na vijnë edhe krijime të shënuara me mashtrime të segmenteve të caktuara në formë shkurtesash apo akronimesh (shkronjat e mëdha që përdoren kryesisht për efekt të veçantë stimulues- vizual ,si p.sh: S’ban S’ki S’mun për analogji me Ban Ki Mun; Deputett (kush do të bëhet deputettt?!), ReferenDUM, ushtari i mirë KLOS, Partia e Kostandinit, apo deformimet tendencioze te grupeve emërore të tilla ,si : partia siçiliste, republika e Kasharit të ansamblit “Babëzia” ,të cilat vijnë si forma të pastra, si neologjizma stigmatizuese ndaj kundërshtarit, që ngjajnë si epitoma në imazhin publik të kundërshtarit. Dhe nuk janë pak: zullumqarë, zemunarë duke vijuar me **klane** të emëruara nominalisht sipas rastit e koniunkturës :lesh e li (LSI), padrino (F.Nano), sovjetiku i fundit (Servet Pellumbi), doktor Rrumpalla, klosarë,Doktori i Zi (F. Nano), Plaku Mere, lengu i fasuleve (S.Gjinushi). Kjo lloj kulture në sjelljen e risive nëpërmjet neologjizmave pagëzohet në politikën shqiptare nga Noli me “kolltukofagët” e “bejlurcinën” e njohur, si gjetje të arrira leksikore për ta kthyer në karikaturë kundërshtarin. Gjithashtu është edhe “shpellar” i “F.Nanos, Esat Pashai i Edi Ramës, kriptokomunistët, Sockomocet, kleptokomunistët, ediskobar (Berisha).

Pavarësisht faktit që fjala është njësia më e vogël e kuptimshme në gjuhë, ajo e vetmuar nuk na jep gjë. Vlera themelore, më e madhe e fjalës është përmbajtja e saj, vlera semantike. Fjala lind e jeton nëpërmjet përdorimeve të saj. Ajo jeton në vlerat që ajo fiton (eros) edhe si fjalë çelës apo dëshmi në një periudhë të caktuar dhe “vdes” kur s’ndihet më nevoja për të. Ballhysa shprehet se: “Fjalët dëshmi janë elemente të rëndësishme në funksion të të cilave strukturat leksikore organizohen dhe vendosen në një lloj hierarkie, {...} në një periudhë të dhënë gjithmonë shfaqen e veçohen fjalë që bëhen dëshmuese, fjalë që pasqyrojnë nocione të reja. Ato shfaqen në gjithë shoqërinë dhe përcaktojnë e përkufizojnë një sektor të dhënë të saj”. Këto fjalë provokojnë reagime të ndryshme kontekstuale. Në formë ato vijnë si diçka e re, një neologjizëm dhe në përmbajtje si një kthesë, si një shtysë më përpara gjithnjë e lidhur fort me kontekstin që u përgjigjet disa koordinatave: bashkëbisedime, vend, kohë etj: Përdorimi i këtyre fjalëve është detyrimisht i fokusuar në një periudhë të dhënë prandaj del e natyrshme si objekt në punimin tone:

- Dhënia në përafërsi e kohës kur lind e përdoret fjala

- Dhënia e dëshmisë së parë të kësaj fjale
- Një përkufizim i saj
- Karakteri i saj prodhues e emocionues
- Identifikimi i tyre ndaj një politikani
- Efekti i saj solidarizues
- Kuptimi i saj konciz, i përpiktë agjitativ

Prurje të tjera, të reja do të shpalosen në punimin tonë më tej. Mjaft të fuqishme në shprehësi dalin edhe polisemitë e paronimitë e përdorura në funksione stilistike, si në rastin: “krimministër” për “kryeministër”, me ngjyime negativ emrat e diktatorëve, si: Pinoçeti i fundit, Bamirësit e fundit (referuar thënies më të fundit të S. Berishës), Sali Ristani, Sali Baba (për lidhje me Ali Baba dhe 40 hajdutët), Mr. Këllira (referuar fig. të Edi Ramës), refresh i FRESH-it etj.

Një grup më vete do të konsiderohet edhe përdorimi stilistik i termave të shtermëzuar në kontekstet e reja ku gjejnë përdorim: partizë “për interesa mediokre partizash”, politikanaxhi apo politikaman (politikaman i keq); demokratist (demokrat i rremë, jo në bindje), korrupsionologji, presidentomani, putinizëm, mitomani, nanoist, xhuvelist e xhuvelizëm (ai që mban qëndrim të lëkundur), ristanist (ai që vjedh votat), fidelomani (dukuria e të qenit besnik), saliberishizëm, fazllaçëve etj.

Po ashtu në ligjërimet e politikanëve janë vërejtur edhe lindje njësisish të reja, me ngjyime më të theksuara e më shprehëse (mbi bazën e një tipi frazeologjik strukturo-semantik të caktuar); kështu p.sh mbi bazën e frazeologjisë “I vë bërrylat dikujt” (me gjymtyrë bosht fjalën bërryla) lind togfjalëshi i qëndrueshëm “lufta e bërrylave” si “luftë për neutralizimin e kundërshtarëve me të shtyrë”, qeveri “me duar të pastra”, “Çorba e D(d)ushkut, Dushku i Nanos”, sipas modelit “e bëri çorbë fare” etj.

Mbi bazën e një tipi frazeologjik strukturo-semantik të caktuar siç është ajo e idiomatikës së “shkoi dushk për gogla” me kuptimin “shkoi për dhjam qeni, kot” lindin njësitë e reja me ngjyime të theksuara e të qëndrueshme si: epoka e republikës së D(d)ushkëzimit, Dushku i madh apo edhe së fundi parlamenti i Megadushkut, që politika t’i largohet goglave të Dushkut., aleanca e betonit, qeveri karavidhesh, gërdecqeverisja.

Deformimi i emrave të përveçëm shërben si një përftesë e re me neologjizma: **Qeni i Stanit** (A.Ristani), **Maci e Baçi**, **Salehu jonë**, **Dritan Murgu (Prifti)**, **Olldashi (Ollujku)**.

Në veprën e tij “Kurban” Rama sjell risi të tilla, si : pasion hipokriziak (hipokrit), i mbrapshtudhëhequr, aferë kuçedrike, indiferentizuar(pjesore), shkrimtarët e tiranizuar, barrikadim force, të reja të dollandërdisura, ulërinte i çakërgjosur, të punohet pasionalisht etj.

Fjalë të krijuara nga individë të caktuar janë një pasqyrë besnike e betejës së ashpër politike që zhvillohet në kampet e kundërta të politikës shqiptare. Shumica e tyre është krijim dhe përdorim i një individi (kryesisht prej udhëheqësve) dhe sot ,edhe pse nuk përdoren apo përdoren rrallë, kanë vlera pasurore e historike për leksikun aktiv të shqipes. Herë-herë do të tentojnë të sillen edhe si simbole letrare, si figura stilistike, artistike: mister 20%-shi, dokt.rumpalla, arapi i fajdeve, bosët e fajdeve, dushkoparlamenti, parlamenti i D(d)ushkut, antimitingjet berishiste, mitingashë, tregishtarët, bllokmenët, dhjetoristët, lëvizja Nano, katarsisi ne parti, lëvizja për mendim ndryshe, shitblerje vote, rilindja etj. Si përfundim, shembujt e panumërt të fjalëve-neologjizma do të dalin shpejt nga përdorimi(disa edhe kanë dalë) e do të harrohen. Njihet tashmë ecuria: harrohet shpjegimi, arsyeja e shkaku pse lindin, harrohet vetë kuptimi, bie nga përdorimi. Kufizimi kohor/ hapësinor e social, forma koncize, vlera emocionale në rritje, të qenurit pro/kundra, evidentimi i një përplasjeje mendimesh, shfaqja e zhdukja, shprehja karakteristike e një epoke, kuadri politik që lidhet përherë me fjalën, ngjizja e tyre në periudha transformimesh në shoqëri (tipi: lëvizja e dhjetorit, partia-shtet, komunizmi, pluralizmi, kurbokracia, piramidat, fshesa, 2 korriku etj).

Partia e Idealeve të Dhjetorit

Moralisto- banal – Emri me të cilin socialistët thërrasin çdo kritik mes tyre që mendon se nuk është e moralshme të qeverisësh me hajdutë.

Koçizimi – Një proces që përfshiu median shqiptare pas vitit 2001. Nënkupton prirjen e të gjithë biznesnemëve për të bërë një gazetë dhe për ta përdorur atë për shantazh ndaj shtetit dhe konkurrentëve sipas modelit të Koço Kokëdhimës.

Muçi-Naçi-Baçi – Referencë për tre ministra socialistë kur qeveria drejtohej nga Ilir Meta në vitet 1999-2002, përdorur nga opozita për të simbolizuar rrënjët e korrupsionit. Bëhet fjalë për Mustafa Muçin, Anastas Angjelin dhe Bashkim Finon.

Zgjedhje të pranueshme – Çdo gjë që nuk përmban përleshje në rrugë me shpata nga shqiptarët ditën e zgjedhjeve, i bën zgjedhjet të pranueshme. Të tilla qenë për vëzhguesit ndërkombëtarë zgjedhjet e vitit 1996, 1997, 2001 dhe 2009.

Parti ministri – Referencë për disa parti të vogla në Shqipëri, të cilave u jepej drejtimi i një ministrie në koalicion qeverisës dhe ku ministria përbënte njëkohësisht zyrat dhe

infrastrukturën e partisë. Partia Agrare Ambientaliste u bë simbol i partisë ministri gjatë periudhës 1997-2005, kur ministria e Bujqësisë që praktikisht zyra e kryetarit ,ndërsa degët e bujqësisë në rrethe qenë njëkohësisht edhe zyrat e kësaj partie në terren. Zyra e vërtetë e Partisë Agrare Ambientaliste në Rrugën Budi në Tiranë, që një barrakë ku dera nuk që hapur kurrë e ku dryni kishte zënë ndryshk. **Partia e Bashkisë** – Një term për të simbolizuar Partinë Socialiste gjatë kohës kur kryetari i saj që njëkohësisht edhe kryetar i Partisë Socialiste.

Paçe presidenciale – Gatimi simbol i Tiranës, që u bë gjithashtu edhe simbol i ish-presidentit Bamir Topi. Për shumë vite, në Tiranë thuhej se presidenti porosiste paçe çdo ditë te një paçeri pranë Pazarit të Ri në Tiranë. Skraparlli – Simbol i njeriut që është bërë zyrtar me meritën e vetme se është nga fshati i kryeministrit dhe rrjedhimisht nga radhët e mbështetësve të Ilir Metës..

Tropojan – simbol i njeriut që është bërë polic, truprojë apo shofer për shkakun e vetëm se është nga fshati i i të parit gjatë kohës që Sali Berisha që president apo kryeministër.

Gjeopolitikë – Një politikan socialist që është verior që mbahet si deputet apo zyrtar në mënyrë të vazhdueshme me qëllimin e vetëm se duhet një verior në këtë parti sa për të mos thënë se është një parti domen e jugorëve. Rrjedhimisht mbahet për arsye gjeopolitike.

Rruzhdiqe – Simbol i mbushjes së kutive të votimit nga komisionerët e qendrave të votimit, të cilët, ndonëse mund t'i përkasin partive të ndryshme, korruptohen së bashku nga një forcë politike e caktuar. Mbushja e kutive me votat e shqiptarëve që ditën e zgjedhjeve gjendeshin jashtë vendit, ndodhi masivisht më 2009 dhe 2013, kur u shënua edhe rritja më galopante e pjesëmarrjes së shqiptarëve në votime. E mori emrin nga fshati Rruzhdiqe në qarkun e Fierit, ku një grup komisionerësh zgjedhorë u kapën duke mbushur kutitë e votimit, gjë që vlerësohet se i dha një mandat shtesë Partisë Demokratike në vitin 2009.

Dushk – sistemi e mori emrin nga fshati Dushk i Lushnjës dhe simbolizon përdorimin e një numri të vogël votash për të prodhuar një numër të lartë deputetësh. Vlerësohet se një seri analizash nga Apollon Baçe në gazetën “Dita” e formëzoi këtë shprehje.

Rrënjët e sistemit të Dushkut duhet të kërkohen në zgjedhjet e vitit 1996, kur maxhoranca e qeverisë së Partisë Demokratike ndryshoi kodin zgjedhor duke ndarë votën për kandidatin nga vota për partinë politike. Rrjedhimisht, PD arriti të marrë në zgjedhjet e 22 majit 1996 60 për qind të votave dhe 87 për qind të parlamentit. Kjo formë e deformimit të sistemit të zgjedhjeve u menaxhua deri në detaje nga Partia

Socialiste në vitin 2001, ku përmes zbrazjes së votave për partitë të tre aleatë të saj të vegjël arriti të marrë 11 deputetë ekstra në koalicionin qeverisës. Kulmi u shënuar në 2005. Në atë kohë u tha që Berisha e moli më mirë lopën e Dushkut.

Parti Taksi – Një shprehje që i atribuohet ish-kryetarit socialist dhe ish-kryeministrit Fatos Nano për të karakterizuar partitë e vogla të spektrit të majtë, pasi Partia Socialiste refuzoi të hyjë në aleancë parazgjedhore me Partinë Socialdemokrate, Partinë Aleanca Demokratike dhe Partinë Agrare para zgjedhjeve të vitit 2001. Parti Taksi që në kuptimin që është një mjet shërbimi ku mund të hysh ose të dalësh sa herë që të duash. Partitë Taksi kanë shërbyer në politikën shqiptare për dy qëllime kryesore: e para, për të zbrazur votat e proporcionalit me synimin për të marrë më shumë deputetë me më pak vota dhe e dyta, për të mbuluar segmente të vogla të padëshrueshme ,por të nevojshme të elektoratit, si ish-pronarët, ish- të përndjekurit, komunistët fanatikë etj. Në këto raste, votat e këtyre segmenteve të elektoratit zbrazeshin te partitë e vogla, të cilat funksiononin si agjentë të rremë të partive të mëdha.

Yes but – Është një shprehje për të karakterizuar qëndrimin e vëzhguesve ndërkombëtarë ndaj parregullsive zgjedhore, në rast se pyeteshin për rastet flagrante të zgjedhjeve. Yes But do të thotë se ndërkombëtarët i dallojnë manipulimet zgjedhore ,por e shohin si shumë të bezdisshme të merren me to.

Hapja e kutive – Një kërkesë e kahershme e partive që dalin humbëse në zgjedhje dhe që pretendojnë (shumë shpesh me të drejtë) se u janë vjedhur votat gjatë procesit të numërimit. Me gjithë kërkesat e shumta, një proces i tillë nuk është realizuar kurrë. Partia Socialiste organizoi edhe një grevë urie në mbështetje të kërkesës për të hapur kutitë e zgjedhjeve të vitit 2009, por pa sukses.

Hartë e sajuar – Një metodë e menaxhimit të zonave zgjedhore me synimin për të minimizuar peshën e votave të kundërshtarit dhe për të maksimizuar peshën e votave të një partie të caktuar. U kthye në shqetësim veçanërisht në vitin 2001, kur Partia Socialiste kreu një hartë elektorale të tillë ku me 40 për qind të votave popullore, arriti të marrë 50 për qind të mandateve për deputet.

Në vitin 2005, në një situatë të çuditshme, Partia Demokratike arriti të krijojë një hartë që i shkante për leverdi asaj dhe që qe pjesë e kompromisit politik të vitit 2003, ku praktikisht Partia Socialiste hoqi dorë nga pushteti dhe pranoi një tranzicion të butë të pushtetit drejt së djathtës.

Hanxhar i krimi – Një shprehje e përdorur nga Sali Berisha rreth vitit 2006 për të karakterizuar të gjitha kritikantët që mund t'i bënte media atij vetë apo qeverisë së tij. U përdor krahas shprehjes Media e krimi.

Kleptokraci – Qe një shprehje e përdorur fillimisht nga Sali Berisha për të karakterizuar (me shumë të drejtë) mënyrën e qeverisjes së socialistëve në periudhën 1997-2005. Një sistem qeverisës ku kryhen vjedhje masive të fondeve publike me synimin që këto fonde të përdoren për të blerë ndikim politik në zgjedhje. Nën një sistem të tillë, hajduti më i madh bëhet automatikisht politikani më i suksesshëm. Berisha pasoi socialistët gjatë qeverisjes së tij, 2005-2013, duke zbatuar pikërisht këtë sistem.

20 përqindëshi – Një shprehje e dalë në fillim të viteve 2000 për të karakterizuar sistemin korruptiv të krijuar nga kryeministri i kohës Ilir Meta, ku çdo funksionar i administratës që vidhte para apo merrte rryshfet, detyrohej t'i transferonte shefit përkatës 20 për qind të shumës së grabitur në mënyrë që shefi t'i transferonte nga shuma e mbetur 20 për qind shefit më sipër, deri te ministri dhe kryeministri. 20 përqindëshi u përdor edhe si akuzë nga Partia Demokratike për të karakterizuar sistemin e dhënies së lejeve të ndërtimit në Tiranë nga kryebashkiaku i Tiranës Edi Rama në periudhën 2000-2011.

Mr. 20 përqindëshi. Shih 20 përqindëshi

Pangosje – Për shkak se në gjuhën shqipe nuk ka një fjalë të përshtatshme për “sexual harassment”, Pangosje hyri në terminologjinë politike si tipi i zyrtarit manjak që kërkon të ketë marrëdhënie seksuale me çdo aplikante për punë. Hyri në terminologjinë politike pasi emisioni investigativ Fix Fare dërgoi së paku dy vajza si aplikante të rreme për punë në zyrën e ish-ministrit të Kulturës Ylli Pango dhe që të dyja përfunduan “të pangosura”.

Mitingash – Një njeri që e ka për profesion të marrë pjesë në çdo miting, me apo pa pagesë në mbështetje të njëjës apo disa partive njëherësh.

5 mijë lekësh – Etiketë për njerëzit që janë aq të varfër sa paguhen nga partitë politike me 5 mijë lekë të vjetra për të marrë pjesë në miting.

Mjafistik – Djalë i ri që flet gjysmë shqip dhe gjysmë anglisht, përgjithësisht i cekët, që flet për gjëra të mëdha në përpjekje për të kapur ndonjë post te partitë politike.

KOP-ist – Anëtar i Komisionit për Orientimin e Politikave, një grup që funksionoi para zgjedhjeve të vitit 2005 si një argument propagandistik për të treguar se Partia Demokratike ‘ka ndryshuar’ nuk është më ajo e dhunshmja. Zakonisht punonjës i nivelit

të ulët të ndonjë OJQ-je ndërkombëtare, përgjithësisht çun i bukur, jo gjithmonë i vlefshëm, që tërheq simpatinë e vajzave të vogla me një buzëqeshje rrezëluese.

Kokëpaljar – Njeri që merr pjesë në një protestë të opozitës, nuk ka asnjë synim për post publik, por përfundon i vrarë dhe i harruar.

Padrino – Huazuar nga filmat italianë me mafia, nënkupton ish-kryeministrin Fatos Nano, etiketuar në këtë mënyrë nga Sali Berisha, derisa ky i fundit mori pushtetin dhe u bë mik i Nanos. Me këtë rast, Berisha deklaroi se etiketimi i kundërshtarit me fjalën “padrino” është një gjuhë fushate dhe nuk duhet të merret seriozisht.

Hi Gomar! – Emri me të cilin aktivisti shqiptaro-amerikan Geri Kokalari thërret Lulzim Bashën, pasi pa se ky i fundit u bë një grabitqar pa limit i parave publike sapo zuri vend në qeveri pas vitit 2005.

Aksident Teknologjik – Kur një grup hajdutësh punësojnë fëmijë 12 vjeçarë për të demontuar municione me shpejtësi, me synimin për të vjedhur metalin dhe barutin me të cilin janë prodhuar municione, shkaktojnë shumë të vdekur në punë e sipër, atëherë kjo do të thotë se kemi të bëjmë me një defekt në përllogaritjen e nxehtësisë së krijuar nga fërkimi i gishtave të fëmijëve mbi metalin e predhave. Ky qe shpjegimi që i dha qeveria e Sali Berishës shpërthimit të 15 marsit 2008 në fshatin Gërdec pranë Tiranës, ku 26 vetë u vranë dhe qindra të tjerë u plagosën.

Qëndrestar – Një budalla naiv që vijon t’i qëndrojë besnik një udhëheqësi politik pavarësisht të gjitha të zezave që ai bën, ndërkohë që qëndrestari nuk ka asnjë përfitim material për veten. Termi u krijua nga mitingjet e përditshme të Partisë Demokratike në vitet 1998-2000, të cilat përfunduan me arrestimin për një natë të Sali Berishës nga aleati i tij i mëvonshëm në qeverisje, Ilir Meta.

Komunistat blu – Një term i përdorur përgjithësisht për funksionarët e Partisë Demokratike që kanë patur një karrierë si funksionarë të Partisë së Punës apo shtetit komunist.

Pagator – Njeriu shërben si ndërmjetës mes një partie politike/biznesmeni dhe mitingashëve që marrin pjesë në miting në këmbim të shumave të vogla të parave.

7 përqindëshi – Zotëria 7 për qind. Përdoret posacërisht për Ilir Metën, pasi ky i fundit u filmua duke deklaruar se do të merrte 7 për qind të aksioneve të një hidrocentrali të ri në këmbim të dhënies së lejes koncesionare.

E zë libri – Një shprehje që përdoret për politikanët që kanë alergji të plotë nga libri dhe që shpesh u shkakton të vjella në rast se hapin një të tillë. I atribuohet Spartak Ngjelës, i cili thuhet ta ketë bërë këtë observim për Fatmir Mediun gjatë një vizite në Amerikë. Mediu hapi një guidë turistike dhe në atë çast u ndje keq dhe Ngjela komentoi duke

thënë se ai “is book sik”. Me kalimin e viteve, Ilir Meta u bë simbol i politikanit që e zë libri, pasi askush nuk e ka dëgjuar të ketë thënë ndonjë gjë në lidhje me ndonjë libër.

Çun trendy – Shih Mjaftist

Thesi i miellit – Përdoret për të karakterizuar metodën e një fushate elektorale të bazuar më së shumti te shpërndarja e ushqimeve bazë si miell, oriz, vaj vegjetal e makarona, te popullata e varfër në këmbim të votave. Është përdorur gjerësisht në vitet 2001, 2005, 2009 dhe 2013 nga shumë kandidatë biznesmenë nga e majta dhe nga e djathta.

Certifikatat – Metoda më e përhapur e manipulimeve zgjedhore deri në vitin 2005, e përdorur veçanërisht nga demokratët, por edhe nga socialistët. Çertifikatat e lindjes shërbenin si mjet identifikimi për shumë zgjedhje në Shqipëri. Metoda e manipulimit që identifikimi në listën e zgjedhësve të njerëzve që nuk votonin ose që gjendeshin jashtë Shqipërisë në ditën e zgjedhjeve, prodhimi i një çertifikate false në emër të votuesit të munguar ku vendosej fotografia e njeriut që do të hidhte fizikisht votën e rreme. Me marrëveshjen politike të vitit 2008, çertifikatat nuk u përdorën më si mjete identifikimi për zgjedhje dhe u zëvendësuan nga kartat e identitetit biometrike.

Laptopist – Një kandidat për politikan që disponon një kompjuter të lëvizshëm me të cilin realizon çudira propagandistike në kohë rekord. Në disa raste, këto lloj kandidatësh kanë arritur suksesin duke u bërë politikanë të nivelit të ulët, veçanërisht në Partinë Socialiste.

Xhaketat e vjetra – Njerëz që e kanë nisur karrierën politike që në vitet 1980, janë bërë milionerë, por sërish kanë mbetur katundarë dhe mbajnë të njëjtin stil veshjeje si në ditën e parë të punës.

Çorapet e bardha – Shih Xhaketat e vjetra.

Politika e vjetër – Shih Xhaketat e vjetra

Xhaketë e vjetër e kthyer mbrapsht – Një politikan shqiptar me karrierë të suksesshme që nga koha e Partisë së Punës që riprezantohet pas disa vitesh pushim si shpëtimtar me një ambalazhim të ri.

Fustan basmeje – Një politikane sot në moshë që e ka nisur karrierën politike në Partinë e Punës duke u paraqitur te eprori me fustan basmeje, në atë kohë, fustani më seksi i disponueshëm dhe edhe fustani më praktik për situata të caktuara.

Çizmet e lëkurës – Një politikane e re në moshë që u paraqit te partitë politike rreth viteve 2000 me bindjen për të bërë karrierë. Dallohej nga çizmet e lëkurës që vishte gjithmonë në rastet e mbledhjes së grupit të punës.

Ministër konviktor – Një numër ministrash (rreth 6 vetë njëkohësisht) që i përkisnin qeverisë Meta 3 rreth vitit 2002. Kishin për tipar të përbashkët faktin që vinin drejtpërsëdrejti nga fshati dhe jetonin në hotel Arbana – (sot Drejtoria e Përgjithshme e Policisë). Qëndruan vetëm pak

muaj në statusin e konviktorit të luksit pasi shpejt u bënë aq të pasur sa blenë shtëpi të parë, të dytë, të tretë, etj. Të paktën njëri prej tyre ndërtoi edhe një pallat të tërë pa leje në një oborr shkollë. **Vaji i ullirit** – Një politikan që udhëtoi jashtë Shqipërisë për herë të parë gjatë viteve '80-të dhe u përkujdes që të merrte një shishe me vaj ulliri me vete me mendimin se në Francë nuk ka të tillë. Megjithëse politikanë të tillë sot janë shumë të pasur, vesin e vajit të ullirit, (voj kome), nuk e kanë hequr ende. **Qeveri e vogël** – (*koncepti shqiptar*) Kur kryeministri ndihet i fuqishëm dhe i aftë të kontrollojë maxhorancën parlamentare pa probleme, krijon pak ministri dhe pak poste ministrash. Kjo që “filozofia” e Sali Berishës në vitin 2005, që u tolerua pas 2009 me krijimin e ministrive shtesë për të joshur aleatët. (*Koncepti Ndërkombëtar*) Kur qeveria beson se privati mund t'i bëjë punët më mirë, mbledh më pak taksa (dmth taksa të ulëta) dhe rrjedhimisht ka më pak shpenzime, duke kufizuar rolin e shtetit në disa shërbime bazë dhe pa shumë shërbime të mirëqënies shoqërore. **Qeveri e madhe** – (*Koncepti shqiptar*) Kur kryeministri e ndien veten të pafuqishëm në maxhorancën e vet parlamentare, krijon sa më shumë ministri të jetë e mundur për të patur sa më shumë ministra. Kulmi u arrit me qeverinë Meta 3, kur u krijuan mbi 20 e kusur poste ministrorë, ku disa ministra nuk kishin as zyra dhe as funksione, por kishin titullin ministër. Dritan Prifti që në atë kohë ministër i Energjetikës, një ish-agjenci që kishte për detyrë të hartonte strategjinë energjetike të vendit. Puna e tij më e madhe si ministër që një studim që tregonte se matur me kalori, elektriciteti që një burim energjie më e lirë se sa nafta në Shqipëri. E tillë pritet të jetë qeveria 2013-2017. (*Koncepti ndërkombëtar*) Kur qeveria beson se shteti duhet të jetë si një baba për të gjithë qytetarët, mbledh shumë taksa dhe kryen shumë funksione publike, përfshirë shërbime të mirëqënies shoqërore.

Metizmi – përkufizuar nga Koço Kokëdhima si situata në të cilën duhet të paguash zyrtarët e qeverisë për të përfituar atë që ligjërisht të takon. Është e ndryshme nga korrupsioni, ku duhet të paguash për të përfituar diçka që nuk të takon.

Vajisje – Sipas Sali Berishës, rryshfeti i bën mirë ekonomisë pasi është si vaj apo si graso, që ndihmon në mirëfunksionimin e administratës shtetërore.

Ministër pa portofol – Njeri kot që nuk duhet të bëhet asgjë ,por njëkohësisht duhet të bëhet diçka. Me raste njeriu më kot në një qeveri u quajt ministër për reformat, ministër informacioni, ministër i teknologjisë së informacionit, ministër koordinues dhe natyrisht, Ministër pa portofol. Kjo nuk do të thoshte në asnjë rast se ai nuk e kishte një portofol.

Katharc(s)is - neologjizëm në fushën e politikës i përdorur fillimisht nga politikanin Fatos Nano me qëllime propagandistike në fjalimet e gjata tipike të tij. Në analogji me

kuptimin fillestar të këtij termi që mbart idenë e pastrimit të brendshëm shpirtëror dhe mendor, ky term u riaktivizua prej tij për të kritikuar pushtetin e Ilir Metës dhe maninë e tij dhe të ndjekësve të tij pas parasë.

Kleptokraci – neologjizëm i përdorur fillimisht nga Sali Berisha me anë të të cilit kritikohej qeverisja e korruptuar e socialistëve gjatë mandateve të njëpasnjëshme të saj përkatësisht në vitet 1997-2005.

Mafiokraci – neologjizëm që i referohet një lloj sistemi të paligjshëm e të fshehtë, të përfshirë në sistemet demokratike ku pushteti është vënë në shërbim të mafies.

Dushku (Sistemi i). është një neologjizëm i përdorur fillimisht në periudhën e vitit 1996, periudhë në të cilën u bënë ndryshime në kodin zgjedhor të cilat e ndanin votën për kandidatin nga vota për partinë politike, duke krijuar kështu një lloj sistemi i cili bazohet në një numër të papërfillshëm votash por që gjithsesi prodhojnë shumë deputetë.

Komunist blu : neologjizëm që i referohet kryesisht nëpunësve të Partisë Demokratike të cilët vijnë nga një karrierë provinciale e niveleve poshtë mesatares gjatë regjimit komunist e që gjithsesi kanë ofiqe edhe në Partinë Demokratike.

Horr dhe lavire bulevardi – neologjizma kuptimore të përdorur nga Sali Berisha për t'iu referuar Presidentit të Republikës dhe Prokurores së Përgjithshme, me anë të të cilave dënonte qëndrimin e mbajtur nga ana e tyre në lidhje me ngjarjet e 21 janarit 2011.

Kokëpalare – term i përdorur nga Ilir Meta para protestave të 11 janarit 2011 për të karakterizuar çdo njeri të thjeshtë e përgjithësisht të varfër, që merr pjesë në protesta të opozitës pa patur ambicie politike.

Neoblokmen *etërit dhe bijtë– neologjizëm i përdorur nga Sali Berisha dhe mbështetësit e tij të krahut të djathtë për të karakterizuar cilindo nga politikanët e Partisë Socialiste, prindërit a të afërmit e të cilit, kanë qënë funksionarë të regjimit komunist.

Ndjese pastë – neologjizëm i krijuar nga Edi Rama për të cilësuar fundin e dëshiruar për Ilir Metën ku synohej mohimi i figurës së tij me anë të retorikës e cila synonte rënien nga pushteti të qeverisjes së të djathtëve.

Listë me neologjizma në shqipe në leksikon politik:

Acquis communautaire	Autoritarizëm
Akreditim	Autoritarizëm
Aktivizëm	Azilkërkues
Aktor (politik)	Berishizëm
Albanistan	Bllokmen
Asociim	Blog
Auditim	Bunkerizim

Census	Komunitar
Centralizim	Konsensus
Çiljetizim	Kontraktual/e
Dakortësi	Korrupsion
Deglobalizim	Kredibilitet
De-institucionalizimi	Krim i organizuar
Dekomunistizim	Krizë legjitimiteti
Delegjitimim	Kumulim
Depolitizim	Liberalizim
Dhjetorist	Lider Lidership
Dialog politik	Lustracion
Dialog social	Margjinalizim
Diskriminim fiskal	Marrëveshje kuadër
Draft	Mikroshtet
Drogokraci	Mocion mosbesimi
Dumping	Nanoist
De-edramaizmi	Nanoizëm
Dumping social	Narkotrafikant
Edvinizmi	Negociim
Ekonomi informale	Neoblokmen
Ekonomi tregu	Neoenverist
Establishment	Neokomunizëm
Europeanizëm	Neoliberalizëm
Europeanizim	Nepotizëm
Eurostat	Ombudsman
Evazion fiskal	Opinion publik
Facebook	Palë kontraktuese
Fleksikurizmi	Pandëshkueshmëri
Fondacion	Parakrizë
Formalizëm	Paramilitar
Freshist	Parlamentarizëm
Funksionalizëm	Partneritet për paqe
Genocidbërës	Parti-shtet
Globalizëm	Pëdëist
Greqizim	Performancë
Grup terrorist	Privatizim
Hetim proaktiv	Pronësi intelektuale
Ilegjitimim	Pushtetmbajtës
Integritet (moral)	Pushtetomani
Intimidim	Ramizist
Klientelizëm	Ramizmi
Kompensim	Rekrutim
Komunistizim	Rezident/rezidencë

Rrjet transkombëtar
Serbizim
Shoqatë jofitimprurëse
Shoqëri civile
Shoqëri civile Shtet
i së drejtës Shtet
ligjor
Solidaritet/solidarësi
Stabilitet
Stabilizim-asociim
Standartizim
Stanistan
Subvencion
Supershtet
Taksapagues
Trafikim
Transparencë
Tweeter Unitarizëm
Vakancë
Vend kandidat Vullnetarizëm Zonja e parë

Kompozimi me anë të formanteve (të cilat quhen pseudo- morfema ose thujse-morfema). Këto elemente mundësojnë formimin e një sërë njësisish leksikore të cilat gjejnë përdorim në fushën e leksikut politik. Për **shqipen** ky lloj kompozimi është gjithashtu i pranishëm, por gjithsesi jo aq produktiv: *meritokraci, mikroshtet, neokomunist, neoliberal, neodiktaturë, paramilitar, paraelektoral, pushtetomani, shkërdhatokraci, kakokraci, diktokraci, demokaturë, ekosocializëm, epistemokraci, hiperpresidencë, ideokraci, kleptokraci superterrorizëm, paraamerikanizëm, ambasadoro-kraci, biodiversitet, transkombëtar, transkufitar, multikulturalizëm, multilateralizëm, multipolaritet, unipolaritet, bilateral*.

Përdorimi i elementeve dijetare nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja shfaqin një produktivitet sipas të cilit një shumicë e madhe fjalësh të reja krijohen duke u përzier mes tyre. Siç vihet re, formanti – *cratie* (i popullit) shërben për të formuar një numër të madh neologjizmesh.

Përveç privilegjit unik të komunikimit dhe përcjelljes së mesazheve, çka e bën shoqërinë njerëzore atë që është sot, gjithkush është i ndërgjegjshëm edhe për karakterin manipulues e negativ që mund të ketë gjuha, me interpretimin që gjithsecili prej nesh i bën asaj në momente e rrethana të ndryshme. Noam Chomsky për këtë shprehet: “Gjuha është një proces i lirë krijimtarië, ligjet dhe parimet e saj janë të përcaktuara, por mënyra sesi përdoren parimet e krijimit të saj është e lirë dhe me një larmi të pafund. Edhe interpretimi dhe përdorimi i fjalëve përfshin një proces krijimtarië të lirë”. E padiskutueshme për rolin që ka në të gjitha fushat e jetës, gjuha përbën një faktor edhe më kyç në lëmin e politikës, ndërkohë që kjo e fundit është “benzina që ushqen motorrin

e botës”. Me miliona njerëz në botë ndikohen nga fjalët e deklaratat që bëhen prej udhëheqësve të tyre për një çështje apo për një tjetër. “Gjuha është gjaku që mban gjallë politikën. Betejat për pushtet politik dhe legjitimizimi i politikave e autoriteteve politike ndodh së pari përmes ligjërimit dhe përfaqësimit verbal. Pushteti mund të ushtrohet ose nëpërmjet imponimit/ndëshkimit, ose nëpërmjet asaj që një komentues amerikan, Walter Lippman e përkufizoi në vitet ’30-të si “fabrikimi i pranimit”. Kryesisht jo në gjendje dhe me shpresën se nuk kanë vullnetin për të ndëshkuar autoritetet politike, në sisteme qeverisjeje të ashtuquajtura demokratike, ka shpesh nevojë për “fabrikimin e miratimit” me qëllim për të zbatuar programet e tyre. *E thënë më thjesht, “fabrikimi i miratimit” është një proces indoktrinimi ideologjik me bazë gjuhësore.* Edhe pse duket si jashtë mase gjithëpërfshirës, ky është një proces mjaft i hollë e i pakapshëm. Ligjërimit përmban vetë hipotezën sipas së cilës, elementet, të cilave u referohet, janë të ditura dhe të rregulluara në kontekstin ku përdoren. Kjo nënkupton se gjuha politike përmban bazën, nëpërmjet së cilës konceptohet, përkufizohet, kuptohet e më pas veprohet. Zakonisht kjo prodhon “fabrikimin e miratimit”. (togfjaleshi në thonjëza është marrë në një material për gjuhën dhe politikën). Të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm se çfarë mund të bëjë një politikan me fjalën e duhur në momentin e duhur. Ai mund t’u japë udhë momenteve historike si rrëzimit të një qeverie, një proteste apo mbështetjeje mbarë popullore etj. Fjalët që zgjedh të thuash janë po aq të rëndësishme sa edhe vendimi për të folur. Në një përkufizim të mundshëm të atij që quhet ligjërimit politik, studiuesit shpjegojnë se “kuptimi i ligjërimit politik nuk mbetet i kufizuar në fushën institucionale të politikës (p.sh, ligjërimit parlamentar, fushatat zgjedhore, programet e partive, fjalimet, etj.), por është i hapur ndaj të gjitha manifestimeve linguistike që konsiderohen politike me argumente bindëse. Në analizën që i bën gjuhës në lidhje me politikën, George Lakoff thotë se gjuha vjen gjithnjë me atë që quhet “strukturim”. Në vazhdim, ai sqaron se “Çdo fjalë përkon me një kornizë konceptimi. Nëse kemi një fjalë si “revoltë”, që nënkupton një popullsi që qeveriset në mënyrë të padrejtë e cila kërkon të hedhë poshtë nga pushteti drejtuesit e tyre, kjo është një kornizë. Nëse më tej, shtoni fjalën “zgjedhës” përpara “revoltë” marrim një kuptim metaforik që nënkupton se zgjedhësit janë pjesa e shtypur e popullsisë, guvernatori është sundimtari shtypës, se ata e kanë rrëzuar nga pushteti dhe kjo është diçka e mirë e gjithçka tani shkon siç duhet. E gjithë kjo rrjedh kur lexon “revolta e zgjedhësve”. *Në fakt, shumë njerëz këtë e lexojnë, por nuk e vënë re.*

Të gjithë bien dakord në një mendim: gjuha në politikë është tepër e ashpër me epitete të jashtëzakonshme. Adresimi i një lumi akuzash kundër moralit, dinjitetit apo edhe

familjarëve të njëri-tjetrit, është bërë gjë e zakonshme, konsiderohet paksa si pjesë e punës dhe e zanatit të politikanit. Përdorimi i një fjalori të rëndë, akuzues në rrafshin etik si trafikant, antikombëtar, mafioz, hajdut, i korruptuar, bllokmen, drogaxhi etj, është mishëruar në trupin e secilit politikan. Përse ndodhin këto devianca (shkarje etike) drejt një të foluri që përbën agresion verbal ndaj tjetrit? Nuk i drejtohet shpesh politikasi politikanit: “Zotëri, më falni ju lutem, t’ju them se nuk e keni të drejtë mendimin tuaj!”, por ia përmbledh me fjalët: “Ik ore trafikant se e di unë përse llomotit kështu ti!”. Ky lloj fjalori banal hyri në Shqipëri qysh në fillimin e viteve ’90-të, si fjalori ku aktorët politikë përdorin kryesisht **metafora gjuhësore** të marra nga gjuha e përdorur mes prokurorit dhe fajtorit, kriminelit. **Pra, gjuha politike kthehet në një simbolikë të ardhur nga fusha e akuzave me nëntekst ligjor pas.** Dikur shenjohej në këtë mënyrë, sepse simbolikisht konsideroheshin ish-komunistët me peshë faji të së kaluarës, çka mund t’i përballte, sipas palës kundërshtare, edhe me kuadrin e ri ligjor. Njëra palë e identifikonte veten me prokurorin në sallën e gjyqit, tjetra kundërshtare vihej në rolin e genocidistit. Kjo gjuhë u kthye në një shkëmbim rolesh mes artikulesve të saj sepse pas ’97-ës ndodh e kundërta. “Pasi një lloj gjuhe hyn në përdorim, ajo ka prirjen për t’u riprodhuar pafundësisht sepse njëri kod gjuhësor sjell tjetrin, që i vjen për shtat atij⁴⁶. Mbi të gjitha gjuha e sharjeve reciproke në kriza politike përbën një mekanizëm strukturues ndaj elektorateve përkatës, pra i ndan elektoratet e secilës parti me mure virtuale. Pra, efektet paradoksalisht kthehen në rregulluese ,ndarëse, rreshtuese mbi votuesit e militantët politikë, ashtu sikurse ka efekte përjashtuese mbi ata që duan të bëhen rishtarë në politikë. Fjalori etik fyes kryen edhe funksionin e njëfarë monopolizimi të politikës prej aktorëve të brendashkruar saj, duke përjashtuar individët që s’mund të përballojnë dot ofendimin në publik. Sot në kushtet e zhvleftësimit të fjalës – për t’u dëgjuar, për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve, ka nevojë që fjala të shkojë drejt ekstremeve të fundit, ose duke ngritur zërin, ose duke i dhënë artificialisht kuptime të tejskajshme fjalorit, duke bërë skandal. Gjuha e politikës po bëhet një materie gjithnjë e më pak e qëndrueshme, spostimet e befta, ndyshimet diametrale, kundërthëniet dhe kontradiktat konceptuale, inkoherenca totale e zyrtarëve të lartë të vendit, janë tipari përbashkues i racës së liderve tanë⁴⁷.

⁴⁶ Profesor A. Fuga në artikullin “Ku po shkon gjuha politike” konstaton se fyerjet politike janë rrjedhojë e kalimit të pragut psikologjik dhe etik në ndërgjegjen e individit, duke e “trashur cipën” në mënyrë metodike e sistemike. Pas pragut fjalët fyese kanë më pak peshë mbi ndërgjegjen e kujtdo, sepse të përdorura me një intensitet të madh ato e humbasin vlerën e tyre, janë pa ndikim tek të tjerët që i dëgjojnë, veshi mësohet me to e kështu ndodh procesi i kthimit të tyre në një fjalor rutinë.

⁴⁷ Skënder Minxhozi, revista “Java”, 2012

Por, gjuha politike nuk përmbillet me deri sa kemi përmendur më lart. Jo më pak e rëndësishme është edhe gjuha e shkresave, dokumenteve zyrtare, e ligjeve, vendimeve, rregullave, urdhëresave, lutjeve, telegrameve, lejeve e përshëndetjeve zyrtare⁴⁸. Leksiku i tyre është më i kufizuar, më i përmbajtur në raport me leksikun e politikanëve në auditor, drejtuar popullit të thjeshtë. Fjalët mbartin gjithmonë një kuptim parësor e të drejtpërdrejtë, pa figura letrare apo përdorime të figurshme të fjalëve. Parapëlqehen fjalitë e gjata me pjesë të nënrenditura e grupe fjalësh që përsëriten dendur, të cilat janë bërë veçanti e letrave, si: duke marrë parasysh se, në bazë të ligjit, sipas nenit, ju vëmë në dijeni, nën emrin tim personal, dora vetë (D.V), kam nderin t’ju parashtoj, në përgjigje të, me propozim të, me nderime, me respekt, shpresoj se, etj. Këtu duket sikur politikani me artin e tij të joshjes, të bën për vete, shpalos anën tjetër të medaljes: paraqitja shpaloset më funksionale, më e përcaktuar, më e ngurosur. Megjithatë kohët e fundit po vihen re çlirime tek disa fjalë, shprehje e ndërtime të vjetruara te cilat po zhdërvjelltësohen, po zëvendësohen. Karakteristike e shkresave apo letrave “parlamentare” e “zyrtare” do të veçonim:

1.Përdorimi i emrave foljorë në vend të foljeve si : punim, hapje, distancim, zhvillim, shfuqizim etj.

2.Përdorimi i togjeve të ngurosur si : ushtron ndikim për ndikon, hyn në lidhje për lidhet etj.

3.Foljet pësore – vetvetore e ato pavetore, si : dihet, duhet, përkufizohet, lejohet, shfuqizohet, merret parasysh etj.

4.Ndajfoljet që mbarojnë me prapashtesën -isht, si : qëllimisht, rregullisht, parimisht, zyrtarisht etj.

3. Më të shpeshta krahasuar me fjalimet elektorale apo debatet në të hapur paraqiten përdorimet e shprehjeve të huazuara apo të papërkthyer si: ad hoc – (latinisht)për këtë qëllim, en bloc – në tërësi (latinisht), apo shprehjeve – huazime ndërkombëtarizma, kalket etj.

Kalket frazeologjike janë shprehje të qëndrueshme, që nga gjuhë të tjera kanë hyrë dhe përdoren në gjuhën shqipe në trajtë të përkthyer⁴⁹. Ato diferencohen si më poshtë:

⁴⁸ I gjithë ky paragraf do të lidhej me të ashtuquajturën gjuhë diplomatike apo administrativo – juridike, gjuha e shkëputur nga auditori, masa e gjerë, por jo më pak e rëndësishme.

⁴⁹ A. Ballhysa, “ Formim Gjuhësor” I, Sejko, f.108.

➤ Me burim folklorik, historik etj, si: fitore si e Pirros (fitore me humbje të mëdha e cila s'lakmohet); lufton me mullinj të erës (harxhon forcat, fuqitë në diçka pa sukses apo të rrezikshme); veza e Kolombit (zgjidhje e mençur dhe e guximshme); syri i Ciklopit (i verbuar); furtunë në gotën e ujit (shumë zhurmë për asgjë); mjet që justifikon qëllimin (kryesisht e përdorur në fjalimet hitleriane për dhunë shfarrosëse të tij ndaj rracës ariane); njeriu me shenjë (politikani Gorbaçov); Anjshtajni i ri (njeri i zgjuar).

➤ Me prejardhje mitologjike si : Kali i Trojës (nënkupton zgjidhje dinake për diçka); kutia e Pandorës (burim fatkeqësish të mëdha); mollë sherri (preteksti për lindjen e një sherri); thembra e Akilit (pika e dobët e dikujt).

➤ Me burim biblik si : alfa e omega (thelbi i diçkaje); buka e përditshme (mjete i jetesës); i lau duart (s'mban përgjegjësi); Kulla Babelit (ngatërresë e madhe ku i pari s'e merr vesh të dytin); filli i Arianës (çështje e koklavitur, labirint); parabolat e Jezuit e porositë e Muhametit, Testamenti i Vjetër; mollë e ndaluar (diçka që dëshirohet, por e ndaluar); kopshti i Edenit (parajsa tokësore); Hossana Barabba (historia biblike e Mesisë); arnë e re mbi rrobë të vjetër (diçka që s'përputhet, që krijon disharmoni); Odisenë (kalimi i një kohe të gjatë); vija e finishit (përfundimi i diçkaje); gjethe fiku (diçka e përdorur për të fshehur diçka).

Të tjerë kalke frazeologjike gjuhësore të përkthyer nga gjuha e origjinës, si: ide fikse; kartë e bardhë; ngjyrë lokale; vë pikat mbi "i"; rreth vicioz; lexoj midis rreshtave; hedh hije; buzëqeshje protokollare; pika ime më e fortë (dobët); roli i të tretit; Genjeshtra e Madhe; me libër shtëpie; pikë; nga lindja në vdekje; arena politike; teoritë e konspiracionit; tra ekuilibri; tolerancë zero; ikonë bukurie; agjendë zyrtare; vulë sekrete; gjuajtje e bukur; luftë politike; rol kyç; prova e zjarrit; sot e gjithë ditën; dele e zezë; çarja e madhe; kopje origjinale; i lirë si ajri; e shkriu akullin; fushë e minuar; kambanat e alarmit; vëllezër siamezë; si një luftë macja me miun; bukën time; patate e nxehtë (çështje e pazgjidhur); ligji i xhunglës; dora e djallit; rrethi i 9-të (Dante); Bota e Re; qershia mbi tortë; shpirti binjak; vuri maskën; shkollë jete; alarmi i kuq i ligjit; fuqia e pushtetit (ital. il potere del potere); Njeriu i Ri; Vëllai i Madh (Big Brother); rol kyç; xhiron e botës; Luftë e Ftohtë; burrë shteti (ital. capo dello stato); spiralja e krizës; syri i ciklonit; lolot e oborrit; sytë e mendjes; muzën e patrazuar; mjet që justifikon qëllimin; miq të nderit (nga it. ospiti d'onore); mollë e kalbur (it. mela marcia); gjigandi i Neandertalit; plan rezervë etj.

Huazimet frazeologjike janë shprehje që përdoren të papërkthyer në gjuhën shqipe, pra, ruajnë të njëjtën përbërje fonetike me gjuhët origjinare nga janë marrë⁵⁰. Burimet nga janë marrë këto huazime shumë të parapëlqyera në leksikun e politikës, janë prej disa gjuhëve të ndryshme, si :

- I. Latinishtja, si: alter ego (një tjetër si vetja); alma mater (nëna jetëdhënëse, shkolla e lartë); aurea mediocritas (e mesmja e artë); casus belli (shkak lufte); curriculum vitae (jetëshkrim, biografi); honoris causa (në shenjë nderi); modus vivendi (mënyrë jetese, veprimi); primus inter pares (i pari mes të barabartëve); pompa magna; status quo; a priori etj.
- II. Frëngjishtja, si: lettre morte (diçka e perealizuar apo ngelur përgjysmë); carte blanche (letër e bardhë, liri e plotë veprimi); fait accompli (fakt i kryer); demode' etj.
- III. Nga anglishtja, si : happy end (fund i lumtur); step by step (hap pas hapi, gradualisht); èait and see (do rrojmë e do shohim); knock out (hedh poshtë, përgenjeshtror); silent consent (miratim i heshtur); strange mayor (njeri i rëndësishëm); personality factor (në kuptimin e një kushti për të vepruar); ready – made (e gatshme); go on (thirrje për kushtrim, për veprim) etj.
- IV. Nga gjermanishtja, si: Blick krig (luftë rrufe); Main Camph (lufta ime) etj.
- V. Nga italishtja, si: eppur si muove (e, megjithatë, lëviz); salto mortale (hedhje vdekjeprurëse, hap i dëshpëruar); colpo di stato (grusht shteti); al sangue (të gjallë, të freskët); bel colpo (goditje e bukur, nishan); bella Italia (vend tërheqës); ala fine (si rrjedhim, si konkluzion) etj.

Gjuha e politikanëve, veçanërisht shkrimet e tyre, midis të tjerash shquhen edhe për frazeologji të pasur e mjaft funksionale.

Për nga shpeshësia e përdorimit, frazeologjia në shkrimet politike vjen fill pas asaj artistike. Si edhe në letërsinë artistike, frazeologjia në këtë lëmë vjen e ndërthurur me elemente krahinore apo etnografike, me nuanca idiolektesh etj.

Përveç ngjyrimet emocionues, këto njësi aktualizojnë dhe “lokalizojnë” dukuritë, nocionet, duke veshur një përmbajtje krejt të re në një kontekst të ri, më të gjerë apo më të specifikuar.

⁵⁰ A. Ballhysa, “ Formim Gjuhësor” I, Sejko, f.109.

Risia që kërkon të përcjellë ky punim, lidhur me gjuhën e politikës, qëndron në pohimin se edhe kjo “gjuhë” është e aftë të “thyejë” kufijtë stilistikë të letërsisë artistike dhe të dijë të “huazojë mirëfilli” njësi të ngurta, njësi tradicionale.

Pra, punimi synon të paraqesë e të mbështesë idenë se: Frazologjia, përtej kufijve tradicionalë, vjen në shërbim, madje deri në shterim, edhe të shkrimeve që si natyrë të tyre s’e kanë pasur traditë frazeologjinë.

Politikanët me “gjuhën” e tyre kanë arritur deri aty sa këto njësi t’i përpunojnë e të ndërhyjnë thellë, madje edhe duke ua shpërbërë edhe strukturën e moçme që kanë pasur.

Këto karakteristika dhe të tjera do të jenë objekt i trajtesës sonë e cila e vjel materialin nga gjuha e politikës e ditëve të sotme dhe na jep jo vetëm të dhëna se çfarë ka ndodhur e po ndodh me këtë “lloj” gjuhe të veçantë, por synon edhe një përfundim, përmendur më lart, që vjen nga krahasimi i këtij përdorimi tradicionalisht.

Është i njohur fakti se frazeologjia, si pjesë përbërëse e sistemit leksikor të një gjuhe, përmban në vetvete edhe një akt shenjimi dhe, si e tillë në thelb ajo përbën edhe një akt njohjeje.

Duke qenë njësi e prodhuar prej kombinimit (i nxitur prej përzgjedhjes individuale të përdoruesit të gjuhës) ajo mbart jo vetëm subjektivitet, por njëkohësisht, edhe elemente të kontekstit (faktorët: situatë, raport shoqëror, qëndrim emocional etj.).

Pikërisht, nën këtë prizëm mund të pohohet se “gjuha” e veçantë e politikanëve, sidomos shkrimet e tyre midis tjerash shquhen edhe për përdorimin e një frazeologjie të pasur e mjaft funksionale. Nga ana tjetër shpeshësia e përdorimit të njësive frazeologjike, sipas studimit e matjeve tona,⁵¹ do të mund të renditej në një shkallë mjaft të lartë, madje fill pas stilit të letërsisë artistike. Këtu si dhe në funksionin e sipërpërmendur frazeologjia del e ndërthurur me elemente krahinore a etnike, me hijëza idiolektesh etj.

Tjetër cilësi e këtyre njësive leksikore është “aktualizimi” dhe “lokalizimi” që u bëjnë ato dukurive, nocioneve, duke veshur për këtë qëllim një përmbajtje krejt të re të përdorur në një kontekst të ri, më të gjerë ose më të ngushtuar.

E reja që kërkon të nxjerrë në pah ky punim (lidhur me gjuhën e politikës) qëndron në faktin se edhe kjo “gjuhë” është e aftë të “thyejë” kufijtë stilistikë të letërsisë artistike dhe se ajo di të “huazojë mirëfilli” njësi të ngurta, njësi tradicionale, njësi që fshehin e

⁵¹ Materiali i pasur që kemi në dispozicion është gjetur e mbledhur në shtypin e përditshëm dhe pjesërisht nga vepra më të fundit të disa politikanëve shqiptarë, etj.

mbartin në vetvete aromën e gjuhës mëmë si dhe përvojat vetjake të bartësve heterogjenë të kësaj “gjuhe”.

Pra, punimi synon të paraqesë e të mbështesë idenë se: Frazeologjia, përtej kufijve tradicionalë, vjen në shërbim edhe të përdorimeve (raportet, fjalimet, artikujt e politikanëve etj.), që si natyrë të vetën nuk e kanë pasur përdorimin e frazeologjizmave, dhe aq më pak përpunimin e tyre.

Politikanët me “gjuhën” e tyre kanë arritur deri aty sa këto njësi t’i përpunojnë e madje, edhe t’ua shpërbëjnë edhe strukturën e moçme; fusha semantike-sintaksore e tyre zgjerohet tej mase gjë që flet për më shumë liri e zhdërvjelltësi stilistikore dhe, për rrjedhojë edhe për aftësi më të forta gjuhësore e komunikuese: *“Ai edhe tri ditë është kryeministër [...] ; I thotë njëherë e mirë Sali Berishës: ‘Ta gëzosh pensionin sepse ne do të ecim më shpejt. Sepse ne nuk ngopemi më me lugën bosh. Nuk ngopemi më me premtime boshe!’ I. Meta, 19 qershor 2013, Lushnje.*

Frazeologjia në gjuhën e politikanëve vjen mirëfilli e lidhur fort me “dukurinë e kontaminimit” (është rasti kur nga dy njësi frazeologjike formohet një e tërë).

“ Mbi atë vijë ecën më këmbë të gjitha historitë e mëparshme të dashurisë a të urrejtjes së Tiranës, me pushtues të ardhur nga matanë detit a nga mbrapa diellit...” (Kurban, 2011, f.427)

Çdo figurë politike (të paktën nga rastet e spikatura) shfaq pothuaj një sistem të njësuar frazeologjik si për nga sasia e përdorimit , ashtu dhe për nga cilësitë e veçanta të këtyre njësive. Po më dukshëm kjo shfaqet si cilësi e “gjuhës” së tyre në përdorimet e proverbave/ e fjalëve të urta. Madje, shpeshherë gjatë frazave të tyre për shkak të analogjisë, shndërrohet një pjesë e proverbit, ose ky i fundit shpërndahet në tërë tekstin si organizues i idesë së përgjithshme. *p.sh: F. Nano : “Ke tetë vjet që bën qejf me këtë të paaftin e gjatë, por përgatitu se pas 23 qershorit ke punë me mua. Mandatin tënd të tretë nuk ke për ta mbyllur dot të plotë, të siguroj për këtë...!”*

Berisha: “Ëndërr e një nate Vjene!” (referuar ëndërr e një nate vere) apo

B. Fino: “Po shkoi puna 70 -70, besoj se me votën time e meritoj kryeministër i stabilitetit apo jo? Kemi punuar bashkë.”

Berisha: “Baçi nuk lahet dot në ujërat e një lumi dy herë.”

Majko më 13 qershor 2013, në takim me familjet tiranase “Si i thonë, atë që ta bën krushqia, s’ta bën as fëmija. Kështu që keni dhënë nusen në dhëndurë që tani do të

qeverisin.” (rasti i fundit sjell në pah dy aforizma që shndërrohen në shtjellim të idesë së përgjithshme të frazës, si organizuese të saj).

Gjithçka që ndodh ka si kufi , si cak që nuk mund të kapërcehet, lidhjen me burimin popullor nga buron fjala e urtë, tematika e njëjtë duhet të mos humbasë.

Si elemente individualizues në këtë gjuhë përmendim: përdorimi i thirrorit (veta dytë njëjës), bashkërenditja që i jep intensitet të madh ligjëritimit, fjalët me kuptim figurativ (epiteti, metafora, krahasimi) si elemente tipizuese, togje me emra veprimi, lokucione librore si : “vë në korrent, bëj me dije, vë në dijeni, mbetem në lidhje” dhe shumë pak elemente bisedore, disa tipa fjalish (kryesisht ato të tipit habitore), ndërtime me dialog të brendshëm ku dashur pa dashur gëlojnë në sipërfaqe edhe ndërtime të qëndrueshme frazeologjike.

Nëpër literaturën nga vijnë shembujt e vjelë, është për t’u vënë në dukje se ato dalin kryesisht me strukturë togfjalëshi, madje herë- herë edhe fjalie (të thjeshtë ose të përbërë) me një larmishmëri ngjyrimore kryesisht e drejtuar drejt së ashtuquajturës “gjuhës së pjerrët”, gjuhës me tendencë. (A.Ballhysa, 2009).

Ato prodhohen dhe përdoren prej politikanëve si të gatshme, si parafabrikate dhe funksionojnë kryesisht (në këtë gjuhë)me vlerën e një fjale të vetme p.sh: fle mbi dafina, heq të zitë e ullirit, në gojë të ujkut, i fryj në vesh, i hedh benzinë, la armët, të paguash ujin sa frëngu pulën, e kapi mat,vegël qorre etj.

Rendi i fjalëve në pjesën më të madhe mbetet i ngulitur (s’ka ndërrim vendesh të fjalëve, s’mund të futen ndërmjet gjymtyrëve fjalë të tjera, s’mund të ndryshohet trajta e fjalës etj.). Të gjitha këto shprehje lidhen me një kontekst të caktuar dhe me vlera konotative të caktuara. Tipari i sipërpërmendur, siç do trajtohet dhe më poshtë, nuk është absolut.

Në pak raste tek disa shprehje të prejardhura, gjatë leksikalizimit të togfjalëshave të lirë që mbartin ngjyrim të figurshëm e vërejmë një lëvizje të tillë: “të shikojmë dritë në fund të tunelit, shpresa vdes e fundit”, duke e krahasuar me “dikush pa pakëz dritë në fund të tunelit dhe ulëriti nga gëzimi” (fjali të bashkërenditura), apo “PS-së i ka mbetur ora tek E.Hoxha”, (“55”, 2 tetor 2012) krahasuar me “Ora kishte mbetur po në vendin ku e kishin lënë të zotët”, “Sali Berishës po i rreshket pushteti nga duart/nën këmbë. Cilit fyell t’i biem?” (“Mapo”, 17 tetor 2012); “ S’e çon në mullirin e politikanit, por në mullirin e qytetarit”; “ qeveritarët e kapur me presh në duar, populli thotë ujku, Rama jo, gjurma.”

Nga ana sintaksore shprehjet frazeologjike funksionojnë si një gjymtyrë e vetme fjalie (kryefjalë, kallëzues, kundrinor etj.). Në krahasim me fjalët- sinonime gjeçjese ato përcjellin një shkallë më të lartë cilësimi, një forcë më të madhe theksimi e shprehësie. Strukturat togfjalëshore sipas kategorisë leksiko-gramatikore shfaqen të llojeve nga më të ndryshmet si p.sh: emër+ emër, emër+ mbiemër, folje+ emër, folje+ emër + mbiemër, folje + folje, folje+ ndajfolje, me vlera të kushtëzuara nga gjymtyra bosht të tilla si: emërore, foljore, mbiemërore, ndajfoljore. Jo më pak i përdorur del në pah edhe modeli i shprehjeve të ndërtuara me elementin krahasues *si* : “ si gjilpërat majë më majë”, “si macja me minë”, “si nata me ditën” etj. Një model sporadik është edhe ai ku njësia frazeologjike vetë shërben si përcaktor i një emri që ka pranë, duke u lidhur drejtpërsëdrejti me të p.sh.:

“Nga poshtë ngjitet përnatë zhurma e bretkosave që jetojnë në kënetën gjithë plehra.....e radhës në vitet e *gjej shesh e bëj përshesh*”. (Rama, 2011)

“.....me burimet materiale të një të jetuari *ku rafsha mos u vrafsha* prej aventurieri endacak” (po aty, fq. 49)

“.....mes shqiptarëve që kjo farë politike *pa din e pa iman*, ka imponuar përmes shembullit të mbrapshtë...” (po aty, fq. 26)

“...komisioni për *mustaqet e Celos*” (“Tema”, 3 maj 2013)

“...qeveri *me duar të pastra*, qeveria e Berishës”

Bregu: “*sultjash-qeveria*” e Ramës e do SHQUP-in si aset të memories komuniste” (“55”, 21 gusht 2013).

Rama gjatë përrurimit të një rruge në Tiranë: “Ne nuk hedhim asfalt ‘*më ka çu moma me la gojën*’”.

“Na lipset një president republike *pa ‘nishan’*” (“Gazeta shqiptare”, 23.08.2013).

Në disa raste ky lloj përcaktori shfaqet me një sifjali përcaktore : “.....dhe politika që s’le dy gurë bashkë për të siguruar mbretërimin me çdo mjet që gjithnjë justifikon qëllimin, e bëjnë...” (po aty, f. 436)

Shprehësia vjen edhe fuqizohet, duke u realizuar nëpërmjet përdorimit të dendur të disa togfjalëshave të qëndrueshëm frazeologjikë të modifikuar me disa rrugë:

a. Kur togfjalëshave të qëndrueshëm a frazeologjikë mund t’u shtohet apo mund t’u zëvendësohet një gjymtyrë e re, duke e aktualizuar përmbajtjen dhe duke forcuar figurshmërinë, rolin ndikues në tërësinë e frazës. Në këtë përftesë të re thelbi i kuptimit

të njësive frazeologjike nuk ndryshon, por vetëm sa ngjyroset me bojën e politikës, fiton nuanca konkretësie, shprehësie e bëhet më aktual. Procesi i modifikimit ose zberthimit të njësisë e ndryshon disi strukturën (gjë që e kemi vënë re edhe në proverba apo aforizma), por në çdo rast ruhet një nga gjymtyrët apo përbërësit e kuptimit të njësisë në njësinë e përftuar. Sipas modelit të fjalës së urtë: “qentë le të lehin, karvani të ecë përpara” është modifikuar ose krijuar për qëllime të forta shprehja : “*Qentë e Edit le të lehin, karvani ynë do të ecë përpara*”, etj.

Apo: “*ku shkel Berisha nuk ka ligj*” krahasuar me fjalën e urtë “ *ku shkel këmba e turkut nuk mbin bar*” (“Tema”, 22 gusht 2012). Artan Lame në korrik, 2005 në KQZ shprehet: “Nëse peshku qelbet nga koka, në PS është qelbur nga këmbët”; Si rast të veçantë kemi veçuar bashkëshoqërimin e një njësie frazeologjike me një “*contradictio in adiecto*”. (J. Thomai, 1991) .

Shembulli: Rama: “*duhet plan solidariteti. Shqipëria digjet nën dëborë, Saliu krihet para TV*”. Siç vihet re ndodhin dy procese të njëkohshme, edhe modifikimi, në këtë rast shtimi i një emri të përveçëm (Saliu) e nga ana tjetër një oksimoron (digjet nën dëborë), për të theksuar më tej gjendjen e emergjencës dhe pafytyrësinë e shtetarit.

b. Në rastet kur njësitë frazeologjike (të qëndrueshme, të vendosura në një tekst apo kontekst më të përvijuar e më të gjerë politik shpërbëhet me anë të shpjegimit apo plotësimit me gjymtyrë të tjera) për qëllime shprehëse. Ky zberthim i tillë aktualizon përmbajtjen politike, duke zbuluar më mirë e deri në fund vlerat (idiomatikën) e saj pasi figurshmëria e njësisë shpaloset në të gjithë frazën (e jo veç në një pjesë të saj), duke ndikuar në një ligjërim të gjallë, bindës, afektiv, ndikues në zemër e në arsye.

c. Po ashtu, në ligjërimet e politikanëve janë vërejtur edhe lindje njësish të reja, me ngjyime më të theksuara e më shprehëse (mbi bazën e një tipi frazeologjik strukturor-semantic të caktuar); kështu p.sh. mbi bazën se frazeologjisë “ *i vë bërrylat dikujt*” (gjymtyra bosht është fjala bërryla) lind togfjalëshi i qëndrueshëm “*lufta e bërrylave*” ,luftë për neutralizimin e kundërshtarëve me të shtyrë; “*Çorba e Dushkut, Dushku i Nanos*”, sipas modelit “*e bëri çorbë fare*” etj.

d. Në rastet e përdorimit të emrave të përveçëm identifikohen përdorime të cilat shtojnë diçka, ose identifikojnë (kur vetë njësia frazeologjike identifikon personin i cili ironizohet) përimitojnë kuptimisht si : Rama referuar figurës së I. Metës: “*Si (m)Meta pas këpucës*”; opinion “*Sebepi i SHQUP ka vënë në nishan (presidenti Nishani) edhe presidentin*” (“Gazeta Shqiptare”, 19 gusht 2013); “*Syri i keq i Don Ramës!*” (“RD”,

31 tetor 2012); “Presidenca ka marrë ‘nishan’ shumicën e re”(Mero Baze, “Tema,21 gusht 2013) etj.

Një rast tjetër ku luhet me emrat e përveçëm vjen si më poshtë: (Rama, 6 qershor, Kukës) “Sot, shkon dhe vjen lart e poshtë një personazh komik që nuk është tek Portokallia, por në krye të Ministrisë së Brendshme, një Flamur ‘pa bisht’ që tundet dhe shkundet nëpër Kukës, Tropojë dhe Has [...] pasi kanë mbetur në dorën e katragjyshit me antiplumb që dreqi e di pse ka kaq frikë...”

Olldashi: “Bëri mirë që u tërhoq nga paranoja e tij dymujore, sepse i kishte hipur Shalsit mbrapsht”. (“Koha Jonë”, 14 Janar 2011); Sali Berishës i ka hyrë lepuri në bark dhe kërkon me çdo kusht të mbrojë qenin e stanit...(24 maj 2011, “Koha”), duke nënkuptuar Ristanin si rojtar të votave të vjedhura.

Apo: “Doktori i bie Moore-it me kokë” (Doktori ka vendosur t’i bjerë prapë murit me kokë) Moore është drejtori për Evropën Qendrore e Jugore në departamentin amerikan të shtetit (Gazeta “Dita”, 29 maj 2013). Shkrimi synon të luajë me shqiptimin e mbiemrit të funksionarit evropian.

“Fushatë e pamoralshme në PD, duke pështyrë aty ku më parë ka lëpirë” (gazeta “Integrimi”, 19.7.2013); “ta vendosnit qeverinë me shpatulla pas murit”; “të bëhem edhe njëherë nuse, pa di unë si të nusëroj”; Meta:”Të mos i hedhin benzinë zjarrit” (“Telegraf”, 12 tetor 2012); të mos bëjë veshin e shurdhër shteti shurdh” (“ZP”, 26 shtator 2012); M. Bregu referuar Ramës: “Të kalosh nga qeni me pelush pehlivani”; “për të shumëfishuar apo për ta bërë qimen tra”, etj. (ku kjo e fundit pasqyron një nuancë përforcuese-saktësuese).

dh. Ndërtime interesante, gati të çuditshme paraqiten edhe :

- “Rrugët e mbetura rrugëve. Përrallat e Berishës i tregon edhe Luli” (“ZP”, 5 qershor 2013), ku njësia vjen si një përcaktor i paveçuar i gjymtyrës bosht, në rastin tonë rrugët. Apo: E.Rama, 20 qershor mitingu përmbyllës në Tiranë: “Edhe për ta mbyllur, se nuk po vazhdoj me rrugët se ju e dini këtë punën e rrugëve, rrugë, rrugë, rrugë mbeti Shqipëria rrugëve, mbetën edhe rrugët rrugëve, se mirë katragjyshi rrugëve e ka vendin, se s’ka rrugë tjetër për të. Votoni 44-ën që t’u heqë vizat me Amerikën thotë. Por sot shqiptarët e dinë se Amerika ia ka hequr (vizën) Saliut. (Në shembull luhet mirëfilli prej politikanit me fjalët rrugë dhe vizë); “Urat e Dibrës që kanë mbetur tek ura” (“ZP”, 17 gusht 2013)

Gjithashtu së fundmi në shtyp vjen edhe shprehja :“A është qelbur media nga koka?” (5 milion për të blerë këtë “peshkun” poshtë) referuar pazareve të këqija të Dollapit. Vini re lojën e fuqishme që përcjellin zëvendësimet e dy emrave në fuqi (“Dita”, 15 gusht 2013)

- Gërshetimi i dy njësisive, duke sjellë një të re më funksionale, më individualizuese dhe më të fuqishme: “ I tërheq nga zverku kërraba e pushtetit politik” e zberthyer në” i tërheq kërraba ” dhe “ tërheq prej zverku”, ku rasti sjell si gjymtyrë bosht foljen kallëzues tërheq; “s’e çon në mullirin e politikanit, por në mullirin e qytetarit”;

- “Thembra e Akilit”, një kalk frazeologjik që i përkthyer përcillet si krijim i ri edhe si “*thembra e pavarësisë*”. A.Duka i referohet figurës së Berishës me vargjet me të cilat rimerret e rikuptimësohet në satirë kallëzuesi foljor: “se ky që po ikën/ ka ikur nga mendja” (“Shqip.com”,18 gusht 2013)

Referuar kalkut frazeologjik në trajtë të përkthyer “Kali i Trojës” vjen edhe paraqitet “Nga kali i Trojës tek kali i detit” (“Shqip”, 22 gusht 2012 lidhur me çështjen e shitjes së një pjese deti Greqisë nga ana e qeverisë shqiptare) etj., apo njësia frazeologjike me vlerë ndajfoljore “*alla turka*” e “*alla frënga*” të pasqyrohet e modifikuar si: “sot në kulmin e fushatës elektorale, në kundërshtim me ligjin dhe ligjet ndërkombëtare, të privatizimit konkret me metoda *alla korleone*, kompanitë serioze u larguan.” (“K.Jonë”, 27.05.2005) ,“*Nën kupolën alla shekspiriane të Teatrit të Metropolit prezantoi sot librin e tij...*” (“Kurban”, f.433).

e. Kemi vënë re gjithashtu që gjatë krijimit të vargjeve frazeologjike të përfutuara nga përdorimet, si mbartëse të gjithë peshës kuptimore të frazës dalin në pah antiteza të fuqishme si : Rama në Bulqizë: “*kush e do pushtetin në krahë dhe familjen në këmbë adresa e vetme është numri 29*”; “*votoni për t’ia ngritur Krujës kokën që ia ka ulur barbaria dhe korrupsioni i tejskajshëm*” etj.

f. Do t’i konsideronim në rrugëtim e sipër drejt procesit të leksikalizimit (ngurtësimit) disa shembuj të vjelura nga shtypi i përditshëm ose fushatat e nxehta prag zgjedhore të tilla si: “ *nuk premtoj të bëj mrekullira se s’kam shkop magjik, por pas 23 qershorit do të keni një derë të hapur*”; “*ne mirditorët ia kemi prerë biletën Ramës vetëm vajtje për Paris*”, “*pas fiks 12 ditësh do e nxjerrin në pension gjyshin e Palokës*”; “*politika nuk ka bërë detyrat e shtëpisë*” ; V. Tavo: “*Doktor, doja të rikujtoj se në çdo rast kryeministër je ti, ose I. Meta pas zgjedhjeve...*” Berisha:” *Vangjel, i nxora kartonin e verdhë Genc Rulit unë për ndërhyrjet që të bëri*”

“Berisha merr statusin, Rama ngel për vjeshtë” (“K. Jonë”, 12 tetor 2012 apo *“Berisha për Vlorën ka mbetur në klasë”* (Gazeta “Shekulli”, 11 tetor 2012).

P. Majko në 21 qershor në miting përmbyllës shprehet: “Nëna Vlorë të ta them labçe i ka vdekur nëna ,do fitojmë”. Blushi më 17 qershor ,Elbasan: “Më kollaj shkon Saliu në hënë me not , sesa shkoj unë në PD. Më kollaj shkon Saliu me vrap deri në Kinë dhe kthehet, sesa shkoj unë në PD. Më kollaj bëhet Saliu eskimez ,sesa unë në PD. Dhe më kollaj shkon Saliu prapa diellit në 23 qershor, sesa shkoj unë në PD, sepse Saliu prapa diellit do të shkojë”.

Disa nga këto njësi frazeologjike të modifikuara ende nuk kanë arritur të bëhen fakte gjuhësore me përdorim të përgjithshëm, ende s’kanë pasqyrim nëpër fjalorë, por disa prej tyre duket se kanë prirje të përgjithësohen.

g. Politikanët luajnë edhe me emrat e përveçëm ,duke dashur të nxjerrin prej tyre njësi të reja, përftesa të reja, ngjyime negative referuar kundërshtarëve si : *“Topi ju hyri në qyp tani.....tani që ju iku topi”* (ironia e S. Berishës referuar figurës së shkëputur prej PD-së, B.Topi) apo *“referendumi është lojë pa top”*; *“PD ia kalon Topin FRD-së”*; *“sa qe T(topi në rrjetin tuaj i premtuat se do të bëhej president , faqeziut...reformimi i topit”*; *“u bë për top një antiedjathtë që më 23 qershor u trajtua si ‘lëkurë fiku’”* (“55”, dt.8 korrik 2013).

gj. Mbi bazën e një tipi frazeologjik strukturor-semantik të caktuar siç është ajo e idiomatikës së *“Shkoi dushk për gogla” me kuptimin: ‘shkoi për dhjam qeni, kot’* lindin njësitë e reja me ngjyime më të theksuara e të qëndrueshme si : *“epoka e republikës së Dushkëzimit”*, *“Dushku i madh”* apo edhe së fundmi *“parlamenti i Megadushkut”*, *“....Rama erdhi ne PS me vendosmërinë për t’i dhënë moral politikës, që politika t’i largohet goglave të Dushkut...”*. (“Shekulli”, 13 qershor 2009).

Të tjera ndërtime të pazakonta kanë për bazë madje, edhe disa lojëra fjalësh si: *“Të dalë nga qypi e të mos flasi si miza në qyp”* të mos e bëjë veshin e shurdhër shteti shurdh (ZP, 26 shtator 2012); *“presidencës i futën këmbët nën të njëjtën këpucë ligjore”* ; *“nuk po dëgjon fare nga veshi perëndimor”*.

Frazeologjia bëhet tipar i qëndrueshëm për diskursin e sotëm politik. Kjo për shkak se përmes përdorimit të frazeologjisë realizohet: thjeshtësia dhe kuptueshmëria më e mirë e një fjalimi politik, ose artikulli në këtë lëmë. Tipar i rëndësishëm i përdorimit të frazeologjisë në diskursin politik është rikuptimësimi dhe ringjyrimi i saj në kontekste të gjera politike. Duke u përdorur në kontekste të gjera politike, njësitë frazeologjike

fitojnë vlera të reja stilistike-emocionuese, ose marrin ngjyrim emocionues, p.sh: B.Klosi: *“kjo qeveri të kujton atë fjalën e urtë të grave keq me burrë, keq pa burrë më mirë të mos isha martuar kurrë”*.

Disa njësi frazeologjike mund të marrin edhe kuptim të ri ose nuanca të reja kuptimore, të ndryshme nga ato që kanë në situata të zakonshme, ndonjëherë aq sa mund të flitet për një njësi tjetër frazeologjike.

Diskursi i sotëm politik karakterizohet dhe nga përdorimi i mjaft frazeologjive dhe shprehjeve të papërkthyer, të marra nga gjuhë të ndryshme, si: “peshkon në ujëra të turbullta” - vepron fshehurazi, shfrytëzon gjendjen e pasigurt që është krijuar; *“lot krokodili”* – lot të gënjeshtërt që lëshon dikush gjoja nga dhembja a nga hidhërimi ose ankesa të shtira që bën dikush me qëllim që të mallëngjëjë dikë; *“kali i Trojës”* – armik i brendshëm që zhvillon veprimtari të fshehta; *“mesi i artë”* – pozicion a gjendje ku nuk ka rrezik të humbësh asgjë; *“shkrin akullin”* – shmang a lufton pengesat e vështirësitë që dalin për të ecur përpara.

Një prirje tjetër e frazeologjizmave në diskursin politik është prirja drejt ngjyrimit negativ që i jepet kontekstit ku përdoret. Si shembull ilustruam njësi frazeologjike te pamotivueshme: *“E majta nuk duhet llastuar, kur flet si e ëma e Zeqos në majë të thanës!”* (“RD”, 2 Maj 2013), ose *“Nuk i duhet bërë hosana së Majtës, pse klith se i paska ardhur koha të kthehet në pushtet”*.(RD, 2 Maj 2013), PS duke iu referuar figurës së Berishës: “Berisha po grindet me veten si plaku Mere” në “Sot”, 23.08.2013.

Mund të thuhet që frazeologjia në diskursin politik përbën një element dallues të fuqishëm me vlera të shumanshme, jo vetëm shprehëse-emocionuese, por edhe karakterizuese për vetë gjuhën politike, për karakterin popullor që ka fituar ajo, për stilin vetjak të politikanëve etj. Nga ana tjetër, frazeologjia e përpunuar e këtij diskursi ushtron ndikim të fuqishëm mbi gjuhën e folur. Si frazeologjia e përgjithshme, ashtu edhe ajo e veçantë për këtë diskurs, përbëjnë një të tërë, të gërshetuar me leksikun dhe strukturat sintaksore. Ajo nuk del si diçka e tepërt, jashtë kërkesave të vetë ligjëritimit politik, por edhe si prirje stilizuese. Kjo “gjuhë” është e aftë të “thyejë” kufijtë stilistikë të letërsisë artistike dhe të dijë të “huazojë mirëfilli” njësi të ngurta, njësi tradicionale. Mund të thuhet se përdorimi i frazeologjizmave është bërë gati-gati, tipar karakteristik i kësaj gjuhe, saqë mungesa e atij përdorimi po ndihet si dobësi e zbrazëti gjuhësore. Mu mbi këtë arsye edhe studimi i mëtejshëm i saj në këtë diskurs është një kërkesë e kohës, me vlera teorike e praktike. Studime të tilla do të jenë ndihmesë për punën e

veprimtarëve politikë dhe në të njëjtën kohë, për njohjen më të thellë të frazeologjisë sonë e të vlerave të gjithanshme në përdorimin e gjallë.

Kalket, huazimet frazeologjike, fjalët e urta dhe proverbat, si dhe thënie të njerëzve të shquar kanë fituar anonimat ,por kjo gjuhe duket sikur me përvetësimin kontekstor që u ben,ben te mundur te lindin per se dyti here,tashme ne nje kohe te re.Mendojme se sa here ato shqiptohen,aq here ato rikrijojne nje histori duke e humbur anonimat e tyre.Me fjale te tjera,metamorfozohen.

Kjo “metamorfoze” ka dalë nga “kullimi” i ngjarjeve historike, i ndodhive të fabulave e të legjendave, i mendimeve dhe i veprimeve të moralshme e të pamoralshme, i përfundimeve prekëse vetjake. Nën këto shprehje mbulohen histori të vërteta e të trilluara, që folësi i sotëm edhe mund të mos i dijë, por domethënien e tyre e merr me shprehjet që kanë mbijetuar. Përgjithësisht përmbajnë në vetvete a të shprehur gjuhësisht një krahasim, i cili i lidh me të tashmen, me situatën tonë ligjërimore, veçse krahasimi bëhet me një ngjarje, dukuri, veprim aq madhor, sa ka mbijetuar deri sot: (si) filli i Arianës, (si) shtyllat herkuliane, (si) një gjordiane, (si) ankthi i Abrahamit, (si) arka e Noes, (si) balonë prove, (si) barkë shpëtimi, (si) betimi i Hanibalit etj. Një pjesë e shprehjeve kanë trajtën e njësisive frazeologjike, të fjalëve të urta a janë proverbializuar: analogjia nuk është argument, i lëshoi (i dorëzoi, i hodhi, i uli) armët, artileri e rëndë, besimi lëviz malet etj.

Ato shfaqen edhe si kalke, edhe si huazime frazeologjike, si fakt i kryer - fr. fait accompli; balonë prove -fr. ballon d’essai; **rreth i mbyllur - lat. circulus citiosus**; bukë dhe lodra - lat. panem et circem; të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja - angl. to be or not to be, that is question; kusht i domosdoshëm -lat. conditio sine qua non; në mesin e gjërave -lat. in medias res; **mënyrë jetese -lat. modus vivendi**; tokë e panjohur - lat. terra incognita; argumenti i fundit- lat. ultima ratio etj. Edhe kur hasen në formën pa përkthim, ato ndihen se janë të kalkuara për shkak të natyrës leksiko-semantike të gjymtyrëve, të lidhjeve sintagmatike të tyre etj., si: patate përvëluese; **grusht i hekurt; gur prove; gjueti shtrigash; mollë e ndaluar**; heshtje që flet; hedh hije; ironia e fatit; bën ligjin; hyri në histori; **jakat e bardha; lot krokodili**; i vesh këmishën e forcës; **luftë e ftohtë; maja e ajsbergut; i bën apologjinë etj.**

Siç vë në dukje prof. Jani Thomai, kalket frazeologjike janë përkthyer fjalë për fjalë nga gjuha burimore dhe gjenden si të tilla në shumë gjuhë të botës, si: vras kohën: fr. tuer le temps; angl. kill time; lexoj midis rreshtave: angl. read between the lines; fr. lire entres

les lignes; avokati i djallit: lat. advocatus diaboli; angl. a devil's advocate; fr. l' avocat du diable; mollë sherri: gr. millon tis eridhos; lat. malum discordiae; angl. the apple of discord; fr. pomme de discorde; ital. pomo della discordia; mesi i artë: lat. aurea mediocritas; angl. the golden mean; frëngj. juste milieu etj.; mollë e ndaluar: angl. the forbidden fruit; fr. le fruit défendue; pomme défendue; fitore si e Pirros: angl. a Pyrrich victory; fr. la victoire a la Pyrrhus ; gjer. Pyrrhussieg; ital. la vittoria di Pirro; rus. Pirrova pobeda; spanj. victoria Pirrica etj.

Shumica e kalkeve frazeologjike kanë edhe tregues të përveçëm, si emra vendesh, personash **që nuk i përkasin botës shqiptare**, si kaloj Rubikonin; varka e Noes; filli i Arianës; **Roma nuk u bë (nuk u ndërtua) në një ditë; shumë zhurmë për asgjë**; edhe ti, Brut; ose Cezar, ose asgjë; dashuri platonike; ëndrra amerikane; **nyje gordiane; muri i Berlinit; feneri i Diogjenit etj.**

Prezenca biblike e tyre duket sikur shton fort bindjen e degjuesit, si: arnë e rë mbi rrobë të vjetër; **t'i japim Cezarit atë që është e Cezarit dhe Perëndisë atë që është e Perëndisë**; i gjethe (fletë) fiku; kulla e Babelit; është Babiloni; mollë e ndaluar; (u shit) për tridhjetë aspra; kolos me këmbë prej argjili; me kostumin e Adamit; mëkati vdekjeprurës; puthja e Judës; u hap sytë të verbëve; toka e premtuar; si shën Thomai mosbesues ; udha e kryqit; zë në shkretëtirë; **fali o zot se nuk dijnë ç'bëjnë; fali o zot, se nuk dijnë se ç'thonë etj.**

a) me prejardhje nga mitologjia, si: kali i Trojës; kutia e Pandorës; mollë sherri; nyja gordiane; shpata e Damolkeut; thembra e Akilit; i fundit i Mohikanëve; pëlhura e Penelopës; kalon midis Skillës dhe Karibdës; zjarri i Prometeut etj.

b) me burim nga historia, gjeografia etj., si: edhe ti, Brut; zbuloi Amerikën; fitore si e Pirros; veza e Kolombit; betimi i Hanibalit; Gjiri i Derrave; pas meje kiameti; ligj i pashkruar; te molla e kuqe; nyje gordiane; Hanibali është te porta; tryezë e rrumbullakët;

ç) me burim nga letërsia, folklori etj., si: furtunë në gotën e ujit; lufton me mullinjtë e erës; shumë zhurmë për asgjë; lamtumirë armë!; si dhelpira me rrushtë; fjalë, fjalë, fjalë; hija e Bankos; kalorës me fytyrë të vrerosur; mban gjarprin në gji; llampa e Aladinit; mali polli një mi; lufton me mullinjtë e erës; pjesa e luanit; qilimi fluturues; rrobat e reja të mbretit; nuk tur-bullon ujë etj.

c) me burim nga filozofia, politika etj., si: unë di se nuk di asgjë; Akili nuk e arrin kurrë breshkën; dashuri platonike; dyshoj, pra jam; ironia sokratike; qëllimi justifikon mjetin; një vend nën diell etj.

d) me burim nga shkencat të tjera, si nga matematika, mjekësia, fizika etj.; enë komunikuese; **i sjell në emërues të përbashkët; fushë e minuar**; helmetat blu; me pikë e me presje; **diplomacia e strucit; qendra e gravitetit (e rëndesës)**; rrip transmisioni; vrimë e zezë; e shumëzohet me zero; vë shenjën e barazimit; shkopi i dirigjentit; violinë e parë etj.

e) një pjesë e mirë e kalkeve frazeologjike kanë karakter thjesht gjuhësore dhe janë përkthyer nga gjuhët origjinare, si: thyej akullin; fakt i kryer; ide fikse; kartë e bardhë; ngjyra lokale; e vret me pambuk; vë pikat mbi “i”; lexoj midis rreshtave (radhëve); rreth vicioz; shpërthen një derë të hapur; hedh hije etj. Huazimet frazeologjike, siç dihet, janë shprehje që përdoren të papërkthyer në gjuhën shqipe, pra që ruajnë të njëjtën përbërje fonetike me gjuhët origjinare. Huazimet frazeologjike dhe shprehjet e tjera të papërkthyer janë marrë nga gjuhë të ndryshme, si:

f) latinishtja (të cilat përbëjnë dhe pjesën më të madhe të huazimeve në shqipe), si: ad augusta per augusta; ad hoc;; advo-catus diaboli; alter ego; alma mater; aperto libro; ars longa, vita brevis; aurea mediocritas; caput mortum; caput mundi; carpe diem; casus belli; castigat ridendo mores; circulus vitiosus; cogito ergo sum; consummatum est; de te fibula narratur; deus ex machina; divide et impera; dixi et animam (mean) salvavi; ecce homo; errare humanum est; exegi monumentum; ex nihilo nihil fit; extra nuros; fiat lux; flagrante delicto; fructus belli; fuit Troja; gutta cavat lapidem; hic sunt leones; homo homini lupus est; honoris causa; im-perum in impero; incredibile dictum; in hoc signo vinces; in medias res; intra muros; in vino veritas; lapsus calami; lato sensu; magister dixit; manus manum lavat; mea culpa; mirabile dictum; modus vivendi; nec plus ultra; nil sub sole novum; nosce te ipsum; o tempora, o mores; pater patria; post festum; primus inter pares; punctum saliens; quod scripsi, scripsi; quo vadis? ; spira, spera; summa cum laude; tabula rasa; urbi et orbi; etj.

g) frëngjishtja, si: a la carte; a l'eau de rose; a livre ouvert; amour propre; après nous le déluge; a propos des bottes; a tout prix; ballon d'essai; belles lettres; billet-doux; carte blanche; caveant consules; chair a canon; cherchez la femme; conseil du lion; couleur locale; danse macabre; e'lan vital; eminence grise; entre nous; fait accompli; fin de siècle; force majeure; homme d'état; homme de lettres; l'amor platonique; le roi est mort, vive le roi; letter morte ; mot a mot; nolens, volens; Paris vaut bien le mes-se; tel pere, tel fils tj.

h) anglishtja, si: big bang; big brother; never say never; fair play; fifty-fifty; five o'clock; happy end; kill with kindness; knock-down; mealting pot; much ado about

nothing; poor Yorick; safety first; self-made-man; step by step; time is money; wait and see etj.

i) ç) gjermanishtja, si: aussprechen was ist; befehl ist befehl; Blitz Krieg; Blut und Eisen (Eisen und Blut); Grosen un Gan-zen; Mehr Licht; Naht und Nebel; Shturm und Drang etj.

j) italishtja, si: colpo di stato; cuopri fuoco; dolce far niente; dulce in fundo; eppur si muove; guarda e passa; pezzo grosso; salto mortale etj.

k) greqishtja, si: dhakrojen jelasomen; Eureka!; gnoti seauton; kai sy teknon etj. Rrallë përdoren edhe shprehje të hua zuara nga spanjishtja, portugalishtja etj.

Ndër shprehjet që përdoren edhe si kalke, edhe si huazime mund të përmendim: balonë prove (balon d'essaie); në kalendat greke (ad calendae graecas); zaret u hodhën (alea jacta est); mesi i artë (aurea mediocritas); kartë e bardhë (carte blanche; carta bianca); rreth vicioz (circulus vitio-sus); këtu është Rodi , këtu kërcë (hic Rhodus, hic salta); o kohë, o moral (o tempora, omnes); zë në shkretëtirë (vox in deserto) dhe shumë të tjera.

Ato “çngurosen” dhe dalin në forma të reja; hyjnë në lidhje të ndryshme leksikore, “marrin frymë” më gjerë duke u vendosur në situata të reja ligjërimore dhe në kontekste të reja fjalësh. Cilat janë disa nga risitë që vihen re në përdorimin e shprehjeve të huzuara në gjuhën shqipe?

“Rrudhja” e strukturës së kalkeve frazeologjike është një dukuri e njohur dhe e përmendur nga autorë të ndryshëm. Rënia e një a e dy gjymtyrëve nga përbërja e shprehjeve të tilla sjell ndryshime të karakterit strukturor, duke dhënë mundësi të shumta që strukturat e mbetura të futen në lidhje të reja leksiko-sintak-sore. Në këtë mënyrë, trajta e rrëgjuar, sikurse trajta e plotë, e ruan kuptimin leksikor dhe ngjyrimin emocionues. Për shembull: fjalët i merr era, e shkruara mbetet nga latinishtja verba volant, scripta manent del në trajtën fjalët i merr era (verba volant), në kuptimin “s’kanë vlerë fjalët po qe se nuk shoqërohen me vepra; fjalët harrohen shpejt”. Por gjen të përdorur dhe vetëm pjesën e dytë e shkruara mbetet (scripta manent). Ndonjëherë rrudhja e këtyre njësive çon në ndërtime të tilla, të cilat, duke u përdorur gjatë në formë të reduktuar, fitojnë përdorim të pavarur dhe kufizojnë përdorimin e kalkeve frazeologjike dhe të shprehjeve të tjera burimore. Madje, ndonjë formim i tillë e shmang plotësisht nga përdorimi formën e plotë, siç është shprehja ana tjetër e medaljes nga frëngjishtja le revers de la medaille, e cila duhet të ketë ardhur nga reduktimi i trajtës së plotë çdo medalje ka dhe anën e saj të kundërt.

Kalket dhe huazimet frazeologjike dalin në lidhje të shumta leksiko-sintaksore, në mikrokontekste të ngushta ose në thënie të ndryshme. Edhe në këtë aspekt kemi risi me vlera të veçanta, që lidhen me përdorimin e frazeologjisë në ligjërim. Studimi i këtyre lidhjeve leksiko-sintaksore ose i fushës semantiko-sintaksore të kalke-ve dhe huazimeve, nuk është thjesht një çështje e formës, sepse kuptimi i tyre dhe vlerat stilistiko-emocioniese zbulohen më mirë në lidhje me fjalë të tjera në ligjërim. Kalket dhe huazimet frazeologjike, duke zgjeruar rrethin e lidhjeve leksikore me fjalë të tjera, zbulojnë deri në fund të gjitha vlerat kuptimore që kanë ose që mund t'i fitojnë në ligjërimin e shkruar, çka mund ta konkretizojmë me disa shembuj:

E përdor-trajte e shkurter+ folje

E bën- trajte e shkurter+ folje

E cilëson- trajte e shkurter+ folje

Është-folje gjysmëndihmese jam me vlerë lidhese ose kepujore

E quan- trajte e shkurter+ folje

E fut- **KALI I TROJËS; KALIN E TROJËS; KALË TROJE**(si emer emerore/kallezore+gjinore/rrjedhore ku emri Troje del ne funksion percaktori)

Hyn si-folje+lidhez menyrore

Luan rolin e-folje+emer+nyje e rases gjinore

Shpreson me anën e-folje+shprehje parafjalore e rases gjinore

E pranon si-tr.shkurter+folje+lidhez

Mbetet si-folje+lidhez

E ka si-tr.shkurter+folje+lidhez

Siç vihet re, vetëm kjo shprehje në gjuhën shqipe përbëhet nga 13 fjalë të rrethit leksikor, në varësi të të cilave ndryshon dhe formën e përdorimit.

Rrethi i lidhjeve mund të zgjerohet ose të ngushtohet në varësi të kuptimit leksikor dhe të vlerave që mbart shprehja e huazuar, si:

Shtyj ,lë , bëj- **NË (PËR NË) KALENDAT GREKE (KALENDAT GREKE)**

Realizoj-

Prodhoj-

Gjen-

Është-

Arrin - (NJË) MODUS VIVENDI Krijon-

Shërben-

U soll-

E bëri-

E paraqiti - FAIT ACCOMPLI E vë para-

Kalke me lidhje të gjera leksikore e sintaksore janë edhe kolonë e pestë “armik i fshehtë; njerëz që në fshehtësi zhvillojnë veprimtari kundër dikujt e diçkaje tjetër”; rreth vicioz “gjendje pa rrugëdalje; pozitë e vështirë”; shkopi i dirigjentit “mjet a mënyrë për të bindur a nënshtruar dikë a diçka”, etj. (shih për më shumë Aktet Vol I Nr 1 pp, PËRDORIMI I SHPREHJEVE TË HUAZUARA NË GJUHËN SHQIPE DHE HARTIMI I NJË FJALORI PËR TO , Ali JASHARI Universiteti “FAN S.NOLP”, KORÇË, SHQIPËRI)

Përmes rijetësimit ne aktualizim synohet të vendosen lidhje të ngushta mes kuptimit të kalkeve frazeologjike dhe situatës ligjërimore.

Shembujt tregojnë se aktualizimi mund të bëhet në të gjitha pozicionet e gjymtyrëve, pra aktualizuesit vihen para, në mes dhe pas gjymtyrëve të shprehjes së huazuar, për shembull: akulli i heshtjes u thye; kolona e pestë **shqiptare**; turbullon ujërat e kulluara; **të gjitha rrugët të çojnë në zgjedhje etj.**

Aktualizimet janë edhe gramatikore, duke ndryshuar e zgjeruar paradigmen e gjymtyrëve shenjuese (folje, emra), përkundër tiparit të qëndrueshmërisë së tyre, si tipar idiomatik. Në kohët tona tashmë edhe dihet se kush i ka përdorur i pari këto shprehje, domethënë ka etimologji të njohur e të datuar për këto përfitime. “Lufta psikologjike” është përdorur për herë të parë në 1964 nga gazetari gjerman L.Farrigo; shkallëzimi i luftës nga teoricieni i Pentagonit Kan më 1966, më vonë u përdor deshcallëzimi që tek ne disa herë doli edhe çkallëzimi; “perdja e hekurt” është e U. Çërçillit dhe “kolona e pestë” është e një gjenerali të Frankos, më 1938. Këto stereotipa të propagandës përbëjnë një mjet të mirëfilltë për luftën politike dhe nëse do të kishin një barazvlerëse shprehëse në gjuhën ku do të nevojiteshin ajo do të ishte e thatë, pa fuqinë dhe kontrollin që vendosin ato në gjuhë.

Me vlerë të theksuar kundërvënëse stilistike kemi zbuluar brenda tekstit të Ramës, duke formuar njëfarë antonimie ndërmjet fjalëve sinonime, si: fjalë-llafe, muhabet; kokë-

rradake; shëtit- sorrollaten; masë – turmë; fëmijë – kalama; treg – pazar etj. Për ta përmbledhur atë çka u tha më sipër: gjuha e një politikani është e tejmbushur me fjalë e shprehje të leksikut abstrakt (që në shkencë konsiderohen edhe si terma); përdoren fjalë të huaja e ndërkombëtare si edhe terma nga fusha e mjekësisë, filozofisë, gjuhësisë, teknikës; një vend të gjerë e zënë formimet brenda shqipes, si emrat foljorë abstraktë me prapashitesat –im, -je, -i, -ri, -si, etj.; fjalët e përbëra me vlerë terminologjike si : (vetëmohim, i kundërligjshëm, ballafaqim, konsolidim, abuzim, etj.); ndajfoljet me –isht, -llëk si: (botërisht, shkurtimisht, vendosmërisht, posaçërisht, tmerrësisht, pikërisht, mrekullisht, kaposhllëk, etj.); mbiemrat me –ar(e) si: (thesar, qëllimor, djallëzor, burimore, parimore, etj.). Vetëm për efekte të caktuara emocionuese të forta, me “përmbajtje të trashë” e “të rëndë” krijohen nga vetë politikanët e përdoren në situata të caktuara krahinorizmat, arkaizmat, dialektizmat, fjalë nga të folmet e zhargonet profesionale, epitete apo nofka të caktuara. Për shembull nga të gjithë politikanët e shfrytëzuar në literaturë Rama i thyen këto tabu në formën e një vetërrëfimi politik për qeverisjen e tij në krye të Tiranës për 11 vjet. Ai i shfrytëzon këto elemente jo si sistem, por duke shtrembëruar atë çka i lejohet e duke shpërdoruar atë çfarë si lejohet me qëllim denigrimin e partisë që ka përkundrejt, pa kufizim. Ai tejkalon kufirin duke përdorur edhe fjalë e shprehje “të rënda” me ngjyrimë të forta emocionuese si : rrumpallhanes, zgëqeve, robo, sllamet, politikë llurbëtirë, çervish, yrysh, llumi kutërbues, qokë formale, lehaqenj të zgjidhur, dërdëllit. Në çdo moment ti si lexues ose si dëgjues i këtyre shprehjeve (si recipient) të duket sikur “futesh” në botën që përcjellin këto fjalë e të duket sikur je përfshirë brenda kësaj tragjikomedie plotësisht. Gjuha e kësaj vepre dallohet për përdorimin e fjalëve të zgjedhura “kumbuese” dhe që “tingëllojnë bukur”. Një tipar tjetër të gjuhës së politikës do të rendisnim pasurinë e madhe me fjalë e shprehje të ligjërimeve popullore, pra, mbështetja fort në gjuhën e folur popullore. Hera – herës, termat ndërkombëtarë të përdorura pa kriter prej politikanëve (sidomos prej Nanos, Metës, Gjinushit) të çojnë vetvetiu në një “intelektualizëm në gjuhë”. Pa dyshim, në këto raste gjuha e dobëson funksionin e saj për t’u kumtuar të tjerëve mendimet, humbet qartësinë ose e vështirëson marrëveshjen gjuhësore. Përditë e më shumë ndeshemi me togje të tilla, si: ushtron ndikim (për ndikon), hyn në lidhje, në fakt, në esencë, në krahasim me, për shkak se, për arsye se, në mënyrë që, etj., apo me ndajfolje që mbarojnë me –isht (si: parimisht, gjerësisht, përfundimisht, etj.) me trajtat pavetore të foljeve (si: duhet, dihet, merret parasysh, kërkohet, lejohet, studiohet, kapet etj.); me foljet e gjendjes, të të menduarit (si: jam, gjendet, mendoj, vërej, pranoj, varet etj.); me para-fjalët apo mbiemrat e formuar nga pjesoret e foljeve, përemrat vectorë, pronorë e

dëftorë, fjalët e përbëra, kompozitë të tipit kryekëput, rrugëzgjdhje, ndjellakeqe, votavjedhës, këmbëngulje, varavingon, larg-pamësi etj. (shënim: herë ato shkruhen me vizë ndarëse në mes e herë të tjera jo). Leksiku në raste sporadike ngërthehet me fjalë të vjetëruara, me fjalë dialektore, me fjalë të të folmeve shoqërore dhe ngadonjëherë nga mjetet e ligjërimit të thjeshtë e bisedor. Për të kaluar në shkresat apo letrat zyrtare (juridike-administrative) do të vërenim: një leksik më të kufizuar; fjalë që gjithmonë përdoren me kuptim të përmirësuar dhe të drejtëpërdrejtë, nuk ndërtohen figura letrare (gjuhësore), ka fjalë të huaja ndërkombëtare e terma, mohohen në mënyrë kategorike fjalët e vjetëruara e dialektore, ka lloje të ndryshme fjalish, lokucione lidhëzore e parafjalore së bashku me togje fjalësh e shprehje të ligjërimit libror, që, nga përsëritja e dendur dhe e vazhdueshme janë kthyer në **formula** ose në elemente tipike gjuhësore, si: duke qenë se, në drejtin (të), si rrjedhim, është rregull që, në bazë të ligjit, sipas nenit, nën emrin tim, kam nderin të parashtoj, i drejtohem asaj ministrie, shpresoj që lutja ime do të merret parasysh, me nderime, ju njoftojmë që, ju vëmë në dijeni se, etj. Me gjithë këtë përcaktueshmëri, shprehje e ndërtime të vjetëruara, disa kallëpe burokratike të diktaturës po ia lënë vendin duke krijuar zhdërvjelltësi në leksik e në sintaksë; p.sh. në shumë dokumente fjala *kërkesë* po zëvendëson *lutje*, shprehjet *përshëndetje* në vend të *me nderime*, në emrin tim me *në emrin tim personal* etj., shprehje të cilave tashmë “u ka skaduar koha”. Dallime në fjalorin e politikës hasen edhe në të folur e të shkruar: - gjatë të folurit mbizotërojnë fjali të shkurtra, mungesore, fjali të përbëra me bashkërenditje, lidhëzat e thjeshta, ndërsa gjatë të shkruarit politikanët i drejtohen fjalive të gjata e të përbëra me nënrenditje me shumë lokucione lidhëzore të plota, kompozitat dëshirore e urdhërore, duke rikujtuar se gjatë të folurit si elemente plotësuese, organizuese shërbejnë edhe intonacioni, gjestikulacioni, pauzat njëtrajtëshe etj, d.m.th me një gjuhë jo të ngrirë, pa kufij censurues.

Lindin vetvetiu dy probleme:

a) **Ç’ndodh me një regjim autoritar, totalitar me gjuhën?!** Dhe përgjigjja vjen sërish vetvetiu: Gjuha politizohet, modifikohet, ngre mure të panevojshme midis njerëzve, shfaqet vulgare në gojën e mbartësve që politizojnë si një pasqyrë e shpirtit dhe e kulturës së pakët zotëruese.

b) **Cila mbetet rrugëzgjdhja?** Të ekzistojë shteti i së drejtës, pluralizmi politik ku gjuha të mos cungohet, të depolitizohet, të jetë e lirë. Fjalë të tilla si fyhreri (për Hitlerin), kuisling, ludist, mekartizmi, tutelë, violencë, verdikt i referohen çka u tha më sipër, një fushe politike të caktuar. Fjalët e referuara i përkasin një periudhe të caktuar

kohore, kur në shoqëri ishte vendosur një sistem totalitar, i cili e ndrydhte fjalën, e tjetërsonte mendimin dhe e sterilizonte gjuhën.

A) Fjalët e termat e këtij leksiku të pasqyruara në fjalorë përkatës janë më të mëdha në numër sesa disa fusha të tjera speciale, tekniko-shkencore (informatikë, elektronikë etj). Stili politik nga ana sintaksore e leksikore afrohet edhe me letërsinë artistike, edhe me stilin shkencor-teknik sepse nga njëra anë përdor fjalë me kuptim të figurshëm e frazeologjinë (krahnorizma, historizma, barbarizma si shtresa leksikore të kufizuara në përdorim) dhe, nga ana tjetër ka një leksik të mirëzgjedhur, terminologji të gjerë, fjali abstrakte, sintaksë të rreptë shkencore etj. Pas letërsisë artistike është ky stil ai që mbështetet më shumë në gjuhën e folur (me frazeologji të pasur e me sintaksë të larmishme).

B) Nga pikëpamja e nënsistemeve të gjuhës, mjetet me vlerë stilistike janë të fushës leksikore e frazeologjike (fjalë, terma, frazeologjizma etj), në fjalëformim (formime ndajshesore, kompozita etj.), të fushës gramatikore (trajta fjalësh, togje, emra foljorë, prapashtesorë, mbiemra, ndajfolje me prapashtesën –ish, –isht etj), fjali me bashkërenditje e me nënrenditje, llojet e ligjëratës etj.) dhe në fushën stilistike (fjalë e fjali të figurshme, epitete, metafora, krahasime, sinonime, antonime, polisemantizma, analogjizma gjuhësorë, numërimi, shkallëzimi, kundërvënia etj.), të cilat karakterizojnë më së shumti gjuhën e autorit të shkrimit për synimet e tij (forcë, ironi, demaskim, larmi gjuhe, individualizim, ndikim emocionues, sugjestionim, theksim, shprehësi etj). Ja disa raste të vjelura prej nesh:

- Me këtë dekret një absolvente në zë si Naxhije Duma, fjala vjen, emërohej në Koplik.
- I gjithë bekgraurdi i tij negativ ishte varrosur. (për E. Hoxhën)
- Muzeu E. Hoxha ishte një piramidë pa sarkofan.
- Thjesht si konspiracioniste e vjetër, ajo kishte menduar se kundër saj mund të organizohej ndonjë atentat.
- Sikur të tërë ata që duan t'i përdorin kujtimet dhe publicistikën për të mbuluar krimet e vjetra dhe për të kryer mashtrime të reja, t'i dinin të gjitha ato që dinë shkrimtarët, rrallëherë do t'u viheshin të shkruarit, mund të kujtohet në një rast ky si Zonjës së Zezë. (Nexhmije Hoxha)
- Nëpër cirkovolucionet e të ashtuquajturës elitë të qytetit vejevinte një rrjet i padukshëm frankmason.

Si mjete të veçanta librore ky leksik përmban emra me:

✓ parashtesa të huaja ose jo si psh: *a-, an-, i-, anti-, de-, dez-, dis-, pro-, in-, pan-, inter-, auto-, super-, poli-*. (a priori, bilateral, unilateral, de jure, de facto, deportim, disponim, filosemitë, antitrust, prosemitizëm, pseudoelitë, rinovim, intoksikim, ad hoc, destruktivitet, rikuperim, dislokim, alokim, demontazh, inspirim, inherente, neoliberalizim, autocensurë, overdraft etj.

✓ Me prapashtesa të huaja : *-ist, -ier/-er, -ant, -ent, -xhi, -çi, -ës, -esë, -ar(e), -or(e), -ishtë/-ishte, (-ë)sirë, -ore/-tore, -inë, -esë, -im, -je, -më/-imë, -atë, -i, -(ë)ri, -ësi, -llëk, -izëm, -azh, -urë, -ikë.*

✓ Përdoren foljet njëvetore ose pavetore (nevojitet, lipset, ngutet etj.) ose përcaktorë të veçuar.

- Shkrimet politiko-shoqërore shquhen edhe për një frazeologji të pasur, tepër funksionale. Frekuenca e përdorimit të tyre është më e larta pas letërsisë artistike (elemente krahinore, historike a etnografike, të folme dialektore, idiolekte). Ja, disa shembuj të sjellë më poshtë, dëgjuar së fundmi:

✓ Ujët rrjedh lart i kulluar, por turbullohet poshtë.

✓ Pëllumbi kur fluturon i rreh krahët.

✓ Kur flinte mbi dafina.

✓ Ka edhe pak vaj në kandil.

✓ Fati ia ka vënë në dorë.

✓ Kush mbjell erën, do të korrë fortunën!

✓ Të tregojmë fytyrat e të fshehim duart.

✓ Të ngopesh me lugë të zbrazët.

✓ Një thikë pas shpine.

Përveç ngjyrimin emocionues, këto njësi aktualizojnë e lokalizojnë dukuritë a nocionet, duke veshur një përmbajtje krejt të re në kontekste të gjera. Por, risia themelore e stilit politik është “thyerja” e kufijve stilistikë, përdorimi i frazeologjisë përtej kufijve tradicionalë, edhe në shkrime që si natyrë s’e kanë pasur frazeologjinë si: raportet, fjalimet, artikujt etj. Është arritur deri aty sa këto njësi të përpunohen e të shpërbëhen në strukturën e moçme që kanë pasur, fusha semantiko-sintaksore e tyre të zgjerohet tejmasë çka tregon një liri e zhdërvjelltësi më të fortë stilistike. Diçka tjetër që lidhet me frazeologjinë është **dukuria e kontaminimit** psh: ‘ka në dorë gurin, edhe arrën’; ‘të rrëmbën dorën e krahun’ (pra kur nga 2 njësi frazeologjike formohet një e tërë).

Të tjera novacione, lidhur me frazeologjinë përmendim:

Së pari krijimi i konteksteve (vargjeve) frazeologjike gjatë dëndurisë së përdorimit, të cilat mbartin pothuajse të gjithë peshën kuptimore e shprehëse të frazës. P.sh: “Plani gjerman i sinkronizimit përfaqëson një metodë tjetër marrëdhëniesh e thënë shkurt “më jep, të jap”, ose e thënë ndryshe “më ndihmove, të ndihmoj”, ose “më jep dorën, të jap krahun”. (njësitë e takojnë së njëjtës fushë leksikore).

Së dyti frazeologjia paraqitet si një sistem kompakt nga ana cilësore e sasiore në fizionominë e çdo shoqërie. Sidomos më e dukshme ajo paraqitet në proverbat e fjalët e urta, në të cilat shpesh herë gjatë frazave vepron edhe ligji i analogjisë, duke shndërruar një pjesë të proverbit, ose kur ai shpërndalet në tërë tekstin si organizues i idesë së përgjithshme. Gjithçka që ndodh ka një kufi, derisa lidhja me burimin popullor (tematika) të mos humbasë. Elemente të tjera që karakterizojnë individualen në stilin politik janë: përdorimi i thirrorit (veta II njëjës), bashkërenditja që i jep intensitet të madh ligjërit, fjalët me kuptim figurativ (epiteti, metafora, krahasimi) si elemente tipizuese, togje me emra veprimi, lokucione gramatikore librore si: “vë në korrent, bëj me dije, vë në dijeni, mbetem në lidhje” dhe shumë pak elemente bisedore, disa tipa fjalish (kryesisht habitore), ndërtime me dialog të brendshëm etj. Po paraqesim më poshtë disa prej shprehjeve frazeologjike dhe aforizmave me të goditura, të vjela në librat e përzgjedhur:

- ✓ “Mushkën dhe gruan duhet t’i marrësh nga vendi yt”
- ✓ “Si kofini pas të vjelit”
- ✓ “I riu si veriu”
- ✓ “Ç’e zuri njeriun dhe s’e hoqi”
- ✓ “Përsëritja është nëna e mësimi”
- ✓ “Po nuk respektoam veten, nuk ka për të na respektuar njeri”

(Alfred Moisiu “Në gjurmë të kujtimeve”)

-Sentenca dhe frazeologji që askush nuk i vë në dyshim dhe që politikanët synojnë edhe t’i individualizojnë sh.lehtë që kemi hasur në punën tonë:

“Në këtë botë korret, ajo që mbillet, kush mbjell lot korr lot, kush ka tradhtuar do të tradhëtohet.”

“Lavdia dhe pasuria janë si uji i detit: sa më shumë të pish aq më shumë ke etje”

“Ne duhet t’i japim popullit liri, jo tirani”

“Dielli u bë nga armiqtë më të mëdhej të Zogut”

“Ishte pula apo veza e paro në këtë dynja?”

“Fol me murin...”

“Kur bien topat, nuk dëgjohen pushkët”

“Bëmë dhe njëherë nuse se di unë si të nusëroj”

“Duhet ndryshuar rrjedha e ngjarjeve. Për këtë duhet ndryshuar shpirti i njerëzve”

- ✓ “Kafshon dorën e të zotit që e ushqen”.
- ✓ “Me të humburit kurrkush nuk do të mbytet”.
- ✓ “Dardha e ka bishtin prapa” .
- ✓ “Njeriu lind me të qarë e vdes me të qeshur”.
- ✓ “Popujt e pjekur nuk bien pre e përplasjes së liderëve”.
- ✓ “Liderët e fortë janë etër dhe bij të sistemeve autoritare”.
- ✓ “Diktatura dhe jo demokracia është produkt i një personi”.
- ✓ “Një pushtet personal nuk duhet të zëvendësohet me një tjetër pushtet personal”.
- ✓ “Kultet më të egra ngjizen në barkun e një ambicijeje”.
- ✓ “Kush rrok shpatën, nga shpata do të bjerë”.
- ✓ Sa më e fortë drita, aq më të dendura hijet”.
- ✓ Historia nuk është një shigjetë, por një bumerang”.
- ✓ “Kur djeg urat, mendo se në cilin breg ndodhesh”.
- ✓ “Mos i qaj hallin kalorësit se i varen këmbët”.
- ✓ “Ku i dihet, bëje të mirën dhe hidhe në det”.
- ✓ “Ha pak, të blesh biçak”.
- ✓ “Hiq e mos e këput”.
- ✓ “Po nuk qau fëmija edhe nëna nuk kujtohet ta ushqejë”.
- ✓ “Sa më pak të gënjyer njerëzit, aq më e qytetëruar është shoqëria”.
- ✓ “Harresa është kthim i krimit në forma të tjera”.
- ✓ “Njerëzit kanë prirje t’u veshin grave të tiranëve ato vese, madje ato krime, për të cilat duhet të përgjigjeshin, në radhë të parë vetë tiranët”.
- ✓ “T’i hedhim benzinë zjarrit”.
- ✓ “Kush mbjell erën, do të korrë fortunën!”
- ✓ “Të ngopesh me lugë të zbrazët”.
- ✓ “Mbush sitën me ujë”.
- ✓ “Me një çështje të drejtë besimi mund të lëvizë malet”.
- ✓ “Të shikojmë dritë në fund të tunelit”.

- ✓ “Besimi pa forcën është kotësi, por forca pa besimin është shterpë”.
- ✓ “Roma nuk u ndërtua në një ditë”. (Ciceroni)
- ✓ “Një thikë pas shpine”.
- ✓ “E ushqen me lugën, të nxjerr sytë me bishtin”.

Siç shohim nga shembujt e mësipërm, pjesa më e madhe e njësive frazeologjike karakterizohen nga:

a.Një strukturë togfjalëshore, madje edhe fjalie(të thjeshta ose të përbëra) me një larmishmëri ngjyrimore .

b.Kryesisht ato prodhohen si të gatshme në ligjërim, pasi ka një strukturë të qëndrueshme fjalësh, e vendosur historikisht.

c.Funksionojnë si një fjalë e vetme p.sh: pëllumbi kur fluturon i rreh krahët; fshati që duket s’do kallauz; dielli duket që në mëngjes ose kur flinte mbi dafina për “i shkonin punët vaj”; “fati i ka rënë në dorë”

d.Rendi i fjalëve në pjesën më të madhe mbetet i ngulitur (s’ka ndërrim vendesh të fjalëve, s’mund të futen ndërmjet gjymtyrëve fjalë të tjera, s’mund të ndryshohet trajta e fjalës etj.) p.sh: t’i hedhim benzinë zjarrit për i fryn zjarrit, i dha zjarr barutit, i hodhi dru zjarrit; mbush sitën me ujë funksionon për rreh ujë në havan, mbart verë e pi ujë;të ngopesh me lugë të zbrazët funksionon për: ngopet me erë, e mban me erë të mollës (të gjitha këto shprehje lidhen me një kontekst të caktuar dhe me vlera konotative të caktuara.)

e.Egzistojnë disa raste shprehjesh të prejardhura, të vëna në përdorim gjatë leksikalizimit të togfjalëshave të lire që mbartin ngjyrim të figurshëm p.sh: “të shikojmë dritë në fund të tunelit-shpresa vdes e fundit” dhe krahasoje me “dikush pa pakëz dritë në fund të tunelit dhe ulëriti prej gëzimit”, (fjali bashkërenditëse).

f.Nga ana sintaksore shprehjet frazeologjike funksionojnë si një gjymtyrë e vetme fjalie(kryefjalë, kallëzues, kundrinor etj).Në krahasim me fjalët-sinonime përgjegjëse ato mbartin një shkallë më të lartë cilësimi, një forcë më të madhe theksimi.Dallo për shembull : ‘shtyjme me bërryla’-‘i qan punën në dorë’ ose ‘i bie kazma nga duart’. Strukturat togfjalëshore sipas kategorisë leksiko-gramatikore në këtë punim shfaqen të llojeve e trajtave nga më të ndryshme si p.sh emër+emër, emër +mbiemër, folje + emër, folje +emër+mbiemër, folje+folje, folje +ndajfolje me vlera të kushtëzuara nga gjymtyra bosht të tilla si emërore, foljore, mbiemërore, ndajfoljore.Në gojën e politikanëve gjithashtu parapëlqehen edhe shprehjet e ndërtuara me elementin krahasues, **si** : “si gjilpërat majë më majë”, “si macja me minë” etj.

4.5 Mënyrat e fjalëformimit dhe rrugët e pasurimit gjuhësor të leksikut politik

Rruga kryesore e pasurimit të këtij leksiku me njësi të reja është formimi i tyre me mënyra morfologjike dhe jomorfologjike⁵², çka do të thotë se shumica e fjalëve dhe e termave të këtij leksiku janë formuar sipas tipave fjalëformues të shqipes (ku përfshihet edhe kalkimi) në përputhje edhe me kërkesat e sotme reale për pastrimin e tij nga huazimet e panevojshme. Nga këta tipa fjalëformues, më prodhimtarë e më aktivë paraqiten ndajshtesimi dhe kompozimi e pastaj vijnë të tjerat.

Ndër tipat e formimeve të këtyre fjalëve (e termave) me ndajshtesim ose me anë të ndajshtesave (të afikseve) dhe të sindajshtesave (të afiksoideve), më kryesorë për këtë leksik janë:

❖ **Tipi i formimeve me parashtesa e me siparashtesa (prefiksoide) që kanë funksione antonimike dhe joantonimike.**

Ndër parashtesat a siparashtesat me funksione antonimike bien në sy: *kundër-* e *anti-*, *pa-e mos*, *para-* e *pas-*, *brenda-* e *jashtë* etj.

a) Formimi i fjalëve të këtij leksiku me parashtesën a me siparashtesën antonimike
kundër- (si p.sh. *kundërkritikë*, *kundërligjor*, *kundërnjerëzor*, *kundërpadit*, *kundërpropozoj*, *kundërsulm*, *kundërsulmoj*, *kundërrevolucion*, *kundërrrymë*, *kundërshtetëror*, *kundërqeveritar*, *kundërterror*, *kundërterrorist*, *kundërterrorizëm*, *kundërpushtet*, *kundërvajtës*, *kundërvajtje*, *kundërbuloj* etj.) përbën një nga tipat më prodhimtarë në fushën e leksikut politiko-shoqëror të shqipes së sotme. Krahas kësaj parashtese ka vijuar të përdoret me funksione antonimike edhe parashtesa me burim të huaj *anti-* (si *antiburokratik*, *antidemokratik*, *antinacionalist*, *antidialektik*, *antiglobalist*, *antifashist*, *antikomunist*, *antikomunizëm*, *antikontrabandë*, *antikushtetues*, *antimilitarist*, *antiparti* etj.). Fjalët e mësipërme të formuara me këto parashtesa shënojnë dikë a diçka ose një tipar të tyre që kundërshton një tjetër dhe kështu u kundërvihen nga kuptimi fjalëve përgjegjëse pa parashtesë. Përdorimi i shumicës së fjalëve me këto

⁵² M. Samara, vepër e cituar, f.44

parashtesa në stilin politik tregon se këto parashtesa janë specializuar ose po specializohen për të formuar një klasë të veçantë leksiko-semantike të këtij leksiku. Ky specializim ka sjellë edhe leksikalizimin e këtyre parashtesave d.m.th shndërrimin e tyre në leksema, të cilat përdoren ndonjëherë si fjalë më vete, kryesisht në kontekste të rastit a individuale me kuptim e ngjyrim politik negativ “ai ose ajo që kundërshton dikë a diçka” (si p.sh “Të gjithë antit e kundrat pjellin diktatura.”) Fjalët e formuara me parashtesat kundër- e anti- nuk pësojnë modifikime nga ana leksiko-gramatikore (në raport me përgjegjëset e tyre antonimike pa parashtesë). Nga pikëpamja leksiko-gramatikore fjalët e këtij leksiku me këto parashtesa janë më shumë mbiemra dhe emra. Emrat janë formuar kryesisht nga tema prodhuese emërore (p.sh kundërkritikë, kundërpadi, kundërrymë, kundërkorrupsion-antikorrupsion; Pa antifashizmin liria do të ishte e kërcënuar”, kurse mbiemrat me këto parashtesa janë formuar kryesisht nga tema mbiemrash të panyjshëm (p.sh *kundërpopullor, antikushitetues* etj). Në krahasim me fjalët e formuara me parashtesën anti- fjalët e formuara me parashtesën kundër- po vijnë duke u shtuar edhe për shkak se funksionet e së parës (me burim të huaj) po i plotëson gjithnjë e më mirë parashtesa e dytë shqipe; prandaj disa fjalë me parashtesën **anti-** tani po përdoren krahas fjalëve të formuara me parashtesën **kundër-**, ndërsa disa të tjera me parashtesën anti- po kufizohen në përdorim; kështu p.sh kemi gjetur *antiligjor* edhe *kundërligjor, antishoqëror* edhe *undërshoqëror, antikombëtar* edhe *kundërkombëtar, antikomunist* edhe *kundërkomunist* etj ndërkaq përdoret kundërmësimje (politike) por nuk përdoret antimësimje etj.

b) Formimet e fjalëve me parashtesat shqipe ç- sh- zh- (si p.sh *çmobilizoj, çmilitarizoj, shtensionoj situatën, zhburokratizoj* etj) ose me parashtesat analoge të huaja **de-/ des-/ dez- e dis-/ diz-** (p.sh *depolitizoj, destalinizoj, dizorientoj* etj.) përbëjnë gjithashtu një tip formimi që është mjaft prodhimtar e aktiv në këtë fushë. Fjalët e mësipërme me këto parashtesa janë kryesisht folje dhe kanë përgjithësisht një kuptim privativ, që kundërvihet me atë që shënon fjala përgjegjëse pa parashtesë. Ashtu sikundër parashtesat **kundër-** e **anti-** edhe parashtesat **ç- sh- zh- ose de- des- dez- e dis- diz-** luajnë këtu rolin kryesor për të realizuar këtu antoniminë ndërmjet kuptimeve përkatëse të fjalëve. Variantet me burim të huaj, d.m.th parashtesat *de- des- dez- e dis- diz-*, ashtu sikurse edhe parashtesa *a-*, nuk janë prodhimtare e aktive në shqipen e sotme.

c) Fjalët e formuara me parashtesat mohuese: pa- (p.sh, *i pavërtetë, i paligjshëm, i pandërgjegjshëm, papërgjegjësi* etj); **mos-**(p.sh *mosbesim, mosorganizim, mosmarrëveshje, moslegalizim, mosndërhyrje*) e **jo-** (p.sh. *jodemokratik, jokapitalist,*

jomarkist, jopublik, joshoqëror etj). Të gjitha këto fjalë po i analizojmë bashkë në një grup të madh meqë këto parashtesa kanë funksione mohuese d.m.th ato mohojnë një cilësi ose një veprim me përmbajtje politiko-shoqërore, të shënuar nga fjala përkatëse pa parashtesë, me të cilën antonimizohet secila prej tyre. Numri i fjalëve të formuara me këto parashtesa në këtë leksik po vjen gjithnjë duke u rritur. Krahas fjalëve të reja të sipërpërmendura me këto parashtesa mohuese të pasqyruara me përzgjedhje në fjalorët e fundit shpjegues, kemi gjetur në botim të ndryshme edhe fjalë të tjera të këtij tipi strukturoro-semantik, si p.sh *mospropagandim, mosbashkim, mosanëtarim, moskallëzim, mospolitizim, mosorientim, jopatriotik, jointernacionalist, joqeveritar, joglobalist etj*. parashtesa jo- në strukturën e disa prej këtyre fjalëve ose termave ndihet pak si e veçuar në shqiptim, prandaj nganjëherë del e shkruar ndaras nga fjala-temë; megjithatë prirja e saj si parashtesë po bëhet një normë fjalëformuese e qëndrueshme, duke zgjeruar më tej funksionet e saj.

ç) Formimet me parashtesat ose me siparashtesat⁵³ antonimike **para-** dhe **prapa-** a **pas-** përbëjnë një grup dhe një tip tjetër fjalëformimi mjaft të gjallë (aktiv) në fushën e leksikut politiko-shoqëror. Nga ana leksiko-gramatikore fjalët e termat me këto parashtesa janë kryesisht emra (si p.sh *paraluftë e pasluftë, paraçlirim e pasçlirim etj*) dhe mbiemra të panyjzuar (p.sh *parakapitalist e paskapitalist, paramarksist etj*). Përveç fjalëve të këtij tipi që pasqyrohen në fjalorët e fundit shpjegues të shqipes, në botimet politiko-shoqërore të vjela për këtë qëllim gjenden edhe mjaft fjalë të tjera, me të cilat vijon të pasurohet ky leksik, si *parakomunist, paranazist, paramartesor e pasmartesor, parashitetëror, parakolonial, paraprosjekt, parazgjedhje, parazgjedhor etj*. Në ndonjë rast parashtesa shqipe **pas-** ka zëvendësuar parashresën e huaj **post-** (*postdiktaturë e pasdiktaturë, postkomunist e paskomunist, etj*)

d) Fjalët e formuara me parashtesën a siparashtesën **brenda-** (p.sh *brendafisnor “brenda një gjaku a një fisi të caktuar”, brendaligjor “brenda ligjit, sipas ligjit”, brendaparlamentar “që ndodh a zhvillohet brenda parlamentit”*) të cilat kundërvihen me fjalët antonime të formuara me parashtesën a siparashtesën **jashtë-** (përkatësiht me fjalët *jashtëfisnor, jashtëligjor “që nuk përputhet me ligjin, i jashtëligjishëm”, jsshtëparlamentar*). Me parashtesën **jashtë-** është formuar edhe fjala *jashtështetas* (tepër e kufizuar në përdorim) me kuptimin “*shtetas që banon jashtëatdheut të vet, emigrant*”.

dh) Fjalët e reja të tipit *pseudopatriot, pseudoatdhetar, pseudodemokrat e pseudopavarësi etj*. kanë në përbërjen e tyre formantin e huaj **pseudo-**, funksionit të të

⁵³E. Hysa i quan këto formate herë parashtesa e herë siparashtesa (Shih “Formimi i emrave me ndajshresa në gjuhën shqipe”f.63)

cilit i përgjigjet nga kuptimi fjala shqipe i rremë. Ky formant luan rol kryesor për të kundërvënë fjalën e re me fjalën temë përkatëse, ku pasqyrohet edhe një qëndrim politiko-shoqëror jomiratues i folësit a i shkruarit. Me këtë formant janë formuar edhe mjaft fjalë të këtij leksiku, që nuk pasqyrohen as në FGJSSH si p.sh. *pseudoaleat*, *pseudodemokraci*, *pseudoorganizatë*, *pseudokonferencë*, *pseudoshkencëtar*, *pseudointelektual*, *pseudoparti*, *pseudopolitikan* etj.

e) Tipi i formimit të fjalëve me parashtesat a me formantet e huaja *pro-* e *filo-* nuk është aq prodhues e aktiv në shqipen e sotme, megjithëse kemi vënë re të përdoren në ligjërimin e sotëm mjaft mbiemra dhe emra të rinj të formuar në këtë mënyrë si. *proamerikan* e *filoamerikan*, *prosocialist*, *prokomunist* e *filokomunist*, *properëndimor* e *filoperëndimor*, *proserb* e *filoserb* etj, të cilët shënojnë një cilësi a tipar të dikujt (që miraton ose përkrajk një pikëpamje, një ideologji etj) që zakonisht kundërvihet me kuptimin përkatës të fjalës së formuar me parashtesën jo-(kundërvënien e fjalëve prodemokrat “që është për demokraci” dhe jodemokrat “që është kundër demokracisë”). Në fjalët e këtij grupi strukturoro-semantik, formantet *pro-* e *kundër-* lidhen nga pikëpamja e prejardhjes kategoriale (si pjesë të ligjëratës) me parafjalën ose me ndajfoljen përkatëse; “Deputetët e amendamentit votuan pro, ndërsa opozita votoi kundër”.

-Ndër gupet strukturoro-semantike dhe tipat e fjalëve të këtij leksiku të formuara me prapashtesa dhe me siparashtesa (sufiksoide)më kryesore janë;

a) Grupi dhe tipi i fjalëve të formuara me prapashtesat sinonimike: *(ë)ri* (p.sh. *ndërgjegjshmëri*, *gjithëfuqishmëri*, *partishmëri*, *rrezikshmëri shoqërore*, *tjetërsueshmëri* etj), *-(ë)si* (p.sh. *kombëtarësi*, *ligjësi*, *papunësi*, *parimësi*, *vazhdimësi*) dhe *-i* (p.sh. *bashkëkohësi*, *kundërti*, *largpamësi* ose *tejpamësi* etj), që shënojnë cilësi a veti abstrakte të karakterit shoqëror e politik. Përveç fjalëve të lartpërmendura në letërsinë politike e shoqërore janë përdorur edhe mjaft fjalë të tjera të formuara me këto prapashtesa, disa prej të cilave nuk pasqyrohen në fjalorët shpjegues të shqipes së sotme, si p.sh. *kulakëri* “të qenët kulak, veprim a sjellje prej kulaku”, *jetimëri* “të qenët jetim”, *pakritikueshmëri*, *palëkundshmëri*, *paparashikueshmëri*, *shegerti*, *feudoborgjezi*, *shkueshmëri* etj. Ky tip formimi është bërë sot aq prodhimtar sa që po tërheq pas vetes edhe mjaft terma dyfjalësh të këtij leksiku, të cilët kanë prirje të njëfjalësohen pa sjellë ndryshime të ndjeshme në kuptimin e tyre (si p.sh. *frymë ideore* > *ideshmëri*), ku duket

se kemi të bëjmë me një zgjerim të prapashtesës **ri-** ose mund të thuhet me një formant të vetëm e “ të ri”(-*shmëri*), por të përbërë sikurse ka ndodhur me formantin **-risht** për formimin e ndajfoljes *botërisht* “publikisht” (nga *bot* + *risht*).

b) Fjalë e terma që janë formuar me prapashtesat : -izëm (p.sh.*majtizëm, djathtizëm, objektivizëm, zogizëm, stalinizëm, enverizëm, monizëm, nanoizëm, berishizëm* etj.) dhe **-ist** (*majtist, djathtist, objektivit, zogist, enverist* etj.) ose **-ian** a me variantin **-jan** (si *stalinian, gorbaçovian* etj.).

- fjalët me prapashtesën **-izëm** janë gjithnjë emra dhe shënojnë zakonisht “rryma, doktrina, metoda filozofike, ide ose pikëpamje me karakter shoqëror, politik e ideologjik” kjo klasë përbën në shqipen e sotme një ndër grupet më të mëdha me terma që përfshihen në këtë leksik: (*politikanizëm, në thënien “politikanizëm abstrakt”*), *diktatorializëm* (“Mania e tij është diktatorializmi”), *mesatarizëm* (“Kritika që i rrafshon vlerat i shërben mesatarizmit”), *amerikanizëm, rehatizëm, aristokratizëm, meritokracizëm, berishizëm, barazitizëm, nihilizëm, nanoizëm, xhuvelizëm* etj.

- fjalët me prapashtesat **-ist** e **-ian (-jan)** janë kryesisht emra (por ka edhe disa mbiemra) që shënojnë “përkrahësit e këtyre rrymave, doktrinave etj”. *grupist* “fraksionist”, *barazitarist* “partizan i barazitarizmit”, *reklamist, kastrist, ramizist, nanoist, berishist, xhuvelist* etj.

Nga pikëpamja funksionale prapashtesat **-ist** dhe **-ian** me të cilat prapashtesa **-izëm** ka vendosur lidhje fjalëformuese dyshe, janë sinonimike d.m.th kanë funksione të njëjta fjalëformuese dhe krijojnë fjalë me kuptime zakonisht të njëjta), megjithatë nganjëherë vërehet edhe njëfarë diferencimi funksional ndërmjet tyre. Kjo do të thotë se prapashtesa **-ian** përdoret atëherë kur mungon fjala përkatëse ose formimi me **-ist** (fjalët *hrushovizëm e hrushovian*, të cilat janë formime të lidhura me emrin e Hrushovit, ndërkohë që mungon formimi me **-ist**).

c) Formimi i fjalëve me prapashtesat sinonimike -o e -(i)zo/-(ë)so (si: *ideoj, programoj, teorizoj, terrorizoj, shoqërizoj, mitizoj, ndërgjegjësoj* etj) përbën një tip fjalëformues mjaft prodhimtar e aktiv, që vijon të pasurojë këtë leksik me folje të reja. Prapashtesa **-o** dhe “simotrat” e saj (**-zo, -so** etj) që mund të quhen edhe variante sinonimike ose zgjerime të **-o-së**, e modifikojnë kategorinë leksiko-gramatikore të foljeve të formuara dhe i klasifikojmë ato si folje vetëm të zgjedhimit të parë; këto folje shënojnë një veprim i cili lidhet drejtpërdrejt me kuptimin politiko-shoqëror të fjalës temë. Fjalët me këto prapashtesa janë formuar kryesisht nga një temë emërore shqipe (si p.sh. *programoj* nga *program* + *o*) ose mbiemërore (p.sh. *ndërkombëtarizoj* nga *ndërkombëtar*+*izo*); por në

mjaft raste të tjera tema prodhuese, motivuese e këtyre foljeve është një fjalë me burim të huaj, së cilës i është bashkuar prapashtesa e shqipes (p.sh ideologji +zo – ideologjizoj).

ç) Sipas tipit të prejardhjes ndajshitesore me anë të prapashtesave **-im** dhe **-je**, të cilat kanë funksione sinonimike, janë formuar një shumicë emrash (si p.sh. *revolucionarizim, emancipim, programim, mitizim, tatim, udhëheqje* etj); këto prapashtesa kanë jo vetëm karakter klasifikues, por edhe një përbërës funksional e semantik të njëjtë: janë emra të lidhur nga pikëpamja semantike e fjalëformuese me grupin e mësipërm (c) të fjalëve e termave dhe tregojnë procesin e veprimit, gjendjen ose rezultatin e veprimit (të shënuar nga folja përkatëse).të tilla janë edhe fjalët: *politizim, shoqërizim e vetëedukim, bunkerizim, liberalizim, legalizim*, si dhe *përçarje* (e partisë), *brumosje* (nga ana politike), *kalitje* etj.

d) Formimet me prapashtesën **-tar** (p.sh.*veprimtar, këshilltar, nismëtar*), me **-ar** (*pushtetar, opozitar, doktrinar, komunar*) dhe me **-(ë)s** (*zgjedhës, shkelës i ligjit, qeverisës, bashkëqeverisës* etj) a me formantet e zgjeruara: **-ues** (*demokratizues, bojkotues, europianizues, kritikues, çifutues, penalizues, sllavizues* etj) e **-yes** (*rrëmbyes i avionit, shërbyes* etj) përbëjnë gjithashtu një grup shumë të madh strukturoro-semantik fjalësh e termash, që vijnë ta pasurojnë leksikun politiko-shoqëror të shqipes.

dh) Grupi i fjalëve të formuara me prapashtesat **-ore**(p.sh. *qarkore* “letër që u dërgohet organeve më të ulëta shtetërore ose partiake nga organet më të larta, *konsultore a këshillimore*) dhe **-or** (p.sh.*programor, pushtetor, ligjor*).

- nëngrupi i emrave me prapashtesën **-ore** (*qarkore, këshillimore*) i cili nuk është sot aq specifik për këtë leksik dhe aq i madh në numër sepse tipi fjalëformues me këtë prapashtesë nuk është shumë prodhimtar e aktiv, këta emra janë të gjinisë femërore dhe tregojnë zakonisht vendin ku kryhet një punë a një veprimtari me karakter politiko-shoqëror.

- nëngrupi i mbiemrave me prapashtesën **-or** (si p.sh botëkuptimor, hetimor, parimor, vendor, ankimor etj) përbën një tip që është më prodhimtar e aktiv, fjalët e këtij nëngrupi janë formuar nga tema e një emri veprimi: ndërsa disa të tjera (si: *rutinor, ideor, doktrinor, statutor, pushtetor*) nuk janë formuar nga tema e një emri veprimi, por nga një emër tjetër jo i tillë(konkret ose abstrakt).

e) Leksiku politik i shqipes është pasuruar edhe me një varg ndajfoljesh të formuara kryesisht me prapashtesën **-isht** (si p.sh *atdhetarisht, filozofikisht, organizativisht,*

politikisht, ideologjikisht, mediatikisht, pabesisht, shoqërisht, demokratikisht, besnikërisht, lumturisht, kombëtarisht), e cila është bërë sot prapashtesa ndajfoljore më prodhimtare e aktive edhe në këtë fushë. Ndajfoljet e reja të këtij tipi janë formuar zakonisht nga tema mbiemërore (krhs.*politikisht* < *politik* + *isht*) ose nga tema emërore (krhs. *besnikërisht* < nga *besnikëri+isht*) dhe përcaktojnë kuptimin e foljes ose të një emri.

ë) Me anë të disa prapashtesave më pak prodhimtare që janë me burim nga shqipja ose nga gjuhë të huaja, si –uç, -xhi, -llëk, -esk, në këtë leksik janë formuar disa fjalë me kuptim politiko-shoqërore ngjyrim zakonisht keqësues si p.sh: *deputetuç* “deputet pa dinjitet”, *diktatoruç* “diktator i vogël”, *thashethemexhi* “llafazan që përgojos të tjerët”, *shkresaxhi a letraxhi* “nënpunës burokrat”, *kompromisaxhi* “ai që bën kompromise të përparimta”, *avokatllëk* politik, *partizanllëk*, *kryetarllëk*, *deputetllëk*, *shkollaresk* “jo i thelluar, jo shkencor”, *libresk* “që paraqitet si në një libër”, *gazetaresk* etj. tema prodhuese e këtyre fjalëve zakonisht nuk ka ndonjë ngjyrim (konotacion) çka do të thotë se është pikërisht prapashtesa ajo që i jep fjalës së formuar një ngjyrim të sigurt me karakter keqësues.

f) Mjaft fjalë të këtij leksiku janë formuar me prapashtesën femërorizuese –e (p.sh. *bashkiake, kryetare, sekretare, deputete, politikane, kryeparlamentare* etj) nga temat përkatëse të emrave mashkullorë, të cilat dalin si çifte gjinisore p.sh *kryetar-i* (S.Pëllumbi) dhe *kryetar-ja* (J.Topalli), *kryeparlamentar-i* dhe *kryeparlamentare-ja*. Në këtë leksik ka edhe fjalë të jera të formuara me prapashtesa mëpak prodhimtare e më pak aktive, të cilat për këtë arsye nuk i kemi marrë në analizë: si p.sh:

-me prapashtesën –*as* (p.sh. *atlantikas* “Aleatët atlantikas kanë planet e veta”);

-me prapashtesën –*urina* (p.sh. *shkresurina*);

-me prapashtesën –*z* (*arëz* “Kopsht i vogël a ngastër e vogël toke pranë shtëpisë)

-Nëpërmjet kompozimit a fjalëpërbërjes, përngjitjes a nyjëzimit janë formuar një varg mjaft i madh fjalësh e termash të këtij leksiku, ku mund të veçohen:

1.Grupi i kompozitave këpujore të formuara prej gjymtyrësh që kanë lidhje bashkërenditëse midis tyre të cilat shkruhen me vizë lidhëse, si p.sh. politiko-shoqëror, politiko-ideologjik, politiko-kulturor, ideologjiko-kulturor, ekonomik-shoqëror,

moralo-politik, ushtarako-politik, juridiko-kushtetues etj. Siç shihet, shumica e fjalëve kompozita, të formuara në këtë mënyrë, përbëhen nga gjymtyrët politik, shoqëror e ideologjik. Ka edhe raste kur kjo e fundit përdoret si gjymtyrë e parë e shkurtuar, duke u shkruar bashkë me të dytën (d.m.th) pa vizë, si p.sh. *ideopolitik* “ideologjik e politik”, *ideoshkencor*, *ideokulturor* etj.

2. Kompozita përcaktore të formuara nga gjymtyrë që kanë lidhje nënrenditëse; në këtë rast njëra prej dy gjymtyrëve përcakton tjetrën nga ana kuptimore. Ky është edhe grupi më i madh i fjalëve të formuara me anë të kompozimit. Sipas kategorisë leksiko-gramatikore, kompozitat e këtij grupi janë kryesisht emra e mbiemra, ndërsa sipas marrëdhënieve e lidhjeve ndërmjet gjymtyrëve përbërëse dallohen këta tipa:

a) tipi emër + emër që ka formuar kryesisht emra ku:

*gjymtyra e dytë përcakton tjetrën (të parën) zakonisht nga pikëpamja e veprimit që kryen dikush a diçka ose nga ana e tiparit a e cilësisë si p.sh. *punëdashës*, *atdhedashës*, *azilkërkues*, *dobiprurës*, *dëmprurës*, *luftënxitës*, *zjarrfikës*, *pushtetmbajtës*, *taksapagues*, *tatimpagues*, *pengmarrës*, *pengmarrje*, *vendimmarrës*, *paqeruajtës*, *politikbërës* etj.

Në leksikun politiko-shoqëror të shqipes ka edhe mjaft fjalë të përbëra të cilat kanë si përcaktuese gjymtyrën e parë, të tillë si p.sh. gjymtyrën:

-krye (*kryeparlamentar*, *kryekëshilltar*, *kryespin* etj) me kuptimin “kryetar” ose “kryesor” që lidhet a bashkohet semantikisht me kuptimin e gjymtyrës së dytë për të formuar një fjalë të re e të mëvetësishme me përmbajtje politiko-shoqërore; në këtë mënyrë janë formuar edhe kompozitat: *kryebashkiak* “*kryetar i bashkisë*”, *kryekomunar* “*kryetar i komunës*”, *kryeprokuror* “*prokuror i përgjithshëm*” *kryedelegat*, *kryebandit*, *kryekriminel*, *kryemafioz* etj.

-zëvendës – (p.sh. *zëvendëskryetar*, *zëvendësekretar*) dhe ndihmës – (*ndihmëskryetar*, *ndihmëskëshilltar*, *ndihmësgjyqtar*), që kanë pothuaj të njëjtin funksion a kuptim, çka do të thotë se fjalët e formuara në këtë mënyrë shënojnë “njeriun i cili zëvendëson ose ndihmon dikë tjetër” që kryen një punë a detyrë gjithashtu me karakter politiko-shoqëror.

-projekt- (p.sh. *projektkushtetutë*, *projekdeklaratë*, *projektmarrëveshje*, *projektstatut*, *projektvendim*, *projektide*, *projektprogram*, *projektrregullore*);

b) tipi emër + mbiemër (*syvigjilent* “syhapët”, *mendjendryshkur*, *mendjendritur* “me mendje të zgjuar” etj) i cili është më pak prodhimtar. Në këtë tip përfshihen edhe mjaft fjalë të përbëra që kanë si gjymtyrë përcaktuese mbiemrin i madh (p.sh. *serbomadh*,

grekomadh, rusomadh, turkomadh etj), i cili semantikisht këtu ka funksione bashkëshoqërimi me kuptimin a konceptin që shënon fjala shovinist.

c) *tipi numëror + emër ose numëror + mbiemër* janë formuar një grup fjalësh të përbëra që kanë si gjymtyrë të parë:

një- (p.sh.*njëkombës “bashkëkombës”, njëpartiak*);

dy- (p.sh.*dypushtet, dypartiak, dypronësi*);

tre- (p.sh.*koalicion trepartiak*);

katër- (p.sh.*marrëveshje katërpalëshe* etj);

pesë- (p.sh.*koalicion pesëpartiak* etj.)

ç) *tipi ndajfolje (a përemër) + emër (ambimër ose folje) dhe përemër + mbiemër* përfshin fjalë të këtij leksiku të formuara me gjymtyrën e parë përcaktuese:

-larg (p.sh. *largshikues, largpamje*) ose *tejt-* (*tejpamës e tejpamje*)

-mirë (p.sh. *mirëkupoj, mirëqeveris*)

-keq (p.sh. *keqqeveris, keqinterpretuj votën, keqpërdoruj besimin*)

-mbarë (p.sh.*mbarëpopullor, mbarëkombëtar*)

-gjithë (p.sh.*gjithëballkanik, gjithëkombëtar, gjithëeuropian*) ose

-tërë (p.sh. *tërëkombëtar, tërëpushtetëror, tërëshqiptar*) e *pan-* (nga greq. Pantos, p.sh. *panamerikan “që ka lidhje me Amerikën Veriore dhe Jugore”, pankombëtar, pannjerëzor*).

Si risi në gjuhën e politikës paraqitet para lexuesit vepra e Edi Ramës “Kurban” përse i përket kompozitave të rralla që ajo sjell të ndërtuara **mbi bazën e figurës së fuqishme të inversionit** (e anasjella) apo mbi bazën e bashkimit të dy, tre apo katër fjalëve duke na dhënë një fjalë të vetme si : shtrimdarkat, rrasuplasu, rrumpallhanes, kudotymosur, tymëflakta, megaqytete, lejeshkelëse, kryetrashësinë etj.

Zakonisht ato i referohen gjuhës së popullit, gurrës së pashtershme të saj, duke përcjellur efekte të veçanta gjatë leximit apo dëgjimit të frazave të gjata. Të tilla siç shprehen edhe studiuesit paraqiten në formën e neologjizmave rreth 40 njësi të reja.

...spiunë të shkathët të kohës që iku dhe të nevojshëm për kohën që erdhi, marifetçinj gjithfarë, e guximtarë **zararmëdhenj**, të cilët e tjetërsuan parkun...

Përdhosja e kujtimit të Kristaq Ramës nga mëkatarë **gojëpashmagje** me në krye Saliun...

...është tharmi i çorbës sociale që gatuhet përditë në kuzhinën e kësaj **palopolitike** njerëzish të ngashëryer.

...derisa në fund të fjalive fyti i spanohej dhe zëri i kthehej në **frymëshfryrje** të çjerrë që mbulohej prej pasthirmave të një turme..

...e kishte kthyer në ata muaj Tiranën, kryeqytetin e vdekur të vendit më të varfër të Evropës, në një **sikafene** të Montartre-it...

Rikthimi triumfal në kongresin ku u konfirmua kryetar i PS-së me një ringritje spektakolare nga **thujshchici** kundër gjithë parashikimeve

Nga deputete, anëtarë farumesh qendrore a politikanë lokalë të profesorë, doktorë shkencash, oficerë policie, biznesmenë, të reja të **dollandërdisuara** e të rinj naivë e ëndërrimtarë...

...teksa qindra e qindra furgonë zhulsa vejevinin rrugëve plot tym e zhurmë duke transportuar **rrasuplasu** tiranasisit e vjetër e të rinj

E me radhë kështu, të gjitha çështjet e tjera komunale të një kryeqyteti që zhytej në ujë nga një rrebesh **pakminutësh**...

...që kemi parë e dimë të gjithë, një revan e njëkohësisht revansh i skllëvërve të komunizmit në **turravrapin** e lirisë së fituar për të pasur më në fund një shtëpi..

S'flas këtu për **lehagenj** të zgjidhur zinxhirësh në oborrin e kundërshtarëve politikë

...sepse ishte i zoti të fliste e të bënte gjëra që askush tjetër s'i bënte dot si ai, në tërë ato vite të **rëndëngarkuara**...

Saliut i interesonte zhvillimi i planit të kontit tanimë kryeministër kurse për Fatosin e kthyer në një **limokondor** gojëfarmak...

...për të mos thënë një fjalë tjetër që e kishte në majë të gjuhës në radhë të parë për **puthadorët** e tij ose pse ishin "mosmirënjohës të pakorrigjueshëm".

...ca prej porosive në tym që rridhnin nga kabllogramet gojore mes kryeministrit, Fatosit e shoqërueve të tij në **shtrimdarkat** e pambarimta deri në orët e vona ku hidhepriteshin batuta e insinuata për të padëshiruarit...

...dhe provokuan edhe dia momente të papëlqyeshme **fjalëkëmbimesh** mes nesh.

...edhe aty ka pronarë të vjetër që vërtet s'kanë tituj pronësie sepse **gjermësot** ajo pronë është trajtuar me të drejtë si publike...

...por ka mbetur përjashta në korridorin përdhes pa mundur dot të mbërrijë deri lart tek ai dhe zhgënjimi lëngues i **prapaportës** i ka lënë në shpirt vragën e një mllefë të paparë.

Sokoli e kishte kaluar provën e depersonalizimit të **plotvullnetshëm** pikërisht në **fillimvitin** 2003....

...që pasuan në mikrofonin e qeverisë e të parlamentit ndaj opozitës “puçiste” që me **cadrapushkë** e **stilopistoleta** kishte synuar përmbysjen e rendit demokratik...

Pavarësisht rezistencës së gjatë prej **shejtanbudallai** të ministrit të arsimit, që e humbi më në fund davanë në një takim...

3.Me anë të përngjitjes janë formuar gjithashtu pak fjalë të këtij leksiku, si p.sh. *thashetheme* (nga tema e së cilës janë krijuar emrat thashethemaxhi e *thashethemnajë*), *agjitprop* “organi që merrej me agjitacionin dhe me propagandën e Partisë komuniste gjatë dhe pak vite më vonë pas Luftës antifashiste nacionalçlirimtare etj.

4. Nëpërmjet nyjëzimit janë formuar mjaft mbiemra zakonisht prej temës së pjesores së foljeve më **–o** (si p.sh. *i emancipuar, i politizuar, i shpolitizuar, i amerikanizuar, i sllavizuar, i ndërkombëtarizuar* etj), të cilët lidhen nga kuptimi me veprimin e foljes përkatëse (p.sh. *i ndërkombëtarizuar* “që është bërë ndërkombëtar apo që ka marrë karakter ndërkombëtar” etj).

Nga literatura jonë kemi vjelur të tjera fjalë si: a priori, abrogim (shfuqizim), akomodim, deportim, disponim, filosemite, antisemite, politikë antitrust,proselitizëm, dezorientim, në disporporcion, deziluzione, demonizim, dezintoksikim, antidote, kontraversal, non grata.Në një rast të vetëm parashtesa ‘post’ na del në fund të një fjale e jo në fillim të saj p.sh: **avantpost**. Parashtesa të tjera që përdoren janë në përbërjen e fjalëve si :**sub**+stanciale, **pre**+dominimin, **ekstra**+terroritet, **anti**+korpe, **pre**+dispozitë, **ri**+novim, **dez**+integrim, **pseudo**+elite apo në shprehjet : **de** facto, **de** jure, **in** ekstremis, **ad** hok.Të tjerë shembuj: multi+ kulturore, pre+ambulën, bi+partizanizëm, bi+laterale, multi+laterale, de+struktivitet, per+turbacione, dis+lokim,mono+mani, de +montazh (kryesisht me funksione mohuese,jomiratuese, privative).Të tjera siparashtesa a

formante janë në fjalët:superfuqi, superlider, superfans, neosampiste, neofyhrehri, neopacifist, neolatin,aglomeruese, kontraversal etj.

Grupi i prapashtesave është akoma edhe më i larmishëm pasi shfrytëzohen dy rrugë: ose merret fjala me strukturën gramatikore të njejtë si në fjalët e huaja ose pjesërisht huazohen metodat e fjalëformimit të shqipes, pra prapashtesat e saj,si në rastet: amplifikim, asocim, atraksion, lobim, ludist, mekartizmi, millennium, mocion, monitorim, pacifist, paroksizëm, paternaliste, penetrim, deportim, disponim, diversitet, implementim, indikacione, perkursion, proslitizëm, reparacione, rinovim, intoksikim, jubilar, kantonizim, kombinacion, kompeticion, kredibilitet, solemnitet, startim, suksesion, diversion, galopante, strapacuese, parcial, dezintegrim, restitucione, obligacione, imminence, lobingje, konsequenca, posibilitet, adaptim, lançim,rikuperim, privacion, survejim, kretinizëm,miksazh, demontazh, stanjacion, violencë.

Nëpërmjet kompozimit a fjalëpërbërjes, përngjitjes e nyjzimit vecojmë edhe fjalët: bellixerancë, aerofotografikë, bekgraund, bonsens, partnership, toutcourt,bllokmenë, hinterland, billboard, rokenroll, nokaut, ofset, baipas,pasuord, apdeit, laptop, gjysmënokdaun, intransigjenca, polivalente, neoliberalizëm, aoutçensurë, bodigard, turkofobi, bashibozuk(njeri i çrregullt); me konversion fjalët: antiglobalisti, infantili, abolicioniste, filosemiti, recidevisti, vrangelisti, i frustruari, konfidenti, i lançuari(emra të gjinisë femërore ose mashkullore që shenjojnë njeriun që kryen një punë a veprimtari politik-shoqërore të caktuar).Gjithë këto tipa fjalëformues për grupime strukturorosemantike fjalësh dëshmojnë për aftësitë potenciale të strukture leksikore, të këtij leksiku, i cili vijon të zhvillohet jo më me fjalë të veçuara, por me klasa e vargje leksikore të karakterizuara nga lidhje paradigmatiche, duke formuar çerdhe kuptimore e nuancore të gjera.E dobishme është dhe mënyra e përzierë e fjalëformimit (emërzimi, mbiemërzimi,parashtesa+prapashtesa,paranyjëzim+prapashtesim,paranyjëzim+përngjitje etj).Leksiku i vjelë nga ne dallohet për një ngjyrim të theksuar negativ dhe pozitiv, për fjalë emfatike, për shabllone patetike, për fjalë polisemike etj.Po paraqesim të tjerë shembuj:

- Me parashtesën **anti-**, - fjalëformuese parashtesë që u jep fjalëve kuptim të kundërt⁵⁴. Parashtesë me prejardhje nga **greqishtja e vjetër**, e cila si element fjalëformues i ngjitet temës së fjalës ,duke formuar një fjalë të re që ka kuptim të kundërt me atë të fjalës. Pra ,parashtesa anti- në shumë raste luan funksion antonimik

⁵⁴ J.Thomai, M.Samara, etj “Fjalor i gjuhës shqipe” Tiranë,2006

(kryesisht si antonime jo të mirëfillta)⁵⁵:antihumanizëm, antieuropian , antikombëtar (më poshtë po paraqesim fjalët me parashtesa të huaja të gjetura nga leksiku i politikanëve gjatë seancave parlamentare).

Antidiskriminim, antieuropian, antihumanizëm, antikonkurrues, antikushtetues, antiopozitarizmi etj.

Nga pikëpamja leksiko-gramatikore fjalët e këtij leksiku me këto parashtesa janë më shumë **emra dhe mbiemra**.

- Me parashtesat **de-/des-/dis-/diz-**

Fjalët e mëposhtme me këto parashtesa janë kryesisht **folje** dhe kanë përgjithësisht një kuptim privativ që kundërvihet me atë që shënon fjala përgjegjëse pa parashtesë. Këto parashtesa nuk janë shumë prodhimtare në gjuhën e sotme. Në vend të këtyre parashtesave po përdoren parashtesat sinonimike c-/sh-/zh-⁵⁶. Këto parashtesa gjithashtu mund të kryejnë funksionin e antonimeve.

Dis (lat) parashtesë me kuptimin ndarje, mohim, heqje, privim; disasocioj, deziluzion, dezinformoj, disavantazh, disobediencë etj.

- Me parashtesat **i-/in-/inter-**

Edhe këto parashtesa ashtu si edhe ato më lart mund të luajnë funksionin e antonimeve. Janë prodhimtare. Nga pikëpamja leksiko-gramatikore janë kryesisht **emra dhe mbiemra**.

Indirekt, inefiçent, intolerancë, irracionale, interlokutor, interkonjeksion etj.

- Me parashtesat **poli-/ultra-/super-/pre-**

Këto parashtesa të huaja janë pjesë e leksikut politik. Ato nuk luajnë funksion antonimik si parashtesat e mësipërme. Polivalent.

Ultra – (lat) pjesë e parë e pjesëve të përbëra me kuptimin : tej masës, tepër, i mëtejshmi, më i skajshmi; ultramodern, superinstitucion, predominoj etj.

- Pra siç e pamë edhe më lart tek fjalët antonime me parashtesa rolin kryesor në lindjen e marrëdhënieve antonimike ndërmjet kuptimeve e luan parashtesa, e cila i

⁵⁵ M.Samara, “Vëzhgime mbi antonimet me parashtesa në gjuhën shqipe” St fil.1,1965

⁵⁶ M.Samara, “ Rreth leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe” Tiranë, 2008, f.59

ngjitet temës së një fjale dhe kështu krijohet një fjalë e re, kuptimi i së cilës i kundërvihet kuptimit të fjalës pa parashtesë⁵⁷.

Gjithashtu në kuadrin e pasurimit të leksikut politik shohim mjaft fjalë e terma që janë formuar më prapashtesa të ndryshme si:

- Me prapashtesën –izëm

Këto fjalë janë emra që shënojnë zakonisht ide e pikëpamje me karakter shoqëror e politik si : objektivizëm, optimizëm, oportunitizëm, punizëm etj.

- Me prapashtesën –ist

Këto fjalë janë kryesisht **emra** që shënojnë përkrahësit e rrymave politike apo doktrinave dhe kanë një kuptim më të përgjithësuar politiko-shoqëror. Si të tilla përmendim : socialist, puçist, grupist etj.

- Me prapashtesat –xhi,-llëk,-esk

Në këtë grup përfshihen ato fjalë të cilat nëpërmjet këtyre prapashtesave marrin ngjyrimë të caktuara me karakter keqësues. Përmendim fjalë të tilla si : qylaxhi, thashethemexhi, interesaxhi, ortakllëk, deputetllëk, gazetaresk, idiotesk etj.

Si një element tjetër fjalëformues më lart përmendëm edhe kompozitat e fjalëve, të cilat formojnë një varg fjalësh e termash të këtij leksiku. Përmendim kështu kompozita këpujore të formuara prej gjymtyrësh që kanë lidhje bashkërenditëse midis tyre, e shkruhen me vizë lidhëse:

Stabilizim-asocim, projekt-rezolutë, akt-marrëveshje, bashkëpunim policor-ndërkufitar etj.; kompozita përcaktore të formuara nga gjymtyrë që kanë lidhje nënrenditëse, ku njëra nga gjymtyrët përcakton tjetrën nga ana kuptimore⁵⁸. Kështu si të tilla përmendim: mitmarrje, marrëveshje, bilaterale, projektstatut, projektligj, procesverbal etj.

4.6 Pse birësojnë fjalë të huaja politikanët?!

“Ksenofobia gjuhësore është shfaqje e frikës për t’u hapur, e pasigurisë kulturore dhe mungesë largpamësie”

⁵⁷ M.Samara, “Mbi karakterin antonimik të kuptimeve të fjalëve në gjuhën shqipe” S.fil.2.1967, f.26

⁵⁸ Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f.71

Në të gjithë gjuhët e botës dhe ato me shkallë të lartë përpunimi e me aftësi e mundësi shumë të mëdha krijuese, gjejmë grupin e fjalëve huazuese, veçanërisht në fushën politiko-shoqërore, shkencore. Huazimi si proces tregon se popujt kanë qenë dhe janë kufitarë ose kanë pasur apo kanë marrëdhënie historike, ekonomike, politike e kulturore ndërmjet tyre. Huazimi ndodh në rrethana historike e gjuhësore të caktuara edhe kur në një gjuhë ka emërtim për të njejtën realie a për të njejtin koncept. Në shqipe krahas një fjale burimore është pranuar fjala e huaj: a. Kur ka qenë një term ndërkombëtar, epilepsi'sëmundja e tokës', grip 'rurfë', turbekuloz 'ndishk'. b. Kur ka sjellë ndonjë nuance kuptimi më të përpiktë dhe më të veçantë: bejtexhi 'vargëzonjës'. c. Fjala e huaj është pranuar dhe kur e ka kërkuar një stil i caktuar i gjuhës si stili shkencor dhe ai politiko – shoqëror në të cilët kanë hyrë fjalë të tilla si : absolutisht 'kryekëput', abuzim 'shpërdorim', argumentoj 'provoj', diferencë 'ndryshim'. d. Janë huazuar fjalë për shkak të prirjes së disa të folmeve profesionale për të qenë 'sa më të përgjithshme, sa më ndërkombëtare'. Kjo gjë vërehet në leksikun e fushave të artit, të modelistëve, të biznesit, të financave, të informatikës. Në punimin tone jemi mbështetur në literaturën dhe shtypin vendas .Përcaktimi i kësaj teme nuk ka si qëllim studimin e huazimeve në përgjithësi, por ka si objekt huazimet në raport me gjuhën shqipe (ndërkombëtarizmat që sot veprojnë e gjallojnë në gojën e politikanëve, mediave, gazetarëve, analistëve) dhe veprimi i huazimeve në ditët e sotme. Qëllimi i kësaj pike është të japim një vëzhgim modest të ndërkombëtarizmave më aktive e vepruese në fushën politike, në aktualitet. Shumë fjalë të leksikut të huaj duke qenë se shënojnë sende e dukuri me rëndësi ato janë pronë e leksikut të shqipes dhe zëvendësimi me fjalë të tjera nuk mund të bëhet më. Në ditët tona, gjuha shqipe është e hapur përballë gjuhëve të huaja sidomos përballë anglishtes, e sidomos ndër politikanë në fjalimet e tyre politike, por dhe emigrantët shqiptarë të Italisë dhe Greqisë. Huazimi ka vlerën e vet pasuruese, por nëse bëhet pa kurrfarë kontrolli e pengese kthehet në një dukuri të dëmshme për gjuhën tone, sidomos kur mbushet me fjalë të huaja ligjërimi i politikanëve. Për këtë qëllim bëhen përpjekje për të penguar huazimin e fjalëve nga gjuhë të tjera, ose për të hedhur jashtë përdorimit fjalët e huaja, kur për ato kemi fjalë shqipe plotësisht me të njejtin kuptim, më të njohura, të përpikta e të qarta për folësit e shqipes.

Në të gjithë gjuhët e botës dhe ato me shkallë të lartë përpunimi e me aftësi e mundësi shumë të mëdha krijuese, gjejmë grupin e fjalëve huazuese, veçanërisht në fushën politiko-shoqërore, shkencore. Huazimi si proces tregon se popujt kanë qenë dhe janë

kufitarë ose kanë pasur apo kanë marrëdhënie historike, ekonomike, politike e kulturore ndërmjet tyre. Huazimi ndodh në rrethana historike e gjuhësore të caktuara edhe kur në një gjuhë ka emërtim për të njejtën realie a për të njejtin koncept. Në shqipe krahas një fjale burimore është pranuar fjala e huaj: a. Kur ka qenë një term ndërkombëtar, epilepsi 'sëmundja e tokës', grip 'rrufë', turbekuloz 'ndishk'. b. Kur ka sjellë ndonjë nuance kuptimi më të përpiktë dhe më të veçantë: bejtexhi 'vargëzonjës'. c. Fjala e huaj është pranuar dhe kur e ka kërkuar një stil i caktuar i gjuhës si stili shkencor dhe ai politik – shoqëror në të cilët kanë hyrë fjalë të tilla si : absolutisht 'kryekëput', abuzim 'shpërdorim', argumentoj 'provoj', diferencë 'ndryshim'. d. Janë huazuar fjalë për shkak të prirjes së disa të folmeve profesionale për të qenë 'sa më të përgjithshme, sa më ndërkombëtare'. Kjo gjë vërehet në leksikon e fushave të artit, të modelistëve, të biznesit, të financave, të informatikës. Në punimin tone jemi mbështetur në literaturën dhe shtypin vendas. Përcaktimi i kësaj teme nuk ka si qëllim studimin e huazimeve në përgjithësi, por ka si objekt huazimet në raport me gjuhën shqipe (ndërkombëtarizmat që sot veprojnë e gjallojnë në gojën e politikanëve, mediave, gazetarëve, analistëve) dhe veprimi i huazimeve në ditët e sotme. Qëllimi i kësaj pike është të japim një vëzhgim modest të ndërkombëtarizmave më aktive e vepruese në fushën politike, në aktualitet. Shumë fjalë të leksikut të huaj duke qenë se shënojnë sende e dukuri me rëndësi ato janë pronë e leksikut të shqipes dhe zëvendësimi me fjalë të tjera nuk mund të bëhet më. Në ditët tona, gjuha shqipe është e hapur përballë gjuhëve të huaja sidomos përballë anglishtes, e sidomos ndër politikanë në fjalimet e tyre politike, por dhe emigrantët shqiptarë të Italisë dhe Greqisë. Huazimi ka vlerën e vet pasuruese, por nëse bëhet pa kurrfarë kontrolli e pengese kthehet në një dukuri të dëmshme për gjuhën tone, sidomos kur mbushet me fjalë të huaja ligjërimi i politikanëve. Për këtë qëllim bëhen përpjekje për të penguar huazimin e fjalëve nga gjuhë të tjera, ose për të hedhur jashtë përdorimit fjalët e huaja, kur për ato kemi fjalë shqipe plotësisht me të njejtin kuptim, më të njohura, të përpikta e të qarta për folësit e shqipes.

Çështja e ngritur së fundmi lidhur me gjuhën shqipe ka qënë çështja për ndryshimin e standardit të saj. Njëri prej studiuesve, Shezai Rrokaj, duke argumentuar me faktin se shqipja është në proces evoluimi, thotë se në këtë moment më shumë se kurrë është e rëndësishme që shqiptarët të kenë më shumë kujdes nga epidemia e fjalëve të huaja. "Unë nuk jam i mendimit se duhet ndërhyrë fort në këtë standard. Le t'i lëmë format të rrjedhin edhe për disa dekada. Të jemi sa më të kujdesshëm nga epidemia e fjalëve të huaja, që e kërcënojnë më shumë këtë standard, se sa nga prurjet që vijnë nga të folmet me dialekt". Përpos gjuhës së politizuar, kulturën tonë gjuhësore, gjithnjë e më

dukshëm, e cënojnë edhe fjalët e huaja, të panevojshme, dhe po kështu ne po përjetojmë *një vërshim të jashtëzakonshëm fjalësh të huaja*. Tung, Hi, Uau, Fuck (dreq, djall) ndodh t'i dëgjosh shpesh. Janë këto shprehjet dhe mjaft të tjera po të tilla, të cilat përdoren rëndom në gjuhën e përditshme. Huazime të ndryshme europerëndimore, duket se këto dhjetë vitet e fundit po e "mbysin" gjuhën shqipe⁵⁹. Trysnia e gjuhëve të huaja zë një vend shumë të madh në gjuhën shqipe, problem i cili cënon shumë aspekte dhe ngre para përdoruesve të gjuhës, në mënyrë të pavetëdijshme dhe të pavullnetshme shumë pikëpyetje:

- Përse përdoren këto huazime?
- Nga cila gjuhë huazohet më tepër?
- Çfarë dëmtojnë këto huazime në gjuhën shqipe?
- Cilat sfera të shoqërisë huazojnë më shumë?
- Kush huazon më shumë dhe pse?
- Pse huazohen fjalë të tjerëve ?

Dhe lista mbetet e pafundme për pyetjet që ngrihen.

Trysnia e gjuhëve të huaja ndihet më shumë në aspektin politik, ekonomik, shoqëror, administrativ dhe është shndërruar në diçka të pashmangshme, diçka që po zhvillohet me natyrshmeri në trupin e gjuhës mëmë, një filiz artificial që gjuha po e ushqen me gjakun e saj.

Fjalët e huaja po fillojnë e po përdoren çdo ditë e më shumë. Një studiues tjetër, prof.Gjovalin Shkurtaj, që është shqetësuar lidhur me këtë problem, ka arritur në maksimumin e fundit : "Ndikimi i gjuhëve të huaja dhe huazimet e shumta po e çojnë gjuhën shqipe drejt shkatërrimit të saj"⁶⁰.

4.6.1 Huazime që s'gjenen në fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe.

⁵⁹SH. Rrokaj, "Huazimet e shqipes standarde", (Konferencë), Tiranë, 1 Maj 2004.

⁶⁰ GJ.Shkurtaj, "Si të shkruajmë shqip", Tiranë, 2008, fq.28.

Ndikimi i disa gjuhëve të huaja, si italishtja, frëngjishtja, anglishtja po ndihet çdo ditë e më shumë.

Huazimet janë të dylllojshme, të domosdoshme dhe huazime të panevojshme, të cilat çdo gjuhë dhe nëpërmjet saj qytetërimi dhe kultura që e mbajnë atë gjallë, i bën në etapa të caktuara të historisë e të zhvillimit të saj. Huazimet janë fjalë që kanë hyrë në disa rrugë.

Huazim i domosdoshëm do të konsiderohej ajo fjalë, ai togfjalësh apo ajo strukturë morfosintaksore që vjen bashkë më një send, dukuri apo koncept të ri. Të tilla mbeten sidomos ato të sferave racionale, konceptuale, shkencore e teknike të cilat ende nuk janë të pasqyruara në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të ribotuar në 2006⁶¹.

Huazim i panevojshëm do të konsiderohej ajo fjalë, ai togfjalësh apo ajo strukturë morfosintaksore që vjen pa shoqëruar ndonjë send, dukuri apo koncept të ri. Ajo që do ta përkufizonte më mirë këtë të dytin do të lidhej me fjalët pavetëdihe, lehtësi, diçka sipërfaqesore, snobizëm, apo më keq akoma siç shprehet studiuesi E. Tupja “snobordhacëri”. Të tilla do të rendisim disa si :

- Lider për udhëheqës
- Religjion për fe
- Resurse për burime
- Akord për marrëveshje
- Gep për hendek etj.

Në këtë sferë do të rendisim edhe pasthirrma emocionale, dhimbjesh, habie, përshëndetjesh të mbetura “peng” nga gjuhët e huaja. Edhe pse mjaft të lehta në përdorim e në komunikim, ato po çojnë në rritjen e shpejtë të dy dukurive: shtrembërimin dhe zhdukjen e fjalëve burimore të gjuhës shqipe. Pas rënies së komunizmit dhe vendosjes së demokracisë, nuk përdoren më historicizmat që i referohen ideologjisë së komunizmit, të tilla si : *perestrojka, gllasnost, revizionizëm*, por vendi iu është lënë termave të reja që lidhen drejtpërdrejt me ideologjinë e re të sistemeve demokratike .Nëpërmjet përkthimit, gjatë komunizmit, shumë terma që u përdorën në gjuhë si: *klasë, kooperativë, luftë e klasave, imperializëm, ndërgjegje, diktaturë e proletarialit, Perestrojka, KGB-ja, kryetari i kooperativës, byroja politike*, kanë pushuar së qeni fjalë të ditës dhe pak e nga pak po e humbasin tërësisht përdorimin e tyre. Shpesh, të përshtatura ose jo në sistemin e gjuhës huazuese, njësitë e huazuara mbeten gjithsesi huazime sipas gjuhës së origjinës. Është rasti për shembull i fjalëve të ardhura nga anglishtja: *subsidiaritet, aparteid, samit, facebook, twitter, lider, janki, leadership, lobj, lobim, nga italishtja : mafie, ideato, maxhoranc,*, nga frëngjishtja : *acquis communautaire, byro, ambasador, neodiktaturë*, që nuk janë fjalë me origjinë nga shqipja , por fjalë të huazuara. Thomai shprehet se fjala është njësia gjuhësore që huazohet më lehtë dhe më shpejt. Kështu, ka gjuhëtarë të cilët i

⁶¹ Akademia e shkencave, “Fjalori i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006.

ndajnë huazimet leksikore sipas rrugës së huazimit, sipas përmbajtjes së huazimeve, sipas shkallës së ngulitjes në sistemin e gjuhës. Fjalët të cilat huazohen janë shumica emra, sintagma nominale, mbiemra (bilateral), sigla (NATO, GjNP), shifra (*II shtatori, G7, G8*). Ndërkohë që listës së huazimeve të tërthorta mund t'i shtojmë edhe fjalë të gjuhëve japoneze, arabe, etj të cilat në të shumtën e rasteve hyjnë nëpërmjet anglishtes : *kamikaz (Jap/via Ang), muxhahedin, Al Kaeda, taleban, HAMAS, Xhihad, ajatollah, ISIS, etj*. Si rregull i përgjithshëm fjalët e huazuara mund të jenë të ngulitura ose të pangulitura.

Huazimet janë të ngulitura në rastin kur ato plotësojnë një boshllëk në të shprehur dhe pasqyrohen rrjedhimisht në fjalorët shpjegues të çdo gjuhe. Ndryshe këto fjalë mund të quhen edhe **ndërkombëtarizma**. Janë fjalë ose terma specifike të gjuhës së shkencës dhe të teknikës, të cilat njihen dhe përdoren **ndërkombëtarisht** si të tilla në shumë gjuhë të botës. Zakonisht nocionet e reja që krijohen nga specialistët e fushës pas një dukurie të caktuar kërkojnë që të krijohen edhe fjalë-terma për të emërtuar këto nocione. Konceptet e këtyre nocioneve (forma) kalojnë më pas nga gjuha e shpikjes së nocionit drejt gjuhëve të tjera ku ky nocion mungon.

Në këndvështrim diakronik, huazime të ngulitura në fushën e politikës fillojnë që me huazimet e koncepteve me prejardhje të gjuhëve greke e latine, deri tek ato të mëvonshme nga gjuhët e tjera ndërkombëtare, si ato të familjes gjermanike (gjermanisht, anglisht), sllave (kryesisht rusishtes) : *perestrojkë, protollok, gllasnost, politikë, shtet, territor, real-politikë, parti, demokraci, liberalizëm, globalizim, grusht shteti, europarlamentar, luftë kundër terrorizmit, konsensus, kompromis, liberalizim*.

Huazimet e **pangulitura** ose barbarizmat janë fjalë të cilat janë në konkurrencë të vazhdueshme me fjalë të brumit të shqipes dhe që, në parim, hasin një qëndresë të drejtë të leksikografëve për të mos i përfshirë në fjalorët shpjegues. Megjithë këtë qëndresë, fakt është se huazimet e pangulitura në ligjërimin politik, përbëjnë problematikën reale të huazimeve. Për shumë kohë tashmë, në ligjërimin politik vendas nuk parapëlqehen fjalë të tilla si : *zbatim, miratim, shumicë, pakicë, kuvend* por gjegjëset e tyre të huaja : *implementim, aprovim, mazh(xh)orancë, opozitë, parlament*.

Pothuajse të gjithë kanë rënë në kurthin e snobizmit leksikor, fjalët e huaja u shërbejnë atyre si një ekran për të filtruar dhe pse jo për të fshehur difektet dhe dobësitë. Samara jep një tjetër pikëpamje në lidhje me këtë :

« Për arsye të tipareve të këtij leksiku, por gjithashtu për shkak të mungesës së vëmendjes dhe prirjes drejt kulturës së gjuhës nga ana e disa politikanëve (me fjalimet e tyre) dhe të disa gazetarëve, analistëve (me shkrimet e tyre) ndodh që leksiku i kësaj fushe të ndihet si pjesa më « e pisët » e fjalëve të huaja të panevojshme ».

Kalket janë një lloj huazimi që nënkupton kalkimin e gjuhës së huaj në planin leksikor dhe sintaksor. Në rastin e parë, ruajmë sintagmën e gjuhës burimore dhe përkthejmë çdo fjalë, fjalë për fjalë (literalisht).

Me këtë lloj përkthimi arrijmë të krijojmë një shprehje të re – një shprehje të kalkuar p.sh.: *acte terroriste /akt terrorist; intégration régionale/integrim rajonal; intérêt national/ interes kombëtar; arms control/ kontroll i armatimeve; international community/ bashkësi ndërkombëtare; project-resolution / projekt-rezolutë*. Nga japonishtja nëpërmjet anglishtes :

- *kamikaz*

Le të shohim si ka evoluar kjo fjalë në gjuhën shqipe.

Kamikaz,-i, m.sh.-ë(t) *edhe si mb.*, ai që vetëvritet (zakonisht me eksploziv, duke vrrarë edhe të tjerët përreth [FGJSH 2006]

Në rrafshin leksikosemantik shohim se kjo fjalë bën pjesë në terminologjinë e terrorizmit (nënfushë e terminologjisë së marrëdhënieve ndërkombëtare) dhe është pasuruar me modifikime semantike dhe kuptime të tjera, të cilat përdoren tashmë në leksikun shqiptar.

Kështu, sipas fjalorit « le Trésor de la langue française », në fillim fjala *kamikaz* emërtonte dy stuhi të cilat në vitet 1274 dhe 1281 shkatërruan tërësisht flotën e pushtuesve mongolë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore për të emërtuar sulmet japoneze ndaj anijeve luftarake amerikane kjo fjalë përdorej me dy kuptime. Së pari, për të emërtuar avionët e ngarkuar me eksploziv, avionë të cilët pilotoheshin vetëm nga vullnetarë vetëvrasës (nga ku buron dhe termi *avion-vetëvrasës*); dhe, së dyti, për të emërtuar aviatorët ushtarakë japonezë të cilët i përplasnin avionët e tyre me anijet ushtarake armike. Sot, në analogji me këtë, termi përdoret në terminologjinë e terrorizmit për të shenjuar një terrorist i cili vetëvritet duke shpërthyer një bombë që e mban në trupin e tij me qëllim që të vrasë sa më shumë njerëz.

- Anglicizmat në shqipen e politikës janë të shumta: *impakt, lob, lobim, mediator, draft, census, liberalizim, miting, samit, sexgate, slogan, baner, preambul, establishment, bojkot, exit-poll, leader, lider, lidership, leadership, tweeter, facebook*. Tipar i anglicizmave të plota në shqipe janë ndjekja e dy a më shumë parimeve për ngulitjen e tyre në gjuhë, duke filluar me atë fonetik, morfologjik, historik, kulturor e etimologjik. Kështu tipar për shqipen janë dysorët (prani e njëkohshme e dy varianteve të së njëjtës fjalë në të shkruar). Integrimi i anglicizmave në shqipe jo përherë ndjek parimin e shqiptimit, pra fjalët duhet të shkruhen ashtu si shqiptohen. Kështu, kemi në shqipe. *Background*, por edhe *begraund, dizajn/design, uorkshop/workshop, task-force/task forcë, data base/databazë, biznesmen/biznesmen, bill of rights, one-stop-shop, impeachment, benefit, resurs*. Anglicizmat shfaqen si: hibride, semantike, sintaksore, morfologjike frazeologjike, etj. Huazimi lind pasi: lind teorizimi i fushës politike (koncepte kyçe dhe metoda të shkencës politike: *komunizëm, shekullarizim, barazitizëm, shtetizëm, qytetari, antiglobalizëm, neo-institucionalizëm, holizëm, teoria e përfaqësimit, koncepti i rrjetit, nocioni i rolit, shoqëri segmentare, socializim politik, hiperterrorizëm*; për të dhënë praktikat e pushtetit, strukturat: *parti, kryetar shteti, regjim demokratik, sistem kapitalist, deputet, rend botëror, koalicion, grupe përkatësie, grupime reference, sektori anti-mafia, ministria e integritetit*; si ndërveprim me fushat e tjera: historia, ekonomia, ligji dhe drejtësia, filozofia, feja.

4.6.2 Psthirrat ideoemocionale, shenja-shprehi që po i zhdukin shprehjet tona shqiptarçe

Ajo që na dallon nga gjallesat e tjera në këtë botë është arsyeja dhe aftësia e të shprehurit të gjendjes, botës sonë të brendshme ideoemocionale. Mjaft të përdorshme e që zënë një vend të gjerë në të përditshmen tonë, janë edhe huazimet që shprehin gjendje emocionale. Bëhet fjalë këtu jo vetëm për psthirrat, si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, por edhe për fjalë të tjera pjesë me vlerën e një psthirme për shembull ndajfoljet psthirmore⁶². Ç’është e vërteta secili popull ruan psthirrat e veta për të konkretizuar gojarisht reagimet e tyre emocionale (ndjenjë, dëshirë, vullnet etj). **Emocionet as importohen dhe as eksportohen.** Mund të huazohet, por gjithnjë në mënyrë të panevojshme, si trupa, si” mish i huaj” në shpirtin dhe mishin e gjuhës sonë. Të tilla mund të rendisim disa: **Psthirra që shprehin habi, kënaqësi a gëzim.**

Ah! Heu! O! Oh! Ua! Tani përdoren psthirrat Uau! dhe Ups! (të cilin profesor Tupja e konsideron si “përbindëshi i huazuar nga disa gjuhë euro-perëndimore”) **Psthirra që shprehin dhembje**

Oh! Uh! Oi! Olele! Tani konkurojnë me Aj! nga frëngjishtja. Ëëë... e cila shpreh ngurrin në të folur tani po zëvendësohet me Aa... nga anglishtja e SHBA-së. **Emra, togfjalësha, ndajfolje me vlerë psthirmore.**

- Po, mirë, bukur, xham, kryevepër, në rregull, u bë, mori fund, se luan topi tani kanë përballë shprehjen Ok! të huazuar nga anglishtja SHBA-së.
- Ec, hë, jepi, hajde, hajt, o burra, forca, yrrja, para, përpara tani përdoren me Go, Fast, Go Aëay, Let’s go on nga anglishtja e SHBA-së.
- Ku ma gjen! E puth dhe e vë në ballë! Përballë kanë tashmë magari. (nga italishtja).
- Dreq, pirdhu, llaka-llaka, dërr-dërr, gam-gam, po përballen me merda italisht, shit dhe fuck nga anglishtja dhe bla – bla – bla të italishtes apo frëngjishtes, si edhe variantin e hiperbolizuar blla – blla – blla të anglishtes.

⁶²E. Tupja, “Si po i zhdukim shprehjet tona shqiptarçe”, Gazeta “Panorama”, 28 Prill 2004.

- Huazime- rrjedhojë e një përkthimi servil: mos, mos more, jo more, ç'thuhet përballen sot me jo (more) përkthim që vjen prej No! ose Non!, të anglishtes dhe italishtes.
- “Tungjatjeta” përballet me “Mirëdita” si përkthim i fjalës përshëndetëse italiane “Buongiorno” ose “Hi”! (shkurtim për How are you?)
- “Tungjatjeta” sot përballet me “Tung” si shkurtim i kësaj shprehjeje ose me “Tjeta”.
- Mos e vrit mendjen, mos e çaj kokën, në rregull përballen me shprehjen ‘s’ka problem’ e cila rrjedh prej frëngjishtes, anglishtes e italishtes për No problem, pas de probleme, non c’e problema.
- Krijime përmes një përkthimi servil të urimeve të përcudnuara. Paç fat, të priftë e mbara, të vaftë mbarë përballet sot me italishten Buona fortuna(me fat të mirë).
- Mirupafshim ka përballë sot Shihemi të italishtes ci vediamo ose anglishtes see you later.
- “Mirudëgjofshim” tani përdoret:” Dëgjohemi” prej italishtes “Ci sentiamo”.
- Mirardhshi tani përdoret Jeni të mirëpritur nga anglishtja “You are welcome”. Kjo do të çojë së shpejti në bjerrjen përfundimtare të dëshirores së shqipes.
- Huazime të panevojshme gjestesh emocionale, të dhunshme, që bien ndesh me traditonalet shqiptare. Për shembull: gishti i madh lart, të tjerët të mbledhur grusht para disa vitesh si gjest shoqërohej me pasthirmën **“na” me kuptimin “ti s’ma hedh dot” apo “hip këtu e shih Stambollin”**. Sot nën ndikimin e huaj ka marrë kuptimin e kundërt për shumë mirë, shumë bukur, ok, jam dakort.
- Gishti i mesit lart e të tjerët të mbledhur grusht përfaqëson një shtrembërim të gjestit shqiptar, por jo të kuptimit të tij nën ndikimin italian për Ç’bën kështu! Ku të çon mushka! A je në terezi!
- Gjesti i tundjes së kokës huazohet për përdorimin e pohimit ose mohimit të diçkaje. Sot norma e shqipes po kombinohet me një normë të paemër dhe tingëllimi i saj krejt natyral ka marrë një formë më të vvarë.

Sipas disa studiuesve fjalët e huaja e pasurojnë gjuhën e sipas disa të tjerëve e prishin atë.

Do të duhet të pajtohemi me mendimin e disa gjuhëtarëve se gjuha pranon fjalë të huaja të domosdoshme për përmbajtjen e tyre, por është i papërligjur vërshimi pa kufi i fjalëve të

huaja të panevojshme. Përgjegjësia kryesore që bie mbi politikanët është se ata, duke dashur të kopjojnë ose, duke u shprehur përciptazi, përdorin terma “qesharakë” për popullin dhe e bëjnë absurde dhe kaotike situatën gjuhësore. Një gabim gjuhësor vihet re me termat e reklamave ose emërtimet e titujve të mallrave që shiten. Ato nuk përkthehen ose përshtaten drejt në gjuhën shqipe, por i mbeten besnikë origjinalit në gjuhën e huaj.

Në gjuhën shqipe huazimet janë të trajtave të ndryshme⁶³. Ato janë **të plota** kur fjala ka hyrë si në gjuhë të huaj, p.sh: futboll, bursë, adresa, depo etj; **Strukturore** kur fjala në të vërtetë është shqip, por e ndërtuar sipas modelit të një fjale të huaj, ndryshe **kalke** si p.sh: bashkëtingëllore, drejtshkrim, ndajfolje, kryevepër, i jashtëzakonshëm, rrënjësisht etj. Huazohen gjithashtu edhe parashtesa e prapashtesa si : -içë, - nik, - kë, - it nga sllavishtja, - xhi, - ci, -llarë; - llërë, - llëk nga turqishtja.

Huazimi konsiderohet i drejtpërdrejtë ose i tërthortë si në rastet më poshtë:

- a) qytet, mur, shëndet, që vijnë direkt prej latinishtes
- b) fjalët me burim grek: sinonim, gramatikë, sintaksë, telefon, janë marrë nga gjuhët neolatine si gjuhë ndërmjetësuese, të treta.⁶⁴

Sot në Shqipëri në situatat më banale të kap veshi fjalë e shprehje joshqip që përdoren krejt pa nevojë. Kur i kërkon dikujt një shami letre, ai të pyet duke të ndrequr “deshe një faoletin?” ose kur në restorant kërkon spaghetti me domate të vogla të korrigjojnë “me pomodorini” çka të bën të mbetesh pa gojë për shqipen tënde të vjetëruar. Të tjera fjalë të huaja përdoren në shtyp :

- “Policia do të intervenojë në çdo rast” për “ndërhyjë”
- “Ekspluatimi i këtij rasti nga opozita” për “shfrytëzimi”
- “Elementi rrisues” për “rrezikues”
- “Kryetari Rama realizoi një konferencë shtypi” për “kreu” ose “dha”
- “Kemi një klimë inekzistente” për “të paqenë”
- “Pastaj u skatenua për “harbua, tërbua, doli nga zinxhirët”
- “Demontimi i municioneve” për “çmontimi”
- “Kjo agjenci lajmesh bën me dije” për “bën të ditur”

⁶³ J.Thomai, “Leksikologjia”, Tiranë, 2006, f.38.

⁶⁴ A.Ballhysa, “Gjuha dhe përdorimi i saj.Çështje teorike-praktike.”, Sejko.

- “U demantua nga vetë Shtëpia e Bardhë “ për “u përgënjeshtroa”
- “Fakti se fatin e Kosovës do ta zgjidhin Bush e Putin, bën me dije për influencën e kufizuar të Evropës” për “ dëshmon”

Në gojën e politikanëve kosovarë p.sh., Thaçi i drejtohet popullit të thjeshtë para zgjedhjeve me fjalët : “**Duhet të partecipojmë** të gjithë në zgjedhje “ ose “Populli i Kosovës më **ka nominuar** kandidat”⁶⁵.

Sërish ne mbetemi në dilemën e famshme “të rroj apo të mos rroj” që përkthehet “t’i përdorim apo mos t’i përdorim fjalët e huaja”? Profesor Kolec Topalli kësaj dileme i jep përgjigjen se “gjuha nuk është monument kulture. Ajo është dinamike, siç është vetë jeta...” Në kohën e sotme gjuha shqipe ndodhet para sfidave të reja që sjell hapja e shoqërisë, zhvillimi i vullshëm dhe i gjithanshëm i jetës, globalizimi, interneti, media, teknologjia .

“Në këto shtjella të mëdha gjuhësh e civilizimesh, me mbisundim të elementit anglo-amerikan, gjuha shqipe e përdorur mish-mash, me frymë(model) e me fjalor të huaj, rrezikohet të bëhet edhe kjo si kanadishtja, gjuhë me gramatikë angleze e me fjalor amerikan, apo si anglishtja e përkthyer në gjuhën shqipe.”

Qemal Murati Sfidë, “Gjuha e Sotme Shqipe – Prirjet e reja “Evropianizuese”, 2005 .IV.

⁶⁵Q. Murati, “Gjuha e sotme shqipe”, vol 4, Tiranë, 2005, fq. 58.

FJALOR

5.1 Fjalorth-tregues me fjalë e terma nga fusha e leksikut politik

1. **A priori** – 1710 “nga shkakun tek efekti” një term i logjikës në referencë me” të arsyetosh, të japësh shkakun, të bazosh, të argumentosh, të gjykosh, t’i mbushësh mendjen dikujt”. Pra, argumentation – argumentim, arsyetim, latinisht fjalë për fjalë “ për atë çka vjen së pari nga priori, rrjedhoja e prior “ së pari “ (shih prior si mbiemër e përdorim lirshëm për “në përputhje me dijet e mëparshme” (1834). Prior – oficeri më i lartë i një shtëpie religjioze të urdhërit 1093. Nga latinishtja “prior” i mëparshëm , superior. Prior si mbiemër 1714 nga latinishtja “prior” i mëparshëm, krahasuar me latinishten e vjetër “ më parë, i pari” , i lidhur me latinishten “më parë” [shih pre-]. **“Takimi dhe biseda e kryetarit të qeverisë shqiptare me kryetarin e një shteti fqinj qoftë ky edhe Millosheviçi i Serbisë nuk mund të gjykohet a priori”.**

2. **Abandonoj kal** - e huazuar nga frëngjishtja abandonner, me burim nga frëngjishtja e vjetër a bandon. Lë, lë pas dore, braktis. Kjo fjalë zëvendësohet me fjalët që kanë të njëjtin kuptim si: lë, lë pas dore, braktis, i braktisur, p.sh: *Nuk e kanë lënë shpresat. S’e lë pas dore punën. Braktisën anijen. Shtëpi e braktisur..*

3. **Abdikim** – (lat. abdicatio – dorëheqje) të hequrit dorë zyrtarisht nga autoriteti sovran, dorëheqje (për sundimtarin)

4. **Abnegacion**, - i. E huazuar nga frëngjishtja abnegation, me burim latin abnegatio. Kjo fjalë e huaj zëvendësohet plotësisht me fjalën shqipe vetëmohim.

5. **Abrogim** – abrogate 1520 sinonime të fjalës: shfuqizoj, anuloj, nga latinishtja abrogates, abrogare “anuloj, shfuqizoj një ligj; nga ab “ larg” + rogare “propozim, ligj, kërkesë, lutje.” Përdoret si mbiemër abrogues në mes të shek xv-të I lidhur me shfuqizimin, anulimin, nxjerrjen jashtë të një ligji që bie ndesh me kushtetutën. **“Lidhur me ligjin elektoral kam përshtypjen që një nga çështjet më të qarta ishte kërkesa e Shiderit që midis të tjerash, të kërkojë domosdoshmërisht abrogimin e ligjit të antigjenocidit që pengon...”**

6. **Abrogoj** ~ova, ~ohet, ~uar, - fjala e ka origjinën në vitet 1520-1530. Vjen nga latinishtja abrogare, e formuar nga ab+rog+atus. Të shfuqizoj me mjete formale apo zyrtare, për shfrytëzimin e një ligji.

7. **Absorboj** *kal.*, absorbim – i *m.*, absorbues, - e *mb.* Folja absorboj me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, përdoret zakonisht në letërsinë tekniko-shkencore me kuptimin “e tërheq diçka dhe e mban brenda vetes, e thith tërësisht. Kjo fjalë zëvendësohet me fjalën shqipe përthith, psh: *qymyri përthith ngjyrat e gazet ose avujt e lëndëve helmuese. Përthith një sasi nxehtësie.* Në kuptimin e figurshëm, në vend të fjalës së huaj përdoren fjalët shqipe thith, përvetëson, bën të vetën, psh: poezia e re shqiptare ka thithur (ka bërë të vetën) në mënyrë krijuese edhe vlerat e poezisë sonë folklorike.
8. **Abstenoj** - (lat. abstinere – përmbahem) përmbahem nga një votim, nuk votoj, nuk marr pjesë në votim, nuk shprehem as “po” as “jo” për një vendim që merret me votim, shmangem.
9. **Abstragoj** – nga angl.abstract- përmbledh, shkëpus, veçoj.
10. **Absurd-e** – adj. (lat.absurditas – i paaftë për t’u kuptuar) që është në kundërshtim me arsyen e shëndoshë e me logjikën, që është pa kuptim, jashtë mendjes.
11. **Ad hoc** – ang.mbiemër (i këtij rasti)
12. **Ad literam** – (lat.) fjalë për fjalë (.angl.ad= emër- e tipit reklamë). Përdoret edhe si shkurtime + literal – po angl.literati- e përdorur si emër për të treguar një njeri të ditur, një njeri të letrave. E përdorur në shqip do të ishte: reklamë prej njerëzish të ditur.
13. **Adapt** – e *mb.* Ky mbiemër me prejardhje të huaj përdoret kryesisht për të cilësuar një njeri që ka aftësitë e vetitë e nevojshme për t’u marrë me diçka psh: njeri adapt për këtë detyrë. Njerëz (persona) adaptë etj. Këtë kuptim e jep fare mirë fjala shqipe i përshtatshëm p.sh : *njeri i përshtatshëm. Është i përshtatshëm për atë detyrë.*
14. **Adaptoj**.v – (lat.adaptare – përshtat) shndërroj, modifikoj.
15. **Adekuat/e** – (lat.adaequatus - i barazuar) që përputhet plotësisht me diçka tjetër, që i përshtatet a i përgjigjet plotësisht diçkaje tjetër. (angl.adequate – i mjaftueshëm që plotëson kërkesat).
16. **Aderoj** v – (lat. adhaerere – bashkoj) bashkohem me një pikëpamje, me një ide, me një rrymë të mendimit, bëj (bëhem) anëtar i nje organizate a shoqate.
17. **Adio** *pasth.* – kjo fjalë e huazuar nga italishtja po përdoret gjithnjë e më pak dhe kryesisht në gjuhën e folur. Në vend të fjalës adio,që lidhet me botëkuptimin fetar, të formuar nga përngjitja e parafjalës a “te” me emrin ‘Dio’ –Zoti, gjuha shqipe ka përsëritur lamtumirë dhe mirupafshim. Fjala lamtumirë përdoret kur largohemi për në një vend tjetër ose kur ndahemi nga një njeri i dashur a diçka për një kohë të gjatë a përgjithnjë, ndërsa fjala ‘mirupafshim’ përdoret si shprehje kur ndahemi nga një njeri i dashur a diçka jo për një kohë të gjatë.

- 18. Adjutant-i** – (lat.adjutans – ndihmës) oficer i caktuar pranë një komandanti ose pranë një shtabi për të kryer detyra ndihmëse, oficer ndihmës.
- 19. Administratë** – (lat.administratio – drejtim) 1. Sistem i veprimtarisë shtetërore për të ushtruar pushtetin shtetëror, qeveria; 2. Njësi organizative që kryen punët administrative në një sektor të ekonomisë, kulturës etj; zyrat e kësaj njësie; 3. Tërësia e punonjësve që veprojnë në aparatin shtetëror, në një njësi organizative të administratës.
- 20. Adresim** – (fr.adresser – drejtoj) të shënuarit e adresës së dikujt ose të diçkaje, drejtim.
- 21. Afashinante** – mb (it. affascinante –magjepsës) 1.rrëmbyes, magjepsës, grua magjepsëse; 2.fig.libër magjepsës, që të rrëmben. *“Zoti Rama kjo nuk është veçse teoria e hollë e afashinante me të cilën ti po kërkon t’i marrosësh militantët e tu”*.
- 22. Aferë** – (fr. affaire- grindje) komplot, skandal, rast që shkakton sensacion. *Ky zotëria këtu që shihni ju është i përfshirë në një sër aferash korruptive, ndaj fshihet nga ligji.*
- 23. Afinitet** – e huazuar nga italishtja affinita, me burim latin affinitas; ngjashmëri, krushqi, raport simpatie, fqinjësi.
- 24. Afirmim** – e huazuar nga frëngjishtja affirmation, me burim latin nga folja affirmare. Pohim, them po.
- 25. Agjitacion** – nga latin agitato(“ose intensive, lëvizje të shpeshta”) që rrjedhin nga agitare. Gjendje e të qenit e tensionuar.
- 26. Agravoj/agravohem** – it. aggravante; rëndues, rrethanë rënduese, e përkeqësuar.
- 27. Akcent** – Fjala e ka origjinën në vitet 1520-1530. Vjen nga latinishtja accentuse formuar me parashtesim ac + centus. 1.Theks, mënyrë shqiptimi ose theksimi e tingujve, fjalëve ose e fjalive në të folur, mënyra e të folurit që është karakteristikë për një njeri a për një grup shoqëror; ndryshim i zërit (ulje, ngritje, forcim, dobësim etj), që shpreh ndjenja të caktuara të folësit, theksim. 2.fig.karakter i veçantë që ka ose që merr diçka;ngjyrimi i diçkaje. *Dëgjova që po thoshte me një akcent peqinas fq.23(Piedestale)*
- 28. Akci** – është fjalë e vjetëruar e ligjërimit bisedor. Për këtë huazim nga turqishtja kemi fjalën shqipe gjellbërës.
- 29. Akomodim** – me kuptimin strehim, dhomë banimi, dhomë në dispozicion; dëshmohet që nga 1600-ta nga akomodohem, strehohem prej frengjishtes accommodation, prej latinishtes accomodationem, accommodation. Kuptimi “diçka/dikush që ofron ndihmë; aplikim; zbatim” është që prej 1610-ës; “akti i të akomoduarit” si emër dëshmohet që në 1640-ën. **“Në një hierarki të zezë, njeriu më i keq akomodohet në vendin më të errët”**. I.

Kadare

- 30. Aks** – e huazuar nga frëngjishtja axe, me burim latin axis. Për këtë fjalë gjuha shqipe ka fjalën më të përgjithshme bosht.aksi politik;vije politike,synim,drejtim.
- 31. Akseleracion** –(lat. acceleratio – nxitje, shpejtim) përshejtim,të shtuarit e shpejtësisë së lëvizjes së diçkaje.
- 32. Aksenti** – accent “të shqiptosh me theks ose stress” 1520. Nga frëngjishtja accenter, nga frëngj vjetër acenter, accent që do të thotë “mënyrë e veçantë shqiptimi”; theks nga latinishtja fundshekulli 14-të, accentus “këngë që i shtohet ligjërimin, fjalës” nga ad-“te” + cantus “një këngë”. E huazuar nga greqishtja prosodia nga pro (për) + oide (këngë, melodi) merr kuptimin e “diçkaje që thekson ose nxjerr në pah,ujdisje” 1972. “**A ndryshoi aksenti i politikës shqiptare për çështjen çame.**”
- 33. Akses** – pasojë, hyrje, e drejtë, krizë, shpërthim, mundësi për të hyrë ose për të përdorur mbeten si sinonime të fjalës. E përdorur në fillim të shek 14-të me kuptim “sulm i etheve” nga frëngjishtja e vjetër acces “sulm, fillimi i një sëmundjeje” (shek 14-të) nga latinishtja accessus “ një ardhje, një pasojë, një afrim”. Kuptimet e mëvonshme vijnë direkt nga latinishtja. Kuptimi “ një hyrje, një prolog” është nga 1600-ta. Kuptimi” zakon ose fuqi për të ndërhyrë në jetën/prezencën e dikujt ose diçkaje” vjen në fundshekullin e 14-të. Si një folje së pari dëshmohet në 1962, fillimisht në informatikë, e lidhur me kuptimin vizitë, qasje,leje kalimi,fjalëkalim në një program”.
- 34. Aksiq** ndajf dhe mb- është fjalë me prejardhje nga turqishtja dhe, si shumë turqizma të tjerë përdoret në ligjërimin bisedor. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” e çon te fjala metë, mangët dhe metë (i, e) mangët (i, e).
- 35. Alinjohem** – me burim francez nga folja aligner. Rradhiten, rreshtohen libra.
- 36. Alokacion** – (latinisht ad- al + location- vend); anglisht allocation; 1.shtim shtojcë; 2.ek. lejim i një llogarie ose i një paragrafu, që futet më vonë në një llogari. *Të njëjtën rritje do të kenë edhe llojet e tjera të pensioneve e të tjera alokacioneve që shpërndahen nga buxheti i shtetit.*
- 37. Alokim** - nga latinishtja locare. Jap me qera.alokimi i fondeve,i buxhetit qeveritar.
- 38. Alt pasth-** në vend të saj përdoret fjala shqipe ‘ndal’, si në terminologjinë ushtarake ashtu dhe në atë sportive p.sh: - *Ndal! Kush kalon? Thirri me zë të lartë: Ndal!*
- 39. Ambigue** – nga latinishtja ambiguus, nga ambigere (“dyshim”), fjalë për fjalë e cila rritet nga të dy anët. E cila mund të kuptohet në dy kuptime.
- 40. Ambiguitet** – nga angl.ambiguity- dykuptimësi; nga ital.ambigua- i dyfishtë.
- 41. Amplifikim** – amplification. Që në 1540-ën “zgjerim” nga latinishtja amplificationem (emri amplification)” një shpërhapje, një zgjerim, zgjatim, zgjatje, i shtrirë, gjerësi, madhësi”

si emri i veprimit. Kuptimi elektronik i termit vjen që në 1915-ën” përforsim, zmadhim, amplifikim” ; si folje amplifikoj vjen që herët nga shekulli 15-të” të zgjerohet, të shtrij, të shpërhap”. Nga frëngjishtja e mesme amplifier, nga latinishtja amplificare; “të zgjerohet” nga amplificus, “i mrekullueshëm” nga amplus “gjerë” (shih ample) + rrënjën e facere “bëj” (shih factitious). Nëkupton “shtim, rritje në volum ose sasi “që si kuptim vjen që nga 1570-ta. Ngushtësimi në përdorim (për zërin) duket se ka dalë në kohën elektronike, 1915-ën në lidhje me teknologjinë e radios. “**Kjo lloj zhurme është amplifikuar në Kosovë nga forca të caktuara kundërshtarë të qeverisë”.**

42. Anarshia – anarkia vjen nga greqishtja, që përkthehet si “pa sundues”. Fillimisht fjaa është përdorur për të treguar çrregullim, kaos, mungesë të harmonisë.

43. Anatemohet – (angl.anathematize – shkishëroj, mallkoj); (ital.anatema- mallkim)

44. Anonçoj - folje nga frëngjishtja, publikoj, bëj të ditur.

45. Anti – parashtesë me prejardhje nga greqishtja e vjetër. Ka hyrë në gjuhën shqipe në përbërjen e disa termave të huaj që kanë përdorim ndërkombëtar psh: antibiotic, antidemokratik, antidialektik etj. Kjo fjalë është zëvendësuar e po zëvendësohet me parashtesën e shqipes kundër-, që e jep të plotë kuptimin e parashtesës anti-. Kështu përdoret *kundërajror* në vend të *ajror* ose *kundërligjshëm* në vend të *antiligjor*, *kundërtank* në vend të *antitank*, *kundërhigjenik* në vend të *antihigjenik* etj. Kuptimi i fjalës në asnjë rast nuk preket.

46. Antidatë- t f(it.antidatë) kal.paradatoj, paradatoj një letër.

47. Antidemokratizëm – nga demokratike me prefiksin anti- , jodemokratike.

48. Antidiskriminim-oj/im – ues mb. (anti+lat.discriminis –veçim, dallim) kundër dallimit të dikujt. Që mbështetet në mos diskriminimin, veçimin e dikujt.

49. Antidoti – ilaç reagues ndaj një helmi, si një fjalë latine antidotum L. “një ilaç kundër helmit”

50. Antieuropian – i mb(asir.anti+ereb-perëndim) banor vendas e Evropës ose me prejardhje nga Evropa. Antievroian-joevropian; jobanor i Evropës.

51. Antihumanizëm – m(lat. anti+humanus- jo njerëzor), që nuk ka dashuri të fortë, të thellë e fisnike ndaj njerëzve.

52. Antikomunist~e – fjala e ka origjinën në vitin 1841. Vjen nga frëngjishtja anti+communiste. E formuar me parashtesim. Kundër komunizmit

53. Antikonformist – emër, ital.anticonformismo, mosnënshtrim, jokonformist, njeri origjinal.

54. Antikonkurrues-e-ja- f(anti+lat.concurrere-vrapoj,rend) jo garues në një garë, jo konkurent me të tjerë, në tregti, ekonomi etj.

- 55. Antikushtetues** – mb(it.anticostituzionale) në kundërshtim me kushtetutën.
- 56. Antimiting~u**, m.sh.~gje,~et. – fjala e ka origjinën në vitet 1250-1300. Formohet nga meet+ing. Mbledhje e gjerë zakonisht në shesh të hapur ku marrin pjesë shume veta dhe ku mbahen fjalime, përkujtohet dikush a diçka, flitet për çështje të mëdha me karakter politik, shoqëror etj për t’iu kundërvënë një mitingu tjetër.
- 57. Antimocionist** – mbiemër, i kundërt me mocionist
- 58. Antiopozitar-iz-mi.** – m(anti+lat.oppositus-kundërvënës); kundër kundërvënies së diçkaje, që nuk pranon kundërshtinë.
- 59. Antipresident** – që është në kundërshtim të papajtueshëm me presidentin; që është në kundërshtim me rregullat dhe parimet të vendosura nga ai. Anti= parashtes me prejardhje nga greqishtja e vjetër.
- 60. Antipropagand-a** (anti, gr.anti-kundër) parashtesë që u shtohet emrave dhe mbiemrave për të shprehur diçka të kundërt që është në kundërshtim me atë që tregojnë këto fjalë pa parashtesa; kundër. Propagand-a (lat. shtrirje, përhapje).
- 61. Antireform/ë** – a. që është në kundërshtim me reformat, që lufton reformat dhe nuk pajtohet me to; nuk i zbaton reformat.
- 62. Antishqiptar** – fjala e ka origjinën në vitet 1590-1600. Me parashtesim anti merr një kuptim kundërshtues anti+shqiptar. Ai që mendon a vepron në kundërshtim me interesat e shqiptarëve.
- 63. Antisocialist**, ~e, mb.sh,~ë, ~e. – fjala e ka origjinën në vitet 1860-1866. Është formuar me parashtesim anti+socialist. Një njeri që e kundërshton socializmin.
- 64. Anuar** – i m. kjo fjalë është zëvendësuar shumë mirë me fjalën shqipe ‘vjetar’ psh: *Vjetari statistikor. Vjetar me punime shkencore* etj. Fjala anuar është krejt e panevjoshme në gjuhën tonë.
- 65. Apatrid** – mbiemër, nga frëngjishtja, ai që nuk ka kombësi në mënyrë legale, pa shtetësi.
- 66. Apelacion** - nga ital.apellativo- i apelit, titull nderi.
- 67. Apelative** – italisht appellativo mb. – titull nderi.
- 68. Apikulturë-** e huazuar nga frëngjishtja apiculture, dhe me burim po francez. Për të zëvendësuar fjalën e huaj apikulturë, që e hasim ende aty-këtu në letërsinë tekniko-shkencore është formuar prej kohësh fjala shqipe bletari. Për të zëvendësuar fjalën apikulturë, që e hasim ende aty-këtu në letësinë tekniko-shkencore, është formuar prej kohësh fjala shqipe bletari/a. Kështu mund të themi: *zhvillimi i bletarisë. Sektori i bletarisë.*
- 69. Aplikim** – (lat. applicator – prirje, ngjitje, bashkim) zbatim, vënia në jetë përdorim.

70. **Aplikoj** - (lat.amplificare – zgjeroj, rrit) e them gjerësisht, degëzoj, analizoj gjerësisht.

71. **Aproksimativ/e** – mb., aproksimativisht ndajf. Fjalët shqipe me kuptim të përafërt me aproksimativ janë i afërt, i përafërt, përafërsisht, përafrisht, me përafërsi që i zëvendësojnë ato plotësisht. Psh: *Shpenzimet kapën një shumë të përafërt prej 19 750 lekësh. Nga këto të dhëna të përafërta del se sa dëme të mëdha i shkaktonte ekonomisë. Kjo sipërfaqje llogaritet përafërsisht 463 70 km².*

72. **Areal** – ital. area-sipërfaqe

73. **Asete** - që nga 1530-ta “pasuri të vetemjaftueshme” nga frëngjishtja asetz, assezt (shek 11-te) mjaftueshmëri, kënaqësi, kompensim” si emër ose si ndajfolje do të thotë “mjaft, shumë, një marrëveshje e madhe e kënaqshme” nga latinishtja ad “për të” + sotis “mjaft”. Si term ligjor, juridik merr kuptimin “pasuri të mjaftueshme”(për të kënaqur borxhet dhe trashëgimite u kthye në një term të përgjithshëm si “ pronë që teorikisht mund të konvertohet në para të gatshme, të thata” që në 1580-ën; përdorimi si emër në njëjës artificial asset vjen në shek 19-të. Sinonime: aktivitet, pasuri, vlerë. **“Kur të dimë, përmasat e pasurive, të aseteve e likuiditeteve do të shohim se çfarë mund të ndahet.”**

74. **Asistent/i** – m., asistoj jokal. Këto fjalë kryesisht librore mund të zëvendësohen mjaft mirë me kuptimin themelor me fjalë shqipe. Kështu në vend të asistent përdoret fjala shqipe ndihmës psh: *asistent i inxhinierit (i regjisorit, i profesorit) – ndihmës i inxhinierit (i regjisorit, i profesorit) etj.* Edhe fjala asistoj zëvendësohet me fjalët ndodhem, gjendem, jam i pranishëm, marr pjesë psh: *Në mbledhje asistonin edhe... -Në mbledhje ndodheshin edhe... Asistoi në operim – Qe i pranishëm në operim. Asistuan shumë veta – Morën pjesë shumë veta. etj.*

75. **Asocimi** (association) – shoqatë, shoqëri, asosacion. Përdoret në 1953 me kuptimin “veprime që vijnë së bashku” nga latinishtja mesjetare associationem, asociacion si emër veprimi. Kuptimi “ një grup personash me një qëllim të përbashkët” dëshmohet që në 1650-ën . Kuptimi “lidhje mendore” dëshmohet që në 1680-ën. Kuptimi i largët për “cilësi ose send i thirrur në mendje me diçka, dikënd tjetër” dëshmohet që në 1810, pra asociimi vjen si sinonim i koleg, shok, lidhje, shoqëri, ortakëri. **“BE, 5 muaj monitorim për liberalizimin e vizave, për marrëveshjen e asocim-stabilizimit...”**

76. **Aspirata** – nga angl. Aspire- arritje, përpjekje, përpiqem të arrij.

77. **Atakoj** ~ova, ~uar, ~ohem – fjala e ka origjinën në vitet 1590-1600. Vjen nga latinishtja atacare. 1. Hedh me vrull forca të ndryshme ushtarake kundër armikut për ta mundur e asgjësuar; hidhem në sulm, mësyj.2. godas papritur me forca ushtarake, bëj

agresion. 3. Godas diçka me çdo mjet për të mos e lënë të zhvillohet, e luftoj për ta dëmtuar ose shkatërruar. 4. Godas dikë a hedh poshtë diçka me kritika e qortime të ashpra, bëj shpifje e trillime a përdor të shara për të dëmtuar diçka a dikë. 5. Bëj përpjekje të mëdha dhe vë të gjitha fuqitë për të arritur diçka, për të përvetësuar njohuri të reja etj, hidhem me vrull e këmbëngulje për të mposhtur pengesat e vështirësitë. 6. Ndërmarr veprime të shpejta e të organizuara për të mposhtur kundërshtarin dhe për të arritur fitoren në lojë. 7. I hidhem dikujt përsipër për ta goditur, për ta grabitur etj, i sulem. *Unë e kam atakuar atë personalisht.*

78. Atenuant – (it.attenuante *mb-* zbutës, lehtësues)

79. Atraksion (attraction) – Që nga 1530, nga frëngjishtja attraction, nga latinishtja attractionem “ tërheqje, një vizatim së bashku”. Si emër veprimi për attrahere. Fillimisht kuptimi i saj vjen nga përdorimi mjekësor pra një fjalë mjekësore (“thithja nga organi, trupi, absorbimin) me kuptimin veprim për të tërhequr që në 1540 (sërisht mjekësor). Më tej shkon e zgjerohet përdorimi i fjalës në fushë të magnetikës e më pas me kuptim të figurshëm i lidhur me anën personale, me cilesitë personale(1600). Kuptimi “ nje gjë që të tërheq, që tërheq nje turme; një ekspozitë, ekzibicion interesant ose zbavitës” vjen në 1829 si një kuptim që ndodh në gjuhën angleze dhe së shpejti transferohet në frëngjisht me ekuivalenten e saj. **“Kështu që ka një atraksion të brendshëm, shumë të qetë në këtë aspekt.”**

80. Atraktiv – mb(ital.attrativo-tërheqës) 1.forcë, fuqi tërheqëse, forca tërheqëse e poezisë.fig.tërheq shumë dikë; 2.fig.josh, ka shumë joshje. *“Shqipëria po dëmtohet rëndë nga mbetje të dëmshme të tilla si plastika, qelqi, të cilat dëmtojnë njëkohësisht edhe nivelin e pastërtisë dhe atraktivitetin e ambientit tonë turistik.*

81. Atribuoj kal – e huazuar nga frëngjishtja attributer dhe italishtja attribuato, me burim latin attribuere- ngjit, vesh.

82. Atrofizim (atrophysim) – “ kequshqyerje ose dobësim nga mungesa e ushqimit dhe e ushqyerjes “ 1590 (nënkuptimi i atrofizuar) nga frëngjishtja atrophie, nga latinishtja atrophia “ kequshqyerje në vetvete diçka që të gërryen stomakun, trupin, nga un-unourished; nga un-“jo” + trophe “ ushqim” nga trephein “të majmesh”. Atropike regjistrohet së pari në 1865. Si mbiemër “i gërryer thellë”. **“Kur hyra në qeveri unë konstatova që kjo klasë e atrofizuar politike, te personazhi i kryeministrit të kohës, funksiononte në një mënyrë vulgare...”**

83. Audit *em* – (1400- 50, anglishtja e mesjetës së vonë audite, latinisht auditus). Kontroll zyrtar dhe verifikim i llogarive dhe i regjistrimeve, veçanërisht i llogarive financiare.

84. Autenticitet – italisht.autenticita – vërtetësi.

85. Autoçensurë – fjalë nga anglishtja me kuptimin: vetëkundërshtim, vetëdënim.

86. Avangardë a – është përdorur kryesisht në letërsinë politiko-shoqërore me kuptime të figurshme, por tashti është zëvendësuar me pararojë.

87. Avari (breakdoën) – një breikdaun, një kolaps, në 1832 nga break + doën (pushim + poshtë). Fraza verbale është dëshmuar së pari në fundshekullin e 14-të. Emri në mënyrë specifike për makineritë dëshmohet në 1838; me kuptimin “një analizë në hollësi, me detaje” 1936. Avari nervore dëshmohet nga 1905-a. “**Të dyja këto gazeta të nisura që në vitet e Luftës patën vetëm një moment avarie.**”

88. Axhendë – agenda vjen që nga vitet 1650-të, nga latinishtja agend me kuptimin fjalë për fjalë “gjëra që duhen bërë”; shumësi neutral i agendus, gerundivi i agree “të bësh” (e lidhur me fjalën akt). Origjina e fjalës lidhet me teologjinë (përkundrejt çështjeve të besimit) kishte kuptimin “pika, paragrafe të veçantë të listës, çështje (në mendimin e ditës ,në program) të biznesit që duhen përmbushur, duhen kryer në një takim” dhe së pari dëshmohet në 1882. “**Prania e BE-së në zonën mesdhetare u bë edhe më e dukshme, ashtu sikurse edhe çështjet mesdhetare gjithnjë e më shpesh zunë vend në axhendën e institucioneve komunitare.**”

89. Background – e huazuar nga anglishtja background. Fushë, sfond, hije.

90. Banderolë – (ital.bandaruola – flamur i vogël). 1. Rrip i gjerë pëlhure ose letre, me një parullë a citat të shkruar në të, që varet në raste festash, ose mbahet në duar në një manifestim etj; 2. Rrip letre për të mbështjellë libra, gazeta etj që dërgohen me postë.

91. Bankënotë – (ital.bancanota) fin.letër me vlerë, me prerje ë caktuar, që vë në qarkullim si para një bankë.

92. Bazal – fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine. FGJSSH e jep me dy kuptime. Në kuptimin e parë përdoret fjala shqipe themelor, në kuptimin e dytë përdoret fjala e huaj, por që mund të por që mund të bëhet bazor ose të zëvendësohet me fundor.

93. Bekgraundi – sfond, prapaskenë, mjedis, kualifikim, dokumentacion, hije, mjedis shoqëror, errësirë, formim kulturor. Vjen që në 1970 nga back + ground. Kuptimi origjinal lidhet me teatrin, më vonë aplikohet për pikturën. Kuptimi figurativ përdoret së pari në 1854, si “baza, diçka e vendosur në terren, argumentim, privilegj i mohuar” etj. “**Nuk themi dot se ai ka një bekgraund madhor...**”

94. Bellixerancë – që në 1570 nga latinishtja belligerantem ,emri belligerans; belli gerare “për luftën” nga bellum “luftë” + gerare “për të mbajtur, për të kryer” si emër që do të thotë” partia apo kombi në luftë” vjen që në 1811. I lidhur edhe me luftë, trimëri si kuptime dytësore: pjesëmarrës i rrahjes, ndërluftues. “**Marrëdhënia e bellixerancës apo e ndërluftimit është ajo që mund të përkufizohet për Kosovën dhe për Serbinë.**”

95. **Benefit** em – me burim latin *beneficium*: fitim, dobi, përfitim.
96. **Best-seller** em- me burim anglez. Libër më i shitur, autor i librit më të shitur.
97. **Big brother** – angl. Vëllai i madh, në kuptimin e reality shoë më i ndjekur.
98. **Bilateral** – *mb.*(lat-dy+lateralis-anësor) 1.dypalësh, që ka të bëjë me të dy palët, secila palë më detyrime dhe të drejta të barabarta ndaj tjetrës; 2.ling.dyanësor. *Këtë dallim thelbësor duhet ta bëni të qartë për të mos lejuar asnjë precedent të pakëndshëm në marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Shqipërisë dhe Rumanisë.*
99. **Bilateral/e** mb., unilateral/e mb – fjalë që del në shkrime shkencore e politiko-shoqërore. Bilateral del në togje të tilla si :marrëveshje, marrëdhënie (bisedime) bilaterale, pneumoni bilaterale etj . E kundërt me të del unilateral. Në këto kuptime të dyja fjalët janë të zëvendësueshme plotësisht me fjalët shqipe i dyashëm, dyanësor dhe i njëanshëm, njëanësor, jo vetëm në përdorimin e përgjithshëm, por edhe në atë terminologjik. P.sh *bisedime të dyanshme(dyanësore), pneumoni (ftohje) e dyanshme (dyanësore) etj.* Bilateral përdoret ndonjëherë edhe me kuptimin “reciprok”, ku, siç dihet, po zëvendësohet me formimin shqip i ndërsjellë psh: bashkëveprim bilateral duhet bashkëveprim i ndërsjellë. **“Në shumë takime dhe konferenca të rëndësishme internacionale dhe rajonale, bilaterale dhe multilaterale është përgatitur me kujdes një klimë e favorshme.”**
100. **Bill-bord** em. – me burim anglez bill-board. Tabele lajmërimesh.
101. **Bizarre-e** mb(frëngjisht.bizarre) (italisht.bizzarro) i çuditshëm, i paparë, i pangjarë.
102. **Blekkaut** em – me burim anglez black-out. Errësim, maskim i dritave, bllokim i kujtesës.
103. **Bodigard** – fjala e ka origjinën në vitet 1725-1735. E formuar nga body+guard. 1.Një person ose një grup personash të cilët ruajnë një individ. 2.një eskortë shoqërimi. *Fino tha se ishte në Fier, por bodigardët e tij dhe biletat e avionit dëshmonin të kundërtën.*
104. **Bonsens** : kuptimi i mirë dëshmohet që në 1726 nga frëngjishtja. Bonsens është ndërmjet injorancës dhe njohurive të marra. Është arsyeja pa arsye. Midis sferës teorike ku kuptojme kuptimin e një fjale ose një ideje dhe sferës praktike ku duam tq reagojmë; në shumicën e rasteve pa qenë i sigurt, për pushtetin, që ta bësh njohurinë një shkak, ka një boshllëk. Bonsens e plotëson këtë boshllëk. Bonsens në ditët tona përkufizohet si arsyeja që plotëson boshllëkun e lënë nga shkenca. **“Ajo mishëron në ide e në veprim, vullnetin e mirë, dëshirën e mirë, bonsensin dhe përpjekjet e bëra gjatë dekadave...”**
105. **Bravo** pasth. Fjalë e huazuar nga italishtja. Shpreh miratim me entuziazëm. Po këtë e jep plotësisht, madje edhe më fuqishëm pasthirrma *të lumtë!* Pasthirrma jonë ka aftësinë të shënojë edhe vetën, së cilës i drejtohet miratimi, me anë të trajtave të shkurtra përemërore që

merr: të lumte!, ju lumtë!, u lumtë!. Me një shkallë më të ulët force, në vend të pasthirmës bravo mund të përdoret edhe të përgëzoj. Ka një përdorim ironik në shprehjen ‘Bravo të qoftë’ me kuptimin: ‘të shtrëngoju dorën!’, ‘nuk e sheh, punë të mire na paske bërë’.

106. By-pass *em* – me burim anglez. Kalim anësor, anëkalim, baipas. Rrugë tërthore, kthesë, i ndryshoj drejtimin, i bie përqark, i bie gjatë, lë mënjanë një pengesë.

107. Byroist ~i m.sh ~ë,~ët – nuk dihet origjina e fjalës. 1. Njeri i zgjedhur në krye të një komiteti ose të një organizate politike e shoqërore, që udhëheq veprimtarinë e komitetit a të organizatës për një periudhë të caktuar. 2. Specialist që drejton veprimtarinë tekniko-shkencore në një ndërmarrje, udhëheq e kontrollon një veprimtari të caktuar në një institucion shtetëror ose është ngarkuar të studiojë një çështje me rëndësi. *Unë isha sekretar i përgjithshëm i një kabineti që kishte filluar të ndryshonte me personazhe aspak të së njëjtës kategori me byroistët tradicionalë.*

108. Celul/ë/a – Këtë fjalë e mbulon plotësisht fjala shqipe ‘qelizë’ si në fushën e biologjisë, ku përdoret si term ashtu edhe në kuptime të tjera. Në vend të celule shtazore duhet qelizë shtazore, ndarja e qelizës për ndarja e celulës. Po kështu në kuptim të figurshëm thuhet në çdo qelizë të ekonomisë, familja është qeliza bazë e shoqërisë etj., duke mënjanuar përdorimin e fjalës celulë. Edhe si term në fushën e muzikës celulë zëvendësohet me fjalën shqipe bulëz, një fjalë e bukur popullore. Fjala cellule përdoret dhe në fushën politico-shoqërore gjatë Luftës Antifashiste dhe në vitet e para pas Çlirimit. Fjala celular përdoret kryesisht në biologji dhe në ditët e sotme në fushën e elektronikës si mjet komunikimi.). “**Ky lloj mekanizmi që në fillim mund të ketë qenë një celulë më pas është shndërruar në një falangë.**”

109. Celular(phone) – 1884 shkurtimi i telephone. Folja dëshmohet që nga 1889, që nga emri. Libër telefoni dëshmohet së pari në 1925 nga phone book; 1927 si “kabinë telefoni”.

110. Cesium – metal, alkalin i rrallë, 1861 i krijuar, i shpikur nga Bunsen dhe Kirchhoff në 1860; në latinisht caesium nga L caesius “blu dhe gri” veçanërisht për sytë, veçanërisht për dy vijat blu në spektrin e tyre. “**Prandaj fiton ai që arrin të prishë ekuilibrin, që ua kalon konkurrentëve me çdo mjet, me cesiume, me spekulime, me teknologji më të përpunuara apo duke përdorur risi në menaxhim.**”

111. Cikm/ë – nuk njihet origjina e kësaj fjale. 1. Mot me acar, ngricë. 2. pjesa e djegur dhe e ngjitur në fund të enës. *Policët përpiqeshin ti shpëtonin cikmës së natës.*

112. Circuit/i *m ~ e/et-* term i huazuar nga gjuhët neolatine. Në vend të tij këshillohet të përdoret fjala shqipe qark. Psh: *qark i shkurtër. Qark i jashtëm. Mbyll (hap, ndërpres qarkun).*

113. Civilizim, ~i m., civilizoj kal., civilizuar (i, e) mb – e huazuar nga frëngjishtja civilisation, me burim latin civilis. Këto fjalë janë zëvendësuar plotësisht me fjalët me përdorim të gjerë qytetërim, qytetëroj, i qytetëruar.

Coëboy – fjala e ka origjinën në vitet 1715-1725. Është formuar nga coë+boy. 1) Një njeri që man dhe ruan kafshët në një fermë, sidomos në SHBA perëndimore, dhe që tradicionalisht shkon për shumicën e punës së tij mbi kalë. 2) një njeri që ekspozon aftësitë që u atribuohen kaubojve të tilla, sidomos në Rodeos. Bushi reagoi si coëboy.

114. Crucial mb, - me burim anglez crucial. Vendimtar, kritik.

115. De facto dhe de jure – latinisht, fjalë për fjalë “në fakt, në realitet” në këtë mënyrë në kuptimin “ekzistuese, por jo domosdoshmërisht e caktuar me ligj” nga facto, rrjedh factum “vepër, akt”. De jure: nga latinishtja de jure “të ligjit” dmth “teë ligjshme, të ligjshëm, me të drejtën e ligjit, kërkohet nga ligji.” “**Një ndër prioritetet apo përparësitë e punës sime de jure e de facto ishte depolitizimi i institucionit të presidentit.**”

116. Decidoj kal- Kjo fjalë ka prejardhje nga gjuhët neolatine (fr. Decider, ital decidere). Në vend të saj mund të përdoret fjala vendos, që e mbulon fare mirë fjalën e huaj në të gjitha kuptimet. Psh: *vendos për zgjidhjen e problemit. Faktorët që vendosin më shumë për ngritjen e rendimentit të punës. Nuk vendos dot etj.*

117. Deciziv/e – mb. Kjo fjalë ka prejardhje nga gjuhët neolatine dhe mund të zëvendësohet plotësisht nga fjala shqipe vendimtar. Psh: *faktorët vendimtarë të fitores sonë. Ndeshjet vendimtare. Rol vendimtar. Prova vendimtare.* Fjala deçiziv ka edhe këto kuptime: prerazi, ashpër (i,e), mprehte(i,e). Në drejtësi deçiziv ka kuptimin e vendimit gjyqësor, veçanërisht për rastet e dyshimta.

118. Definicion/i – m. Kjo fjalë e huaj ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja e italishtja (fr. Definition, ital.definizione). Për ta zëvendësuar atë është krijuar e po përdoret fjala përkufizim psh: *Përkufizim shkencor. Përkufizim i materies. Përkufizim i foljes. Përkufizim i gjatë i shkurtër etj.*

119. Definitive/e – mb., definitivisht ndajf. Fjala definitive ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja e italishtja(fr.definitiv dhe ital. definitivo, latin. Definitivus). Kuptimin e mbiemrit definitiv e jep fare mirë fjala shqipe përfundimtar psh: *Vendim përfundimtar. Përgjigje përfundimtare. Zgjidhje përfundimtare etj.* Ndajfolja definitivisht është formuar benda shqipes me prapashtesën-isht.

120. Demarsh, ~ i m – ka hyrë në shqipen nga frëngjishtja. Është përdorur më shumë në publicistikë. Kuptimin e saj “perpjekje që bëhet për ti rënë prapa një pune ose për të arritur

diçka, duke ndërhyrë te dikush, duke folur me dikë për ti mbushur mendjen etj” e jep plotësisht fjala shqipe përçapje. Psh : *bën përçapje të reja. I vajtën kot të gjitha përçapjet.*

121. Demolim – e huazuar nga frëngjishtja demolition, me burim latin demolin. Prishje, hedhje poshtë, gërmadhë.

122. Deportim (deportation) – që nga 1590 nga frëngjishtja mesjetare deportation, nga latinishtja deportationem (emri deportatio), si emër veprimi. Deport i dëshmuar në fundshekullin 15-të “ të sillesh”. Nga frëngjishtja e vjetër “ deporter” sjellje nga de “ tërësisht , formalisht” + porter” për të kryer,të mbash veten “; kuptimi origjinal lidhet me sjelljen. Me kuptimin” dëboj” njihet rreth viteve 1640 nga latinishtja deportare, transport, dëbim, migrim, për t’i çuar jashtë “ larg” nga de në kuptimin e saj “jashtë, larg + portare “ për të kryer” (por e lidhur me etimologjinë popullore me “port” portus). **“Nuk është kohë e shkuar dëm ajo që quhet si biçim deportimi i tranzicionit, që është vetëm një formë tjetër e diktaturës.”**

123. Derivat – m(lat.derivato – burim, rrjedhë)diçka që buron nga diçka tjetër, prodhim i diçkaje, nxjerrje; 1.kim.bashkim organik që del nga bashkimet e tjera organike; 2.gram.fjalë e prejardhur. *Marrëdhëniet e tij me shtetasin serbo-boshnjak, Dashamir Fazllic, marrëdhënie nga të cilat kanë derivuar një sërë aferash korruptive të bëra publike kohët e fundit edhe në shtyp.*

124. Destinim, destinoj – kur është fjala për të lënë diçka për një qëllim ose të ndarë për një punë, në vend të i destinuar mund të përdoret mbiemri i caktuar psh. *Goma të caktuara për t’u prerë. Lista e mallrave të caktuara për në portin e Durrësit. Lahet në banja të caktuara për këtë punë.*

125. Determinoj kal., determinohet pës., determinim m., determinant mb- këto fjalë të huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja e frëngjishtja. Në vend të tyre kanë filluar të përdoren gjerësisht, sipas rastit, fjalët shqipe përcaktoj, përcaktohet, përcaktim, përcaktues, vendimtar. Ja disa shembuj: *përcaktuan fitoren. Pjekja është një nga faktorët më kryesorë që përcakton cilësinë e mirë të rrushit. Faktorë përcaktues. Rol vendimtar etj.* Folja determinoj mund të zëvendësohet edhe me shprehjen luan rol vendimtar. Ky grup fjalësh ka edhe këto kuptime:kufizim, ngushtim, reduktim, caktoj, vendos, forcoj.

126. Dezhurn/i – mb. Kjo fjalë e ka burimin te frëngjishtja “de jour” – “i ditës”(dmth që ka radhën e shërbimit atë ditë). Trajta dezhurn ka hyrë në gjuhën tonë nga rusishtja dezhurnij. Përdoret me dy kuptime. Së pari dezhurn përdoret në kuptimin ai që ka radhën për të ktyer disa shërbime në një institucion, që ka filluar të zëvendësohet me togfjalëshin nëpunës i shërbimit. Së dyti fjala dezhurn përdoret nganjëherë në kuptimin “ shërbimi që kryhet në një institucion nga punonjësit e saj në ditë të caktuara e sipas një radhe të caktuar”.Në këtë rast,

në vend të saj duhet përdorur togfjalëshi shërbim ditor ose thjesht fjala shërbim. Psh: *kam shërbimin ditor dhe jo dezturnin.*

127. Deziluzion/i - m. kjo fjalë është huazuar nga frëngjishtja. Vendin e saj po e zë tashmë fjala shqipe zhgënjim, e cila ka gjetur një përhapje të gjerë p.sh *Adnani ngriti supet. Shpresa e kuptoi : më tepër se dyshim, ai gjest shprehte një zhgënjim të thellë.* Edhe për fjalët e tjera që janë formuar nga tema e kësaj fjale si deziluzionoj, deziluzionohem, i deziluzionuar kemi fjalët e gjuhës sonë zhgënjej, zhgënjehem, i zhgënjyer.

128. Diçiturë – titull, tekst i shkruar, titra. Në fundin e shekullit 14-të nga frëngjishtja e vjetër “ duke marrë, duke konfiskuar”; caption “arrest, kapje, burgim”; nga latinishtja captio, captionis “një kapje, sekuestrim, mbajtje me forcë, me zor” nga captus, capere “për të marrë”. Kuptimi i fjalës evoluon e zhvillohet në titujt e padive ligjore që përfshijnë konfiskimin; “fjalë që përdoret në fillim të çdo dokumenti, pra kreu i një kapitulli ose pjese, seksione/ndarje të një artikulli (1789) dhe sidomos e përdorur në SHBA me kuptimin ”Përshkrim apo titull më poshtë, një ilustrim” që në 1919. “**Gjatë ditëve pasardhëse, zgjedhësit e mi të ardhshëm panë një mori fotografish të mia, të shoqëruara me një sërë diçiturash ngjitur tyre.**”

129. Difezë/a – fjalë difezë, e huazuar nga italishtja difesa është përdorur në terminologjinë ushtarake e sportive. Ajo është zëvendësuar me fjalën shqipe mbrojtje psh: *sistemi i mbrojtjes. Mënyrat e mbrojtjes. Mbrojtja e skuadrës mike.* Edhe mbiemri difensiv është zëvendësuar me fjalën shqipe mbrojtës psh: *Veprim mbrojtës për Veprim difensiv etj*

130. Difuzion – m.(it.diffusione e nga frëngjishtja – diffusion). Ajo është përdorur për mjaft kohë si term i fizikës, por sot në tëkstat shkollorë është zëvendësuar me fjalën shqipe shpërhapje. Ky term përdoret me dy kuptime: 1. Depërtim i dyanshëm i molekulave a i atomeve të një trupi (sidomos të lëngët a të gaztë)midis molekulave a atomeve të një trupi tjetër me të cilin është në kontakt (p.sh Shpërhapja e lëngjeve, e gazeve). Koeficienti i shpërhapjes. 2. Përhapja e rrezeve të dritës që kalojnë nëpër një trup të ejukshtëm ose që bien në një sipërfaqe jopasqyruese në të gjitha drejtimet (p.sh Shpërhapja e rrezeve të dritës). Fjala shqipe shpërhapje i jep fare mirë kuptimet e fjalës së huaj difuzion, e cila nuk duhet të përdoret më. *Fenomeni i bojkotimit të seancave parlamentare dhe protestave në mbarë vendin ka pësuar një difuzion të gjerë, i udhëhequr nga fryma e revoltës mbarëkombëtare.*

131. Diklin – me burim anglez decline. Tatëpjetë, shpat, pjerrësire, rënie, ulje.

132. Diskrecion – m.(lat.discretio – maturi) 1.kujdes e vëmendje në bisedë, arsye e urtësi, kujdes për ndjeshmërinë e të tjerëve; 2.ruajtje e fshehtësisë së besuar; 3.shpirtmadhësi,

maturi, arsyeshmëri. *Natyrisht, Kushtetuta dhe Konventa lejojnë një aspekt të tillë diskrecioni.*

133. Diskutant mb – kjo fjalë është me burim latin discutere. I diskutueshëm, i kundërshtueshëm, i kritikueshëm.

134. Disponibël – me burim latin disponibilis. I lirë që s’është i zënë, i gatshëm.

135. Disponim – available, që nga mesi i shek 15-të me kuptimin “e dobishme, gjithashtu e vlefshme, efektive, e aftë për të prodhuar efektin e dëshiruar” nga dobi + gjendje. Kuptimi “në dispozicion të dikujt, i aftë për të bërë diçka të dobishme e të përdorshme”, regjistrohet së pari në 1827. ... **interpretohej si sinjali i dukshëm i një disponimi rus për ndërhyrje në zonën kufitare.**

136. Distributor – me burim latin distribucio. Ndarës, shpërndarës

137. Diversitet – diversity, që në mesin e shek 14-të me kuptimin “cilësia e të qenit ndryshe”; më së shumti merr sensin neutral nga frëngjishtja e vjetër; diversite’ (shek 12-të) “ndryshim, tipar unik, i rastësishëm” gjithashtu për “ligësi, çoroditje” nga latinishtja diversitatem “mosmarrëveshje, kundërshti, i kundërt” gjithashtu me një kuptim të dytë “ndryshueshmeri” nga diversus “mënyrë e ndryshme kthimi”. Merr kuptimin negativ për “ të kundërshtosh atë çka është e drejtë dhe e pranueshme” ose “çoroditje, zvetënim, djallëzi” të dëshmuara në shoqërinë angleze që nga shek 15-të, kryesisht. **“Betejat për demokracinë e brendshme në parti filluan me mocionin antiberisha në 1992, shuarjen e diversitetit të mendimit me manorat e referendumit në 1994.”**

138. Dixhitalizuar – fjala e ka origjinën në vitet 1950 – 1955. Është formuar nga digit +ize. 1.Për të kthyer (të dhëna)për të formuar digjitale për përdorim në një kompjuter. 2. Për të kthyer (matjet analoge fizik) për formë digjitale. *“Tani janë ekonomitë më të digjitalizuara në Bashkimin European”*

139. Draft – e huazuar nga anglishtja draft. Projekt, skicë, ide.

140. Dubël md dhe ndajf – ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja dubel. Ajo zëvendësohet me fjalët shqipe dyfishtë (i, e), dyfish.

141. Efiçent – mb(it.efficiente – veprues)1. I efektshëm, i vlefshëm, me rendiment; 2. I aftë, i zoti, që mbaron, kryen punë; 3.në gjendje të mirë, në rregull, në gjendje pune. *“Viti 2009 është produkt i masave efiçente të ndërmarra në politikën dhe në sferën monetare”.*

142. Ekspresiv mb – e huazuar nga frëngjishtja expressive. Kjo fjalë neolatine me kuptimin “ me kuptimin që e shpreh diçka bukur, qartë e në mënyrë të gjallë” nuk jepet ne FGJSSH.

143. Ekstension – m(lat.extensio – shtrirje) 1.shtrirje, përhapje, rritje e gjatësisë ose e vëllimit, zgjerim; 2. a)lëvizje me të cilën dy skajet e një pjese tërhiqen me drejtim të kundërt; b) lëvizje me të cilën vendosen në pozicion të drejtë pjesët e një gjymtyre (p.sj gjstë thyerjes ose luksacionit). *Është forcuar ekstencioni, janë forcuar qendrat e këshillimit.*

144. Ekuivokë – equivocate, nga latinishtja mesjetare aequivocatus, aequivoco (nuk quhem ,thirrem nga i njëjti emër). Nga latinishtja e hershme aequivocus (“ambig”, i keqkuptuar) i referohet frengjishtes equivoquer. 1- si folje kalimtare të përdorësh fjalë me kuptim të dyshimtë ose me kuptim tjetër, të shprehësh opinionet e dikujt me terma që parakuptojnë, ose pranojnë kuptime krejt të ndryshme, që ka për qëllim të gënjejë, të mashtrtojë; të përdorësh shprehi ambige të cilat e çojnë natyrën e bisedës në një dyfishmëri. 2-ta bësh ekuivokal ose ambig. *Ai ekuivokoi betimin e tij nga një ndruajtje në mjekër. George Buck. “Dënon fuqishëm e pa ekuivokë aktet e dhunës dhe tentativën e dështuar për një akt shteti.”*

145. Ekzibicionizëm~zmi – (lat.exhibitio, exhibitionismus – paraqitje, ekspozim) 1. Dëshirë për të treguar para të tjerëve vlerat vetjake dhe për t’u dalluar. 2. **Med.sëmundje shpirtërore për të zbuluar e treguar pjesët e trupit.**

146. Ekzigjent – kjo fjalë zëvendësohet me fjalën shqipe kërkues psh: *ai është kërkues ndaj vetes. Duhet të jemi më shumë kërkues.*

147. Ekzil – m(lat.exsilium – mërgim) 1.përzënie nga vendi, nga atdheu, mërgim, ndjekje nga atdheu; 2.vendi i mërgimit, vendi ku jeton i mërguari”*por unë nuk e bëj të iki në ekzil atë, ai do të rrijë këtu”.*

148. Elaboroj f kal – me burim latin elaborare. Përpunoj

149. Emergjente – vjen nga frëngjishtja emergente. E menjëhershme

150. Eminenca - rreth viteve 1400 “projektim, gungë”. Në fillim të shek 15-te merr kuptimin “pozitë e lartë ose pozicion i ekzaltuar, i lartësuar” nga frëngjishtja e vjetër eminence “ i ngritur” ose direkt nga latinishtja eminentia “person me reëndësi, person i ngritur”, nga eminentem, eminens “i shkëlqyer, i shquar”. Si një titull nderi (tani vetëm i kardinalëve) ajo është vulosur rreth vitit 1650-të. Ishte Francois du Leclere Trembley (1577-1638), agjent sekret i Risheljesë(kardinali Richelieu). Sinonimet e fjalës janë: lartësi, famë, emër, eminencë, vend i ngritur etj. **“Disa e quanin eminenca gri e pushtetit, ai që gëzonte thujse autoritetin dhe privilegjet e një guvernatori.”**

151. Emisarë – emissary (emër). Që në 1620-ën nga frëngjishtja emissaire (shek 17-të) ose drejtpërdrejt nga latinishtja emissaries, do të thotë “ që është dërguar jashtë”, nga emissus . Emitter “ të dërgosh përpara”. Shih emit (ex- (jashtë) + mittere- (me dërgue). **“Shqetësimi**

tjetër që ngritën emisarët amerikanë kishte të bënte me zërat për kalimin nga Shqipëria në Kosovë...”

152. Enklava – enclaves 1868; nga frengjishtja enclave; nga frengj e vjetër enclaver “përmyll, rrethoj, vë, fut, shtie, vend i rrethuar; përfshin, përmban. 1.Territor brenda një shteti, njëkombësie, një shteti, një gjuhë etj i rrethuar nga të gjitha anët me elementë të huaj 2. Ling.ishull gjuhësor; 3.pronë e rrethuar nga të gjitha anët, me pronën e një tjetri Shek 13-të nga latinishtja in clavare mbyll, rrethoj, mbyll me çelës; nga in “në” + clavis “çelës” , i rrethuar nga prona që e zotëron dikush tjetër. Është dëshmuar në anglisht që nga mesi i shek 15-të. Nga frengjishtja e mesme enclaver, pra kuptimet : rrethoj, përbëj, përfshij, mbyll në çmendinë, ndryj, siguroj, rras brenda, bllokuj fondet etj. si kuptime jo të drejtpërdrejta. **“Ai nuk mund ta pranonte konceptin e enklavës ose të kantonizimit.”**

153. Erupsion – në gjuhën tonë fjala erupsion ka hyrë nga frëngjishtja dhe është përdorur sidomos në gjeologji, astronomi, në mjekësi etj. Mbiemri eruptive ka kuptimin “që del me vrull, që shpërthen me furi”. Emri erupsion dhe mbiemri eruptive zëvendësohen me shpërthim dhe shpërthyes. Psh: *disa shpërthime në diell kanë ndikime të menjëhershme në përhapjen e valëve etj.*

154. Eskorta – shoqërues, eskortë, shpurë, rojë, përcjellës janë sinonimet e fjalës. Si emër përdoret në 1570-ën me kuptimin ushtarak nga frengjishtja mesjetare escorte’ (shek 16-të) nga italishtja scarta “një udhëheqës” nga scargere “për të drejtuar” nga *excarrigere e formuar ng ex – “jashtë ose –ish” + carrigere “rregulloj”. Kuptimi për “personin shoqërues të një tjetri për një rast social, për një okazion” është dëshmuar në 1936. Si folje vjen në 1708-ën. Me ngjyrimin social vjen që në 1980-ën i lidhur me përcjell, shoqëroj. **“Pasi vërtet kisha shumë problem daljen në mengjes nga shtëpia ime, pasi eskorta i krijonte problem trafikut, si një zonë me shumë lëvizje.”**

155. Event – m(it.evenmnto – ngjarje, ndodhi, rast) 1. Rast fatlum 2. Event i rëndësishëm (ngjarje e rëndësishme) *“Hyrja e Shqipërisë në NATO përbën një nga eventet më të rëndësishme në historinë e shqipëtarëve”.*

156. Evident/e – kjo fjalë mund të zëvendësohet me njërën nga këto fjalë ose shprehje të gjuhës sonë: i qartë, i dukshëm, që duket sheshit. Kështu në vend të : *lidhje evidente* mund të përdoren togjet *lidhje të qarta*.

157. Evittoj kal., evitohet pës., evitim m- folja evittoj me prejardhje nga gjuhët neolatine mund të zëvendësohet me disa fjalë shqipe si: mënjanoj(mënjanohet), shmang(shmangët). Kështu në vend të evittoj rrezikun (gabimin, të keqen) mund të përdoret sipas rastit

mënjanoj(shmang, i shmangem) rrezikun (gabimin, të keqen) etj. Si rrjedhime dhe emri evitim zëvendësohet me fjalët mënjanim, shmangie.

158. Evoluim – me burim latin evolution. Transformimi gradual dhe në vazhdimësi.

159. Facial – f(lat.facies-faqe, pamje e jashtme) 1.gjeol.pamjet e përbërjet e ndryshme të cilat formësohen njëkohësisht në kushte të ndryshme. “*Në Aeroportin e Rinasit funksionon një sistem ultramodern i identifikimit dhe analizës automatike të të dhënave biometrike të imazhit facial*”

160. Falanga (phalanx) – si fjalë dëshmohet që në 1550 nga greqishtja phalanx- phalangos “ linjë e betejës”, është rreshtuar për betejë gjithashtu edhe “ gisht apo kockën e gishtit” fillimisht me kuptimin “ një copë druri e rrumbullakët, trangu” me origjinë të panjohur ndoshta me një bazë indoevropiane bhelg- derrasë, rreze”. Në anatomi fillimisht merr kuptimin e “radhë e tërë e nyjave të gishtërinjëve e cila i përshtatet këmbësorisë e lidhur së bashku”. Me kuptimin figurativ “ numri i personave të lidhur së bashku me një shkak të përbashkët” vulozet që në 1600 (falangist- anëtari i një organizate fashiste e themeluar që në 1533). “**Ky lloj mekanizmi që në fillim mund të ketë qenë një celulë më pas është shndërruar në falangë. E kjo gjë nuk mund të kryhej pa ndihmën e asaj pararojë që shfaqet zakonisht në kësi rastesh: falanga e rimohuesve.**”

161. Fantazmagorik~e mb. Sh.~ë,~e - **fjala e ka origjinën në vitet 1795-1805**, kompozita vjen nga frëngjishtja fantasmagorie e formuar nga pjesa e parë phantasm dhe elementi i dytë ndoshta grek agora + -ia. 1.Një sërë kalimesh të fantazmash, iluzionesh ose shfaqesh mashtruese si në një ëndërr ose si e krijuar nga imagjinata. 2. Një ndryshim skene e përbërë nga shumë elemente. 3.Një sekuencë fantazie e imazheve të rastësishme shoqërore, siç shihet në ëndrra ose ethe. 4.Shfaqje fantastike surreale. *Entuziazmi dhe shpresa e demokratëve për fitore i bënte naivë, me një shkëlqim disi fantazmahorik në sytë.*

162. Fascinoj f kal – e huazuar nga frëngjishtja fasciner, me burim latin fascinare. Magjeps, ngashëllez.

163. Feirplej em – me burim anglez fair- play. Lojë sipas rregullave(pa hile).Feston, celebron, te festosh nje jubile. 2- (te gezosh pa mase) te shprehesh nje lumturi te madhe. Sinonime ekzaltim, triumph, të harlisesh, të gëzosh. Latinishtja klasike jubilatus, jubilarë, te tregosh ose te ndjesh nje gezim te madh; te festosh nje jubile apo nje rast te gezueshem; te festosh te shtunen e trete pas pashkeve; ne psallmin e 100-te i referohet nga titulli i saj latin iubilarë, iubilat te ulerasesh nga gezimi. Perdorimi i saj i pare messhekulli 17-të e përdorur nga shkrintaret kristianë.

164. Filatur/ë - f. kjo fjalë e huaj ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine dhe është zëvendësuar nga fjala tjerretore (nga folja tjerr me prapashtesën –tore) psh: *punon në tjerretoren e Kombinatit të Tekstileve “Kosova”. Punonjësit e tjerretores.*

165. Filosemite(philosemitism)- pro judaizmit; që në vitin 1847 “judenj, çifutë, arabë, asirianë, armenianë” nga latinishtja moderne Semita; nga sem apo Shem një nga tri djemtë e Noas i cili konsiderohet si babai i Semitës në kohën kur Antropologjia ishte e lidhur ende me Biblën nga hebraishtja Shem, Sem. “**Lidhur me çështjen edhe më delikate, atë të racizmit, ne përmendim shpesh me të drejtë prirjen filosemite dhe mbrojtjen e hebrenjve prej shqiptarëve.**”

166. Fleksibilitet - Daton në 1610 me kuptim fizik të fjalës për: lakueshmëri, përkulshmëri. Origjina e saj vjen nga latinishtja *flexibilitatem* (-tas), nga *flexibilis*, *flexible* që rreth shekullit të XV-të, me kuptimin që mund të jetë përpunuar, i shtruar, i lakueshëm, i lëvizshëm, energjik. **Ai gjeneron në shumicën e rasteve më tepër fleksibilitet, harmonizim më të mirë, më shumë fokusim në çështje konkrete.**”

167. Flu - fjala e ka origjinën në vitet 1565-1575. Është formë e përgjithshme e anglishtes së vjetër fleësa shkurtuar. U largua, iku, fluturoi.

168. Fokist/i – m. kjo fjalë e huaj e cila ende haset në përdorim për të emërtuar punëtorin që ushqen e mban ndezur zjarrin në një lokomotivë, në një vapor etj ka hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja. Në vend të saj përdoret fjala zjarrrtar, e formuar nga zjarr me prapashtesën –tar psh : *Zjarrrtari i lokomotivës. Kujdesi për shëndetin e zjarrrtarëve.*

169. Foni ~ a f.~e,~së,~në – origjina e fjalës vjen nga greqishtja phone zë. Një pajisje elektronike e përdorur për të ritur fuqinë e sinjalit ushqyes në të, për përforcimin e sinjaleve të frekuencave audio në një radio etj.

170. Fraktur/ë ~a – fjala e ka origjinën në vitet 1375-125. Vjen nga latinishtja *fractura*, haset në frëngjisht prej nga është huazuar nga anglishtja. Është ekuivalente me *fract(us)* pjesorja *frangere+ura, -ure*. 1.Thyhet diçka solide, veçanërisht një kockë në trup. 2.Vendi ku diçka është thyer dhe shenjë e fortë për të ndaluar. 3.pamja e sipërfaqes së një minerali apo guri të thyer; kuarci ka një frakturë të parregullt. 4.i kthen drejtimin dritës, rrezes etj., e bën të ndërrojë drejtimin, e përthyen; 5.fig.veproj në kundërshtim me diçka jopërparimtare, që ka qenë e zakonshme në të kaluarën e që tani pengon zhvillimin, e mohoj atë, e hedh poshtë përfundimisht si të papërshtatshme e të keqe.”*Bilanci përfundimtar qenë disa dhjetëra të plagosur me plagë, thyerje apo fraktura, një pjesë e të cilëve, të shtruar në spitalin e Tiranës”*

171. Frustrim em – me burim italian frusto dhe nga frëngjishtja frustration. Hile, padrejtësi, mërzi ndaj dikujt.

172. Fulltaim mb, e huazuar nga anglishtja full-time. Orar plotë.

173. Fyhrer – nga fuhrer, në 1934 vjen prej fuhrer und Reichskanzler, titull i marrë nga Hitleri në 1934 si kreu i shtetit gjerman, nga gjermanishtja fyhreri “udhëheqës”, nga fuhren “për të udhëhequr, për të çuar” nga fuaren “për të vënë në lëvizje, për të çuar, për të shkuar, për të udhëtuar”. Titulli i Hitlerit ishte modeluar në duçe, tek Musolini. **“Ç’është e vërteta ne shqiptarët jemi pak racist. E dini, konti francez Gabinio dhe fyhreri gjerman Hitleri na kanë përcaktuar si arianë.”**

174. Gallant – fjalë me origjinë në vitet 135 – 1400. Vjen nga frëngjishtja galer, gallant. 1. jashtëzakonisht të sjellshëm dhe i vëmendshëm për gratë, i sjellshëm; .hijerëndë, i madh. *“Kam ndier idhnimin gallant të Jusuf Vrionit, që nuk foli për jetën e tij”*

175. Geto – ghetto vjen nga fjala “gheto” ose “ghet” e cila nënkupton zhargon në venecianisht dhe që përdoret me këtë kuptim në lidhje me një vend ku shllaku ruhej i lokalizuar në të njëjtin ishull si hapësira e burgosjes (getot veneciane). Një alternativë tjetër prejardhjeje është nga italishtja barghetto, zvogëluesi i borgo”boro nga” (lagjija). *Gjithçka që Garmet kishte për të thënë për atë ishte që ai supozoi se po ekuivokonte. Edëard Stillingfleet.* **“Serbët kanë në dorë shtetin dhe i kanë detyruar Shqiptarët të rrojnë si në geto.”**

176. Gjeneroz – me burim latin generosus, por e marrë nga frëngjishtja genereux. Bujar, fisnik.

177. Gjeopolitikë – fjalë me origjinë në vitet 1900 – 1905. Vjen nga gjermanishtja geo+politics. 1. studimi ose zbatimin e ndikimit të gjeografisë politike dhe ekonomike në politikë, fuqia kombëtare, politikën e jashtme, etj të një shteti; 2. kombinim i faktorëve gjeografikë dhe politikë që ndikon një vend apo rajon; 3. një politikë kombëtare në bazë të ndërlidhjen e politikës dhe të gjeografisë.” *Shqipëria nuk ishte veçuar nga gjeopolitika “*

178. Gjysmënokdaun – nga fraza verbale shtangie “ që të trullos nga një goditje për një akuzë, raundi i 10-të si goditja e fundit në boks; trokas jashtë, godas nga jashtë, si zhargon merr kuptimin “person tërheqës” që në 1892. Me kuptimin “bëj një përpjekje, mundim të madh” vjen që në vitin 1936. Sionime: goditje, trokitje, kritikë e ashpër, çuditje, përplasje, godas me një çokë, qortim, qëllor, vë poshtë, protestoj. **“Që qarqeve të ndryshme në Ballkan, u intereson kjo gjendje gjysmënokdauni në të cilën ka rënë vendi ynë, kjo merret me mend...”**

179. Goniometër – kjo fjalë e huaj shënon një vegël të posaçme përtë matur këndët, është shqipëruar me fjalën shqipe këndmatës.

180. Grant – *m*(ang.grant) em.lëshim, dhënie. Dhurim (dhuratë); dhënie, falje e një pasurie, prone, aktdhurim; 2.fin.ndihmë, subvencion, bursë studimi. *Granti i buxhetit të shtetit për qeverinë vendore u rrit nga 7.1 miliardë në 21 miliardë, pra u trefishua dhe po ecën drejt katërfishimit në vitin në vazhdim.*

181. Granuloj – kal., granulohet vetv., granulim, i granular mb – fjala granuloj me temë neolatine, mbulohet në të gjitha kuptimet e saj nga fjala shqipe kokrrizoj, psh: *kokrrizon lëndën plastike. Kokrrizon pluhurin.* Edhe fjalët e prejardhura granulohet granulimi i granular zëvendësohen me fjalët shqipe: kokrrizohet, kokrrizim, i kokrrizuar. *Psh: Makinë kokrrizimi, Superfosfat i kokrrizuar.*

182. Habituës – *m* (lat.habitus – dukje, sjellje, veti) 1.veti, karakter, cilësi e ndonjëmentaliteti, të një sjelljeje etj si rezultat i ushtrimit të një aktiviteti të caktuar; 2.biol.pamje, dukje e përgjithshme e një organizimi, sidomos e një bime; 3.med.shtati, tërësia e shenjave të jashtme që karakterizojnë ndërtimin dhe trajtën e trupit; veçoritë e siptomave të jashtme, në bazë të të cilave mund të përcaktohet sëmundja. *Konventa e Bernës”Për ruajtjen e jetës së egër dhe habitateve natyrore europiane”.*

183. Igrasi/a – *f.* fjalë e huaj me përdorim krahinor, që ka hyrë në gjuhën shqipe nga greqishtja. Në vend të saj shqipja ka lagështirë, lagështi, formuar nga tema e mbiemrit i lagësht, psh: *Ka lagështirë të madhe. Ka marrë lagështirë. Lagështia e ajrit. U dëmtua nga lagështira.*

184. Iminent – që nga 1520-ta nga latinishtja *imminet* (si emër *imminens*) “për të dalë, për t’u afruar, të qenit afër” nga in “në” + *minere* “dal jashtë”, i lidhur me fjalën kodër, lartësi. Si sinonime janë fjalët: i pashmangshëm, i afërt, i shpejtë. Si sinonime emrash janë: afërsi, kërcënim, rrezik. “Unë mendoj që kjo sëmundje që mundon shtresën e varfër ka të bëjë me kolapsin iminent në kulturë, që nuk mund të shërohet vetëm me para.”

185. Imperativ – fjalë e huaj me prejardhje nga gjuhët neolatine. Në vend të saj përdoren fjalët shqipe urdhërues dhei domosdoshëm.

186. Implementim – Si fjalë e mesit të shek XV-të nga latinishtja *implementem* “një mbushje” (me dispozita) nga latinishtja *implere* “për të mbushur” nga in (në) + *plere* (për të mbushur)(e lidhur me *plene*). Kuptimin e “mjet” vjen që në 1550-ën nga nocioni i gjërave të siguruara, të kushtëzuara për të realizuar një punë; në kuptimin e “asaj që mbush një shtëpi”. Si folje del në 1806 fillimisht me origjinë kryesisht skoceze, ku përdorej me një kuptim ligjor “përmbyshje”. Kjo çoi në keqpërdorimin për *implementation*, së pari e dëshmuar në 1926. Lidhja bëhet me fjalën “e zbatuar”(zbatim). “Startimi i implementimit të forcave ndërkombëtare dhe i përbërësve civilë po zhvillohet në mënyrë pozitive.” fq 589

“Gjatë bisedimeve kërkova të vazhdonte pa ndërprerje puna për implementimin deri në fund të marrëveshjes së Ohrit.”

187. Implikoj kal., implikohem vetv. – këto fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, fëngjishtaj impliquer, nuk janë përfshirë në FGJSSH. Ngatërroj a përziej.

188. Impostoj – e huazuar nga anglishtja impost. Vë një detyrë, një taksë, imponoj, detyroj, shtrëngo.

189. Impozant – mb. fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja dhe zëvendësohet nga fjalët hijerëndë dhe madhështor psh: *shtatore hijerëndë. Atij i pëlqente të fliste me një ton madhështor. Përpara na del tabloja madhështore e Shqipërisë.*

190. Impresion – fjala e ka origjinën në vitet 1325 – 1375. Vvjen nga latinishtja impresion, e formuar nga impress+ion. 1.një efekt i fortë i prodhuar në ndjenja, ndërgjegje, intelekt etj; 2.efekti i parë dhe i menjëhershëm i një eksperience ose perceptimi mbi mendjen, ndjesi; 3. Efekti i prodhuar nga një agjenci ose ndikimi. *Cili ka qenë impresioni juaj nga ky takim. Fq.98(Jeta ime)*

191. Indeks/i – m. Në vend të kësaj fjale që ka hyrë nga frëngjishtja përdoret fjala shqipe tregues. Kjo përdoret jo vetëm në letërsinë politiko-shoqerore, por edhe në letërsinë shkencore e teknike psh: *Treguesi i përgjithshëm i çmimeve. Treguesi alfabetik (kronologjik, gjeografik, bibliografik). Treguesi i dendurisë. Të dhënat e treguesit.*

192. Indikacion – fjala e ka origjinën në vitet 1535 – 1545. Vjen nga latinishtja indication, e formuar nga indicate+ion; indication “vleresim” nga indicare ”nxjerr në pah, tregoj; nga in (në) + dicare (shpall) deklaroj, tregoj, shfaq, zbuloj, nxjerr në shesh, nxjerr jashtë ligjit” nga dicere “duke folur, duke thënë”.. 1.çdo gjë që shërben për të treguar apo nxjerrë në pah, s një shenjë; 2.një shenjë e veçantë ose që vë në dukje ose tregon praninë e një sëmundjeje, një ilaç i përshtatshëm apo trajtim; 3.një akt.” *Një rrethanë e panjohur deri atëherë është vizita e një grupi dhe lidershit të UÇK-të cilët zbritën në Tiranë për të marrë indikacione nga komuniteti ndërkombëtar”*

193. Indikator – e huazuar nga anglishtja indicator, tregues, dëftor, indicator.

194. Indipendenc/ë – Në vend të kësaj fjale të huazuar nga italishtja përdoren fjalët shqipe pavarisi dhe i pavarur psh: *Pavarsia kombëtare. Mbrojtja e pavarsisë. Shpallja e pavarsisë. Dita e pavarsisë. Shtet i pavarur. Lufta për pavarisi.*

195. Inefikas – e huazuar nga frëngjishtja inefficace. Diçka apo dikush që është i padobishëm. Pa efekt

196. Infektiv – mb. Kjo fjalë përdoret në terminologjinë e mjekësisë me kuptimin “që ka aftësinë të kalojë nga një i sëmurë te një i shëndoshë(për sëmundjet). Zëvendësohet me fjalën shqipe ngjitës. Psh: *sëmundje ngjitëse. Nuk është ngjitëse.*

197. Ingranoj – fjala e ka origjinën në vitet 1760 – 1770. Vjen nga fjala ingrain (në kokër) e formuar me parashtesim in + grain. 1. Të ngulit ose të fiksojë thellësisht dhe në mënyrë të vendosur, si në natyrë ashtu dhe në mendje; 2. Rrënjos, fiksoj në mënyrë të vendosur; 3. Ngërthej, përfshij. *Po ingranohen, nesër do të ketë më shumë.*

198. Inkurajues – fjala e ka origjinën në vitet 1400 – 1450. Vjen nga frëngjishtja encorag(i) e formuar nga en + corage. 1. I shtoj vrullin a fuqinë diçkaje, bëj që të kryhet diçka më shpejt e më mirë; 2. bëj që të ngjallet me forcë një ndjenjë, një dëshirë, një gjendje etj; 3. E bën të kundërveprojë në një mënyrë të caktuar, e bën të veprojë më me gjallëri e me forcë, ngacmon. *Të armatosur mirë, nën thirrjet inkurajuese, grupi nisi edhe një herë sulmin.*

199. Inovativ mb – e huazuar nga fr.innovatif. një regull i ri, metod e re në shkencë në teknik.

200. Insert – e huazuar nga anglishtja insert. Fletë e shtuar, fashikull.

201. Insinuatë – insinuation. Që nga 1520-ta nga latinishtja insinuationem, emër I veprimit për insunuara. Nga latinishtja insinuatius “ta sjellësh me dredhime, ta lakosh rrugën e dikujt në”, nga in “në” + sinuare ”të dredhosh, përkulem, kërrusem, lakoj, kthesë. Ose lakore nga “sinus”, lakore, mbështjellje. Kuptimi i “prezantimit me dredhime, gjarpërime ose jodrejt-përdrejt” që nga 1640-ta. I gjendur në përdorim si mbiemër, ndajfolje, folje etj. “**E quajta thellësisht të njëanshme, të paargumentuar dhe e hodha poshtë çdo insinuatë që bëhej në adresë të Shqipërisë se gjoja territorin e saj...**”

202. Insistoj – fjala e ka origjinën në vitet 1580 – 1590. Vjen nga latinishtja insistere e foruar me parashtesim in+sister. 1. Të jenë këmbëngulës, të qëndrueshëm apo të vendosur në disa çështje, dëshirën kërkesën a qëllimin...etj; 2. Të këmbëngulin në drejtësinë e kërkesës; 3. Për të shpallur a të ruajtur në mënyrë të vendosur diçka (ai këmbëngul se ka parë fantazmat) 4. Për të kërkuar apo vazhduar kërkimet. *Dhe kjo pasqyrohet në telefonatat që bënë ata, ku insistojnë, veçanërisht për shëndetin.*

203. Inspiroj kal., inspirohem pës., inspirim vetv., inspirues mb.- këto fjalë janë me temë nga gjuhët neolatine. Folja inspiroj përdoret me kuptimin” bëj që të lindë në ndërgjegjen e dikujt një mendim, një ndjenjë etj dhe është zëvendësuar me foljen frymëzoj. Edhe fjalët inspirim inspirues janë zëvendësuar përkatësisht me frymëzim, frymëzues psh: *Frymëzimi i poetit. Burim frymëzimi. Shembull frymëzues.*

204. Instruktor kal~ ova,~uar,~ohet - fjala e ka origjinën në vitet 1375-1425. Vjen nga latinishtja *instructus* formohet nga pjesorja *struere* me parashtesën –in dhe prapashtesën –tus. Te furnizojë me njohuri, sidomos nga një metodë sistematike, të mësojë, të trajtojë, të edukojë, të informojë.

205. Instrukтив – sinonime të : edukativ, udhëzues, mësimdhënës, instruktues, fundshekulli 15-të, nga latinishtja *instruct* “udhëzoj “që rrjedh nga *instruere* “ organizim, informim, mësim” fjalë për fjalë,” ndërtoj, drejtoj, udhëzoj,” nga *in* (për) + *struere*(*grumbulloj, ndërtoj*). Rrjedh nga *udhëzoj, udhëzues*. “**Tani ju po merrni përsipër një rol që nuk duhet ta merrni sepse e vërteta është se nuk ka patur asnjë urdhër. Pas kësaj është mbajtur një qëndrim instruktiv”.**

206. Intension em – e huazuar nga anglishtja *intensity* ndosha edhe nga frëngjishtja *intention*. Burimi i saj është nga latinishtja *intentio*. Qëllim, mendim.

207. Interchange em – e huazuar nga anglishtja *interchange*. Ndërkëmbim, ndërrim, qarkullim.

208. Interferoj f jokal - e huazuar nga frëngjishtja *interferer*, me burim latin *interferre*. Ndërhyj, trazoj.

209. Intoksikimi (*intoxication*) – sinonime : dehje, trulllosje. Që nga fillimi i shek. 15-të me kuptimin deh; ose plot helm nga latinishtja *mesjetare* *intoxicates* , *intoxicare* “tëhelmosh” nga latinishtja *in(në)+toxicare* (të helmosh) nga *toxicum helmi* ;lëndë toksike ;folja me kuptimin tëhelmosh dëshmohet së pari në 1520 me kuptimin të dehesh , ose të dehësh së pari regjistrohet në vitin 1570 me nënkuptimin i dehur , i çmendur ,dikush i luajtur mendsh .”**Periodha e bilardos ishte thjesht një periudhë dezintoksifikimi nga jeta politike dhe problemet e qeverisjes”.**

210. Intoksikohet vetv., inoksikacion, - fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Helmohej, helmim.

211. Introduksion – kj fjalëe huazuar nga gjuhët neolatine, pothuaj nuk përdoret më në gjuhën shqipe. Ajo është zëvendësuar me fjalën shqipe *hyrje*.

212. Introduksion – m. kjo fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine është zëvendësuar me fjalën shqipe *hyrje*. Ja disa shembuj: *Hyrja e veprës. Është pajisur me një hyrje. Hyrje e gjatë (e shkurtër)*.

213. Irracional – mb(lat.*irrationalis* – i paarsyeshëm: empirik) 1.që nuk mund të kapet e nuk mund të shpjegohet nga arsyeja njerëzore:joracional; 2.mat.që nuk mund të shprehet a paraqitet në trajtën e një raporti. “*Asnjë metodë, sado radikale apo irracionale, nuk ka shërbyer ndonjëherë për ta bërë një qëllim më të drejtë apo një qëndrim më fisnik*”.

214. Itinerar – fjala e ka origjinën në vitet 1425 – 1475. Vjen nga latinishtja *itinerarum* e formuar nga *itiner+arius*. 1. Një plan i detajuar për një udhëtim, sidomos një listë të vendeve për të vizituar, planin e udhëtimit. 2.një linjë e udhëtimit, rrugë. *Duke lëvizur nëpër të njëjtin itinerar grupi u nda në dy pjesë.*

215. Joga em – e huazuar nga anglishtja *jog*, me burim aziatik. Përdoret në fushën e sportit, vrapim i lehtë.

216. Jubilar: (jubilate) : Takimi midis dy shteteve shumë të rëndësishëm si Kosova dhe Belgjika për çështjen e pazgjidhur ende është një ngjarje *jubilare* për të gjithë shtetet.1.Feston, celebron, të festosh një jubilee.2.Të gëzosh pa masë, të shprehësh një lumturi të madhe.Si sinonime të fjalës mbahen: egzaltim, triumf, të harlisesh, të gëzohesh.Prejardhja nga latinishtja klasike; *jubilatus*, *jubilare* “të tregosh ose të ndiesh një gëzim të madh; të festosh një jubije apo një rast të gëzueshëm;të festosh të shtunën e tretë pas Pashkëve që i referohet psallmit të njëqindtë me titullin latin *iubilare*, *iubilat* “të ulërasësh nga gëzimi”.Së pari fjala u përdor në mesin e shekullit të 17-te, nga shkrimtarët kristianë.

217. Kakofoni – me burim grek *kakophonia*. Takimi ose përsëritja e tingujve, rrokjeve që të vrasin veshin.

218. Kalkukoj kal., kalkulim – termi *kalkuloj*, me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, përdoret me kuptimin “ bëj veprime me numra për të nxjerrë njëpërfundim ose për të gjetur atë që kërkohet”. Në vend të këtij termi përdoret fjala shqipe *njehsoj*, *llogarit*.

219. Kantonizim – *cantonata* f. (shumës *cantonate*)
Cep , qoshe (i një ndërtese). “**Ai nuk mund ta pranonte konceptin e enklavës ose të kantonizimit**”.

220. Karakoll~i (tur.karakol-rojë, patrullë) arm.ndërtesë e thjeshtë dhe e ngushtë, e ngritur si kullë me mur ose prej dërrase, ku qëndronte roja që ruante kufirin, hyrjen në një repart ushtarak etj.

221. Kaskad/ë – f. zëvendësohet nga fjala *ujëvarë*. Edhe kjo fjalë si sinonim i fjalës *katarakt* është përdorur pa nevojë për fjalën *ujëvarë*.

222. Katarakt/i – m. kjo temë nga gjuhët neolatine, që ka kuptimin “rrjedhë uji që bie me rrëmbim nga një lartësi e madhe dhe e thiktë”, zëvendësohet nga fjala *ujëvarë*. *Psh: Ujëvarat e Drinit. Bie si ujëvarë.*

223. Kazus – m(lat.casus – rast) 1.rast; 2.përfundim; 3.jur.ngjarje ose fatkeqësi e shkaktuar pa veprimin dhe fajin e njeriut; 4.gram.rasë. “*Zoti e shpëtoi nga vdekja dhe i hoqi Ramës, mesa duket, një kazu për të thelluar vrullin revolucionar*”

224. Kesh em – e huazuar nga anglishtja *cash*. Para, para të thata.

225. Koagulon *kal. e jokal.*, koagulohet vetv., koagulim, i koagular mb – këto fjalë me temë nga gjuhët neolatine përdoren kryesisht në mjekësi dhe zëvendësohen me fjalët në gjuhën shqipe mpiks, mpikset. Psh : *E mpiks gjakun. Mpikset shpejt. Mpiksja e gjakut.*

226. Koicidon *jokal* – kjo fjalë me temë të huaj nuk jepet në FGJSSH .Kjo fjalë në gjuhën tonë përdoret me kuptimet : 1) “Ka gjëra të njëjta a të përbashkëta me diçka tjetër”; 2) “Ndodh në të njëjtën kohë me diçka tjetër, bie në po atë kohë”. Në keto kuptime ajo zëvendësohet plotësisht me fjalët shqipe përkon, përputhet, pajtohet psh: *Thëniet e tyre përkonin. Ardhja e tij përkoji me ditëlindjen tënde.*

227. Kolaps (collapse) - si sinonime të rënie, shkatërrim, shembje, rrëzim, dështim, dobësim i forcave, prishje, gërmadhe, rrënim. Dëshmohet si folje që në 1732 nga latinishtja collapses nga collabi “rënie së bashku” nga com (së bashku) + lapse(rënie, të bjerë, të rrëshkasë”)(e lidhur me lapsus: gabim). Si mbiemër vërtetohet që në 1600- ën nga latinishtja collapsus dhe ndoshta kjo solli foljen. Si emër kolaps dëshmohet që në 1801. “Unë mendoj që kjo sëmundje që mundon shtresën e varfër ka të bëjë me kolapsin iminent në kulturë, që nuk mund të shërohet vetëm me para”

228. Kombinacion – fundi i shek 14-te nga frengjishtja e vjeter combination, frengj moderne combinaison, nga latinishtja combinationem “ nje bashkim dy e nga dy”; te bashkosh, zgjedhje e perbashket. Nga com “se bashku”+ bini “dy nga dy” ose “dysh”. Origjina nga combine ”makina qe shkurton, prët, pastron grurin,kombajne”. “Duhet thënë se natyra pluraliste e bën politikën edhe më tërheqëse, më dinamike, të veçantë dhe me mundësi të shumta për lloj-lloj kombinacionesh, çka e afron atë më tepër me artin se me shkencën.” Fq8 “Ajo që po ndodhte në Shqipëri në këtë kohë ishte një kombinacion mes qesharakes e tragjikes”

229. Komercial – 1680 “që kanë të bëjnë me tregtinë” nga commerce + al me kuptimin “i paguar për reklama”(në lidhje me radion dhe me tv) që në 1932; me kuptimin “bëhet për hir të fitimit financiar” (artet) që në 1871. Emri që parakupton “transmetimi i reklamave në radio dhe në tv” vjen që në 1935. “Në shumicën e rasteve ajo ka huazuar si burime “dokumentare” disa botime tepër tendencioze e komerciale.”

230. Kompatabilitet em – e huazuar nga frëngjishtja compatabilitet, dheme burim latin compatibilis. Pajtueshmëri.

231. Kompeticion – akti i te konkuruarit, rivalizim per supermaci, çmim. Nje ndeshje per çmime, honorare ose avantazhe. Rivalitet. Origjina qe nga 1595- 1605 nga latinishtja e vone competition (competition); ekuivalente me competit (us) te competere “ te takohesh, te qendrosh karshi dikujt, te jesh bashke + ion si prapashtese. Sinonime me rivalitet, lufte, nje

seri lojerash, eventesh; ne kuptimin ekologjik do te thote lufta ne mes individeve te llojeve te njejta ose te ndryshem per ushqim, hapesire, drite etj. kur keto jane te pamjaftueshme per te furnizuar nevojat e te gjithëve. Ne 1608 – 1610 “akti I te konkuruarit” nga latinishtja competitionem “marreveshje, rivalitet, kundershiti per diçka”. Kuptimi ” rivalitet, konkurrence ne treg” deshmohet ne 1793, ndersa ne biznes “subjekte qe konkurojne” si kuptim i viteve 1961. **“Vendet balltike, tani janë vendet më të dixhitalizuara në BE, janë ekonomi kompetitive dhe kanë thithur më shumë investime të huaja”**

232. Kompetitiv ndj – e huazua nga frëngj.competitive. Konkuruese

233. Kompjuter, ~i - fjala e ka origjinën në vitet 1640-50. Vjen nga frëngjishtja computer dhe është formuar compute+ -er. Një pajisje zakonisht elektronike që përpunon të dhënat sipas një grupi udhëzimesh me shpejtësi të lartë matematike apo logjike, apo që mbledh, ruan apo ndryshon proceset e informacionit.

234. Komplikoj – e huazuar nga frëngjishtja compliquer. Ne vend të këtyre fjalëve te huaja të ligjërimit bisedor përdoren fjalët shqipe ndërlikoj, ndërlikim, koklavit, koklavitje.

235. Komporthem f vetvetore – e huazuar nga frëngjishtja dhe italishtja comportare se comportet, me burim latin comportare. Sillem kundejt dikujt, adaptohem.

236. Koncentroj kal., koncentrohem vetv., koncentrim, i koncentruar mb – fjala koncentroj temë nga gjuhët neolatine është zëvendësuar me fjalën përqendroj psh: *Përqendroi forcat. Përqendruan zjarrin. Nuk përqendrohet dot. Me vështrim të përqendruar.*

237. Kondicionoj – kal., kondicionohet vetv., kondicionim., i kondicionuar – këto fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine nuk jepen në FGJSSH sepse në vend të tyre prej kohësh popërdoren fjalët e ndërtuara me temën kushtëztoj, kushtëzohet, kushtëzim.

238. Konfidencial – (it.confidenziale). 1.miqësor, i përzemërt, i afërm, përshtëdetje miqësore; 2. I fshehtë, sekret, lajm i fshehtë, njeri i besuar(flet në konfidencialitet të plotë). *“.....është normale që mund të jetë me konfidencialitet, mund të jetë i hapur, por zgjedhja është e atij që thërret tryezën dhe ne e respektojmë.”*

239. Konfident – 1570 “i sigurt në vetvete, i sigurt për vetveten”, nga latinishtja Confidentem (emri confidens) “ në mënyrë të vendosur, me besim, i pavarur, i sigurt në vetvete, i guximshëm”. Lidhja e fjalës me confidant e njohur në 1610 për” një individ mashkull i besuar në çështjet private”; nga frëngjishtja shek 16-të” besim, një mik i besueshëm, një mik për kokë.” **“E donin Shqipërinë si një shtet konfident në vetvete, dhe jo si një vend në protektoratin e një shteti tjetër”.**

240. Konfirmoj – fjala e ka origjinën në vitet 1250 – 1300. Vjen nga latinishtja confirmare e formuar nga con+firm. 1. Të përcaktojë të vërtetën, saktësinë, vlefshmërinë, ose vërtetësinë

e diçkaje, të konfirmojë, të verifikojë:ky raport konfirmon dyshimet e mia. 2. Të njohë me siguri të caktuar: a është konfirmuar rezervimi i dhomës sonë? 3. Për të bërë të vlefshme ose të detyrueshme nga disa akte formale ose ligjore, për të vepruar; sanksionoj; ratifikoj. *Sapona e konfirmoi Elez Biberaj me telefon nga Uashingtoni. Fq164(Piedestale)*

241. Konfondo kal., konfondohet vetv., konfondim, i konfonduar mb – Folja konfondo, me temë nga gjuhët neolatine, ka kuptimin “përziej bashkë pa rregull e pa kriter; ngtërroj në mendje; marr një gjë për një tjetër”. Ja disa shembuj: *I ngatërruan emrat. Më ngatërroi me një shokun e vet. Ngatërrimi i dy çështjeve të ndryshme. Ngatërrimi i emrave.*

242. Konfrontoj kal., konfrontohem vev., konfrontim m – Folja konfrontoj me temë nga gjuhët neolatine, ka kuptimin ballafaqoj, ballafaqohem, ballafaqim. Psh: *ballafaqoj mendimet (pikëpamjet, përvojën, metodën e punës) me një tjetër. U ballafaquan para kolektivit. Ballafaqimi është një nga format më të frytshme të kontrollit punëtor.* kjo çerdhe fjalësh që zë fill nga një temë e burimit neolatin, nuk është përfshirë në FGJSSH sepse në vend të tyre përdoren fjalët shqipe ballafaqoj, ballafaqohem, ballafaqim Sipas rastit këto fjalë zëvendësohen edhe me fjalët përqas, përqasem e përqasje. Psh: Përqasja e dy gjuhëve. Përqas dy përkthime.

243. Konseguenca – që nga fundi i shek XIV-te” konkluzion, përfundim”nga frengjishtja e vjetër consequence” pasojë, rezultat”(shek 13-te) nga latinishtja consequentem (emër conssequens) “për të ndjekur pas”, nga com “me” + sequi “për të ndjekur”.Kuptimi ‘rrjedhojë’ vjen nga togfjalëshi “i pasojave të shtatzanisë”.Vitet 1600. ...,”**por në një liri që siguron me të vërtetë konseguenca e kushtetutës ecën përgjithësisht me qeverinë në harmoni”**.

244. Konsiston jokal – Kjo fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, ka kuptimin qëndron, psh: *Ku qëndron shkaku i këtij ndryshimi? Këtu qëndron e vërteta.* Fjala konsistim ka këto kuptime : fortësi, dendësi, lidhmëria më e fortë apo më e dobët e përbërësve, qëndrueshmëri. Folja konsiston konsiston ka këto kuptime: të jesh i qëndrueshëm, i ngulmët, që bëhet me këmbëngulje.

245. Konsolidim – consolidation. Rreth viteve 1400, nga latinishtja consolidationem (emri cosolidatis) nga consolidat, consolidare “per te bere te forte, per te konsoliduar” nga çon “se bashku” + solidare “ te besh, te jesh solid” nga solidus. Solid si mbiemer perdoret ne fund te shekullit 14-te nga frengjishtja e vjeter solide “ i forte, kompakt, dendur” nga latinishtja solidus “ i forte, I tere, i plote” (i lidhur me trajten “solvus”- i shpetuar, i lire) nga nje baze i.e-ne * sol – “ e tere, e plote” nga greqishtja holos i/e tere; nga latinishtja salus “shendet, qe gezon shendet te mire”. Ne zhargone kuptimi transmetohet si “ i mrekullueshem, i shquar, i

njohur dhe se pari deshmohet ne 1920 mes muzikanteve te xhazit. Emri regjistrohet nga fund i shekullit 15-te si jugu i forte, jugu solid ne historine politike te SHBA-se e deshmohet qe ne 1858. Solid/e si nje term ne fizike deshmohet qe nga 1953, me kuptimin “te punesosh tranzistore” (ne krahasim me tubat e vakumit)vjen si kuptim qe ne 1959. **“Nuk mund të ecësh i sigurt në rrugën e demokracisë edhe kur ajo është e konsoliduar nëse do të arsyetohej sipas parimit: “Re ka plot në qiell, por mbase nuk bie rrufeja”**

246. Konspirative – (conspiracy) folja conspire përgjithësisht që vjen nga rrezja latine çon (“me” dhe “spiro” marr frymë, kështu që ‘conspire’ fjalë për fjalë nënkupton ‘të marrësh frymë së bashku’. A) Akti i dy ose disa personave të quajtur konspiratorë, që punojnë fshehtësisht, për të përfituar disa qëllime , për të arritur disa rezultate të planifikuara, zakonisht e kuptuar me ngjyresë negative, përkeqësuese. B) Ligj (një bashkëmarrëveshje midis dy a më shumë personave për të thyer ligjin ndonjëherë në të ardhmen). C) një grup korbash. **“Takimet kokë më kokë mbartin në vetvete diplomacinë konspirative prandaj edhe bëhen, por nuk mund dhe nuk duhej bërë një i tille midis dy njerëzve që përfaqësonin dy qeveri.”**

247. Kontemporan – mb. Fjalë që ka hyrë nga gjuhët neolatine. Nuk e ka FGJSSH Kjo fjalë është zëvendësuar me fjalën shqipe bashkëkohor. Psh: *Qytetërimi bashkëkohor. Autorët (shkrimtarët) bashkëkohorë. Shoqëria bashkëkohore.*

248. Kontraversitet – f.(it.contraversione – shkelje) 1.kundërvajtje; 2.gjobë për kundërvajtje. *“Tema e komisioneve hetimore shkakton kontraversitet të lartë politik”.*

249. Koordinoj kal., koordinim – këto fjalë kanë temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Bashkërendoj.

250. Korrent – Fjalë me burim nga gjuhët neolatine. Është zëvendësuar me fjalën shqipe rrymë. Psh: *Rrymë elektrike. Rrymë e vazhdueshme. I ndërpreu rrymën.*

251. Kredibilitet – që nga 1590 nga latinishtja mesjetare credibilitas, nga latinishtja credibilis. Me kuptimin” mungesë, hendek besimi “vjen në 1966 lidhur me deklaratat zyrtare gjatë luftës së Vietnamit nga credible” i besueshëm” fundshekulli 14-të apo” i denjë për t’u besuar”. **“Territori politik kundër PS-së tregon se dikujt nuk i intereson kredibiliteti i saj në rritje në vend dhe në Evropë, si një nga forcat kryesore demokratike të Shqipërisë.”**

252. Kuisling –quisling. Që nga 1940 ,nga Vidkun Quisling (1887-1945), një politikan fashist norvegjez që drejtoi qeverinë kukull gjatë pushtimit gjerman të Norvegjisë në Luftën e Dytë Botërore , i vrarë për tradhti pas humbjes së Gjermanisë. Së pari fjala u përdor në Londër “Times” në 15 prill 1940 , në një kontekst tjetër. **“Qeveria angleze e ajo**

amerikane u kujdesën të aktivizonin e të mbanin afër edhe ata kuislingë e tradhtarë që me çlirim të vendit morën arratinë.”

253. Kurioz mb ., kuriozitet – janë fjalë të huaja të panëvojshme që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine në vend të këtyre fjalëve janë përdorur fjalët shqipe kureshtar dhe kureshtje.

254. Laborist – (angl.labourist)që i përket laborizmit, që ka të bëjë me partinë laboriste.

255. Lançim- Daton që në vitin 1300, nga frëngjishtja ‘Lancher’, (lancier)”hallakas, flak, hedh tutje”, nga latinishtja ‘lanceare’-përdor një heshtë, nga lancea në latinisht ‘shtizë e lehtë’.Kuptimi i prejardhur ka kaluar në ‘të hedhësh një varkë në det, në ujë’ dhe së pari dëshmohet në 1400.Kuptimi I figurshëm I fjalës mbartet në nocionin e “vështirësive që ka çdo fillim, nisja e një pune të re”(p.sh:lançimi i një libri në treg, lançimi I një makine të re).
“Nuk ka asnjë arsye ta bëjë këtë, sepse Berisha qe ai që lançoi në një popull, që firmosi...”

256. Latent-e adj – (lat.latens – i fshehtë) i fshehtë, që nuk duket, i padiktueshëm, i mbuluar, i pavënë re.

257. Lateral-e adj – (lat.lateralis – anësor) anësor, që është anash, sekundar, dytësor.

258. Leadership (lidership) – pozicioni i një lideri nga leader+ship ,fjalë e shtrirë që nga fundi i shek të 19-të për” nga karakteristikat e nevojshme të të qenit lider” 1821 anglisht.
“Hajrizi dhe Hidajet Hyseni kishin vërejtje, sesi Rugova kërkonte të ruante lidershipin e tij në Kosovë, por edhe për faktin se nuk konsultoi me Tiranën...”

259. Legal-e – adj (lat.legalis – ligjor) që bëhet ose zhvillohet haptaz, jo fshehurazi, që lejohet me ligjet në fuqi.

260. Legjitim-i – adj(lat.legitimus) i ligjshëm.

261. Leguminoz/e – Term i botanikës me burim nga gjuhët neolatine. Emri leguminoze, -t ka kuptimin “familje bimësh, e cila përmbledh barishte, shkurre ose drurë që e kanë frytin bishtajë”. Pra, leguminozet zëvendësohet me fjalën bishtajore. Psh: *Bimët bishtajore. Perimet bishtajore.*

262. Likuidoj – v(lat.liquidare – rrjedh) 1.shlyej (një borxh); 2.zhduk, asgjësoj. *Viti 2009 është produkt imasave eficente të ndërmarra në politikën dhe në sferën monetare, për të mbështetur sistemin tonë financiar me likuiditet të kërcënuar nga rënia e depozitave përmes marrjes së një kredie prej rreth 200 milionë euro.*

263. Limitacion-i – m(lat. limitatio – kufizim) të kufizuarit, kufiri deri ku mund të arrijë diçka ose dikush.

264. Llogarit – v(gr. Njehsoj) 1. Numëroj, njehsoj, bëj veprime me numra; 2. E kam parasysh, e përfill; 3.fig. mendoj, bëj veprime me mend për diçka.

265. Lobim – lobbying, lobby në 1550 nga latinishtja mesjetare laubia, lobia “ecje e mbuluar, në një manastir” nga lauba “sallë, holl, hapësirë”; me kuptimin sallë e madhe hyrjeje në një ndërtesë publike, dëshmohet që në 1640-ën. Me ngjyresë politike do të thotë “ata që kërkojnë të ndikojnë, të ndërhyjnë, t’i japin vetes hapësirë në legjislacionin” dëshmohet më vonë në zakonin e mbledhjeve jashtë dhomave legjislative. Si folje vjen në 1850-ën, I lidhur me fjalën lodge- degë lokale e një shoqërie të vogël. **“Pas konsultimit me stafin e tij apo të saj, me liderin e grupit, me përfaqësuesit e parapëlqyer të lobingjeve, me grupet e interesit, me korrespondencën e zgjedhësve...”**

266. Lobist-i - m(angl.lobbyst) ai që vjen në lob për të biseduar e për të ndikuar që të miratohet ose të mos miratohet një ligj.

267. Lokacion-i – (lat.locatio – vendose) vend, hapësirë, vend për të vendosur diçka, truall.

268. Lokal-e – adj(lat.localis – i vendit) 1. Ai që jeton a vepron në një rreth, krahinë, qytet a fshat të caktuar; që është vetëm për një vend të caktuar, i vendit; 2. med. që është i kufizuar në një vend të caktuar, që bëhet vetëm në një pjesë të trupit (për sëmundje), i pjesshëm.

269. Lokaut-i – m (ang.lock-mbyll + out – jashtë; lock out- përjashtim) mbyllja e një fabrike ose ndërmarrjeje dhe lëshimi masiv i punëtorëve nga puna.

270. Luajalitet (loyalty) – që në vitet 1400, nga frengjishtja e vjetër loyalte, loyaute, loyial nga latinishtja legalis “ligjore” nga lexlegis “ligj”. Si mbiemër merr formën leal, leale me po të njëjtin burim latin me kuptimin besnik(e), besnikëri ku fjala merr një ngjyrim feudal si “besnik në kryerjen e detyrimeve ligjore apo betim i sinqertë, besnik, i vërtetë” që është vërtetuar për herë të parë në 1952 e lidhur me subjektet e sovranëve apo qeveritarët; merr kuptim figurativ tek qentë, tek të dashuruarit, me kuptimin “i ndershëm, i besueshëm, i vërtetë etj. **“Luajaliteti ndaj vendit që u jep strehë dhe i mbron pakicat njëlloj si shtetasit e vet, është kriteri i parë i detyrueshëm në çdo demokraci...”**

271. Ludist (luddite) – 1811, emri i huazuar nga një bandë e organizuar endësish tekstilësh që shkatërruan makineritë në Midlands dhe në Anglinë veriore 1811- 1816 për shkak të frikës se s’do të punonin më. Supozohet se emri vjen nga Ned Ludd i cili në 1799 bëri të njëjtën gjë përmes çmendurisë, por së pari historia u tregua në 1847. **“Indiferenca e sindikalistëve ka arritur kulmin. Shumica e punonjësve të sektorëve të ndryshëm punojnë “në të zezë”. Ndjenja e reagimit ndaj padrejtësive, shfrytëzimit pa limit nga punëdhënësi të tipit ludist...”**

- 272. Lumpen** ~i M.(gjer.Lump-zhelan, rreckaman, varfanjak)
- 273. Luterian-i** – m (gjerm. Sipas Martin Luther-it, themelues i protestantizmit) protestant (sh.), ithtar i mësimit të Martin Lutherit.
- 274. Makartizëm/-zmi** – m(ang. sipas Joseph MacCarthy, 1909 – 1957, senator amerikan) politika reaksionare e Makartit , që zhvillohej nën parullën: “luftë kundër rrezikut komunist” në periudhën e pasluftës së dytë botërore.
- 275. Marketing-u** – (ang.marketing – tregti) hulumtim sistematik i tregut për të shitur prodhimet; zyra që merret me këtë veprimtari në një ndërmarrje prodhuese, tregtare e ekonomike;Marketing politik
- 276. Masterplan** – 1. Si emer plani master, nje plan i pergjithshem per arritjen e nje objektivi i perdorur rreth viteve 1925- 1930. 2. Nje permbledhje ne funksion te nje projekti afatgjate te qeverise psh “Bordi i zonimit miratoi nje masterplan per zhvillimin e ri. 3. Master ne shkence, ne inxhinieri, ne teologji, kryeveper, master per t’u bere rreshter, officer, master te grades etj. 4. Nje plan i dhene , udhezim/e te pergjithshme. 5. Nje dokument i plote qe percakton nje strategji te pergjithshme (emer). 6. ne arkitekture- nje permbledhje e vogel grafike qe tregon elementet kryesore te nje projekti. 7. Nje skice afatgjate per nje projekt qeverie. 8. Sinonim: plan kryesor. **“Këtu nuk kishim të bënim me një masterplan, por kishim të bënim me një shpallje për të gjithë subkoshiençën e Partisë së Punës dhe shoqërisë shqiptare, se luftën e klasave duhej ta shihnin me fytyrën e E.Hoxhës.”**
- 277. Matrikulloj** – (lat.matricula – amëz)regjistroj, shënoj në amëz.
- 278. Medicin/ë** – medicinal mb - Fjalë me burim nga gjuhët neolatine. Është zëvendësuar me fjalën shqipe mjekësi dhe mjekësor. Psh: *Mjekësia ligjore. Qendër mjekësore. Studion për mjekësi.*
- 279. Medikolegal** – në vend të kësaj fjale të përbërë nga dy tema të huaja, po përdoret formimi shqip mjekoligjor. Psh: *Komisioni mjekoligjor. Shqyrtim mjekoligjor.*
- 280. Mekartizmi** – Fjalori i trashëgimisë amerikane e përkufizon “ si një praktikë politike të akuzave publike i lidhur me tradhëtinë apo subversionin , por pa prova të mjaftueshme”. Subversion nënkupton “ përpjekje sistematike për të rrëzuar ose kërcënuar një qeveri ose një sistem politik nga persona që veprojnë nga brenda (Merriam Webster ’s Dictionary of Laë, fjalori i ligjit). Termi zë fill më 9 shkurt 1950 kur në fjalimin e mbajtur në ditën e Linkolnit në Ëheeling, Virginian Perëndimore , në grupin e grave republikane, senatori Mekarti, duke tundur një letër në dorë, shpalli se zotëronte një listë me 205 emra komunistësh të punësuar në departamentin amerikan të shtetit. Termi specifikisht përshkruan veprimtaritë e zhvilluara në periudhën e njohur si paniku i kuq i dytë (i kuq = komunist), frikë e ekzagjeruar nga

ndikimi komunist në institucionet amerikane dhe nga spiunazhi nga agjentët sovjetikë në vitet e para pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Termi lidhet me emrin e Jozef Rajmond Mekart senator i SHBA-së në 1946 – 1957. “Gjuetia e tij e shtrigave “ është përkufizuar si “Arritja kryesore e Mekartit ka qenë coroditja e mendjes së publikut nga kërcënimet e komunizmit nga brenda dhe nga jashtë”. “Fryma mekartiste ushqeu politikën e agresivitetit, të frymëzimit, të tensionimit, të destabilizimit, të mospërfshirjes dhe të inhibitimit.”

281. Mentor – m(gr. Këshillues)ai që këshillon dikë për një punë. *Tashmë publiku është i sigurt për autorët e tij, për mentorët e tij dhe për përfituesit direkt të skandalit.*

282. Mikse ~mixed – folja mix. 1530 nga anglishtja mesjetare myxte shek 15-të, nga latinishtja mixtus; miscere” të përzjesh”, nga i.e – në *meik “të përzjesh ose përzihem, shoqërohem, nakatos”. Emri dëshmohet që në 1580-ën, “martesa të përziera” që në 1690 në një kontekst fetar; kuptimi social u përdor ne 1942 në SHBA; “qese e përzier ,koleksion heterogjen” vjen që në 1936; “konfuz” vjen që në 1826 dhe “përzjerje” dëshmohet së pari që në 1898. “Është premtuar krijimi i komisioneve mikse që në realitet thuhet nuk janë mbledhur kurrë.”

283. Militant-i – m(lat.militare – shërbej si ushtar; militaris – ushtar) të qenët militant, qëndrim e veprimtari prej militanti, frymë luftarake.

284. Millenium (millennium) - Që nga 1630 nga latinishtja mille “mijë” + annus “ vit” (vjetore) e formuar në analogji me biennium, triennium etj. Së pari në anglisht në kuptimin e periudhës njëmijë vjeçare të sundimit të parashikuar të krishtit në tokë (zbulesa 1-5). Në kuptimin e çdo periudhe të përbërë nga njëmijë vjet, së pari dëshmohet në 1711. “... **apo 400 vjet më parë, pra më shumë se një milenium pas themelimit të saj.**”

285. Minimizim-i m(lat.minimus – shumë i vogël) zvogëlim i tepërt, zvogëlim, ulje në kufirin më të poshtëm.

286. Ministër/-tri – m(lat.minister – shërbëtor)anëtar i qeverisë, që drejton një ministri, sekretar shtetëror.

287. Mirazh-i – m(fr.mirage – vegim, përthyerja jo e njëllojtë e rrezeve të dritës në shtresat e ajrit me dendësi të ndryshme dhe që krijon te njeriu përshtypjen e rreme të shtresave të ujit, të sendeve të përmbysura ose të shformuara, mashtrim optik; përshtypje e rreme, pamje a dukje mashtruese, iluzion.

288. Miting-u – m(ang.meeting – takim, mbledhje) mbledhje e gjerë, zakonisht në shesh të hapur, ku marrin pjesë shumë njerëz dhe ku mbahen fjalime me karakter politik e shoqëror.

289. Mocion – si emër përdoret në fundin e shek 14-të nga frengjishtja e vjetër motion (shek 13-të), nga latinishtja motionem, motio “një lëvizje, një emocion” nga motus, movere “për të lëvizur” i lidhur me move – veprim. Si folje përdoret në procedurat parlamentare së pari në 1747 me kuptimin “te udhëhiqesh ose të drejtohesh nga një shenjë, gjest, lëvizje” dhe së dyti shfaqet rreth vitit 1787. Sinonime për fjalën në shqip janë: levizje, mocion, propozim, veprim, interpelancë, shkresë, marionetë, ecje, gjest, zbrazje, e ecur, bëj shenjë(folje), diçka e vënë në lëvizje, për të filluar”. Lëvizje civile, lëvizje anatemi, të shuash një lëvizje, të mbash nën kontroll një lëvizje, lëvizje lineare, lëvizje unazore, lëvizje e sensorëve, shkenca është në lëvizje, lëvizje grafike, kapje e lëvizjes, vë/vendos në lëvizje, vë në operacion janë disa nga përdorimet e fjalës. **“Mocion për debat do të thotë një propozim për debat, kur hidhen idetë dhe drejtimet thelbësore të problemeve... Betejat për demokracinë e brendshme në parti filluan me mocionin antiberisha në 1992 shuarjen e diversitetit të mendimit me manorat e referendumit në 1994.”**

290. Modus vivendi – (lat.) mënyrë e jetesës, jetë toleruese ndaj të tjerëve në bashkësinë e palëve të kundërta, bashkëjetesë.

291. Mondan-e adj – (it.mondano) që lidhet me jetën plot dëfrime, që ndjek modën, që bën jetë të zbrazët dhe pa kuptim.

292. Monitorim – monitoring /monitor. Që nga 1540-ta me kuptimin e parë të “një djaloshi /zotërie /të riu /shkollari në shkollë i ngarkuar për të mbajtur rregullin” nga latinishtja monitor “dikush që kujton, qorton ose kontrollon “nga monere “të qortosh, të paralajmërosh, të këshillosh”i lidhur me memini “. “Unë kujtoj, unë jam i ndërgjegjshëm për”.....dhe me mens “mendje” nga forma e rindërtuar i.e-ne me bazë*men – të mendosh (shih mendje). Hardhuca quhet në këtë mënyrë sepse ajo mendohet ose supozohet që jep paralajmërim për krokodilet (1826). Me kuptimin “mbledhje, tipa anijesh që lëvizin ngadale, të veshura me pllaka hekuri” vjen më 1862 dhe është mbiquajtur kështu nga emri i së parës anije me këtë dizajn, e zgjedhur nga kapiteni Ericsson sepse ajo mendohej se “do të paralajmëronte konfederatën e aleatëve në luftën civile në SHBA. Duke u shtrirë më tej kuptimi merr një ngjyrim të ri të “një pajisjeje që kontrollon vazhdimisht cilësinë teknike të transmetimit”(1931) dhe kjo çoi në një kuptim specifik për “ një ekran televiziv ku shfaqen vazhdimisht foto nga një aparat i veçantë, nga një kamera”. Si folje të monitorosh (monitoring) dëshmohet në 1924. Fjala lidhet me trajta si folje dhe si mbiemër. **“Ky del si një monitorim imperativ i situatës që po kalon vendi, në një kohë që fragmente të politikës, po mbështetin hapur konfliktin dhe kundërvënien.”**

- 293. Monitor**-oj (ang.monitor) 1.kujdestar, këshilltar; 2. Monitorizoj-kotrolloj me monitor (regjistrimin e zërit), vëzhgoj (një emision në studio); ndjek; vëzhgoj(me radar); kap, interceptoj. *Kërkon prej qeverive përkatëse që, në bashkëpunim me komisionin, ta monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme repektimin e saj.*
- 294. Monopol**-i m – (greqisht – e drejta që ka vetëm dikush për të prodhuar, për të tregtuar ose për të përdorur një mall a diçka tjetër. 2. Fig.mundësi a e drejtë që ka vetëm dikush, zotërim a sundim i plotë i dikujt në një fushë të caktuar.
- 295. Montazh**-i m – (fr.montage – mbërthim) bashkim dhe lidhje e pjesëve të veçanta të një makine, të një pajisjeje, të një godine a të një aparati; montim.
- 296. Moratorium**-i m(lat.moratorium – shtyrje për më vonë) 1. Ek. Shtyrja e afatit për shlyerjen e huave a të kredive, që bëhet me vendim qeverie ose me ligj me raste të veçanta e në rrethana të jashtëzakonshme; ndalim i përkohshëm i pagimit të borxheve; 2. Ndërprerje e përkohshme e një veprimi, e një pune a veprimtarie, shtyrje për një kohë e një pune.
- 297. Mortalitet**-i m – (lat.mortalitas) vdekshmëri.
- 298. Moto**-ja (it.motto – parullë; shaka) qëllim a synim i rëndësishëm, ide a parullë që e nxit dhe e udhëheq dikë në jetë ose e shtyn përpara në një veprimtari.
- 299. Mufatur** – nuk njihet origjina e kësaj fjale. 1.Të fryrë, të enjtur. *Disa ende me sy të mufatur nga përgjumja.*
- 300. Multilateral**-e adj(Lat.multi – shumë + lteralis – anësor) i shumanshëm, shumëpalësh.
- 301. Municipal**-e adj – (lat.municipalis – i qytetit)vetëqeverisës, i pavarur.
- 302. Muzë**-a (gr. & lat. Musa) 1. Në mitologjinë greke secila nga të nëntë hyjneshat, bijat e Zeusit dhe të Mnemosisë; 2. Poezi, burimi e frymëzimi poetik, frymëzimi për të krijuar, krijimtaria poetike e dikujt me veçoritë e veta dalluese.
- 303. Nazizëm**/-zmi – m.(lat.shkurtim për: nacionalsocializëm) fashizmi gjerman; nacionalsocializëm, koha e sundimit hitlerian (1933 – 1945) dhe gjithçka që lidhet me të.
- 304. Neolatin** – adj(gr. – i ri + lat.Latinus – latin) që e ka prejardhjen nga latinishtja ose që është krijuar mbi bazën e saj, për gjuhët si (italishtja, frëngjishtja, spanishtja, rumanishtja etj) 2.që është pasardhës i romakëve ose që ka qenë ndikuar thellë nga pushtimi dhe qytetërimi romak.
- 305. Nokaut**-i m – (ang.knock – godit + out – jashtë; knockout) 1.fig. humbje e plotë në diçka; humbje keqas; 2. Sp.gjendja e boksierit që është goditur nga kundërshtari e që është rrëzuar përtokë dhe që nuk arrin të ngrihet brenda dhjetë sekondash, duke u quajtur i mundur.
- 306. Nonsens** - (lat.non – jo+ sensus – kuptim)pakuptimsi, gjë e pakuptimtë, budallallëk

- 307. Non-stop** – adv(ang.nonstop)pandërprerje, vazhdimisht, në mënyrë të vijueshme, gjithnjë.
- 308. Nostrifikim-i** m – (lat.noster – yni + facere – bëj; nostrificato – „bërje diçka tonën”) pranimi me ligj i një dokumenti(dëftesë shkollore etj) i cili është fituar në vendin e huaj.
- 309. Novacion-i** (lat.novus – i ri) metodë e re në prodhim ose në teknikë; diçka e re e përparimtare në fushën e shkencës a të artit, risi.
- 310. Nudist** – (lat.nudus – lakuriq)ithtar i nudizmit, ai që lahet e rrezitet lakuriq.
- 311. Odise-ja** f(gr. Odise – mbret Itakës sipas mitologjisë greke) 1. Mit. Eposi i njohur i homerit mbi bredhjet dhjetë vjeçare dhe përjetimet e jashtëzakonshme të mbretit të Itakës, i cili pas rënies së Trojës kthehet nëpërmjet detit në atdhe. 2. Fig,bredhje, endje, aventurë.
- 312. Ofezë-a** f – (lat.offendere – fyej; it.offesa) fyerje.
- 313. Ombrellë-a** f – (fr.ombrelle) 1.çadër dore, që shërben për tu mbrojtur nga shiu a dielli; 2. Bot.tufë lulësh, bishtat e të cilave dalin nga i njëjti vend dhe zgjaten njëlloj, degë të disa pemëve në trajtë çadre; 3. Fig. mbrojtje kundër goditjeve që mund të vijnë nga lart.
- 314. Omega** – (gr. – O e madhe) emri i shkronjës së fundit të alfabetit grek.;nga alfa te omega –nga fillimi deri ne fund,nga a-ja te zh-ja.
- 315. Omniprezent-e** – (angl.omni-rrallë; presence-prani)1.paraqitje, pamje, sjellje, qëndrim 2. Present, i tanishëm, aktual.
- 316. Ordiner** – **adj**(lat.ordinarus – i rregullt) i zakonshëm, i rëndësishëm, i rregullt. *Ka qenë lufta kundër kapjes së shtetit, ka qenë kundër krimit ordiner dhe atij të organizuar.*
- 317. Ornamente** – n. emër fillimi i shekullit 13-të “ një aksesori” , nga frëngjishtja e vjetër “ornamentum”. “Pajisje, zbukurim, stoli, dekorim, pajisje që të shtien në kurth”, nga ornari ”I pajisur, i adhurueshëm, i admirueshëm”(shiko ornate). Që nënkupton dekorim, zbukurim është pritur që nga fillimi i shek 14-të. Folja regjistruar në 1720,e prejardhur nga emri. “**Hymë në një sallë të madhe të veshur me dru dhe të zbukuruar me ornamente klasike në mure e tavan, si dhe...**”
- 318. Pacifist** – 1906 nga frëngjishtja pacifiste (shih pacifizëm); 1902 që vjen nga frëngjishtja pacifism nga pacifique (shih paqësor). Që nga 1950-ta “të kerkosh të vendosësh paqe”, nga frëngjishtja e mesme pacifique; nga latinishtja pacificus “ paqedashës, paqebërës, paqësor”; nga pax – pacis “paqe” + rrënja e facere “të bësh” me kuptimin paqësor, i qetë. Regjistrohet së pari herët, në 1630-ën. “**Duhet të ishte dikush pacifist e i mbytur fort me pacifizëm.**”
- 319. Paroksizëm** – dalldi, papriturishmëri, sulm, që në 1570 nga frëngjishtja mesjetare paraxysme(shek 16-të) më parë në trajtën paroxime (shek 13-të) nga latinishtja e mesme

paroxysmus “ acarim i një sëmundjeje” ose “ nxitim, nxis” nga para “përtej” + oxynum “theksoj, nxis ” nga oxys “theksim, mprehtësim”. Kuptimi jomjekësor i fjalës është dëshmuar në 1600-ën. Sinonime : dalldi, atak, krizë, shpërthim si kuptime të prejardhura të fjalës. **“Një pjesë e elitës politike e kulturore e fqinjëve sllavë në vend që të shpjegonte se populli shqiptar nuk mund të paguante mizoritë, kapardisjet e trillet e feudalëve të vet, bëri shpesh të kundërtën: e nxiti revanshin gjer në paroksizëm.”**

320. Paternaliste – paternalisation do te thote rrjedh nga babai, mashkullarizim. 1. Te trajtosh atesisht; veçanerisht te mbeshtetesh dhe te kontrollosh , pra ta besh te varur karshi vetvetes. Folje kalimtare , ta besh ateror, te vendosesh ne nje rol ateror nga latinishtja pater “baba, atë”. **“Për italianët ishte një popull fëminor që kishte nevojë për paternalizëm.”**

321. Penetrim – fillimi I shek. XV lë të nënkuptohet që është i përshkueshëm, i depërtueshëm. Nga latinishtja penetrates, penetrare “ te vendosësh ose të futesh në; brenda , të hysh në ” e lidhur me penitus “**penus inner**” pjesët më të fshehura të një tempulli, magazinë ushqimi, “penates” vendruajtje ushqimesh, të mirash, materialesh. Lidhjet me penetrated ,penetrating janë përdorur që në 1630 , me një kuptim figurativ për “ të prekësh ndjenjat thellësisht, jo qëllimisht e dikujt ”. **“Me polici dhe ushtri, kishim bërë një rrethim të jashtëzakonshëm dhe kam arritur bashkë me ta të penetroj pas një kohe nëpër një rrugicë përtej televizionit.”**

322. Perkusione – që nga 1540 “ një goditje, një mrekulli” nga latinishtja percussioem emri percussio, si formë rrjedhore e percutere “ në greve” nga per “përmes” + quater “ne grevë”, shkundje, dridhje etj. Lidhjet me instrumentat muzikore së pari dëshmohen në 1776 si përdorime dytësore të fjalës. **“Figura të ndritura të Rilindjes Kombëtare e kanë shkruar emrin e tyre në panteonin e kulturës turke, duke na dhënë shembullin e perkursioneve tronditëse, që s’njohin kufij, as xhelozit të ngushta pseudonacionaliste.”**

323. Permanente – permanent, herët shek. 15-të nga frëngjishtja e mesme; latinishtja permanentem , emër: permanens “qëndrueshmeri, durimshmëri”, pra duroj, vazhdoj, qëndroj deri në fund nga per- “përmes” + manere – “qëndroj”(shiko residencë). **“Për çdonjërin e këtyre tri drejtimeve themelore është parashikuar ngritja e tryezave permanente të rrumbullakëta.”**

324. Persistencë – qe nga 1540 nga frëngjishtja persistence, nga latinishtja persistentem. Qe nga shek.XVI shqiptohet me a. folja eshte persist e shfaqur që në 1530 nga frëngjishtja mesjetare persister (shek. 14-të), nga latinishtja persistere “te vazhdosh me ngulm” nga per “tërësisht”+ sister “ të bësh që të qëndrosh ende, të qëndrosh”. **“Po kështu jashtë**

racionalitetit është edhe terminologjia e barazisë apo elitarizmit e ushqyer nga persistenca e një mentaliteti të vjetëruar dhe konsumuar monist.”

325. Perturbacione – nga latinishtja perturbation, etimologjia e saj lidhet me perturb “shqetësoj” + ation “situata”; si emër i panumërueshëm, në njëjës perturbacion me kuptimin “turbullim, agjitacion i një shteti në gjendje të trazuar ” (i panumërueshëm) 2. (i panumërueshëm) “një ndryshim i vogël në një sistem fizik apo më gjerë në ndonjë sistem të caktuar psh., biologjik, ekonomik 3. (si emër i numërueshëm në astronomi e fizikë merr kuptimin “Ndryshim në një orbitë për shkak të ndikimit të organeve ose trupave të jashtme, agjitim”. Kuptime të prejdardhura nga kuptimi parësor janë: turbullirë, shqetësim, çmendje, trazim”(për njeriun). **“Çdo gjë tjetër do të sillte perturbacione të paparashikuara që mund të çonin deri në situata të pakontrolluara si nga partitë politike ashtu edhe nga sindikatat.”**

326. Pezhorativ – fjalë përbuzëse, “kundërshtim me anë të sugjerimit, se diçka nuk është e mirë ose se nuk është shumë i rëndësishëm”; fjala ka konotacion negativ sidomos me kuptimin “denigrim, prirje denigruese ose nënçmuese, pakësuese”. 1. Prirje për të bërë keq, prirje për të degraduar, nënçmuar, zhvleftësuar ,përçmuar”. **“Unë e quaj se fjala fraksion është me sens pezhorativ, por që një pjesë e partisë ka ide ndryshe.”**

327. Pinjoll, Pinjoli – njeri nga familja “sens famille” de pin, Joli frengjisht. **“Ai ishte një pinjoll i familjes Nano që kërkonte të zhvlerësonte situatën”**

328. Politikë antitrust – 1890, SHBA nga anti + trust në kuptimin e një monopoli ekonomik. Trust si emër përdoret rreth viteve 1200 nga traust “ndihmë, besim” apo komfort, ngushëllim, besim, besnikeri, rehat apo marreveshje, aleance, siguri. Kuptimi i “bizneseve të organizuara për të reduktuar konkurrencen” regjistrohet me 1877. Si folje regjistrohet me kuptimin “besim”, pra politike antimonopolesh ose politike kundër monopolit ekonomik që në 1903.

329. Pompoz – (gr. Suitë; vizitë madhështore; lat. pompa – madhështi pomposus) i bujshëm, i zbukuruar tepër, i stërholluar e i fryer, madhështor.

330. Posedoj - (lat.posidere – zotëroj) kam diçka, zotëroj diçka, e kam në pronësi.

331. Preambul – fundi i shek 14-të nga frengjishtja vjetër(shek 13-të) preambule, nga latinishtja mesjetare preambulum ”diçka paraprake” nga preambulus “duke ecur përpara” si formim i prae “para” + ambulare “për të ecur”. Sinonime: hyrje, parathënie, bëj hyrje, ecje e shtruar, hap i qetë. Kuptimi fillestar lidhet me sferën e kafshëve e sidomos për kuajt dhe kalorësit. **“Në preambulën e traktatit shpallej fundi i luftës midis Italisë dhe fuqive aleate.”**

332. Predominioj *kal.*, predominim, predominues mb. – Fjala predominoj ka kuptimin “kam epërsi, zotëroj mbi të tjerët, sundoj mbi të tjerët, shquhem më shumë” dhe zëvendësohet me fjalët mbisundoj, mbizotëroj.

333. Prepotent – (lat.praepotens - i fuqishëm) ai që e përdor forcën për të detyruar ose për të shtrënguar një tjetër të veprojë ashtu si thotë ai; mujshar, dhunues.

334. Prognoza – vitet 1650, vjen nga latinishtja prognosis “parashikim paraprak për rrjedhën e mundshme të një sëmundjeje”; nga greqishtja prognosis “njohuri paraprake”, nga progignokein “duke ditur paraprakisht, nga pro “para” + gignoskein “ardhje tek nohja, tek dija”. Prejardhja më e hershme besohet të vijë nga “gnostik” si- besimtar në një doktrinë mistike, fetare të diturisë shpirtërore- apo me kuptimin grek “gnostikos” si “duke e ditur, në gjendje të dallojsh” apo “mësoj, bëj me dije” e aplikuar në sekte të ndryshme kristiane që dëshmonin njohuritë e tyre drejtpërdrejt, personale përpos Ungjillit dhe hierarkisë së kishës. **“Prognoza ishte imediate: të largoheshin menjëherë pa lënë gjurmë.”**

335. Promotor – Sponsor, promovues. Hasur së pari në mesin e shek 15-të “ai që nxit” emër agjenti nga promote sinonime: nxitës, përkrahës, reklamues, lëvrues, themelues. Në kuptimin specifik i lidhur me anën financiare për” ai që çon në formimin e një kompanie” dëshmohet që në 1876; kuptimi i “atij që organizon ngjarje, evenimente sportive ose argëtuese “dëshmohet që në 1936. **“Sesioni promotor nis me ligjet që duan 84 vota...”**

336. Proselitizëm – 1650 si folje dëshmohet që në fund të shek 14-të, nga frengjishtja vjetër proselite (shek 13-të) nga latinishtja proselytes, greq proselytos “të kthyer, të konvertuar (për judaizem) i huaj, dikush që sapo ka ardhur” nga protî “drejt” + rrënja e eleusesthai “të vij, duke ardhur drejt”, vizitor i ri, i sapoardhur. Fillimisht ne gjuhen angleze me kuptimin “një pagan i konvertuar në judaist (fundshekulli 14-të). **“Proselitizmi i dhunshëm, ndërrimi i emrave, i fesë, fyerjet, keqtrajtimet, burgimet me shkak e pa shkak e gjer te torturat e vrasjet me një plumb pas kokës...”**

337. Prosperitet~i – (lat.prosperitas-lumturi) përparim, mirëvajtje, mbarësi.

338. Pseudoelitë – snob, një pseudointelektual. Elite 1823 nga frengjishtja elitë “seleksionim, zgjedhje” nga frengjishtja e vjetër eslitë (shek 12-të) folja elire, elisre “të nxjerrësh diçka, të zgjedhësh” nga latinishtja eligere”zgjedhje”. E huazuar nga anglishtja e mesjetës si “person i zgjedhur” (fundi i shek. 14-të) një peshkop i zgjedhur që vdiq në mesin e shek 15-të i paraqitur në “Don Juan” të Bajronit në 1920. **“Kundërshtarët e një koncepti të tillë, nga elita e vërtetë, e përjashtojnë “elitën politike”, duke e quajtur këtë të fundit si pseudoelitë, si “elitë vulgare që bie lehtë nën ndikimin e masave të kuptuara si turma lehtësisht të manipulueshme.”**

339. Purifikues~e – adj.(lat.purus- i pastër+facere-bëj) spastrues, që spastron, që spastron nga një e keqe, që lan “mëkatet”.Që është në kundërshtim me parimet europiane; që kundërshton parimet europiane. Fjalë me etimologji nga greqishtja e vjetër, formuar me parashtes me prejardhje nga greqishtja e vjetër, ka hyrë në gjuhën shqipe në përbërjen e disa termave të huaj. Kjo parastesë po zëvendësohet sipas rastit me prashtesën e shqipes kundër.

340. Refleksion – fjala e ka origjinën në vitet 1350 – 1400. Anglishtja e ka ahuzuar nga latinishtja në formën reflexion – reflexio. Ekuivalente me formën latine reflex(us). Formohet me prapashtesim reflex + ion. 1.një imazh i pasqyruar nga një pasqyrë, ose në një sipërfaqe uji; 2.veprimi ose procesi i pasqyrimit të temperaurës, tingullit, ose të dritës; 3.një e dhënë për diçka (veshja është reflektimi i personalitetit tuaj); 4.një gjykim i zgjatur dhe i kujdesshëm për diçka a dikë; një frazë e shkruar apo e folur për diçka që është menduar me kujdes; 5. Një përshtypje ose një përskrim i diçkaje; 6. Përqëndrim mendor, konsideratë e kujdeshme. *“Të njëjtat fjalë unë kisha dëgjuar ti përsëriste edhe dy ditë më parë, gjatë një séance të refleksioneve të organizuara në ILA nga Edi Rama dhe Ardian Klosi”*

341. Rekurs – recourse ,fundshekulli 14-të, nga frengjishtja e vjetër recours shekulli 13-të, nga latinishtja “recursus” kthim mbrapa, tërheqje, kthim, kthesë. **“Hapet rruga për titullarët e kësaj prone për të bërë rekurs në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut të Strasburgut për “dhunim...”**

342. Reparacione (reparations) - fundi i shek 14-të, “riparim” nga reparationem latinisht si emër reparation “ akti i riparimit, restaurimit” nga latinishtja reparatus “rivendosur” ,pra do të thotë “ akti i riparimit apo ndreqjes” dhe ky kuptim është vulosur nga 1400-ta. Kuptimi “dëmshtëpërblim apo kompesim për dëmet, si borxhe të agresorëve” është vulosur në 1921 nga frengjishtja reparations – dëmshtëpërblimet, borxhe të lara ,të shlyera (1919). **“Të vetmet çështje në lidhje me Shqipërinë që u prekën në këtë konferencë ishin ajo e incidenteve në kufirin shqiptaro-grek dhe e reparacioneve, borxheve ende të pashlyera që Shqipëria duhej të merrte nga Italia.”**

343. Rinovim (renovation) – fillimi i shek. 15-te renovacion “rilindje shpirtërore” gjithashtu “rindertim, rikonstruksion”. Nga latinishtja renovationem “riperterij, rivendos”. Nga re”perseri” + novare “bej te re” nga novus “ e re”. **“Në këtë kategori do të përfshija krijimin e KOP-it nga S.Berisha, i reklamuar në prag të zgjedhjeve të 3 korrik 2005 si rinovim i paprecedent, si një papërqëndrim i aftësive intelektuale e qeverisëse, duke tërhequr në politikë...”**fq 136 **“Ai ishte një rinovim total e solid i situatës kaotike që ishte krijuar pas zgjedhjeve elektorale.”**

344. Rotacion – m(lat.rotare-rrotulloj) 1.rrotullim, sjellje rotull; 2. Ndryshim i pozitës, ndërrim. *Në këtë kuadër, ne kemi të angazhuara prej datës 18 korrik 2008, me rotacion 6-mujor, 63 ushtarakë nëmisionin paqeruajtës në Çad.*

345. Rotativë - fjala e ka origjinën në vitet 1545-1555. Vjen nga latinishtja në formën rotation. 1.Një kthesë rreth si në një aks. 2.Astronomi. lëvizja apo rruga e tokës ose një trup qiellor i kthyer në aksin e saj. *“Po del nga rotativa”*

346. Sadizëm/-zmi – (fr.sadisme – sipas autorit francez të romaneve të paturpshëm, markizit De Sade, 1740-1814, të cilin Napoleoni I e pat dërguar në spital si psikopat) 1. Med.çrregullim i sëmurë psikik, kur epshi seksual kënaqet duke i shkaktuar tjetrit dhembje ose mundime; 2. Prirje e sëmurë për të ndier kënaqësi kur u shkakton të tjerëve vuajtje e mundime të mëdha, egërsi e stërholluar.

347. Sagë-a – (norv. Saga – diçka që tregohet, që rrëfëhet; gjerm. Sage- perëndeshë e tregimeve dhe e historisë së po pujve të Veriut) lit. këngë epike popullore ose legjendë e përhapur sidomos në vendet skandinave e në Islandë në mesjetën e hershme.

348. Salutoj – (lat.salutare – nderoj) përshëndet, nderoj.

349. Sanksionim-i m – (lat.sancto – urdhër i prerë) miratim përfundimtar nga një organ më i lartë i një ligji, i një vendimi, i një programi etj që e bën të detyrueshëm për t’u zbatuar.

350. Sens – fjala e ka origjinën në vitet 1350-1400. Vjen nga latinishtja sensus dhe përdoret si emër. 1. Një nga shqisat, si shikimi, dëgjimi, nuhatja, shije apo prekje, me të cilat njerëzit dhe kafshët përceptojnë stimuj me origjinë nga jashtë ose brenda trupit; 2.funksionimin e tyre apo veprimtarine, ndjesi; 3.një vlerësim ose të kuptuarit e aftësisë ose vlerave(është qesharake të mos kesh sens humori); 4.ndërgjegjësim ose vetëdije për diçka(ka sensin e vetëvlerësimit) 5.arsye të gjykuarit drejt diçkaje (nuk ka sens të shkosh vetëm); 6. Një gjendje normale e mendjes, aftësia për të menduar qartë(asnjë në sensin e drejtë të fjalës nuk do ta linte vetëm një fëmijë); 7.kuptimi i një fjalie a fraze (fjalja nuk ka sens); 8. Një mënyrë në të cilën një fjali a fjalë merr një tjetër kuptim (në sensin figurativ; ajo që thua ti ka sens në një farë mënyre); 9.një ndjesi e përgjithshme ose një mendim i përbashkët i një grupi njerëzish (sensi i mitingut ishte.....). *“Vite më pas, kur distanca kohore të jep mundësi të gjykoje më thjeshtë, pata kujtuar me admirim ato momente dhe atë sens sakrifice”.*

351. Sentencë-Që nga 1660 nga latinishtja dictum “fjali të thëna “(nje thenie , fjali e mirë , profeci ,një urdhër ,një komandë) vjen nga dictus , dicere të thuash (diksion) . 1. Mendim i shprehur me pak fjalë, që përmban një të vërtetë jetësore ose morale; fjalë e urtë; 2. Jur.vendim i gjykatës.Në përdorimin ligjor merr kuptimin e shprehjes se mendimeve nga

juria që është përmbyllja formale e një çështjeje , pra në kuptimin gjyqimor, vendimi i një seance gjyqësore. “**Muzeu E.Hoxha ishte një piramidë pa sarkofan, pa sentencë”.**

352. Sentimental-e adj – (lat.sentire – ndjej; fr.sentimental – i ndjeshëm) 1.që preket shumë shpejt në ndjenja, tepër i ndjeshëm; 2.lit. që i kushtohet shumë botës së ndjenjave, që përshkruan njeriun dhe natyrën me shumë ndjenja.

353. Sepal – fjalë e huaj e botanikës që emërton secilën nga gjethëzat, zakonisht të blerta, që përbëjnë kupën e lules”. Kjo fjalë zëvendësohet me fjalën shqipe nënpetël. Psh: *nënpetla e lules. Lule me katër nënpetla.*

354. .Separatizëm/-zmi – (lat.separatio – ndarje) përpjekje për tu shkëputur nga një tërësi a bashkësi e organizuar politike, ekonomike, shtetërore, fetare etj.

355. Sfumim – 1847 nga italishtja sfumato, me kuptimin “i tymosur, i vendosur nën flakë;si emër shfaqet sfumim me prapashtesën –im. “**Për ta sfumuar sado pak këtë çështje në momentin kur po diskutohet çështja e Kosovës...**”

356. Shik – adv (fr.chic- shije, elegancë) në mënyrë elegante e me shije të stërholluar.

357. Silvikultur/ë – term bujqësie, me prejardhje nga gjuhët neolatine. Është zëvendësuar me fjalën shqipe pylltari. Psh: *Zhvillimi i pylltarisë. Kurs për pylltari.*

358. Simbiozë – Symbiosis 1877, si një term i biologjisë “ lidhje e ndërsjellë, e përbashkët, dobiprurëse të dy oganizmave të ndryshëm” nga latinishtja moderne. Nga greqishtja symbiosis “ një të jetuar së bashku”; nga symbios (një) të jetuarit bashkë, me një partner tjetër, nga “syn”- (së bashku) + “bios”(jetë). I jepet një kuptim më i gjerë, jobiologjik në 1921. Një kuptim më i herët për “ jetë sociale e përbashkët” gjendet që në 1620. “**Ndoshta më e vlefshme do të ishte rritja e konsensusit të ri, e një simbioze të re midis vetë popullit.**”

359. Simultane – simultaneity 1. Ndodhi, ekzistencë, diçka e kryer në të njëjtën kohë, kontemporan; nga latinishtja simul “ në të njëjtën kohë” sem si rrënjë i.e-ne + taneous (i menjëhershëm,i njëkohshëm, bashkëpunim, rastësi, bashkëndodhje, koincidencë). “**Fryma simultane është një nxitje edhe më e madhe e cila njëkohësisht edhe hapësirën që kontributi i Turqisë dhe...**”

360. Skaner (scanner) – sinonimi i skanograf. 1927, si një lloj pajisjeje mekanike, si folje del në fund të shek 14-të si “shenjë tek këmbët metrike”, nga scandere latinisht “të hetosh” fillimisht nga latinishtja klasike “ të rritet, të ngjitet(kuptimi që të çon tek ritmi në rritje dhe zbritje në poezi) merr kuptimin hapa, hedhje, pengesë, kërcim. Kuptimi “ i hedh një sy shpejt, e çek” është vërtetuar së pari në 1926 ndërsa, si emër skanim del së pari në 1706 me kuptimin pamje nga afër, shqyrtim,kqyrje,vëzhgim. “**Kuptohet, shumica e mendimeve dhe**

e paradigmave të tilla, sot për sot kanë karakter hipotetik, rrahin për nga e ardhmja, kanë nevojë për një skaner i cili t'u përgënjeshtrojë tiparet e një utopie.”

361. Skeptik – (gr. – dyshim)vëzhgim, 1.ithtar i rrymës së skepticizmit në filozofi; 2. Ai që dyshon e shfaq mosbesim për gjithçka, njeri që mban gjithnjë qëndrim skeptik.

362. Skuadronet – 1560, nga italishtja “squadron” “squadra” “batalion” nga squad 1640 “një numër i vogël ushtarësh të vendosur për disa qëllime luftarake, formacion trupash etj. “... si një hero shqiptar që iu pre koka nga squadronet greke që erdhën për të vrarë brenda territorit shqiptar.”

363. Snob-i – (shkurticë angleze për latinishten: sine – pa + nobilitas – bujari, fisnikëri; snob) njeri i pa vlerë, njeri që imiton të tjerët, që shtihet i kulturuar i dijshëm etj

364. Solemnitet – solemn, shek XIII-të, nga frengjishtja e vjetër solempne (frengj solennel), nga latinishtja sollemnis ,, ceremoni formale, tradicionale, mbase e lidhur me sollus “ e tëra, shuma, në tërësi. Nga safe (i sigurt) si emër “shportë ku mbahen sendet e vyera, arkëz për orenditë” ;fillimshkulli XV-të nga frengjishja mesme en sauf me siguri ; nga sauf e regjistruar së pari më 1688 nga ndikimi i safe si mbiemër(i ruajtur mirë). “**Ishte samiti i fundit i shekullit, u zhvillua me solemnitet të madh, në prani të 28 studentëve.**”

365. Solid- e adj – (lat.solidus – i fortë) 1. I ngjeshur, i fortë, i qëndrueshëm, i mirë me vlerë; 2. I vërtetë, real, i plotë.

366. Solidar-e – adj (fr.solidaire – i përbashkët) 1. Që bashkohet me idetë, qëllimet dhe veprimet e një tjetri, që është gati të ndihmojë dikë për të arritur një qëllim të përbashkët; 2. Jur.që është përgjegjës për diçka në tërësi sëbashku me një tjetër.

367. Solucion – (lat.solutio – zgjidhje) 1. Zgjidhje, sqarim i një çështjeje.

368. Sondazh – (fr.sondage – hulumtim, kërkim) 1. Sondim; 2. Fig.hetime paraprake me rrugë të ndryshme ose me mënyra të tërthorta për të njohur gjendjen, mendimet a qëndrimet për diçka.

369. Soticizëm/-zmi – (gr. – sallë, galeri mbi shtylla; sallë e shkruar lara-lara në Athinën e vjetër, ku mbante ligjërata filozofi i shquar Zenon; shkolla e Zenonit të cilën e themeloi më 308 p.e.r dhe të cilën e mbylli imperatori bizantin Justinian më 529, kur i mbylli të gjitha shkollat filozofike. 2.fig. qëndresa me durim dhe gjakftohtësi para fatkeqsive, sprovave e vështirësive të ndryshme të jetës.

370. Spekulum-i – (lat. speculatio – hetim, vëzhgim, kërkim) 1. Nxjerrje e fitimeve me rrugë të parregullt; blerja e shitja e mallrave dhe e sendeve me rrugë të parregullta; 2.fig. shtrembërimi i së vërtetës, i fakteve etj në dëm të dikujt; dallavere, mashtrim.

371. Spote – Si emër vjen që në 1200-ën. Sinonime të vend, pikë, njollë, spërkë, puçërr, njollos, turpëroj, njolloj dhe si mbiemër lokal, vendor. Kuptimi parësor për “njollë morale” ndoshta nga anglishtja e vjetër “një vend, një copë toke, cen, vend sa grimca, ngastër etj. Është e mundshme që disa nga këto kuptime janë të huazuara. “Grimca, njollë” si kuptime vijnë nga mesi i shek 14-të. Kuptimi për “vend i veçantë” vjen nga 1300-ta. Kuptimi për “interval i shkurtër në një transmetim, gjatë një shpalljeje ose njoftimi” vjen që nga 1923. Në zhargon merr kuptimin e “ një dënimi me burg” dhe pastaj “për të vënë dikë në një situatë të vështirë” që në 1928-ën. **“Synoja të afirmohej nevoja e nxitjes së pluralizmit të mendimit me anë të këtyre spoteve propagandistike, por jo më shumë se të bindja...”**

372. Spunto – it. 1.pikënisje, shkas, nismë, jap shkas; 2. Thartim, shije e tharët (e verës); 3. (muzë frymëzimi) takt i parë i një motivi. “.....*por kjo spunto dhe mbështetje është bllokuar pikërisht nga kjo politikë refraktare e Sali Berishës*”.

373. Startim – Si emër përdoret në fundin e shekullit 14-të , sinonime të saj janë :fillim, start , nisje , fill, sefte ,sinjal i nisjes , brofje , trembje , hapje , ,buron ,futem , bëj të , shkaktoj , tërhoqa, vë në lëvizje e bëj sefte (si folje). Kuptimi themelor për “një lëvizje e papritur” nga startoj(folje) me kuptimin akti /veprimi i nisjes së ndërtimit të një shtëpie” vjen që në 1946. Në kuptimin e “ mundësi për të filluar një karrierë ose kurs veprimi” dëshmohet që në 1847. Në kuptimin “nisje fallco, gjoja, nisje e rremë” dëshmohet që në 1850. **“Startimi i implementimit të forcave ndërkombëtare dhe i përbërësve civilë po zhvillohet në mënyrë pozitive.”**

374. Subkoshiencë – (lat.sub – nën + conscientia – vetëdije) psik.nënvëtdije.

375. Substicion – (lat.substitutio – zëvendësim) 1.zëvendësim, të zëvendësuarit; 2. Ling.zëvendësimi i një fjale me një fjalë tjetër, duke marrë edhe kuptimin e fjalës së zëvendësuar.

376. Sufiçit – (lat.suficiens – i mjaftueshëm, i tepërt) 1, fin. Të holla që dalin të tepërta në krahasim me vlerën e mallrave të shitur, malli i tepërt në krahasim me sasinë që duhet; 2. Teprica e të ardhurave kundrejt shpenzimeve në buxhet.

377. Suksesion – Succession; që herët në shek. e 14-të nga frengjishtja e vjetër succession; nga latinishtja successionem , emër – succession “diçka që vjen pas, një mbërritje në një vend a diçka më pas, përfundimi më pas” nga successus, succedere (shih succeed) lidhur me suksesiv (shek 15-të). Succeed “ që vjen menjëherë më pas, të zësh vendin e dikujt tjetër”; nga frengjishtja e vjetër succeder (shek 14-te); nga latinishtja succedere (vjen pas, i shkon afër, pas) nga suc., pas, ngjitur me + cedere., shkon, lëviz ^kuptime dytësore ^: të arrish rezultate të mira, të kesh rezultate favorizuese ,të kesh sukses. Eshte regjistruar së pari

neë shek. e 15-të me ndajfolje si pjesë eliptike(mirë). Pra, kuptimet janë kthesë, ndryshim, të ndryshosh drejtimin e jetës tënde si kuptime figurative. **“Veçse procese të tilla në një shoqëri të ndarë në të pasur dhe të varfër, nuk mund të mos shoqërohen me suksesione dezintegruese, me luftë të ashpër politike, pse jo dhe me zhgënjime të shumta.”**

378. Supremacion – (lat.supremus – më i larti) pushteti më i lartë; fuqi eprore, epërsi politike, autoritet epror, hegjemoni.

379. Surrogate – herët, shek 15-të; nga latinishtja surrogates, surrogare “zëvendëson, vendos në një vend tjetër”. Nga sub “ në vend të, poshtë” + rogare “të pyesësh, të propozosh”. Kuptimi “gua shtatzanë e fertilizuar me vezën e një gruaje tjetër” dëshmohet që në 1978 (1972 tek kafshet, nënë zëvendësuese,njerkë në një kuptim ,nuancë psikologjike që në 1971). **“Duke lënë pas, me të drejtë e me vendosmëri gati plebishitare, surrogatin e kolektivizmit dhe të luftës së klasave, pati shpërthime spontane të individualizmit aq sa u harruan disi grupet dhe shtresat sociale, interesat e të cilave duhej të shprehnin dhe të mbronin partitë politike.”**

380. Tabulimet - (lat.tabula – 1.tryezë pune; 2.në formë pasqyre, tabelë liste. *“Ky është proces që i paraprin tabulimit dhe shpalljes së rezultatit zgjedhor”*

381. Tekstualisht ndajf – ka kuptimin “siç është (thënë e shkruar) në tekst”. Merr kuptimin “fjalë për fjalë” dhe “pikë për pikë”, që përdoren sipas rstit, kur riprodhojmë diçka të shprehur me shkrim a me gojë pa i hequr e pa shtuar gjë. P.sh: *Ai ia përsëriti fjalë për fjalë ashtu siç i kishte parë e dëgjuar.*

382. Transparencë – (it.transparente – i tejdukshëm) i tejdashëm.m.(teatër), perde e tejdukshme(në sfond) 2.fig.njeri transparent , qeveri transparente.

383. Tribal – fisnor, që në 1630 “që ka të bëjë me fise” nga fisi(tribu) + al. Kuptimi “karakterizuar nga një ndjenjë e fortë besnikërie ndaj një grupi njerëzish” dëshmohet që në 1951. Si emër tribu vjen me kuptimin e parë “një nga 12 divizionet e hebrenjeve të lashtë”. Nga latinishtja tribus “ një nga tre ndarjet politike,etnike të shtetit të origjinës, romak (Tites, Ramnes, Luceres që i korrespondojnë ndoshta Latinëve, Sabvinëve, etruskëve dhe më vonë ndoshta një nga 30 ndarjet politike të krijuara nga Servius Tullus ndoshta nga tri-tre + rrënja e foljes jetë, jetë qyteti. Në kuptimin biblik lidhet me facem phyle gerqisht “rracë ose fis i njerëzve, grup burrash të bashkuar nga lidhje dhe prejardhje gjaku, një fis. Kuptimi më i zgjeruar vjen për”grup etnik dhe masë njerëzish” ne 1590. Sinonime : fis, popull,grup. **“Ne duhet të dimë se si mbërritëm deri këtu, në këtë tokë grupimesh, në luftë urrejtjesh tribale.”**

384. Tutela – tutelage. Shek XVI-të nga latinishtja tutela” mbrojtje, ruaj, shikoj, ndjek, vrojtoj, observoj, i mbaj sytë tek, kam kujdes, mbaj sytë hapur, të bërit roje, vrojtim, rri roje, rri vigjilent”. Si variant i tueri “ shoh mbi , kuptim, instruksion, mësim”. Së pari shfaqet më 1857 me këtë kuptim. Tutor – fundi i shek XIV-të për “roje, mbrojtës, kujdestar, burgosës, mbajtje nën arrest”. Nga frengjishtja e vjetër tutour - roje, mësues privat. Nga latinishtja tutorem , roje, shikues. Nga tutur variant i tueri “ruaj” me një origjinë të panjohur. Kuptimi specifik për “djalë i lartë, zotëri, senior i emëruar për të ndihmuar një të ri në studimet e tij”, është regjistruar që nga 1680-ta. Folja është dëshmuar që nga 1590-ta. Gjendet si ndajfolje, mbiemër etj. **“Por nga ana tjetër, fakti që ju tani, të themi dolët nga tutela politike e PD-së...”**

385. Users – *em.ang.* 1.përdorues(telekomunikacioni, ai që punon në shërbimet e telekomunikacionit); 2.përdorues droge. *Nënpunës të administratës shqiptare, përdorues apo users në portalin elektronik të përgjigjes së pyetjeve të pyetësorit, janë të angazhuar në këtë proces.*”

386. Vakuum – (lat. vacuum – zbrazëti)1. Hapësirë pa ajër; fig.zbrazëti, zbrazësirë. Projektligji ka për qëllim të plotësojë një vakum ligjor që këmi në legjislacionin përkatës”.

387. Vandalizëm/zmi – (lat. vandalismo – shkatërrim) shkatërrim barbar e i pamëshirshëm i monumenteve të artit e kulturës dhe i të gjitha gjërave me vlerë; veprim i egër e barbar, sjellje prej vandali, barbarizëm, mizori.

388. Verdiqt – që nga 1530 ,nga anglishtja mesjetare verdict (vitet 1300) “ një vendim jurie lidhur me një rast, çështje” e formuar nga Veir “e vërtetë” + dit “dire” të thuash (zakonisht në të folur, në ligjërime). Origjina vjen nga latinishtja mesjetare verdictum. **“...një verdiqt i shkruar nga një pjesë e Evropës bashkë me Rusinë, për ndarjen e shtetit shqiptar midis fqinjëve...”**

389. Vicioz – vicious ,fillimi i shek. XIV-te; “i natyres se keqe, i poshter, i lig” nga latinishtja vitiosus “me te meta, i demtuar, i korruptuar” nga vitium “faj”. Kuptimi i “i prirur për te qene i eger ose i rrezikshem” deshmohet se pari ne 1711 (tek kafshet, sidomos tek kuajt) “ i mbushur me inat, i hidhur , i rende” vjen qe ne 1825. Sipas ligjit “i njollosur nga disa faje te natyrshme” (shek 14-të) gjithashtu edhe ne sensin logjik (shek 16-të) “rreth vicioz” 1792 ku i jepet nje kuptim i pergjithshem, i arsyetuar ”si nje suate ne te cilen veprimi dhe reagimi intensifikojne njeri-tjetrin”1839. **“Ishte një rreth vicioz nga i cili askush s’mund të ndahej dot...Uashingtoni dhe Londra kërkonin të futnin probleme ndërkombëtare të Shqipërisë në një rreth vicioz...”**

390. Violencë – dhunë, në anglishten mesjetare fjala është aplikuar edhe në lidhje me ngrohjen, rrezet e diellit, tymin me kuptimin”që ka disa cilësi aq të forta sa për të prodhuar një efekt të fuqishëm”; nonviolent merr kuptimin e kundërt, diçka paqësore. Gjithashtu non-violent në 1920 i referohet “ praktikë, parim për largimin nga dhuna” dhe së pari e gjejmë në shkrimet e Gandit nga non “jo”+ violent “ i dhunshëm”. Shprehja e tij është: “është më mirë të jesh i dhunshëm, në qoftë se ka dhunë në zemrat tona sesa të vesh mantelin e jo-dhunës, e paqes për të mbuluar pafuqishmërinë”. [Gandi, “jo violencia(mosdhuna) në Paqe dhe në luftë,” 1948]. Sinonime të fjalës janë: dhunë, forcë, violencë, përdhunë, dëm, cënim, keqpërdorim, përdhunim. Si emër përdoret në fund të shek 13-të me kuptimin “forcë fizike e përdorur për të shkaktuar lëndime apo dëme, nga frengjishtja e vjetër violencë “dhunë”, nga latinishtja violentia “vrull”, nga violentus “ i fortë, me forcë “të lidhura ndoshta me violare “të shkelësh”. Fjala merr një tjetër kuptim “të dobësuar,” “trajtim jo i duhur”, dhe dëshmohet që në 1590. **“Çdo ditë e më shumë po ushtrohej violencë mbi fjalën, mendimin, veprimin e lirë e për këtë duhej të agjitohej dikush.”**

391. Violet – mb. Me prejardhje nga gjuhët neolatine. Në vend të saj përdoret vjollcë. P.sh: *Ngjyrë vjollcë. Fustan vjollcë.*

392. Virilitet~i (ital.virile) – burrit, i burrit, burrëror.

393. Virtuoz – (it.virtuoso – plot virtyt) ai që zotëron në mënyrë të përsosur artin e tij; që ka arritur shkallën më të lartë të mjeshtërisë.

394. Vitale – vital fundi i shekullit të XIV-te “ manifestim i jetes”, nga latinishtja “vitalis” ose që i perket jetes” nga vita ”jete”; e lidhur me vivere “ te jetosh”; nga forme i.e-ne me baze *gëei – nga persishtja e vjeter *fivaka “ i gjalle” nga greqishtja bios “jete”, “kafshe” lituanisht gy vata (i perjetshem) jete; anglishtja e vjeter CWIC, CWICU “ te jetosh, te jesh gjalle. Kuptimi i “ te qenit i nevojshem ose i rëndesishem” vjen që ne 1610 përmes nocionit të “ i domosdoshem, thelbesore për jeten”(fund i shek 15-te). “Kapacitet jetesor” dëshmohet ne 1852. **“Në rrethanat e qeverisjes me metoda totalitare, shpërthimi i këtij revolucioni dhe formimi i qeverisë demokratike në Shqipëri ishin një dëshmi e vitalitetit të... “**

395. Vokacion~i – (lat.vocatio-ftesë në gosti; fr.vocatio)thirrje, fig.pirje, talent shije zotësi që ka dikush për diçka, për një profesion, ose për një krijimtari artistike etj, të dhënë pas diçkaje me përkushtim. *Europa kontratën me Shqipërinë dhe shqiptarët e firmosi vetëm me ne, sepse ne ishim dhe u faktuam që në ditën e parë të themelimit si forcë e vokacionit përendimor të kombit shqiptar.*

396. Vulnerabël (ital.vulnerabile-i cënueshëm) i prekshëm, i dëmtueshëm.

397. Xingografi~a f.sh., ~të,!e,~së, ~ne (saktë zinkografi) fjala e ka origjinën në vitet 1825-1835. Kompozita është formuar nga zinc + o +graphy. Arti apo procesi i gdhendjes me mjete kimike për të formuar një plan të printuar (fotografi).

PËRFUNDIME

Stili politik dhe leksiku që e pasqyron atë lidhet me gjuhën e veprave politike e shoqërore, të shtypit, radios, televizionit, fjalimeve, bisedave, artikujve në këtë fushë.

Leksiku është i zgjedhur me një terminologji të gjerë, me emra e fjalë abstrakte apo me fjalë që kanë kuptim të drejtëpërdrejtë, fjalë të vjetëruara dhe dialektore, njësi frazeologjike etj. Tipari më i rëndësishëm i këtij leksiku është fjalori i zgjedhur që në pjesën më të madhe mbulohet nga fjalë e shprehje ndërkombëtare, nga togfjalësha me ngjyrim përkatës, të lidhur me jetën e veprimtarinë e partive e organizatave politiko-shoqërore si : komitet drejtues, degë, forum, këshill kombëtar, seksion etj, si dhe fjalë e shprehje që pasqyrojnë dukuri më të rëndësishme të aktualitetit si: miting, fushatë elektorale, konsensus, debat politik, liberalizimi i çmimeve (i vizave), e drejta e autorit. Janë karakteristike për këtë stil gjithashtu përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve parafjalore, lidhëzore si: burime nga, sipas pohimeve të, në drejtim të, në bazë të, me anën e, duke u mbështetur në, në krahasim me, përsa i përket, për faktin se, lipset që etj.

Ky leksik si një ndër mjetet gjuhësore më të përshtatshme për stilin politiko-shoqëror vazhdon edhe sot e kësaj dite t'i tërheqë gjuhëtarët me përmbajtjen e tij me karakter të veçantë shenjues (denotativ) dhe ngjyrimor (konotativ).⁶⁶ Lidhur me këtë përmbajtje me karakter të veçantë emërtues, terminologjik ose joterminologjik, nganjëherë edhe shprehës-emocionues, studimet e ndërmarra kanë shfaqur qëndrime e interpretime jo të njëjta mbi marrëdhëniet e këtij leksiku me leksikun e përgjithshëm, atë të letërsisë artistike, me publicistikën, me situatën e realitetin shoqëror përkatës ku dhe kur përdoret nga bartësit e gjuhës, si edhe me metodën e studimit të tij. Me disa prej studimeve është arritur të përlligjet rruga e zhvillimit dhe e pasurimit në shkallë të gjerë të këtij leksiku nëpërmjet huazimeve ose "interferencave" të gjuhëve ndërkombëtare si anglisht, frëngjisht, italisht etj. Në një kuptim më të gjerë do të përkufizohej si "tërësia e të gjithave njësisive leksiko-semantike, ose e të gjitha fjalëve dhe emërtimeve, togfjalëshave ose jotogfjalëshave që shenjojnë nocione, dukuri, sjellje shoqërore të njerëzve". Fjalët dhe termat që ngërthen ky leksik kanë kryesisht karakter shenjues (emërtues) nga fusha e politikës, e ideologjisë së pushtetit shtetëror si edhe nga nënfusha speciale të shkencave si filozofia, ekonomia politike, historia, diplomacia, nga drejtësia, nga artet etj. Ky leksik përfshin edhe një pjesë të nomeklaturës terminologjike me

⁶⁶M. Samara, "Rreth leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe", Akademia e Shkencave, Tiranë, 2008.

Nxij (denigroj) fig.	Pëdëist
Njollë fig.	Pëlhura e Penelopës
Njohja (e qeverië së re)	Pëllumb paqeje fig.
Organ(izëm) politik	Përça e sundo!
Orë zero pikënisja	Penë e ndaluar fig.
Opsion libr.	Pazar politik keq.
Ombrellë politike fig.	Pol i qendrës fig.
Otakllëk keq.	Pluripartizëm
Papizmi (pushtet i Papës)	Platformë politike
Paneuropian	Pjellë politike fig.
Panik	Pikë nevralgjike (kyce)
I paparti keq.	Presion politik fig.
I paangaazhuar politikisht	Premtim elektoral
Padrino keq.	Prapavijë e partisë
Pagëzot me emrin FRD	Praparojë politike keq.
Paketë ligjore	Pranvera arabe fig.
Paçavure	Politikomani keq.
Pakt	Politikë e degës së ullirit / e dyerve të hapura, e grushtit të hekurt/ e strucit
Parajsë/ferr fig.	Politikëbërësit
Paralizë qeverie fig.	Populiste keq.
Paranojë politike	Post (factum; festum, mortum) lat.
Pari	Poshtë (në bazë)
Përcarje në parti	Pozitë (post)
Perde e hekurt fig.	Prag elektoral
Perde tymi fig.	

Prezenca e OKB-së	Rutinë parlamentare
Propagandë politike	Selia rozë
Proces (politik)	Rol i Kasandrës
Protagonist politik	Rrafsh politik
Puthja e Judës (tradhtare)	Rregulla të lojës
Puthadorë keq.	Rrjeta e merimangës keq.
Punist keq.	Rrotacion politik
Pucist keq.	Rrufe në qiell pa re
Puc	Rrjet politik
Provokacion politik	Rrëzoj regjimin
Qelizë e partisë	Rrëshqas (nga e majta)
Qetësi Olimpik	Rreze
Qendra (baza)	Rreth vicioz
Qëndrim politik	Separatist keq.
Quo vadis lat.	Sëmundje politike keq.iron
Qoshe politike fig.	I sëmuri i Bosforit
Qielli i shtatë	Sferë politike
Vend i ditës	Sigurims keq.
Restauroj regjimin	Simbiozë fig.
Revanshizëm politik (keq.)	Sabotator iron.
Reformator	Sahanlëpirës keq.
Reformomani keq.	Salltanet keq.
Reklamë politike	Samit
Rilindje	Satelit keq. shërbyes
Rival libr.	Satirë politike
Rivendikoj	Satrap keq.

Scripta moment lat.	Sherrnajë
Sejmen keq. servil	Shet (votën)
Spekulim keq.	Shikas
Solidar libr.	Shkarkoj nga detyra
Spastrim	Shkresurina keq.
Spekter politik	Shkërdhatokraci
Slogan keq. parullë boshe	Shushunjë fig.keq.
Sklerotizim i partisë	Shtylla e Herkullit
Skenar politik fig.	Shtresë politike
Situatë politike	Shportë karavidhesh keq.
Skandal politik	Shkel ligjin
Spiunllëk keq.	Shkëmb graniti fig.
Superfuqi	Shkop magjik
Strategji politike	Tabula rasa lat.
Stuhi politike	Tabelë qitjeje keq.
Subjekt politik	Taktikë politike
Subersion keq.	Teatër politik
Sui generis	Tarafllëk keq.
Stafeta fig.	Taraf keq.
Stampë fig.keq. kallëp	Tension politik
Stan me lepuj/derra keq.	Tigër prej letre
Status quo	Terr politik
Stërpolitikanë keq.	Terapi shoku fig.
Superparti keq.	Tokë e premtuar
Atartim fig.	Transparencë politike
Shenja e Kainit	Top secret

Treg politik	Vall street angl.
Tribunë politike	Vatër partie fig.
Trojkë	Vyshkje partie fig.
Truk politik	Vullnet politik
Trumbetim politik	Vijë politike
Trysni	Viktimizim
Tumor në parti fig.	Violinë e parë fig.
Tymnajë politike fig.	Vlerë partiake
Turmë elektorale	Vox populi) (in deserto) lat.
Tur elektoral	Vuaj të zitë e ullirit
Trubullirë fig.	Vegël e verbër fig.
Thikë me dy presa fig.	Vesh me pushtet fig.
Thikë pas shpine	Verë e re në fuçi të vjetër
Thundra fig.	Verdikt
Thur intriga politike	Verbëri politike fig.
Thembra e Akilit	Vetëtimq në qiell të pastër
Thashethemnajë keq.	Veza e Kolombit
Në udhëkryq fig.	Vë në korrent
Ultra (i djathtë)	Vë pikat mbi “i”
Ujdi politike keq.	Xixaman keq.
Ujëra të turbullta fig.	Xhungël në politikë fig.
Urë politike fig.	Xhuvelizëm keq.iron
Uragan në politikë fig.	Xhentëllmen
Varësi politike	Ylli i Solomonit
Skandali i Vatergeitit	Zvarritje burokratike
Vallja e vdekjes fig.	Zjarri i Prometeut

Zinxhira politikë fig.	Zhurme elektorale
Zi kombëtare	Dora jonë për ta do jetë e shtrirë.
Zbardh të vërtetën fig.	ndëshkimin kuptimplotë të forcave që
Zbres në detyrë fig.	duan të ribëhen gjarpër rreth këmbëve
Tolerancë zero	tona!
E zeza mbi të bardhë	kukullën e të paudhëve
Zë në shkretëtirë	pa din e iman
Luli thjesht ha përshesh	maskarallëkut mediatik
gomarllëqesh digjitale	për inat të qeverisë!(asosacion me ‘Për inat
të sime vjehrrë,do fle me mullixhinë.’)	

50 Shprehjet më të bukura të politikanëve tanë në parlament apo në përrurime të ndryshme (marrë nga gazeta “Tirana Observer”)

Batutat

Politikanët që njihen më tepër për batuta janë Fatos Nano dhe Edi Rama, të cilët në çdo situatë e nxjerrin një shprehje e cila sjell të qeshura te të pranishmit. Aktualisht batutat më të forta jepen nga kreu i qeverisë dhe lideri i opozitës, pasi Nano është shkëputur prej kohësh nga politika aktive. Ndryshe nga fillimi i karrierës politike, aktualisht me stufin e një politikani me eksperiencë dhe me peshë në vend përveç veshjes, shprehive, ka ndryshuar rrënjësisht edhe batutat. Me të ardhur në krye të PS-së, batutat e Edi Ramës janë me pakicë në krahasim me tetë vitet e para të karrierës së tij. Jo më pak se Rama është i dalluar dhe Berisha në batuta. Ai me ironi të hollë nuk lë kundërshtar pa thumbuar me batuta. Ka raste që

seanca parlamentare kthehet në një asamble batutash mes Berishës dhe deputetëve të opozitës.

1. Dritëro Agolli në një vizitë në Skrapar në vitin 1994, kur një grup demokratësh e qerasën me raki, shkrimtari ju thotë: Do ta pi rakinë tuaj, sepse një demokrat në Skrapar është sa një socialist në Tiranë.
2. Dritëro Agolli në vitin 1997, pas deklaratës së Nanos për **meritokracinë** e kuadrove: Kësaj i them **shkërdhatokraci** dhe jo demokraci.
3. Edi Rama sapo emërohet ministër i kulturës në vitin 1998 nuk pranoi badigardë duke deklaruar: ‘Nuk do të pranoj **badigardë**, përjashto rastin kur të më japin një më të gjatë se vetja’.
4. Pjetër Arbnori, ish-kryetari i parlamentit, data 13 shtator 1999. Është e vështirë të jesh ministër Kulture në një vend me kulturë të tillë.
5. Edi Rama, ministër i Kulturës, në gusht të vitit 1999: Është e vështirë të jesh ministër Kulture në një vend me kulturë të tillë.
6. Edi Rama gjatë fushatës së Nanos për katarsis në vitin 2001: Nano është bërë si **Robert Çamçakëzi**, fut duart në xhepa dhe bredh nëpër kantier.
7. Fatos Nano në gusht të vitit 2001 kur shkon në Lezhë për fushatë elektorale, del nga makina dhe i hap derën Lesit duke i thënë: “E, c’është një lider partie para një lideri të shtypit të lirë.”
8. Fatos Nano gjatë fushatës për katarsis në vitin 2001: E mora Ramën me **thonj pa prerë** nga Parisi dhe e bëra ministër.
9. Fatos Nano: Në mbledhjen KPD-së në dhjetor të 2001: Lavatriçe? Po Musa, ti nuk vlen as sa një lavatriçe.
10. Fatos Nano në parlament në vitin 2001: Unë jam çliruar nga makthet e Berishës. Ndërsa kam thënë se **lëvizjen “Nano”** nuk e ndalon dot më as vetë Nano, regjimin e Berishës në Shqipëri nuk e kthen dot më as vetë Berisha.
11. Arta Dade në dhjetor të vitit 2001 gjatë fushatës së Nanos për Katarsis: Më tepër të dhemb kur ta fut i yti.

12. Edi Rama në komision hetimor ndaj tij, i drejtohet Uran Metkos: Nuk t'i zgjidh dot hallet. Vetëm mund të të jap ndonjë pulë të pjekur dhe një shishe raki ta pish me Shpëtim Rroqin.
13. Edi Rama më 9 tetor 2002 i drejtohet Njazi Kosavrastit: Sikur të ka gjet **doktori te gabi**.
14. Gramoz Ruçi pas akuzave të Nanos se e ka mbajtur në kurriz për 12 vjet: Kemi një shprehje ne andej nga jugu, dhëndrit të ri mos i dil përpara gjashtë muaj para e gjashtë muaj pas dasmës.
15. Edi Rama më 9 tetor 2002 i drejtohet Rusmajlit: Do t'u jap një shkallë të Komunales që të shihni çfarë kam unë në kokë!
16. Edi Rama më 9 tetor 2002 i drejtohet Rusmajlit: Të fala **doktor Najlonit**.
17. Edi Rama në vitin 2002 në emision televiziv: kushedi se cila nga stërgjyshet e tezes së njërit, s'ka pasur një moment gëzimi me stërgjyshin e hallës së tjetrit.
18. Pandeli Majko, Gazetari: A do ta pranoni postin e kryeministrit nëse do t'u propozohet? Unë nuk jam nga ata që ua fusin thikën pas shpinë shokëve. (Më pas e pranon postin e kryeministrit).
19. Edi Rama: "Unë solla në Tiranë grupin "Scorpions" ndërsa PD-ja Rroqin me kitarë".
20. Edi Rama: Kemi vënë bythën në qendër se nuk ka mushkonja, në periferi ka më shumë mushkonja me llastiqe në dorë.
21. Edi Rama si kryetar i Bashkisë së Tiranës pas akuzave si i korruptuar: Nuk ka bir kurve të gjejë lekë të vjedhura në xhepat e mi.
22. Nikollë Lesi në tetor të vitit 2004 gjatë protestave anti-Nano: I kam kërkuar Berishës të më japë PD-në mua dhe për 24 orë e rrëzoj Fatos Nanon.
23. Fatos Nano në parlament në vitin 2004: Pasuria ime më e madhe, më e çmuar dhe e hipotekuar në sytë e të gjithëve, është Sali Berisha.
24. Kastriot Islami më 22 prill 2004 në parlament: Herën e parë ta thashë italisht, tani do ta them shqip: Je bërë **si Cari i Ruisisë**.

25. Bamir Topi ne parlament për Fatos Nanon: Unë, zoti kryeministër, nuk merrem me ndryshime mbiemrash. Ju keni të njëjtin mbiemër **Nan-i vogël**. Ndërsa ju e doni në shumës mbiemrin tim, që të më arrini mua me gjatësi.
26. Sali Berisha më 10 shtator 2005 në kohën kur ai piu pak ujë nga gota që gjendej mbi foltoren e Kuvendit, disa deputetë vijuan me komentimin e fjalëve të tij. Berisha iu drejtua krahut të majtë me fjalët: Nuk i flitet tjetrit, kur pi ujë”.
27. Sali Berisha në gusht të vitit 2005 në konferencë për shtyp: Nikollë Lesi është i vetmi që **ngrin në gusht**.
28. Sali Berisha, ish-shefi i opozitës në emisioni “Opinion” në TV “Klan: E kam gjetur presidentin (për Moisiun), duke luajtur domino, përpara se ta propozoja atë në postin e presidentit.
29. Edi Rama më 6 maj 2005, me të hipur në “arenën” e fjalimeve të socialistëve kërkon t’i hiqet podiumi që ndodhej para foltores: **Kongresmenët** nuk kanë faj që duan të më shkurtojnë se jam shumë i gjatë.
- 30.** Artan Lame në korrik 2005 në KQZ: **Nëse peshku qelbet nga koka në PS është qelbur nga këmbët**.
31. Ben Blushi në korrik 2005 në edicion informativ në Tv “Klan”: Nga partia Socialiste kishte kandidatë që bënëin fushatë me pantallona të shkurtra.
32. Nikollë Lesi, njëherë pas fitores së zgjedhjeve të 3 korrikut 2005 nga koalicioni i djathtë: Tani do të ketë vetëm investime dhe arrestime.
33. Gramoz Ruçi në kongresin e tetorit (2005) të PS-së: Tani që kaluam në opozitë as ujë nuk kemi.
34. Edi Rama menjëherë sapo zgjidhet nga Kongresi në krye të Partisë Socialiste deklaroi 10 tetor 2005: Duhet të ulim numrin e burrave për metër katror.
35. Edi Rama gjatë inagurimit të një rruge në Tiranë: Ne nuk hedhim **asfalt “më ka çu moma me la gojën”**.
36. Bujar Leskaj, ministër i Kulturës në një Konferencë shtypi për konfliktin me FSHF: Do ta ngul aq thellë atë gozhdë, sa të thonë **o lele, o mami gozhda**.

37. Sali Berisha, në 16 mars 2006 në konferencë shtypi tek kryeministria: Gazetarët jashtë tani, se po t'i lesh këta bëhen banorë të Kryeministrisë. Po nuk kanë faj këta kur shohin Bashën, që ka pothuajse moshën e tyre.
38. Blendi Klosi më 14 mars 2006 në Parlament: Zonja Topalli që nga dje nuk të njohim si kryetare Kuvendit. Ti përfaqëson vetëm frikën e 80 burrave në Kuvend të cilët janë kthyer në gra.
39. Sali Berisha në prononcim për median më datën 16 mars 2006 për situatën në Parlament: **Bilbilentë që bilbilojnë. Majko ishe bërë si Ce Guevara.**
40. Genc Pollo, ministër i Arsimit pas largimit nga PDR-ja e Nard Ndokës: Politika duhet të përballet me **haxhiqamilizmin** parlamentar, sepse në rast se përmes PDR-së kemi sjellë pa dashje në Kuvend ndonjë kokërr jo **“du babën”** por **“du postin”**.
41. Blendi Klosi në seancën parlamentare të datës 27 maj 2006: kjo qeveri të kujton atë fjalën e urtë të grave, **keq me burrë dhe keq pa burrë, më mirë të mos isha martuar kurrë.**
42. Fatos Nano, data 14 korrik 2006 gjatë bisedës me Berishën në një pritje në ambasadën franceze: “Karrigen tënde dhe timen **nuk e ha as dreqi**”.
43. Spartak Ngjela më 28 korrik 2006 në parlament: Kur dola nga burgu i pashë njerëzit duke ngrënë fara, dje isha në Durrës dhe po hanin misra, kemi ecur shumë këto 15 vjet.
44. Namik Dokle i drejtohet Nishanit në datë 28 korrik 2006: Jam duke bërë një dramë, por më mungonte roli i idiotit, por tani e gjeta.
45. Arta Dade i drejtohet ministrit të Jashtëm në Parlament: I duket vetja si **Don Zhuan** ministrit tonë të jashtëm dhe thotë pata një bisedë miqësore me zonjën Ilika (ministrja e Jashtëm e Maqedonisë) ashtu sikurse mendon se ka pasur edhe ndjenja të tjera të miqësisë apo simpatisë me gra apo me shoqe të tjera që zotin ministër e kanë rrethuar edhe në kohën kur pinte çaj me klor kur ishte nxënës në shkollë.
46. Pandeli Majko në dhjetor 2005 iu drejtohet demokratëve për krizën energjitike: Deri në fund do na akuzoni se e kemi bërë **pakt me perëndinë** që të mos bjerë shi.
47. Neritan Çeka: Nuk ka faj njeri. Jetojmë **në kohën e Haxhi Qamilëve**. Vetëm në Parlament janë nja **50 Haxhi Qamilë**, mos të shtojmë edhe ata të qeverisë.

48. Sali Berisha në bashkinë e Kamzës, 5 shkurt 2007: Po shikoja lajmet, shikoja Edvin Ramën në bulevardin e Kombinatit. Po ecte pash më pash bulevardit të Kombinatit dhe takon papritmas, në mes të bulevardit, një gomar. Aty ku ju kishte premtuar se do të kalonte tramvaji, po kalonte sot vetëm veshgjati për të përshëndetur ish-kryetarin. Pas 3 vitesh takohej me veshgjatin në të njëjtin vend.

49. Edi Rama për Berishën: Dua t'i kërkoj falje publike **Pinokut**, kësaj krijese naïve të përrallave që e kam fyer pa të drejtë dhe krahasuar me Saliun.

50. Fatos Nano pas një mungese të gjatë në parlament (2007), merr pjesë në një seancë për të mos djegur mandatin. Sapo hyn në parlament, kryeministri Sali Berisha ishte i pari që e ngacmoi Nanon, duke e pyetur: Faos, ku e ke pas celularin, pse s'më ke marrë njëherë? Dhe Nano ia kthen menjëherë: "Nuk kam pasur lekë në telefon, ndaj s'të kam marrë".

Në fund të këtij punimi kemi paraqitur disa letra zyrtare dhe pjesë të tjera ku ilustrohet fare thjeshtë "gjuha e shkresurinave"⁷⁰ e dalluar mjaft qartë nga gjuha në publik apo gjuha e politikës në seanca të ndryshme parlamentare. Mjetet gjuhësore më karakteristike të këtyre copëzave ilustruese të çojnë në këto arritje:

Së pari gjuha politike e sotme përshkohet dhe jo pa një qëllim specifik nga fjali të gjata e të përbëra me nënrenditje. Po veçojmë këtu vetëm 2 shembuj: "Në kulmin e poteres kriminale të fuqisë pushtuese kur luhej televizisht nën atakun final të dirigjentit të manipulimit të zgjedhjeve të 8 majit maskarada e përmbysjes së rezultatit të numërimit në Komisionin Qendror të zgjedhjeve, para syve të mbarë një populli të shushatur e të tensionuar e miqëve e partnerëve ndërkombëtarë të zënë në ngushticën mes murit të së vërtetës, që kishin parë me sytë e tyre e kishin lexuar të shkruar shkoqur në raportin e ndërmjetëm të misionit të vëzhgimit, dhe murit të gënjeshtreve e të vendosmërisë qorre të Saliut për t'i shkruar deri në fund prapësisë ,duke shkukur tërbueshëm mbi 10 votat që ia morën gojën e mendjen, ra e depërtoi renë e zezë grumbulluar mal mbi Bashkinë e Tiranës një letër e shkruar prej Ismail Kadaresë." ("Kurban", Edi Rama, f.414-415). Apo : " Ne e dimë, gjithashtu, se këto ngjarje, personale dhe kolektive, duke qenë pjesë ejetës së shoqërisë, natyrshëm kanë të bëjnë direkt me historinë e një periudhe dyzetë vjeçare, kap shumë të rrahur dhe po kaq të përfolur, e cila,

⁷⁰ Mendimi ynë për shkresat zyrtare(letra lutjeje, telegrame falenderimi, mesazhe ngushëllimi, etj)

pasi ka kaluar njëherë rrëmbimthi si tragjedi, ka sheshuar më pas shumë gjëra dhe ka fshirë pa lënë gjurmë shumë jetë individësh të veçantë, të cilët, padrejtësisht i ka nxjerrë nga kujtesa historike e shoqërisë shqiptare.” (S. Ngjela “Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare”, 1957-2010, f.13)⁷¹. Qëllimi i këtyre fjalive tepër të gjata ka të bëjë me ngjeshmërinë e informacionit që kërkohet t’i përcillet publikut njëkohësisht me forcën ndikuese që kërkon politikani të ushtrojë në mendjen e në zemrën e lexuesit. Para elektoratit këto periudha të stërgjata “thyhen” sepse askush nga publiku spektator s’do “ia kishte ngenë” të dëgjonte të tilla tekste-fjali, duke krijuar tek ai lodhje, mërzi, hallakatje e duke shkaktuar të kundërtën e asaj që pret një politikan: forcën e e fjalës së tij si veprim (aksion) gjuhësor. Menjëherë të vjen në mendje fraza e një gjuhëtari të madh Wittgenjshtainit i cili ndër të tjera apelon: “Shihe fjalinë si instrument dhe kuptimin e saj gjeje në përdorim!” (Philosophische Untersuchungen, 1953, f.421). Si mendje gjeniale, si pararendës i pragmatikës gjuhësore të shek XX-të dhe i teorisë mbi analizën e tekstit ai argumenton bindshëm duke thënë se: “Të kuptosh një gjuhë do të thotë të zotërosh teknikën e funksionimit të saj” (Po aty, f.129) dhe si një aksiomë që i vë kapakun gjithçkaje, arrijmë në konkluzionin se : “Gjuha flet, jo njeriu” (Hajdeger). E tillë funksionon edhe gjuha e politikanit në podium, një “gjuhë e shkrirë”, jo më e ngurtë në formatin e klisheve të njëpasnjëshme si tek letrat zyrtare, etj. Në ligjërime gjuha shfaqet me tërë përmasat e saj reale – funksionale dhe në tërë vitalitetin e saj. Ligjërimi është universi ku gjuha shpalos e shfaq potencialin e strukturave të thella e sipërfaqësore⁷². Pra, gjuha dhe gjithçka përcillet përmes saj nuk duhet parë si diçka ideale, por shfaqja konkrete e saj gjatë përdorimit e funksionimit si i vetmi realitet gjuhësor. Gjithnjë të fshehura prapa tezës së gjuhëtarit të njohur qëndrojnë dy aspekte të mirëdallueshme: konteksti në të cilin fraza shqiptohet (pronunciohet) dhe qëllimi i folësit (në rastin tonë politikanit) në marrëdhënie me vendin e kohën reale të përdorimit të saj. Pra, nëpër fushata elektorale, konferenca shtypi, mbledhje të ndryshme ky “speech act” (akt lingvistik)⁷³ mes politikanit dhe publikut ndodh në suazën e një dhënieje – marrjeje reciproke. Thëniet, shprehjet vlerësohen si shqiptim (si thënie) në një situatë të caktuar reale dhe rrjedhimi është që kemi jo vetëm një akt shqiptimi por edhe atë të veprimit.[“Në të kundërt(kupto në krahasim me thënien konstativë vërejtëse, pohimin) thënia performative (vepruese) nuk mundet të jeta as njëra as tjetra, ajo zotëron funksionin e saj: shërben për të kryer një veprim” (Austin, 1987,

⁷¹ Është për t’u vërejtur se nga këta dy shembuj rastësore të shkëputur prej nesh, periudha e parë rezultojnë me gjashtë sifjali dhe periudha e dytë me pesë sifjali kryesisht përcaktore ,kundriore e rrethore.

⁷² Në mbrojmë mendimin e Wittgenjshtainit i cili e mohon krejt ekzistencën e sistemit abstrakt gjuhësor, duke pranuar si të vërtetë të vetme vlerën përdorimore që ka gjuha, si një klasë aktesh ligjërimore. Fjalët dhe fjalitë s’kanë vlerë në vetvete, por përmbushin qëllime të caktuara gjatë përdorimit të tyre.

⁷³ Shih : A. Ballhysa, “Gjuha dhe përdorimi i saj”, Sejko, f.40.

f.49)⁷⁴. Për të kaluar diçka më tej në mendimin e Austinit dhe vërejtje të shfaqura apo zbuluara nga literatura që kemi hasur Austini-i mbron idenë se thëniet performative (vepruese) janë p.sh, të pagëzuarit, të premtuarit, të cilat nuk vihen në dyshim si të vërteta apo të rreme, dhe u nënshtrohen disa rregullave për të qenë thënie të lumtura, d.m.th, të sukseshme. Sipas mendimit tonë këto thënie performative në politikën shqiptare ngelen në stadin e thënieve të palumtura – pjesa e tyre më e madhe - , pasi autorët e tyre, politikanët edhe pse zotohen shumë nuk arrijnë t’i plotësojnë apo t’i përmbushin ato, për t’i kthyer ato në veprim. Premtimet jepen por nuk përmbushen. Në analizën e mëtejshme të po këtij autori thënia e politikanëve shqiptarë (mendimi ynë L.L) është e palumtur (e pasuksesshme) pasi ajo formulohet pa sinqeritet. Kështu, një njeri (politikan në rastin tonë) nuk mund të premtojë në qoftë se ai vetë nuk ka si synim t’i zbatojë ato që ka premtuar, ose në qoftë se e di se nuk mundet t’i realizojë ato për të cilat ka dhënë fjalën. Së fundi, fjalia e tretë që vendos Austin për thënien performative të palumtur: vërtetësia e saj provohet vetëm pas efektit të asaj thënieje, me një fjalë vetëm pas veprimit që kryhet. Pra, politika me gjuhën e saj zotohet shumë ,por arrin veç me “thyerje të detyrimit” (shprehje e Austin –it). Këto thënie deklamuese përfundojnë në diçka pa efekt, pasi asgjë nuk kthehet në realie. E rëndësishme është që akti prelokutor realizohet sepse elektorati voton, mirëpret, fuqizon pushtetin e fjalës së politikës⁷⁵. Pra populli “ngacmohet” dhe reagon ndaj këtij “akti të joshjes” së politikës në përgjithësi e shkon të votojë?!

Së dyti ,si veçori tipike e një teksti politik kemi vënë re përdorimin e disa lokucioneve librore, si mjete gramatikore e si togje fjalësh (në kundërshtim me..., në lidhje me, duke pasur parasysh se, duke iu referuar të dhënave, pasi, për arsye se, duke qenë se, kërkoj pranimin, përdorimin e disa fjalëve të huaja me vlerë të përgjithësuar, si terma (sekrete, publik, suazë, dogma, analiza, perëndimore, shumica), togje fjalësh karakteristike për gjuhën e shkruar (i japim të drejtë, vëmë në korrent, bëhet kërcënuese, shuaj lëvizjen, japim dorëheqjen, është shuar, ka ndërruar jetë etj.), fjalë të përdorura si epitete e krahasime, me kuptim të figurshëm e me ngarkesë të theksuar emocionuese (e nesërmja e sigurt, vegla e ndyrë, gjurmë të përgjakura, vathë partiake,vitet e gjej shesh bëj përshesh, ferri politik, ngërç fatal, si derrat e kënaqur të Migjenit, si Arkani në Bosnjë, si me dorën e djallit etj), fjalë e shprehje nga goja e popullit (e kishin në majë të gjuhës, nuk e vunë asnjëherë ujin në zjarr, i lanë me vite me gisht në gojë, nguli këmbë e dhëmbë në debat, kështu i donte mushka drutë,

⁷⁴ Po aty, vepra e cituar më lart.

⁷⁵ Akti prelokutor karakterizohet nga prodhimi i efekteve, i ndikimeve mbi ndjenjat, mbi mendimet a mbi veprimet e dëgjuesit (marrësit), të dhënësit ose mbi persona të tjerë, pra mund të thuhet diçka me qëllimin, pikësynimin a objektivin që të arrihen efekte.

Shqipërinë e prerë në besë, nuk ngurroi të vinte hapur gishtin në plagë, s’e dëgjon njeri, të fshehin gjurmët, na ranë në dorë, etj) .Siç shihet gërshetohen fjali e shprehje librore me fjali e shprehje popullore. Mbizotëruese është ligjërata e zhdrejtë, shumë fjalë që shënojnë cilësi, d.m.th mbiemra e ndajfolje, mbiemra me prapashtesa, që kanë ngjyrim emocionues pozitiv dhe që përdoren herë-herë si fjalë poetike; fjalë e shprehje popullore që të kujtojnë ligjërimin e përditshëm me qëllim që t’i japë një ngjyresë të fortë ligjërimin. Ndeshim gjithashtu mjete gjuhësore të veçanta, ndër të cilat më shumë bien në sy disa shprehje e formula tipike për lutjet e telegramet, për relacionet e raportet, pra për dokumentet e shkresat zyrtare (i nënshkruari, kërkoj pranimin, me respekt, me rastin e, urimet më të mira, që formuloj në emër të..., në emrin tim personal etj); ka disa fjalë, të huaja që gjithashtu i karakterizojnë këto lloje shkrimesh ,si: (prosperitet, formuloj, akomodoj, aspiratat, dekikat, ulje drastike); fjalë që në leksikon e përgjithshëm të shqipes përdoren me kufizimet përkatëse (**shkëlqesi, zoti, zonja** etj). Të gjitha këto që përmendëm më lart përzgjidhen me kujdes nga gjithë pasuria e mjeteve të shprehjes si më të përshtatshmet (si nga përmbajtja ashtu edhe nga shprehësia). Pra, politikani arrin ta manovrojë gjuhën, të luajë me të, dhe mjetet e saj kryesisht sintaksore, leksikore, fjalëformuese e frazeologjike t’i verë në shërbim të pushtetit të “gjuhës potenciale” që kërkon të përcjellë në elektorat. Duke vazhduar më tej, dallojmë ndërtimin e fjalive me shumë emra prejfoljorë prapashtesore dhe me emra në rasën gjinore; p.sh “.....ku thonjtë e korrupsionit gërryejnë me **çmendimin** e etheve të parasë pasurinë e gjithë shqiptarëve, duke shkallmuar barqet e hapura të nëntokës që po shterpëzohet nga shfrytëzimi pa kriter.....” apo “.....përmes **dezinformimit** e **keqinformimit** të vendeve aleate, sa përmes **informimeve** e **rëfimeve** konfidenciale.....” etj; apo “ Kryesia e PS-së bëri mbledhjen e radhës për **shqyrtimin** e planit të **punimeve** të vjeshtës....” (shtypi). Me jo më pak vlerë politikanët përdorin edhe ndërtimet e fjalive në mënyra të caktuara të foljeve; p.sh., kryesisht në përcjellore, si: “**Duke e parë** çështjen kështu, e kupton se kjo kohë e paskongresit të XX-të i kishte gjallëruar sërish forcat intelektuale që ishin goditur nga Hoxha e që vegjetonin ende në parti”(Ngjela) apo të tjera përcjellore si: **duke e marrë parasysh, duke ditur se, etj.**

Modele letrash zyrtare për të inkuadruar klishtë e hyrjeve dhe mbylljeve, formatimin, strukturimin e frazave librore të politikanëve shqiptarë.

Drejtuar: Znj. Ina Rama

Prokurore e Përgjithshme e Shqipërisë

E nderuar zonja Prokurore e Përgjithshme e Republikës,

lejomëni t'ju drejtohem publikisht në këtë moment kaq përcaktues për fatin e demokracisë shqiptare, ku roli i organit të akuzës është vendimtar dhe hetimi i plotë e i paanshëm i tragjedisë së 21 janarit domosdoshmëri mirëfilli historike.

Ju përgëzoj fillimisht edhe drejtëpërsëdrejti për hapat e rëndësishëm që janë hedhur së fundmi në drejtim të zbardhjes së vrasjeve dhe për bashkëpunimin e suksesshëm me FBI-në, falë mbështetjes së paçmuar të qeverisë së Shteteve të Bashkuara e të Ambasadorit Arvizu.

Mbështetja e posaçme e partnerit të madh strategjik të Shqipërisë e të shqiptarëve nuk përbën vetëm një garanci më shumë për hetimin e 21 janarit. Ajo **përbën** edhe një detyrim më shumë të institucioneve të drejtësisë e të vetë politikës shqiptare për ta merituar këtë mbështetje kaq të vyer, **duke përmbushur** standardet e një drejtësie të denjë për vizionin e për vlerat që partneri ynë i pazëvendësueshëm mishëron si simbol i përbotshëm demokracie dhe me plot të drejtë kërkon prej të gjithëve ne **në funksion të një** Shqipërie demokratike.

Nga ana e Partisë Socialiste dhe forcave të opozitës së bashkuar, unë Ju garantoj gjithashtu për mbështetjen tonë pa kushte në këtë hetim, për suksesin e plotë të të cilit kemi qenë dhe **jemi tërësisht në dispozicion** të organit të akuzës.

Kërkesën Tuaj për përfshirjen në hetim të tre deputetëve socialistë e kemi pranuar pa asnjë ngurrim dhe **ju siguroj** se do të japim votën tonë në parlament që imuniteti i tyre të mos përbëjë pengesë për ekzigjencat e një hetimi shterues e të paanshëm. Të njëjtën gjë do të bëjmë edhe nëse nevojat e hetimit do të kërkojnë përfshirje deputetësh të tjerë të Partisë Socialiste.

Por në këtë pikë e shoh të udhës t'ju bëj publikisht një pyetje dhe një shpjegim nga këndvështrimi im si kryetar i Partisë Socialiste e në këtë rast edhe organizator i demonstratës së 21 janarit.

Pse zonja Prokurore e Përgjithshme nuk jam thirrur ende unë vetë, **pikërisht në cilësinë e Kryetarit të Partisë Socialiste e të opozitës dhe për rrjedhojë** edhe të koordinatorit të të gjitha përgatitjeve të asaj demonstratë, për organizimin e së cilës të tre deputetët e kërkuar prej jush nuk kanë bërë as më shumë e as më pak se të gjithë kolegët e tyre e, padyshim, asgjë më shumë se sa unë personalisht?

Jam i bindur se dëshmia ime do të vlente për hetimin tuaj jo më pak se dëshmitë e tyre. Prandaj pres me padurim që të thirrem për të kontribuar me gjithçka di për këtë hetim kaq të rëndësishëm për drejtësinë në Shqipëri, e për vetë Shqipërinë në rrugën e mundimshme të ndërtimit të shtetit të së drejtës.

Dua të besoj se ju do ta çmoni seriozisht këtë shprehje vullneti nga ana ime për ta ndihmuar hetimin dhe nuk do të ngurroni të më rendisni edhe mua në radhën e të hetuarve. S'kam asnjë imunitet dhe mbi të gjitha asnjë dallim nga të tre deputetët në fjalë apo nga cilido tjetër që, njësoj si ata, ka qenë pjesë e organizimit të demonstratës së 21 janarit.

Më anë tjetër, vjen natyrshëm edhe një pyetje e pandarë nga e para, të cilën dua t'ju bëj po publikisht.

Cila është pse-ja e mospërfshirjes në hetim të kryeministrit Sali Berisha dhe ish-Ministrit të Brendshëm Lulëzim Basha, si dy hallkat më të larta të zinxhirit të komandës së Gardës së Republikës e si përgjegjës të drejtpërdrejtë për funksionimin e asaj garde që në 21 janar vrau njerëz të pafajshëm?

E pamundur **të kuptohet nga ana jonë**, por me sa kam vënë re edhe nga ana e opinionit të shqetësuar publik, mbetja e hetimit në nivelin politik tek vetëm tre deputetët opozitarë. Megjithë gatishmërinë e tyre të plotë ata s'mund ta përmbushin dot assesi nevojën e një hetimi shterues të të gjithë nivelit politik, që as mund të ndahet nga hetimi e as mund të hetohet pjesërisht.

Pranoni paraprakisht ndjesën time nëse kjo kërkesë e prokurorisë për imunitetin e vetëm tre deputetëve opozitarë, nuk është fundi po vetëm fillimi i hetimit mbi rolin e palëve e të aktorëve politikë për gjithë sa ndodhi në 21 janar në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”.

Më tutje akoma zonja Prokurore e Përgjithshme, ju me siguri jeni në dijeni të dëshmisë rrëqethëse, publike, të vëllait të njërit prej të vrarëve, të ndjerit Hekuran Deda, i cili ka denoncuar publikisht kryeministrin Sali Berisha për një ofertë tronditëse në adresë të familjes Deda. Besoj se edhe kjo dëshmi e bën të domosdoshme marrjen në pyetje të Sali Berishës, bashkë me dorëzanin e tij që ka premtuar tek familja Deda në emër të Sali Berishës jo vetëm para, por dhe fotografinë e vrasësit të Hekuranit në këmbim të favorit të mikpritjes në shtëpi të kryetarit të qeverisë.

Shqipëria meriton të dijë të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe asgjë tjetër përveç të vërtetës. Të njëjtën gjë meritojnë padyshim edhe miqtë e partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë. Sepse, në opinionin tim modest, e vërteta e plotë e 21 janarit nuk është thjesht e vërteta e një ngjarjeje tragjike, por një gur themeli në procesin e demokratizimit të vendit tonë e të garantimit të barazisë para ligjit për vitet e ndoshta dekadat që vijnë.

Jam plotësisht i vetëdijshëm për barrën Tuaj shumë të rëndë në kushtet kur rendi ligjor në Shqipëri është thellësisht i kompromentuar dhe hetimi seriozisht i penguar nga dëmtimi i

qëllimshëm i provave, ashtu siç jam i vetëdijshtëm edhe për të gjitha ngarkesat e pamërituara që ka vënë mbi supet e organit të akuzës politike e përbaltjes së pakursimtë të institucionit të prokurorisë e të vetë **autoritetit Tuaj kushtetues**, përveçse dinjitetit Tuaj njerëzor. Të tilla pengesa të pashembullta e ngarkesa të jashtëzakonshme s'ka dyshim se nuk e lehtësojnë kryerjen e detyrës nga ana e prokurorisë dhe **Juaja personalisht**. Por misioni i lartë që keni ndaj popullit shqiptar përmes Kushtetutës së tij e bën praktikisht të pamundur në këtë rast uljen e nivelit të hetimit për sa u takon palëve e aktorëve politikë.

Ata duhet të hetohen që të gjithë, **pa dallim e pa anshmëri**, pavarësisht fuqisë aspak të vogël propagandistike dhe jo vetëm propagandistike që njëra palë, fatkeqësisht ajo në pushtet, i kundërvë prej një viti këtij procesi kaq të rëndësishëm hetimor duke sulmuar egërsisht prokurorinë **e ju personalisht**.

Duke ju siguruar edhe njëherë për mbështetjen pa asnjë **ekuivok** që opozita shqiptare dhe unë si kryetari i saj do t'i japim deri në fund organit të akuzës, **lejomëni zonja Prokurore e Përgjithshme që bashkë me konsideratën time më të lartë t'ju shpreh publikisht edhe besimin** se kërkesa logjike për të mos lënë jashtë hetimit të plotë nivelin politik të vendit, do të çmohet nga prokuroria si një domosdoshmëri e patjetërsueshme në rrugën e nxjerrjes në dritë të të gjithë të vërtetës së 21 janarit tragjik.

Punë të mbarë në misionin Tuaj të vështirë dhe sukses në këtë përpjekje që së fundmi i ka dhënë publikut shqiptar rezultate inkurajuese për zbardhjen e krimeve të asaj dite, e cila jo vetëm s'duhet të përsëritet më kurrë po mund dhe duhet të shërbejë **si një pikë kthese për shtetin e së drejtës në Shqipëri**.

Me shpresë dhe respekt,

Edi Rama

Kryetar

Më poshtë letra e plotë dërguar Presidentit Bamir Topi

Shkelqësisë së tij, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z. Bamir Topi

Shkelqësia Juaj, Z. President

Tashmë është bërë e qartë situata e terrorit dhe rrezikut për **spastrim të ri etnik** në pjesën veriore të Mitrovicës. Sulmi i datës 8 prill 2012 ndaj familjes Haradinaj pati për pasojë vdekjen e Selver Haradinajt dhe plagosjen e fëmijëve të tij. Të nesërmen, në të njëjtën lagje, u mor peng polici i Kosovës, u përzë patrulla policore dhe u shkatërrua pika e saj statike, kurse gazetarët u sulmuan dhe pati dhunë ndaj tyre. Të gjitha këto janë më se të mjaftueshme për ta provuar qëllimin e **strukturave armiqësore e kriminale** të Serbisë në veri të lumit Ibër.

Siç e dini, Republika e Kosovës nuk mundet që këtë çështje ta iniciojë për diskutim në organizata apo struktura ndërkombëtare si OKB dhe NATO.

Ndërsa Ju, si përfaqësuesi i Republikës së Shqipërisë dhe i shqiptarëve në OKB dhe NATO, mundeni që ta **inicioni** diskutimin mbi rrezikun e afërt të spastrimit etnik të shqiptarëve në Mitrovicë.

Nevojitet pra, veprim politik e diplomatik kombëtar, para se përmasat e spastrimit më të ri etnik ndaj shqiptarëve në pjesën veriore të Mitrovicës, të ngjajnë me ato të viteve 1998, 1999 dhe 2000.

Ndihma Juaj në këto momente është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme.

Me respekt dhe mirënjohje,

Albin

Kryetar

i

Lëvizjes

Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Prishtinë, 10 prill 2012

Kurti

VETËVENDOSJE!

Letra e plotë e Nanos

Të dashur socialistë, u bënë 21 vite që ne jemi bashkë. U bënë 21 vite që ne së bashku përpiqemi me atdhedashuri e përkushtim që ta transformojmë Shqipërinë tonë në një vend të merituar e të denjë europian. Gëzuar së bashku 12 Qershorin, festën e themelimit, festën e të gjithë Socialistëve të mirë e të ndershëm.

Asgjë dhe askush nuk ka mundur të **na ndajë ne** nga njëri-tjetri **socialistë të dashur** e të shtrenjtë. **Së bashku** kemi bërë beteja të mëdha e kemi fituar beteja të mëdha, **së bashku** e kemi reformuar dhe transformuar Shqipërinë, duke e kthyer nga një vend diktatorial e i pazhvilluar, në një vend demokratik, me zhvillim në rritje dhe me përqsasje gjithnjë e më të madhe me një vend europian. **Së bashku** kemi fituar disa zgjedhje parlamentare dhe lokale dhe e kemi qeverisur me shumë dashuri, **devocion** e shpirt transformator Shqipërinë në nivel qendror dhe lokal.

Ne së bashku ngritëm standarte të reja, ndërtuam modele të reja, ndërtuam vlera e histori të cilat ende dhe sot mbeten të paarritshme dhe të pakonkurueshme nga kundërshtarët tanë politikë.

Unë ju bëj thirrje të dashur socialistë që ne të vazhdojmë të ecim bashkë, të fitojmë bashkë e ta qeverisim dhe transformojmë Shqipërinë bashkë. Unë jam tashmë para jush i gatshëm për t'ju udhëhequr drejt fitoreve të reja.

I vetmi që **na ndan ne** sot është vetëm ai njeri që e quan veten Kryetar të Partisë Socialiste, edhe pse ai që ditën që **ka vënë këmbë** në krye të partisë sonë, ka shkaktuar veç **humbje, humbje, dhe humbje**. Edi Rama sot ju ka shkaktuar juve të dashur socialistë **humbjen** e rradhës.

Beteja, qëndrimi dhe strategjitë e tij noprane, pamend dhe **prej arlekini**, i dhuruan Sali Berishës fitoren e rradhës, **duke i lënë fushë të lirë** Berishes që ta zgjedhi vetë Presidentin që donte.

Unë prej muajsh e javësh i ofrova Edi Ramës **dorën e bashkëpunimit** dhe bashkimit, por Edi Rama e refuzoi me këmbëngulje. I kërkova të kalonim **nga zona e mosmarrëveshjeve tek zona e marrëveshjeve** për të mirën e socialistëve dhe Shqipërisë, por Edi Rama përsëri refuzoi.

Unë prej muajsh e javësh u përpoqa t'i tregoja e ta këshilloja Edi Ramën se **së bashku** mund të nisim një kohë të re të bashkimit të së majtës, **duke fituar** betejën e parë që kishim në rradhë, por Edi Rama **refuzoi e refuzoi**. **Unë** kërkova mbështetjen dhe mirëkuptimin e Edi Ramës që **së bashku** ta fitonim garën Presidenciale për t'u dhënë shqiptarëve Presidentin më të mirë. Por Edi Rama më **refuzoi** mua, **refuzoi** garën, **nxori** socialistët **jashtë fushe** dhe bëri një **ratifikim hileqar të** fitores së njëanshme të Sali Berishës. **Edi Rama humbi**. Por me këtë humbje të rradhës së Edi Ramës humbëm të gjithë ne socialistët.

Kam ndjekur deklaratat më të fundit të Edi Ramës ku guxon e më drejtohet mua me akuza idiote dhe qesharake. Nuk mundet të mos ndjej zhgënjim të thellë, indignatë dhe refuzim të plotë **ndaj limbos ku vetë Edi Rama ka mbetur. Limboja e Edi Ramës nuk mund të lejojmë të kthehet në limbo të Shqipërisë, të shqiptarëve dhe të socialistëve.**

Ky **paloKryetar** ka guxim e më akuzon mua se **qenkam përdorur** si diversion dhe tallje nga **Qeveria**, në një kohë kur Edi Rama rendi **si bataksi** nëpër natë me një torbë me **ëndrra perverse Kryeministore** drejt Gjirit të Lalzit, ku shiti brenda një nate 4 viktimat e 21 janarit, 26 viktimat e Gërdecit, zgjedhjet e 8 majit, zgjedhjet e 2009, grevën e urisë të dhjetra deputetëve dhe socialistëve, **e mijëra e mijëra** sakrifica madhore që socialistët e mirë dhe të ndershëm kanë bërë për të. Pas darkës së Gjirit të Lalzit, nëse ka patur një njeri që Qeveria e ka përdorur dhe tallur keqazi, ky është **Edi Rama. Edi Rama** ne darkën e Gjirit të Lalzit, por edhe në tryezat me Sali Berishën ka këmbëngulur vetëm tek një **Pazar i ndyrë**: Kushdo le të zgjidhet President, vetëm Fatos Nano të mos zgjidhet. Qeveria e përdori Edi Ramën kundër Fatos Nanos, dhe Edi Rama ia plotësoi dëshirën Qeverisë. Sot President është zgjedhur Ministri i Brendshëm i Berishës, ndërsa **Fatos Nano dhe socialistët kanë humbur, për shkak të** Edi Ramës. **Qeveria u tall** në Gjirin e Lalzit me Edi Ramën sepse me një pjesë të **Qeverisë** i ofruan ngjala për darkë dhe i krijuan iluzionin **idiotesk** se mund të rrëzohej **Qeveria** e të plotësohej **ëndrra perverse** e Edi Ramës për t'u bërë Kryeministër. E tallën dhe **e lanë me gisht në gojë** këtë **humbarak pervers dhe liganak**.

Unë në thirrjet e mia të dy ditëve të fundit i jam drejtuar për mbështetje vetëm socialistëve të vertete, gjithë Partisë Socialiste e cila është **partia e ime e zemrës**, e për asnjë moment Edi Ramës.

Të dashur miq socialistë! U bënë vite tashmë që Edi Rama nuk përfaqëson më socialistët apo interesat e tyre. U bënë vite tashmë që Edi Rama përfaqëson vetëm një klan uzurpator e pervers humbarakësh e frikacakësh që u ka shkaktuar socialistëve vetëm humbje, dhembje e nëpërkëmbje, sikurse e ka zhytur Shqipërinë në kriza të njëpasnjëshme. Edi Rama është mbjellësi i krizave, urrejtjes dhe humbjes. Edi Rama nuk e ka më mundësinë që të jetë Përfaqësuesi, Zëri e aq më pak Lideri i Socialistëve.

Unë nuk mund të lejoj më që socialistët e mi të dashur, Partia Socialiste e cila është partia e zemrës sime, të vazhdojnë të rropaten, rraskapiten, keqpërdoren, sakrifikohen, torturohen nga duart e papërgjegjshmërisë dhe paaftësisë së Edi Ramës i cili di veç të humbasi.

Unë tashmë u vetëofrohem të gjithë socialistëve dhe popullit opozitar që së bashku të marrim fatet e Partisë Socialiste dhe të Shqipërisë në duart tona e të mos lejojmë më që humbjet e parreshtura të socialistëve të kthehen në humbje për Shqipërinë, nëpërkëmbja e socialistëve të kthehet në nëpërkëmbje për Shqipërinë, kriza e Edi Ramës të qëndrojë si kërcënim e ndëshkim krizash për Shqipërinë.

Unë shpreh e ritheksoj edhe njëherë mirëbesimin tim, e i bëj thirrje Partisë Socialiste, Kryetarit të Grupit Kuvendor të PS Gramoz Ruçi, dhe drejtpërdrejtë të gjithë deputetëve të PS që në këto momente kaq të rëndësishme për fatet e Shqipërisë të bëhen dalëzotsa, të rigjejnë dinjitetin, të marrin vendime të drejta në tejkalimin e këtij ngërçi politik të stërzgjatur.

Mos lejoni që një aventurier humbarak e liganak si Edi Rama t'ju tërheqë zvarrë e t'ju nëpërkëmbë dinjitetin duke ju zhytur juve dhe Partinë Socialiste por edhe Shqipërinë në krizën e padijes, paaftësisë, pamundësisë, dhe perversitetit të tij politik.

U drejtohem sot drejtpërdrejt gjithë te zgjedhurve te Partisë Socialiste, ne gjithë Shqiperine, gjithë socialisteve dhe perfaqesuesve te popullit opozitar, që të ngrihen përmbi këtë realitet të zymtë, dekurajues, humbës por edhe dëmtues për fatet e Shqipërisë e për integrimin european, ku e ka katandisur PS-në, Kryetari aktual Edi Rama.

Edhe pasi kisha vendosur ta mirëbesoja deri ditën e sotme Edi Ramën, zhgënjimi dhe rizhgënjimi im i vazhdueshëm i shprehur ndër vite, ka vetëm një arsye: Edi Rama e ka braktisur popullin opozitar. Zyra e tij është shndërruar në një zyrë të prodhimit të politikave të krizave e konfliktualitetit, urrejtjes dhe përplasjes, mohimit dhe zhbërjes së historisë së Partisë Socialiste dhe të zhvillimeve pozitive transformuese në Shqipëri, duke e dëmtuar

rëndë Shqipërinë, shqiptarët dhe vetë socialistët. Edi Rama **ka broçkollitur** papushim këto ditë e javë **kinse për** konsensus, ka bere sikur ka kërkuar konsensus në një kohë kur e vërteta e hidhur është se ai ka braktisur në mënyrën më skandaloze, më të pashpirtë dhe më të papërgjegjshme viktimat e 21 Janarit. **Sot pas 1 viti**, me 4 shqiptarë të vrarë dhe të tradhëtuar mbi shpinë, Edi Rama kërkon të bëhet Kryeministër, duke i lënë ata në harresë, e duke shmangur garën e Presidentin, e **duke mbajtur peng** të gjitha **zgjidhjet e zgjedhjet** e nevojshme që duhet të bëjë Shqipëria për të marë **statusin Kandidat.**

Edi Rama nuk e përfaqëson më Partinë Socialiste. Edi Rama përfaqëson njeriun aventurier i cili ka uzurpuar Partinë Socialiste, të cilën e ka keqpërdorur për interesat e tij të ngushta dhe **klienteliste,** banale, perverse dhe informale. Edi Rama e ka drejtuar Partinë Socialiste me sukses të plotë **nga humbja në humbje.** *Të nderuar te zgjedhur socialistë, të dashur socialistë, ju bëj thirrje që të mos e lejoni paaftësinë dhe pamundësinë e Edi Ramës për të fituar, që të kthehet në sëmundje e gjendje të përhershme për Partinë Socialiste, por edhe në një pengesë madhore për zhvillimin dhe integritetin e Shqipërisë.*

Së bashku me mua keni fituar gjithmonë dhe e keni mundësinë të vazhdoni të fitoni. **Nderojeni** historinë dhe traditën tonë të përbashkët fituese por edhe transformuese pozitive në mënyrë që së bashku të bëjmë fituese Shqipërinë.

U shpreh mirënjohjen të gjithë atyre përfaqësuesve të Partisë Socialiste, por edhe të zgjedhurit e saj në Komuna e Bashki, nga çdo cep i Shqipërisë, të cilët këto ditë me kanë shprehur solidaritetin dhe mbështetjen e plotë për Projektin tim fitues. **Me Fatos Nanon fiton e majta, fitojnë socialistët, fiton edhe Shqipëria.** **Të nderuar deputetë të Partisë Socialiste** tejkalojeni, refuzojeni sistemin e **vullneteve të ndrydhuna** që ka **instaluar** Edi Rama në Partinë tonë të përbashkët që kur kemi qenë bashkë ka qenë liberale, demokratike dhe fituese. **Bëhuni dalëzotsa dhe së bashku** me Fatos Nanon **fitoni për Partinë Socialiste dhe Shqipërinë.**

Ngrihuni përtej limbos së Kryetarit aktual Edi Rama, dhe bëjeni Partinë Socialiste dhe Shqipërinë fituese me Fatos Nanon. Sistemi humbës që ka **instaluar** Edi Rama duhet shembur dhe ndryshuar. **Të bëhemi bashkë që të fitojmë bashkë!** *Gëzuar festën e themelimit!*